




AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

EMIGRACIONI POLITIK SHQIPTAR NË VITET 1944-1990

Konferencë Ndërkombëtare Shkencore





AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

EMIGRACIONI POLITIK SHQIPTAR NË VITET 1944-1990

Tiranë, 2021

Përgatitën për botim

Dr. Valbona Pllaha

Dr. Ornela Arapi

Koordinatorë e publikimeve

Ardita Repishti

Redaktore gjuhësore

Elona Driza

Design

Onufri

ISBN

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë rrethanë si pasqyrim i qëndrimit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Tiranë, 2021

Përmbledhje e kumtesave dhe referateve të mbajtura në
Konferencën Ndërkombëtare Shkencore të organizuar nga:

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet
e ish-Sigurimit të Shtetit,

në bashkëpunim me

Institutin e Historisë pranë Akademisë
së Studimeve Albanologjike,

Institutin për Studimin e Krimeve dhe
Pasojava të Komunizmit,

Institutin e Integritit të Ish të Përndjekurve Politikë

Muzeun Historik Kombëtar

Ministrinë e Punëve të Jashtme

PËRMBAJTJA

Emigracioni politik shqiptar '44-'91 Dr. Gentiana Sula Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit	8
Z. Pandeli Majko Ministër i Shtetit për Diasporën	16
Z. Brian J. Williams Koordinator i Përhershëm i OKB-së	20
Z. Bernd Borchardt Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri	24
Prof. dr. Hamit Kaba Emigracioni politik shqiptar në SHBA pas luftës së dytë botërore dhe raportet e tij me emigracionin e vjetër	28
Prof. asoc. dr. Enriketa Pandelejmoni “Kriminelët e luftës”: Emigracioni politik shqiptar në Itali dhe raporti me shtetin komunist shqiptar 1945-1955	40
Ma. Leonora Laçi Komiteti Kombëtar “Shqipëria e Lirë” dhe veprimtaria e emigracionit në vitet 1949-1953	60
Prof. asoc. dr. Pranvera Teli (Dibra) Epilogu i një diktature. Nga “terrorist” në “të padë- nueshëm” i ndante vetëm një det. Rrëmbimi i pesh- karexhës “Dukati” për arratisje në Itali, 6 janar 1989	82

Dr. Gjon Boriçi “Përpyekjet e Sigurimit të Shtetit për të vënë nën kontroll emigracionin politik shqiptar në vitet 1945-1974”	87
Prof. asoc. dr. Afrim Krasniqi Ngjarjet e korrikut 1990 dhe përpyekjet e regjimit për ta minimizuar impaktin e tyre politik	130
Dr. Adriana Duka Dritëhijet e veprimtarisë politike të shkrimtarëve të arratisur	154
Prof. asoc. dr. Enis Sulstarova Emigracioni politik në letërsinë e realizmit socialist	178
Lekë Tasi Emigracioni 1944-1990: për një kthim tek e vërteta faktike në kurrikulat e shkollës	201
MSc. Andrea Llukani Dritëhije mbi veprimtarinë e peshkopëve me origjinë shqiptare Evlogjio Kurilla dhe Pandelejmon Kotoko	218
Msc. ark. Elma NDRECA Refleksione për eksodin e 2 korrikut 1990 dhe “Rrugën e Ambasadave”	230
Foto gjatë zhvillimit të konferencës	252



Dr. Gentiana Sula
Kryetare e Autoritetit
për Informimin
mbi Dokumentet
e ish Sigurimit të Shtetit

Emigracioni politik shqiptar në vitet '44-'91

*Na shajnë e na poshtojnë,
na plasin gjamën:
anmiq t'adheut!
Tradhtarë!
Arshi Pipa, Poezia NEMESIS*

Konteksti historik i Europës së pasluftës

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore përkoi me lëvizje masive demografike në Europë. Miliona gjermanë lanë tokat në Europën Qendrore e Lindore, hebrenjtë lanë vendet e vuajtjes për vende më të sigurta dhe jokomunistët largoheshin që t'u shpëtonin regjimeve të dhunshme komuniste që po vendoseshin në vendet e tyre. Edhe nga Shqipëria pati ikje të konsiderueshme.

Fati i këtyre miliona të zhvendosurve në Europën e prekur

¹ Fjala e hapjes në konferencën ndërkombëtare mbi Emigracionin politik shqiptar në vitet 1944-1990, organizuar nga AIDSSH dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, në bashkëpunim me IH, ISKK, IIPP, 2020.

thellë nga lufta qe shumë i vështirë. Ndonëse Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut u garantonte mbrojtje nga përndjekja dhe nga mohimi i nënshtetësisë, apo Konventa e Gjenevës për refugjatët e vitit 1953, u garantonte të drejtat e riatdhesimit, sërish gjendja e tyre mbetej krejt e paqartë, sidomos sepse, - pas kapjes së vendeve të Europës Qendrore e Lindore nga komunistët, - ata i rezistuan riatdhesimit në masë të madhe, duke tentuar të zhvendoseshin në SHBA.

Vetë politikat migratore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës u përcaktuan në atë kohë nga konfliktet që buruan nga Lufta e Ftohtë. Kështu, në 1948, një akt për të zhvendosurit dhe një program i posaçëm “për të ikurit” u ofronte një vend (hapësirë) të qetë banimi të larguarve nga regjimet komuniste.

Thellimi i konfliktit Lindje-Perëndim dhe vitet e para të Luftës së Ftohtë krijuan kontekst të mjaftueshëm për një tjetër reformë legislative në SHBA, ligjin e shpëtimit të refugjatëve, që në vitin 1953 lejoi pranimin - përgjatë tre viteve,- të 214 000 refugjatëve, ku thuhetse 70% vinin nga vendet komuniste.

Në 1959, disa refugjatë të cilësuar “të vështirë”, vazhdonin të jetonin në kampet e Europës. Ishte koha kur Kombet e Bashkuara lançuan projektin e tyre ambicioz, duke e shpallur vitin 1959-1960 *Vitin Botëror të Refugjatëve* e duke synuar kështu mbylljen përfundimtare të kampeve të refugjatëve në Europë. Besojmë se me pak përjashtime, të ikurit nga Shqipëria i përkisnin pikërisht kategorisë së fundit.

Situata në Shqipëri

Vetëm në vitin 1959 u kalua një dekret në formë amnistie për të arratisurit, nga i cili u përjashtuan në atë kohë rreth 208 persona, që u cilësuan si “*kriminelë lufte*”. Në fakt, ky dekret duket se nuk krijoi besueshmëri, sepse gjatë gjithë periudhës '44-'91 u riatdhesuan

“

Rreth 13 600 persona u numëruan të arratisur në raportet e Sigurimit të Shtetit, nga 1944 deri në vitin 1990, pa llogaritur të larguarit e ambasadave në korrikun e '90-s. Nga këta, rreth 4 784 ishin gra e fëmijë. Dominonin të ikurit e viteve 1945 e 1948. Rreth 998 të tjerë vdiqën ose u vranë nga regjimi në përpjekjen për t'u larguar nga vendi.

”

janë, në fakt, edhe imazhet më të fuqishme të denoncimit të një sistemi jonjerëzor.

Për shumë nga ne, kjo periudhë mund të duket e largët, nëse nuk e lidhim drejtpërdrejt me histori njerëzore.

vetëm 60 persona². Duket se të arratisurit kishin pasur të drejtë, sepse stigma “i arratisur”, i hoq vetëm rreth 190 vetave. Për të tjerët dhe familjet e tyre, Sigurimi i Shtetit vendosi një regjim të rreptë mbikëqyrjeje dhe represioni.

Rreth 13 600 persona u numëruan të arratisur në raportet e Sigurimit të Shtetit, nga 1944 deri në vitin 1990, pa llogaritur të larguarit e ambasadave në korrikun e '90-s. Nga këta, rreth 4 784 ishin gra e fëmijë. Dominonin të ikurit e viteve 1945 e 1948.

Rreth 998 të tjerë vdiqën ose u vranë nga regjimi në përpjekjen për t'u larguar nga vendi.

Sipas raportimeve, ikjet u tentuan më shumë nga Gjirokastra, 1399; nga Shkodra, 924; Saranda, 859; Korça, 729, Kukësi, 777; Vlora, 436; Dibra, 520; Tropoja, 402, e më pas Tirana, 333 veta; Erseka, 214; Pogradeci, 178; Puka, 184 e Durrësi, 161.

Rreth 4 785 veta u larguan me ambasadat, me valën e parë të 2 korrikut 1990. Me tej shteti filloi të emetonte pasaporta dhe të lejonte daljen nga Shqipëria, përmes ikjeve masive që

² Të dhënat janë marrë nga raporti për emigracionin në Shqipëri, përpiluar nga Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 1990.

Është fakt që shumë prej tyre jetojnë dhe kanë akoma shumë pyetje për të cilat kërkojnë përgjigje: për fatet e tyre, për stigmën e “të arratisurit”, apo për futjen “në një thes”, si të implikuar me pushtuesit gjatë Luftës së Dytë Botërore.

E vërteta është që si kolaboracionistë u listuan vetëm 200 prej tyre.

Dua të ndaj me këtë rast, historinë e jashtëzakonshme të një zonje të nderuar, Mri Mrnaçaj.

Mrinë e takuam në Nju Jork, ku na priti si sovranë, e rrethuar nga “oborri” i saj, me djem e vajza, nipër e mbesa. Një familje patriote që i dha jetë dhe e ushqeu lëvizjen për të drejta kombëtare dhe liri në Amerikë. Dosjet e Sigurimit për personazhet e kësaj sage po zbardhen.

Historia e saj e rrallë zë fill në moshën 5-vjeçare, ku u detyrua të largohej nga trojet e traeshëguara në malësi, ku i ati ishte bajraktar i njërit prej fiseve, duke e lënë në flakë kullën ku u rrit, me të atin që digjej tragjikisht brenda. E gjitha, sepse bindjet e familjes së bajraktarit dhe gjinisë nuk përputheshin me mënyrën se si e mendonte jetën dhe progresin udhëheqja komuniste e kohës. Mënyra e jetesës dhe patriarkalizmi i tyre e sistemi i ndërveprimit në malësi, që i rezistoi edhe pushtuesit osman, i vuri në përballje për jetë a vdekje me “forcat e ndjekjes”, ose me të vetmen alternativë: largimin pa kthim nga vendi për këdo që do të mundej.

Mrija ka dëshmuar për platformën “Edhe muret kanë veshë” një histori që veshët tanë nuk kanë mundur ta dëgjojnë më parë, për shkak të izolimit dhe largësisë, ndonëse shtëpia e saj, edhe sot, është një copëz Shqipërie në Shtetet e Bashkuara, në konceptin kulturor.

Mrija tregon historinë e endjes pa atdhe për më shumë se 10 vjet në kampet e Europës, deri në vendosjen përfundimtarë në Amerikë.


Historinë e dhimbjes për humbjen e njerëzve të dashur, ndarjen nga familja, nga trojet e lashta ku u lind, u rrit dhe u martua, në moshën 16-vjeçare...

Si Mrija në SHBA, në komunitetet shqiptare në Belgjikë, Zvicër, Egjipt, Itali, Gjermani, etj., kemi ndeshur gjurmë të vuajtjes së mohimit të atdheut, të ankthit për përndjekjen e familjes që mbeti pas, që u internua në kampet me gjemba, të punës së detyruar apo në fushat e Myzeqesë, duke e vuajtur në breza cilësimin e “armikut të popullit’ apo “agjentit të shtetit të huaj”, meqë kishin të bënin me një apo më shumë “të arratisur”.

Shpeshherë, edhe sot e kësaj dite, ata përballen me pamundësinë e qasjes në regjistrin e gjendjes civile, në nënshtetësi, në banesë, pronë apo sende vetjake.

Po ashtu përballen me nevojën për ta kuptuar vetë fatin e vet, si dhe për t’u mirëkuptuar në një komb të cilit i përkasin, me shumë përkushtim e dëshirë. Me nevojën për t’u njohur përpjekjet dhe sakrificat e familjeve të tyre për liri e të drejta kombëtare, në mënyrën që e menduan dhe punuan ata.

Duke përdorur të dhënat e raporteve të Sigurimit të Shtetit mbi emigracionin politik, na paraqitet ky dimension dhe kjo dinamikë e emigracionit politik ndër vite:



Studime të tjera do të duhen që të nxitet debati publik, studime të bazuara në dokumente dhe fakte, me filtrin e një disipline të fortë shkencore dhe me qasje shumëdimensionale, duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve:

1. Cilat janë veçoritë e krijimit të emigracionit politik shqiptar gjatë viteve 1944-1990? Cila qe shtrirja gjeografike e emigracionit politik shqiptar; kampet e emigrantëve në Europë? Cilat janë disa nga profilet e emigrantëve politikë të spikatur dhe veprimtaria e tyre?
2. Cila qe veprimtaria e emigracionit politik shqiptar për mbrojtjen e interesave kombëtare shqiptare dhe veprimtaria e tyre për të luftuar regjimin komunist në Shqipëri? Cilat ishin shoqatat e krijuara nga emigracioni politik shqiptar dhe qasja e tyre kundrejt Shqipërisë komuniste? Operacioni "Rollback" dhe përfshirja në të e emigracionit politik shqiptar?
3. Si reagoi shteti komunist shqiptar ndaj emigracionit politik shqiptar? Si ndikoi Lufta e Ftohtë, marrëdhëniet e shtetit shqiptar me jugosllavët, grekët dhe italianët? Si punoi Sigurimi i Shtetit me emigracionin shqiptar dhe me familjet e tyre në Shqipëri?
4. Kush tentoi dhe cilat ishin mënyrat që u përdorën për kalimin e kufirit? Sa prej tyre u vranë dhe u plagosën? Si u trajtuan personat që u kapën në kalim kufiri? Cili ishte konteksti ligjor për vrasjet tragjike në kufi?

Për këtë duhet të përdoren burime arkivore të kryqëzuara dhe dëshmi gojore të mbledhura, sipas metodologjive me bazë shkencore, nga institucione të specializuara.

Studimet do të zhvillohen përmes përdorimit të dy burimeve: arkivit dhe dëshmimeve.

Arkivi

Pranë arkivit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ruhet dhe administrohet një larmi dokumentesh arkivore, që përmbajnë dhe trajtojnë informacione e të dhëna rreth emigracionit politik shqiptar, të arratisurve jashtë vendit, grupeve diversante, organizatave të ndryshme politike të krijuara nga emigracioni shqiptar në Europë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vende të tjera. Këto dokumente konsistojnë në raporte, statistika dhe informata mbi veprimtarinë e emigracionit shqiptar në vende të ndryshme, relacione dhe raporte mbi bandat e diversantët që operonin kryesisht në Jugosllavi, Europë, SHBA, etj., relacione dhe statistika për të arratisurit, të dhëna dhe dosje për emigrantët politikë e ekonomikë, etj.

Dokumentet e mësipërme përlllogariten të jenë afërsisht 90 mijë dosje e fashikuj dhe i përkasin periudhës 1944-1991. Shumica prej dokumenteve bëhen publike për herë të parë për qytetarët dhe studiuesit, në këtë konferencë për emigracionin.

Dëshmitë gojore

Që në 2018, Autoriteti me partnerë ka ndërmarrë projektin e mbledhjes së dëshmimeve gojore të të mbijetuarve të përndjekjes nga Sigurimi, në mbështetje të platformës së krijuar për këtë qëllim “Edhe muret kanë veshë”. Marrëveshja e Autoritetit me Zërin e Amerikës dhe bashkëpunimi me Federatën Panshqiptare “Vatra” ka mundur realizimin e intervistave me të arratisur në Shtetet e Bashkuara, të përndjekur nga Sigurimi i Shtetit, dëshmitë e të cilëve janë depozituar pranë arkivit digjital të Autoritetit. I njëjti projekt vijon në Belgjikë, në bashkëpunim

me komunitetin shqiptar atje, e do të synojë edhe bashkësinë shqiptare në Gjermani, në këtë garë me kohën!

Në shifrat e larta të emigracionit të shqiptarëve në shekuj, si dhe gjatë tranzicionit të zgjatur, kjo përmasë duket vetëm një fraksion.

Por ky fraksion është shumë i rëndësishëm për vendin tonë. Të integruar tërësisht në shoqëritë pritëse, sot emigrantët “e arratisur” përfaqësojnë ura të forta komunikimi me vendet më të zhvilluara dhe me aleatët tanë. Ata nuk reshtën së dashuri Shqipërinë dhe së qeni aktivë, në forma të ndryshme, për të denoncuar shkeljet e të drejtave të njeriut në Shqipërinë komuniste dhe duke ngritur zërin për të drejtat kombëtare.

Shoqëria shqiptare u detyrohet atyre për heqjen e baltës, për qartësimin e fatit dhe njohjen e kontributeve!

Bibliografi

Kampi i Tepelenës, Dëshmitë e të mbijetuarve. (2018). Tirana: AIDSSH.

Kur Sigurimi merrej me shkencë. (2019). Tirana.

Raporti Vjetor: Raportimi i parë. (2017). Tirana: 2017.

Të mohuar nga regjimi: Mbi sistemin e burgjeve, internimit dhe punes se detyruar gjate regjimit komunist ne Shqiperi, 1945-1990. (n.d.). (2018) Tirana. Instituti i Historisë, AIDSSH. ISKK.



Z. Pandeli Majko Ministër i Shtetit për Diasporën

Të nderuar pjesëmarrës,

Shqiptarët migracionin e kanë një cilësi kolektive, por edhe tregues të raporteve të tyre me historinë kombëtare.

Historia e migracionit shqiptar gjatë periudhës 1944-1990 përfaqëson një raport të rëndësishëm të kombit shqiptar me kohën. Ajo është ende e pashkruar. Ky vlerësim vjen edhe pse historianët kanë një prirje neglizhuese karshi së vërtetës kontroverze. Ata duan që renditja e fakteve të jetë një “prozë” me personazhe pozitive dhe negative.

Më lejoni që pamjen e një historie kontroverze ta filloj me një “sekret” të familjes sime. Familja ime ishte e lidhur me LANC-in. Por në periudhën komuniste në biografinë e anëtarëve të familjes mungonte një anëtar i saj. Ai ishte xhaxhai i tim ati. Ai ishte shtetas i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vetëm përmendja e tij anësore mund të hapte probleme të paparashikuara për familjen. Pohimi për pasjen e një familjari në Perëndim ishte thujse një “njollë” në biografi.

Komunizmi në Shqipëri në pamjen e jashtme ishte “shfaqje” e gjatë groteske. Në fund, ajo që mbeti ishte pasqyra për të parë veten.

Xhaxhai i tim ati u përpoq pas Luftës të vendoste lidhjet me familjen nëpërmjet UNRRA-s e përfaqësuesve shqiptarë të saj në Gjirokastrë. Prishja e marrëdhënieve të regjimit komunist që po vendosej në Shqipëri me Shtetet e Bashkuara të Amerikës solli edhe arrestimin e shqiptarëve që punonin për UNRRA-n.

Që të kuptoni tmerrin e familjes sime për “xhaxhain amerikan” mjafton t’ju them se ata i dogjën të gjitha fotot e tij dhe ndaluan çdo bisedë për të. Në vitin 1952 kjo ishte një arsye më shumë pse ata vendosën të shpërnguleshin dhe të vendoseshin nga Gjirokastra në Tiranë. Shqipëria përjetoi një nga regjimet komuniste më të egra dhe ajo çka vlen të theksohet ishte izolimi si konkluzion. Kontaktet politike dhe sociale me vendet e tjera, madje edhe ato komuniste, u shkëputën.

Cjatë periudhës së regjimit komunist migrimi jashtë Shqipërisë konsiderohej si një akt tradhtie dhe si i tillë ndalohej me ligj. Por, pavarësisht masave të vendosura nga shteti komunist, pati nga ata që guxuan dhe të largoheshin. Një numër shqiptarësh që konkurron viktimat e Murit të Berlinit dhanë jetën në përpjekjen e tyre drejt lirisë.

Emigrimi më i lartë nga Shqipëria ndodhi pikërisht në vitet e para, pas Luftës së Dytë Botërore. Në pjesën më të madhe kundërshtarë politikë të qeverisë së re të sapodalë nga lufta u larguan në kampet e refugjatëve në Greqi, Itali e Jugosllavi, para se të shpërnguleshin në destinacionet përfundimtare, të zgjedhura ose jo nga autoritetet vendase. Në mesin e viteve 1950

“

Komunizmi në Shqipëri në pamjen e jashtme ishte “shfaqje” e gjatë groteske. Në fund, ajo që mbeti ishte pasqyra për të parë veten.

”

fillim i viteve 1960 një grup i parë i emigrantëve të kësaj periudhe mbërriti në tokën amerikane.

Sipas statistikave amerikane, gjatë viteve 1931-1975 janë rreth 2500 (2.438) shqiptarë që janë vendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndërsa gjatë viteve 1983-1990 rreth 300 shqiptarë kanë arritur të shkelin në tokën e lirisë amerikane.

Do të ishte pikërisht ky grup i larguar në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist ai që do t'i shërbente lëvizjes antikomuniste të shqiptarëve në Amerikë, ku deri në vitin 1967 kishte prurje të refugjatëve shqiptarë drejt Amerikës nga kampet Italisë, Greqisë dhe Jugosllavisë. Sipas të dhënave, migrimet e fundit mund të kenë qenë ato të fillimit të viteve 1970, të ardhura nga kampet e Jugosllavisë, të cilave iu shtohen ato nga shqiptarë të Kosovës, Malit të zi, Maqedonisë së Veriut dhe rajonit të Luginës.

Ka të dhëna se një kategori tjetër, prej rreth 400 shqiptarësh, emigruan drejt Australisë në vitet e para që pasuan vitin 1944. Në mënyrë të ngjashme, një kalvar tjetër refugjatësh shqiptarë prej 150-200 vetash mbërriti në Belgjikë në vitin 1956. Në vitin 1967 në Belgjikë numëroheshin rreth 800 refugjatë shqiptarë.

Për ata që, në fjalorin e kohës, "arratiseshin" nga Shqipëria, masat ndëshkimore të vendosura nga regjimi nuk preknin vetëm individët, por edhe familjet që linin pas. Gjatë viteve 1950-1989 mundën të largoheshin nga Shqipëria rreth 20 mijë shtetas shqiptarë.

Diaspora shqiptare prodhoi autoritetet e veta. Ato u vendosën pranë emrave të diasporës më të vjetër, si Faik Konica dhe Fan Noli. Nga opozicioni antikomunist figura e Ahmet Zogut ruajti qëndrueshmëri konstante.

Në dëshminë e Hamit Matjanit kam lexuar se ai përmend një shtetas amerikan që dinte shqip: "...Për Majkon... Rrinte civil, gradën nuk ia mora vesh, ishte në moshën 30-35 vjeç, mesatar i trashë, syzi dhe flokëzi. Merrej më tepër me krejt përgatitjen e

grupeve që futeshin në Shqipëri dhe gjetkë. Gjithashtu, ky i priste dhe i pyeste këto grupe kur ktheheshin nga ato vende. Edhe mua me shokët e mi, si kur u nisa, ashtu edhe kur erdha, ky na mori në pyetje.”

Kur pyeta tim atë për këtë individ, ai thjesht më tha të “qepja” gojën. Pas viteve `90 mësova detaje të tjera. Matjani në dëshminë e tij thotë se Majko ishte nga Borova e Kolonjës (ku në dijeninë time aty nuk ka familje me këtë mbiemër) Ai para vdekjes, me sa duket, i bëri shërbimin e fundit njeriut që njihte.

Nuk jam optimist që jeta është një skenar filmash. Di që ajo është e komplikuar dhe shpesh pa përgjigje, por të vërtetat që prodhuan komunizmin në Shqipëri nuk mund të imagjinohen pa klonin e “kufirit”. Ashtu si liria nuk mund të shpjegohet pa diasporën shqiptare.



Z. Brian J. Williams

Koordinator i

Përhershëm i OKB-së

Nëse do të kisha një mesazh të vetëm për të përcjellë sot, ai është se Kombet e Bashkuara besojnë plotësisht se eksplorimi i vërtetë i së kaluarës ka rëndësi të drejtpërdrejtë për përpjekjet e sotme për ndërtimin e demokracisë.

Kombet e Bashkuara janë një organizatë e paqes që u ndërtua mbi tmerret e luftës dhe konfliktit të armatosur. Pas luftërave, OKB-ja filloi menjëherë diskutimin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, duke njohur lidhjen e pandashme midis respektimit të të drejtave të njeriut dhe paqes së qëndrueshme.

Në të njëjtën kohë me miratimin e Deklaratës, OKB-ja gjithashtu filloi të diskutojë një traktat detyrues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Ndërtimi i institucioneve që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe kufizojnë fuqitë e qeverive nuk ishte një punë e lehtë.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut u nënshkrua në vitin 1948 dhe u desh deri në 1954 që të formulohej drafti i parë i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) që iu paraqit Asamblesë së Përgjithshme dhe akoma 12 vite të tjera (1966) që të bihej dakord për tekstin e më tej 10 vite të tjera para se të hynte në fuqi ky traktat ndërkombëtar.

ICCPR është me rëndësi për konferencën tuaj sot. Ajo përfshin të drejtën e lëvizjes së lirë, të largimit dhe kthimit nga një

shtet. Po ashtu përfshin lirinë e besimit politik, të drejtën për një gjykim të drejtë, parandalimin e torturave. Këto janë të gjitha të drejtat që u mohuan në mënyrë të papranueshme nën regjimin e Hoxhës.

Dhe Shqipëria u bë pjesë e ICCPR-së vetëm në vitin 1991.

Kuadri global i sotëm për zhvillim, Agjenda 2030, apo Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) gjithashtu njohin këtë lidhje midis paqes, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

OZHQ 16 ka të bëjë me paqen, institucionet e përgjegjshme dhe drejtësinë.

Çfarë duhet të bëjë Shqipëria për të arritur OZHQ 16?

Duhet të ndërtojë një sistem gjyqësor efikas dhe të pavarur, diçka që tashmë është duke u kryer në një shkallë të jashtëzakonshme.

Por për të arritur OZHQ 16 institucionet e Shqipërisë gjithashtu duhet të jenë të përgjegjshme, dhe kjo përfshin të përgjigjen për krimet e kryera nën regjimin e Hoxhës.

Në vitin 2016, grupi i pavarur i punës nën Këshillin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe Zhdukjet me Forcë vizitoi Shqipërinë. Singerisht ata u befasuan kur zbuluan se nuk po bëhej më shumë për të gjetur dhe për të dhënë një përgjigje për 6.000 persona të zhdukur. Ata vunë në dukje se nuk është ndërmarrë asnjë ndjekje penale e vetme për këto raste të zhdukjeve. Dhe ata bënë thirrje për një proces të gjerë, gjithëpërfshirës të kërkimit të së vërtetës në Shqipëri (dhe këtu dua të nënvizoj dhe të aprovoj gjithçka që kolegu im nga OSBE tha për rëndësinë e trajtimit të së kaluarës dhe drejtësisë së tranzicionit).

“

**Drejtësia
tranzicionale
– një kusht i
domosdoshëm
për të krijuar
institucione të
përgjegjshme dhe
demokratike në
Shqipëri**

”



Në përgjithësi, Grupi i Punës vuri në dukje një ngurrim të vazhdueshëm të Shqipërisë për të adresuar të kaluarën e saj të shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut dhe mungesën e një debati kombëtar gjatë periudhës së diktaturës.

Citoj nga raporti:

“Në përgjithësi, Grupi i Punës vuri në dukje një ngurrim të vazhdueshëm të Shqipërisë për të adresuar të kaluarën e saj të shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut dhe mungesën e një debati kombëtar gjatë periudhës së diktaturës.”

Historia e Shqipërisë është me rëndësi absolute për situatën e sotme. Si mund t’u kërkohet qytetarëve të kenë besim tek institucionet qeveritare nëse ato institucione nuk mund as të ndriçojnë dhe të pranojnë gabimet e tyre të së kaluarës? Të pranosh nuk është një shenjë gabimi, nuk është një veprim dobësie, është një veprim kurajoz. Të qenët i përgjegjshëm për drejtësinë tranzicionale është një kusht i domosdoshëm për të krijuar institucione të përgjegjshme dhe demokratike në Shqipëri.



Kombet e Bashkuara në shumë forma e kanë inkurajuar këtë ide që eksplorimi i së kaluarës dhe e vërteta është e nevojshme për të arritur pajtim. Në vitin

2005, Këshilli i të Drejtave të Njeriut në përpjekje për të luftuar pandëshkueshmërinë krijoi një parim të quajtur:

E DREJTA E PATJETËRSUESHME E MËSIMIT TË SË VËRTETËS.

Unë dua të uroj këtu Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Qeverinë për themelimin e tij. Autoriteti po bën pikërisht atë që këto parime thërrasin, që të orientojnë shoqërinë drejt një debati për të ndriçuar historisë e Shqipërisë. OKB-ja ka qenë një përkrahëse

krenare e Autoritetit që nga themelimi i tij. UNDP-ja ka mbështetur Autoritetin për të dokumentuar krimet e komunizmit, për kryerjen e hulumtimeve mbi konceptin e punës së detyruar në kampe internimi gjatë regjimit komunist, mbledhjen e dëshmime verbale midis të mbijetuarve dhe organizimit të eventeve publike.

Si OKB në të gjithë Ballkanin Perëndimor jemi duke u përpjekur të sigurojmë më shumë mbështetje financiare nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Paqes për të punuar në pajtimin në të gjithë rajonin dhe shpresojmë të punojmë më shumë me Autoritetin këtu.

Kështu që konferenca juaj ka shumë rëndësi jo vetëm për interesin historik, por edhe për të sotmen, dhe uroj një debat të thellë dhe të plotë.



Z. Bernd Borchardt Kryetari i prezencës së OSBE-së në Shqipëri

Ju falënderoj që më keni ftuar të flas në këtë veprimtari shumë të rëndësishme e që zhvillohet në kohën e duhur. Prezenca e OSBE-së e ka mbështetur dialogun për shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën prej shumë vitesh dhe kemi theksuar diçka në deklaratat dhe fjalimet tona: Regjimeve shtypëse mund t'u vijë fundi ose me revolucion ose nga kolapsi, por nëse ato nuk diskreditohen edhe publikisht, ideologjia e tyre mund të rezistojë. Njohja e “të keqes dhe të së gabuarës” e ndan shoqërinë edhe më shumë nga regjimi i mëparshëm, dhe kontribuon te njohuria kolektive që përbën lëvizjen normative duke hedhur poshtë ideologjinë e mëparshme dhe te veprimi dhe afirmimi i ndryshimit ideologjik që përbën transformimin çlirues. Pranimi dhe dënimi i krimeve të së shkuarës, mbart në vetvete një dimensionin transformues konsolidimi publik i të cilit sjell çlirimin e shoqërisë. Ekspozimi i gabimeve stigmatizon autorët e tyre, i nxjerr jashtë loje dhe i lë ata pas te një e kaluar e keqe. Një gjë e tillë përshpejton lëvizjen normative që është shumë e rëndësishme për këtë tranzicion çlirues. Janë zhvilluar shumë

studime rreth mënyrës se si armiqtë e luftës apo armiqtë politikë të së shkuarës mund të pajtohen pas luftës apo pas një shtypjeje të madhe, veçanërisht sa i përket Luftës së Dytë Botërore dhe shpërbërjes së diktaturave, qofshin ato komuniste apo të djathta dhe se si shoqëritë mund të pajtohen. Përfundimet ende nuk kanë arritur të kenë karakterin e një paradigme mbizotëruese, por vërej një opinion të gjerë akademik, sipas të cilit, pa u marrë me të kaluarën, ndasitë në shoqëri do të qëndrojnë të thelluara dhe kthehen në hendeqe edhe më të vështira për t'u kaluar. Duke parë Shqipërinë e sotme unë vërej argumente të forta që e mbështesin këtë pikëpamje akademike: Shpesh dëgjojmë – dhe sa më i ndezur debati, aq më shpesh ndodh – fajësim pa kursim për ata që mendojnë ndryshe. Nuk dëgjojmë vetëm argumente kundër këndvështrimeve të tyre, gjë që do të ishte normale, por dëgjojmë përpjekje për t'u zhbërë figurën. Dëgjojmë refuzimin e dialogut me kundërshtarin politik. Dëgjojmë sulme ndaj atyre që përpiqen të vendosin faktet përballë miteve. E gjitha kjo më duket si mbetje nga modeli i sjelljes komuniste. Sikurse e përshkruajnë shkencëtarët, në pak vende polarizimi politik është kaq i thellë sa në Shqipëri dhe “përballja me të kaluarën”, me krimet e neveritshme të diktaturës komuniste, vetëm sa ka filluar. Sipas literaturës, pajtimi ka nevojë të bazohet jo vetëm te drejtësia për sa i përket llogaridhënies dhe kompensimit, por gjithashtu në nocione të ndryshme të së vërtetës, pranimi dhe njohjes. Kjo nënkupton pranim të palëkundur të mizorisë – dhe njohja e kontekstit më të gjerë politik dhe rrethanave janë të nevojshme për t'iu kundërvënë relativizmit të përgjegjësive dhe ngritjes së miteve historike. Dialogu rreth së kaluarës, për mua, është një akt i rëndësishëm për përparimin e lëvizjes normative të transformimit politik që përmenda më herët. Siç thotë edhe një nga studiuesit kryesorë të drejtësisë tranzitore, Ruti Teitel: Nevojitet kuptim i përbashkët politik, kritik ndaj ideologjisë



**Kultura e kujtesës
e lidhur me
viktimat dhe me
vuajtjet përforcon
ndryshmin e
rrëfimit që është
i nevojshëm për
të ndërtuar një
shoqëri liberale
pas shpërbërjes
së një diktature.**

së regjimit të mëparshëm. Gjyqet japin një pjesë të këtyre njohurive. Kthimi dhe kompensimi gjithashtu. Por edhe njohuritë e tjera për dhimbjet e së kaluarës luajnë rol thelbësor për aftësitë e shtetit që të ketë sukses me tranzicionin çlirues. Komisionet e së vërtetës kanë luajtur rol thelbësor në shumë vende pas mizorive të diktaturave. Kultura e kujtesës e lidhur me viktimat dhe me vuajtjet përforcon ndryshmin e rrëfimit që është i nevojshëm për të ndërtuar një shoqëri liberale pas shpërbërjes së një diktature. Siç e ka përkufizuar presidenti i ndjerë i Çekisë Václav Havel: ndryshimi nga “të jetosh brenda gënjeshtërsë apo brenda të vërtetës”. Thënë kjo, konferenca e sotme përbën një tjetër hap të rëndësishëm e të nevojshëm drejt të kësaj të vërtete.

Vrasjet e njerëzve që përpiqeshin të largoheshin nga Shqipëria, ekzekutimi i atyre që kapeshin ndërsa përpiqeshin të largoheshin, eksodi i një pjese të mirë të elitës së para luftës në vitin 1944, largimi i detyruar i bashkëshortëve të huaj të shqiptarëve pas shkëputjes me Bashkimin Sovjetik – së bashku sollën kaq shumë dhimbje te njerëzit. Kjo vuajtje e meriton të theksohet këtu – dhe të jetë pjesë e përbaljes me të kaluarën e keqe. Ne, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, kemi mbështetur nga viti 2015 deri më vitin 2018 nxitjen e dialogut në Shqipëri për të kaluarën e saj komuniste. Po ashtu, kemi ndihmuar në zhvillimin e Autoritetit të Dosjeve të Ish-Sigurimit. Sot po punojmë me Fakultetin e Shkencave Sociale, Fakultetin e Drejtësisë dhe Fakultetin e Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës për krijimin e një programi studimi të nivelit Master për

Drejtësinë Tranzitore, në mënyrë që të krijojmë mbështetjen e duhur akademike në Shqipëri për këtë detyrë të vështirë. Jemi të lumtur që kontribuojmë në këtë dialog.



Prof. dr. Hamit Kaba
Akademia e Studimeve Albanologjike
Instituti i Historisë

Prof. Dr. Hamit Kaba historian dhe drejtues i departamentit të Studimeve Bashkëkohore në Institutin e Historisë, Tiranë. Disa nga botimet e tij janë: UNRRA në Shqipëri: 1944-1947 – 2000; Shqipëria në rrjedhën e luftës së ftohtë: (studime dhe dokumente) – 2007 Shqipëria dhe të Mëdhenjtë: nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë – 2015.

EMIGRACIONI POLITIK SHQIPTAR NË SHBA

PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE DHE

RAPORTET E TIJ ME EMIGRACIONIN E VJETËR¹

Mbërritja e emigrantëve politikë shqiptarë në SHBA

Historia e emigracionit politik shqiptar nuk fillon me periudhën e pasluftës së Dytë Botërore. Kjo ishte valë e dytë apo e tretë. *Vala e parë* e emigracionit politik shqiptar duhet kërkuar në periudhën pas dështimit të Lëvizjes së Qershorit të udhëhequr nga Noli. “Në dhjetor 1924, ka theksuar Ali Këlcyra, pothuajse 1200 intelektualë nacionalistë shqiptarë shkuan në mërgim, për të protestuar përpara botës kundër ardhjes në pushtet të Zogut, i mbështetur nga shtetet fqinje e në mënyrë të veçantë nga Jugosllavia”.² *Faza*

¹ Kjo kumtesë është mbajtur në Konferencën mbi emigracionin politik në Shqipëri, të organizuar nga Autoriteti i Hapjes së Dosjeve dhe Instituti i Historisë, më 26 shkurt 2020.

² The National Archives (më tej: *TNA*), FO 371/48106, Intervistë e Ali Këlcyrës, Bari, February 7, 1945.

e dytë lidhet me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste në vitin 1939, dhe largimin e detyruar të mbretit Zog dhe qindra shqiptarëve të tjerë në drejtim të Turqisë, Britanisë së Madhe, Francës etj. *Vala apo faza e tretë* e tij fillon në mbarim të Luftës së Dytë Botërore [LDB] dhe vazhdon deri në rënien e regjimit komunist në vitin 1991.

Valës së parë të ikurve nga Shqipëria menjëherë pas mbarimit të LDB do t'i shtoheshin të tjerë shqiptarë të arratisur nga vendi i tyre për shkak të ndjekjeve, persekutimeve, dënimeve dhe pakënaqësive të krijuara nga ndryshimi i sistemit dhe reformat radikale të qeverisë komuniste. Është e vështirë të japësh një numër të saktë të arratisurve nga Shqipëria pas LDB, por ata janë me mijëra. Pas ndarjes shqiptaro-jugosllave të vitit 1948-1949, 5000-8000 shqiptarë të tjerë u larguan nga Shqipëria në drejtim të Jugosllavisë. Ministria e Jashtme e Shqipërisë në vitin 1975 do ta llogariste numrin e emigracionit politik jashtë vendit në rreth 10000 -12000 persona.³

Numri i emigrantëve politikë shqiptarë në SHBA në vitet 1945-1954 ishte i kufizuar. Për arsye të afrisë tokësore me Shqipërinë, mbështetjes së vendeve fqinje për të pritur të arratisurit dhe situatës ndërkombëtare të atyre viteve, të larguarit u vendosën fillimisht në Itali, Greqi, Turqi e pak më vonë edhe në Jugosllavi. Shumica e tyre u vendos në kampet e refugjatëve në Itali, nën kujdesin e UNRRA-s, Kombeve të Bashkuara, autoriteteve vendase, të vëzhguar e këqyru nga shërbimet e ndryshme të inteligjencës. Pas një periudhe fillestare relativisht të vështirë vëzhgimi e dyshimi ata u rehabilituan e stabilizuan relativisht shpejtë. Periudha e viteve 1944-1948 mund të konsiderohet si *faza e parë*, gjatë së cilës emigracioni politik shqiptar u riorganizua. Krijimi i Komitetit 'Shqipëria e Lirë' në gusht 1949 e deri në mbarim të operacioneve anglo-amerikane për rrëzimin

³ *Historia e Popullit Shqiptar*, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë Vëllimi IV, Tiranë: Toena, 2009, f. 270.

e regjimit komunist në Shqipëri në vitet 1953-'54, shënon *fazën e dytë* dhe më intensive të tij. Veprimtaria e emigracionit politik shqiptar në vitet 1949-1954 shënon kulmin e saj. Por si pa dashje, ai u gjend në syrin e ciklonit të zhvillimeve dhe konfrontimeve të mëdha ndërkombëtare, të dy kampeve armiqësore, të Demokracive Perëndimore të udhëhequra nga SHBA, dhe Bllokut të Vendeve Komuniste të udhëhequr nga BS. Emigracioni politik shqiptar u bë pjesë e lojës së madhe të shahut politik të Mëdhenjve. Shumë shqiptarë të arratisur u përfshinë në operacionin Rollback, të planifikuar nga autoritetet britanike e amerikane dhe shërbimet e tyre të fshehta. Përfundimi pa sukses i tyre, i veniti shpresat e të larguarve për t'u kthyer në Shqipëri. Pas kësaj

fillon një *faza e tretë* dhe fundit, më e qetë, më monotone, kur përdorimit të forcës ia zunë vendin propaganda dhe fjalët.

Në vitet 1944-1948 në SHBA u fut një kontingjent i pakët shqiptarësh të arratisur. Zyra Amerikane e Emigracionit e cilësonte këtë kontingjent 'si ish-bashkëpunëtorë të fashizmit, të futur kontrabandë kinse nga CIA dhe nga Departamenti i Shtetit'.

⁴ Pas krijimit të 'Komitetit Shqipëria e Lirë' dhe zhvendosjes së

⁴ Sarah L. Olson, "U.S. Immigration of People of Albanian Nationality 1913-1983", Immigration Seminar, December 2, 1985, në: Arkivi i Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë (më tej: AMPJ), Viti 1985, Dosja 1155.

“

**Valës së parë të të
ikurve nga Shqipëria
menjëherë pas
mbarimit të LDB do
t'i shtoheshin të tjerë
shqiptarë të arratisur
nga vendi i tyre për
shkak të ndjekjeve,
persekutimeve,
dënimeve dhe
pakënaqësive të
krijuara nga ndryshimi
i sistemit dhe reformat
radikale të qeverisë
komuniste.**

”

qendrës së tij nga Parisi në New York, kufijtë e SHBA u hapën më tepër për emigracionin politik shqiptar. Numrit të kufizuar të arratisurve nga Shqipëria iu shtuan të tjerë emigrantë politikë të larguar nga Italia, Greqia, Turqia etj. Në vitin 1949 mbërriti nga Egjipti në Amerikë, ish-imami i Vlorës, Vehbi Ismaili, i cili krijoi të parën Shoqatë të Myslimanëve shqiptarë në SHBA.⁵

Duke filluar me vitin 1948 e në vazhdim qeveria amerikane nxori disa akte ligjore që favorizonin futjen e disa kategorive personash, duke përfshirë edhe emigrantët politikë. Ndër ta do të përmendim ligjin për Personat e Shpërngulur të vitit 1948, Akti i Ndhmës për Refugjatët i vitit 1953, Akti për Personat e Shpërngulur i vitit 1957, Akti i korrikut të vitit 1970 etj.⁶ Akti më favorizues dhe nxitës për emigrantët politikë evropianë dhe shqiptarë mbetet ai i vitit 1960, i cili lejoi hyrjen pa kufizim të refugjatëve politikë nga Evropa Lindore e Qendrore. Shifra ekzakte për emigrantët politikë të futur në territorin amerikan është e vështirë të gjendet, sepse ata figurojnë të regjistruar së bashku me bashkatdhetarët e tyre të ardhur nga Kosova dhe territoret e tjera të ish-Jugosllavisë.

Veçori dhe ngjashmëri ndërmjet emigracionit të vjetër dhe emigracionit të ri

Emigracioni i vjetër në SHBA, i organizuar rreth 'Vatrës' [e pjesërisht rreth organizatës 'Shqipëria e Lirë', të krijuar në vitin 1941 nga Kostandin Çekrezi] kishte tradita të shkëlqyera në mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare, dhe ndikim të rëndësishëm mbi 'atdheun e origjinës' - Shqipërinë. Por emigracioni i ri ishte

⁵ AMPJ, Viti 1959, Dosja 522, "Mbi Kolloninë Shqiptare në SHB të Amerikës". Relacion i përgatitur nga Reis Malile-Përfaqësues i Përhershëm i Shqipërisë në OKB, 22.1.1959, f. 33.

⁶ Sarah L. Olson, "U.S. Immigration of People..."

i një natyre tjetër. Studiuesi i njohur me origjinë shqiptare në Departamentin e Shtetit (DSH), Stephen Peters,⁷ ka vënë në dukje disa tipare të emigracionit politik shqiptar në SHBA, dhe ndikimin e tij mbi komunitetin e vjetër. “Me pak përjashtime, përmend ai, përbërja e emigracionit të vjetër shqiptar ishte me bazë fshatare dhe me stok bujku, ndërsa ardhja e tyre në Amerikë kishte shkaqe të padiskutueshme ekonomike”⁸. Por edhe origjina e elitës së shqiptarëve të Amerikës, me emra të tillë, si: Sotir Peci, Fan Noli, Faik Konica, Kristo Dako, motrat Qirjazi, Kostandin Çekrezi, Anastas Pandelev, Vasil Marku e Kristo Thanas, përmend Peters, përveç Faik Konicës, ishte pothuajse e njëjtë me atë të popullit të thjeshtë. Ata ndikuan tek shqiptarët e thjeshtë të Amerikës, duke i iluminuar e edukuar ata, me shpirtin e patriotizmit, me ndjenjën e identitetit kombëtar dhe punës në interes të atdheut.

Por gjendja e emigrantëve të vjetër ndryshoi gradualisht pas mbërritjes së emigrantëve të rinj politikë. Të ardhurit ishin nacionalistë shqiptarë të larguar pas vendosjes së pushtetit komunist në Shqipëri, të akuzuar prej tij, si ish-kolaboracionistë e kriminelë të luftës. Kontingjenti fillestar i të ardhurve do të shtohet e pasurohet nga koha në kohë, me të tjerë persona, të larguar nga Shqipëria për shkak të represionit komunist. Refugjatët politikë dalloheshin nga emigrantët e para luftës nga pikëpamja e arsimimit dhe profesionalizmit. Të parët në përgjithësi vinin nga fshati dhe ishin analfabetë. Ata punonin në

⁷ Stephen Peters përpara LDB kishte punuar si mësues në Normalen e Elbasanit. Gjatë LDB kreu studimet në Universitetin e Harvardit dhe filloi punën në Misionin e OSS [Office of Strategic Services] për Shqipërinë. Pas mbarimit të LDB punoi në Departamentin e Shtetit dhe kreu mjaftë studime cilësore për politikën e jashtme të Shqipërisë, gjatë periudhës së komunizmit. Pas daljes në pension e deri sa vdiq në vitin 1986 vazhdoi të shkruante për Shqipërinë. Shih: Hamit Kaba, *Nga Luftë në Paqe, Shqipëria dhe SHBA 1939-1946*, ASA-Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina KH, 2020, f. 270,283,297,450.

⁸ Stephen Peters, “Characteristics, contributions and responsibilities of Albanian-Americans”, *International Seminar of Pan-Albanian Federation “VATRA”*, New York: November 1969, f. 96.

punë të zakonshme në sektorin e shërbimeve e në prodhim në fabrika e uzina. Fëmijët e tyre rrallë studionin në universitete dhe në degët e ndryshme të dijes. Në këtë kuptim ata ndjeheshin inferiorë ndaj kontingjentit të ardhur pas Luftës. Pjesëtarët e emigracionit politik të pasluftës ishin arsimuar e përgatitur në shkollat kombëtare shqiptare, ndërsa shumica e tyre ishte specializuar e trajnuar në universitetet evropiane.

'Të vjetrit' dhe të ardhurit rishtas në përgjithësi kishin pikëpamje të ndryshme politike, por sidoqoftë tek të dy palët mbizotëronin interesat kombëtare. Kontingjenti i të ardhurve i përkiste një spektri të gjerë politik, por mungonte krahu i majtë ekstrem. Brenda tij kishte edhe elemente të majtë me pikëpamje socialiste e socialdemokrate. Në një studim të Ministrisë së Jashtme të Italisë të vitit 1954, Abaz Ermenji e Vasil Andoni - dy figurat drejtuese të Ballit Agrar, konsideroheshin si 'nacionalistë-komunistë'. Ndryshe nga të vjetrit, të ardhurit kishin pasur pozita të rëndësishme në sistemin legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor, parlamentar dhe në biznesin privat në Shqipëri. Disa të tjerë, ndonëse nuk ishin marrë me politikë, kishin spikatur si profesionist të mirë në fushat e tyre. Mund të thuhet pa droje se shqiptarët që mbërritën në Amerikë pas LDB ndikuan në rritjen e vlerave intelektuale e profesionale të komunitetit shqiptaro-amerikan. Ky tipar është vënë re në fusha të tilla si mjekësia, arsimi, letërsia etj. Studiues të tillë si Stavro Skëndi, Isuf Luzaj etj., jepnin mësim në universitetet më të mira amerikane.

Një tjetër dallim i rëndësishëm ndërmjet emigracionit të vjetër dhe të ri të pasluftës ishte edhe aspekti gjeografik. Përpara vitit 1944 pjesa më e madhe e shqiptarëve të Amerikës kishin ardhur nga Shqipëria Jugore, ndërsa shumica e të ardhurve të rinj pas LDB, vinin nga Shqipëria Veriore e Qendrore. "Mjaftë prej tyre, përmend, Stephen Peters, ishin nga Malësia e Madhe, me tharm të fort e të qëndrueshëm malësori-trashëgimtarë të vërtetë të Skënderbeut. Me ardhjen e këtyre gegëve të fortë, vijon ai,

komuniteti shqiptaro-amerikan u bë më përfaqësues dhe më i balancuar se ç'kishte qenë më parë.⁹ Të ardhurit i forcuan e pasuruan më tej cilësitë e mira të komunitetit shqiptar në botën e re, të njohur si njerëz punëtorë, të papërfshirë në veprime të paligjshme e kriminale.

Por refugjatët politikë ndikuan edhe në një aspekt tjetër mbi komunitetin shqiptar. Me luftën e tyre politike ata ndikuan gradualisht jo pak në largimin e një lloj afeksioni ndaj qeverisë komuniste në Shqipëri. Ky fenomen vihet re sidomos tek 'Vatra' dhe figurat drejtuese të saj si Qerim Panariti, por edhe tek Noli etj. 'Vatra' pas vitit 1958 u distanca nga qeveria komuniste e Shqipërisë dhe simpatia ndaj saj.

Pjesë e emigracionit politik të ardhur nga Shqipëria, ishin edhe një numër jo i vogël minoritarësh shqiptarë, të cilët hynë në SHBA më herët se të tjerët. Një pjesë e konsiderueshme e tyre gjetën ngushëllim tek 'Federata Panepirote' e Amerikës. Ata u solidarizuan me drejtuesit e kësaj organizate, në kërkim të territoreve të Shqipërisë Jugore, të njohura nga Greqia me termin 'Vorio Epir'. Emigracioni politik shqiptar në Amerikë nuk u bashkua me këtë kauzë, përkundrazi i kundërshtoi atë me forcë. Ai mbeti deri në fund kundërshtar i regjimit komunist në Shqipëri, por nuk u bë preh e politikave të fqinjëve të Shqipërisë. Në vjeshtën e vitit 1960, kur festohej 15-vjetori i OKB-së në New York, shkoi edhe kryeministri i atëhershëm i Shqipërisë, Mehmet Shehu. Qëndrimi i tij u prit me protesta nga emigracioni politik shqiptar dhe nga Federata Panepirote. Të parët e akuzonin kryeministrin komunist për politikën represive dhe izoluese të Shqipërisë ndaj Perëndimit, të dytët, kërkonin bashkimin e territoreve të Jugut me Greqinë. Emigrantët politikë shqiptarë u ndeshën me 'Panepirotët'. Si rezultat, policia e New York-ut mori masa dhe caktoi orare të ndryshme për të demonstruar kundër delegacionit shqiptar në KB.

⁹ *Po aty*, f. 97.

Mund të shtrohet pyetja, a ka pasur flirtime nga radhët e emigracionit politik shqiptar me kërkesat dhe pretendimet territoriale të fqinjëve ndaj Shqipërisë? Dokumentacioni arkivor që njohim, përmend edhe raste të tilla, por ato janë të rralla, dhe në përgjithësi të detyruara nga rrethanat. Më të ekspozuar e të dyshuar kanë qenë disa pjesëtarë nga radhët e emigracioni politik shqiptar, të larguar nga vendi, pas ndarjes së Shqipërisë me Jugosllavinë, në vitet 1948-1949. Qeveria jugosllave i hapi kufijtë për rreth 5000 deri në 8000 refugjatë politikë shqiptarë, të cilët sipas burimeve italiane u larguan ilegalisht nga Shqipëria. Të drejtuar e instruktuar nga Dushan Mugosha, rreth 250-300 shqiptarë ishin mbledhur në Prizren dhe kishin zgjedhur Këshillin Ekzekutiv të Komitetit të Prizrenit.¹⁰ CIA [Central Intelligence Agency], që kishte dijeni për aktivitetet e tyre, mbajti qëndrim të rezervuar dhe nuk e përfshiu kontingjentin e shqiptarëve të arratisur në Jugosllavi, në operacionin për rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri. Ajo dyshonte tek qëllimet e Tito-s dhe synimet e tij ndaj Shqipërisë, të cilët nuk kishin të bënin vetëm me rrëzimin e regjimit të Enver Hoxhës, por edhe me bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë.

Mosmarrëveshjet në gjirin e emigracionit të vjetër e të ri në SHBA

Komuniteti i vjetër i emigrantëve shqiptarë në SHBA ishte përfshirë në radhët e dy shoqatave të njohura: 'Vatrës' dhe 'Shqipërisë së Lirë'[SHL]. Në maj 1945, Kostë Çekrezi dha dorëheqjen nga drejtimi i kësaj organizate, për shkak të akuzave që iu bënë nga anëtarët e saj, se ai pengonte afrimin e saj me qeverinë komuniste të Shqipërisë. Përkundrazi, Çekrezi pretendonte me

¹⁰ NARA, Roll 1, File 767.867, Internal Affairs of Albania 1955-1959, 'The Albanian Question Today', Romë, Jyly, 6, 1954, f.10.

të drejtë, se 'SHL' nuk po ecte mbi bazën e parimeve të pranuar në themelimin e saj, se do të shërbente si urë lidhëse ndërmjet SHBA dhe Shqipërisë. 'SHL' u afrua me qeverinë e Tiranës dhe e ruajti afeksionin ndaj saj deri në vitet '70-'80.

'Vatra' evoluoi gradualisht dhe u largua gradualisht, nga një lloj afeksioni për qeverinë komuniste dhe i hapi rrugë pranimit në të emigrantëve politikë në gjirin e saj. Përfshirjes së emigrantëve politikë në gjirin e 'Vatrës' iu hap rruga pas dy modifikimeve që iu bënë statutit të saj, në shtator 1958: *Së pari*, 'Vatra' nuk duhet të kishte marrëdhënie me ato shtete me të cilat SHBA nuk kishin marrëdhënie diplomatike, d.m.th nuk duhet të kishte lidhje me Shqipërinë. *Së dyti*, në shtator 1958 Kuvendi i 'Vatrës' ndryshoi statutin e saj, duke miratuar një klauzolë, sipas së cilës në të, mund të pranoheshin 'të gjithë bijtë e racës shqiptare'.¹¹ Liberalizimi i statutit përmes këtij neni krijonte mundësinë që në të hynin të gjithë shqiptarët, pavarësisht nga bindjet e tyre politike. Pavarësisht nga ky ndryshim, përfshirja e elementeve të arratisur nga Shqipëria në degët e Vatrës e ca më pak në drejtimin e saj, ishte një proces i vështirë, për shkak të kundërshtimit të disa prej anëtarëve të vjetër të 'Vatrës', propagandës së qeverisë komuniste dhe rolit që luante Misioni Shqiptar pranë Kombeve të Bashkuara në New York. Ndryshimet e bëra u pritën keq nga qeveria shqiptare, e cila pas kësaj kohe e konsideroi 'Vatrën' dhe drejtuesve të saj, si Qerim Panariti [editor i gazetës 'Dielli' dhe sekretar i saj] si njerëz në shërbim të reaksionit dhe të Departamentit të Shtetit. Të pakënaqur ishin edhe me Nolin. Për të ndryshuar situatën u punua fort, por pa sukses, që në zgjedhjet e ardhshme të 'Vatrës' të mbështetej kandidatura e Peter Priftit.

Nga njohja e deritanishme e dokumentacionit mund të themi se, marrëdhëniet e 'Vatrës' me emigracionin politik në SHBA

¹¹ AMPJ, Viti 1959, Dosja 522, "Mbi Koloninë Shqiptare në SHB të Amerikës". Relacion i përgatitur nga Reis Malile-Përfaqësues i Përhershëm i Shqipërisë në OKB, 22.1.1959, f. 10.

nuk u përmirësuan aq sa shpresohet. Dera u çel përgjysmë. Pas ndryshimit të statutit, në aktivitetet përkujtime kushtuar 'Vatrës', gazetës 'Dielli', apo përvjetorëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, do të merrnin pjesë disa nga intelektualët më të shquar, që i përkisnin emigracionit politik. Në seminarin ndërkombëtar të nëntorit të vitit 1969, kushtuar 'Vatrës', kumtuam disa nga personalitetet e shquara të kulturës shqiptare, që vinin nga radhët e emigracionit politik të shqiptarëve në Amerikë dhe jashtë saj, të tillë si: Martin Camaj, Zef Valentini, Namik Resuli, Ernest Koliqi, Hasan Dosti, Ragip Frashëri [djali i Mehdi Frashërit], Stephen Peters etj.¹² Në kumtesën e tij me titull: "Fan Noli, përlëvdues epiko-lyrik i burrnis shqiptare", Ernest Koliqi do të shprehet: "Gabimet ase në datsh të thuesh fajet qi Fan Noli ka mujtë me ba, nuk i a zbresin vlerën tri veprave të pashoqe qi ai kreu, pasojat e mira të cilave edhe sot ndiehen në rrjedhë të historisë shqiptare e janë: themelimi më 1909 i fletores 'Dielli', praeludium i themelimit të Shoqatës pan-shqiptare 'Vatra' në Boston, më 1912 në bashkëpunim me Faik Konicën, - pranimi shpëtues i shtetit shqiptar në Lidhjen e Kombeve më 17 dhetuer 1920, e krijimi i Kishës orthodoxe autoqefale shqiptare. Edhe po të pranojmë për hipotezë se Fan Noli pat njolla, vazhdon më tej Koliqi, këto tri vepra të shkëlqyeshme krejt ia shlyejnë".¹³

Shenjat e afrimit ndërmjet emigracionit të vjetër e të ri në SHBA ishin vënë re në fillim të viteve '60. Në 50-vjetorin e shoqërisë 'Vatra', të kremtuar në Boston, në vitin 1962, Ali Këlcyra, një nga krerët me emër e disi ekzotik të Ballit Kombëtar, ishte ulur në tavolinën kryesore, pranë Fan S. Nolit. Të dy ishin personalitete të njohura dhe personazhe me stazh të gjatë si emigrantë, por rrugët e tyre ishin ndarë herët. Bashkëpunëtorë në Lëvizjen e Qershorit, ndërsa më vonë, jo më miq, si dikur. Pjesëmarrësit në

¹² *Internatinal Seminar of Pan-Albanian Federation "VATRA"*, New York: 28-29-30 November, 1969, f. 284.

¹³ Ernest Koliqi, "Fan Noli, përlëvdues epiko-lirik i burrnis shqiptare", në: *Internatinal Seminar of Pan-Albanian Federation "VATRA"*, New York: 28-29-30 November, 1969, f. 165.

atë kremtim, ndiqnin me sy e kureshtje bisedën e gjallë të Nolit me Këlcyrën. Noli, duke e ndjerë kërsëherinë e tyre u ngrit dhe foli para të gjithëve, ashtu siç ai dinte të fliste, duke përcjellë mesazhe të rëndësishme: “Në Greqinë e vjetër, u tha Noli të pranishmëve, lufta bëhej me armë, por edhe me fjalë-logos. Një luftë e tillë u zhvillua mes oratorit më të shquar, Demostenit dhe një tjetër oratori të shquar-Eskinit. Puna ishte, vazhdoi më tej Noli, nëse duhej t’i binin Filipit të Maqedonisë apo jo. Demosteni donte luftë, kurse Eskini ishte kundër. Luftën me logos e fitoi Demosteni dhe Eskini e syrgjynosën në një ishull të Persisë. Në atë ishull, Eskini hapi një shkollë oratorie. Një ditë u lexoi dishepujve të tij fjalimin që kishte mbajtur kundër tezës së Demostenit. Ata u habitën aq shumë saqë i thanë: Po ti u mbajte këtë fjalim athinasve dhe ata të syrgjynosën? Dhe Eskini u përgjigj: Ah, ta dëgjoni atë makaranë tjetër, se ç’u tha e do ta kuptonit arsyen. Këtë meselë, e përfundoi Noli fjalën e tij, i tregova mikut tim këtu pranë [Ali Këlcyrës], pasi ai më tregoi ç’kishte bërë e ç’kishte folur në Shqipëri”.¹⁴

¹⁴ Ilda Qato, *Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1954*, tezë masteri e pabotuar, Tiranë: janar 2012, f. 3.



| Prof. asoc. dr. Enriketa Pandelejmoni

Prof. asoc. dr. Enriketa Pandelejmoni (Papa) është pedagoge e historisë në Departamentin e Historisë, Universiteti i Tiranës. Ajo ka doktoruar në Universitetin e Gracit, në Austri për Historinë Bashkëkohore të Evropës dhe Evropës Juglindore. Fokusi i saj kryesor në kërkimet shkencore dhe mësimore, përfshin historinë bashkëkohore, komunizmin dhe kujtesën, me interes mbi Shqipërinë.

Ajo është autore e monografisë, “Shkodra. Family and Urban Life 1918-1939 (Lit Verlag 2019), dhe bashkëautore e vëllimit me dokumenta arkivore “Aspekte të historisë së komunizmit në Shqipëri përmes materialeve arkivore dhe burimet sekondare” (Tiranë 2020), si dhe bashkëautore e disa vëllimeve me studime, si “Myths and Mythical Spaces. Conditions and Challenges for History Textbooks in Albania and South-Eastern Europe (Göttingen 2018); “Thirrja për Liri. Studime mbi totalitarizmin dhe tranzicionin në Shqipëri” (Tiranë 2016); “Albania. Family, Society and Culture in the 20th Century” (Münster 2012).

Prof. Asoc. Dr. Pandelejmoni është autore e një sërë artikujsh shkencorë me tematika nga historia bashkëkohore e Shqipërisë, të botuar në revista akademike brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndër artikujt e fundit të saj është edhe “Italian fascist modernisation and colonial landscape in Albania 1925-1943, *Perspectivas* Vol. 25 (2021), Special Issue: Environmental histories of Mediterranean Fascism, pp. 43-56.”. Aktualisht ajo po punon për çështje të marrëdhënieve shqiptaro-italiane pas Luftës së Dytë Botërore.

“KRIMINELËT E LUFTËS”: EMIGRACIONI

POLITIK SHQIPTAR NË ITALI DHE RAPORTI

ME SHTETIN KOMUNIST SHQIPTAR 1945-1955

Abstrakt

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore qeveria provizore e Shqipërisë i dërgoi komisionit të OKB-së për krimet e luftës (1945) kërkesën për të dorëzuar të ashtuquajturit “kriminelë luftime”, të cilët ishin shpërndarë në kampet e ndryshme të IRO-s. Një ndër shtetet kryesore ku emigracioni politik shqiptar ishte strehuar ishte Italia, e cila ishte kthyer në strehë të shumicës dërmuese të ish-politikanëve shqiptarë që qeverisën Shqipërinë gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, duke shërbyer në administratën fashiste apo dhe atë naziste gjatë pushtimit të vendit. Pjesa më e madhe e tyre u angazhuan në Itali në organizatën politike Blloku Kombëtar Indipendent. Gjithashtu, në Itali ishin strehuar

në kampet e IRO-s edhe shumica e eksponentëve të Ballit Kombëtar, të cilët ishin në antagonizëm me Bllokun Independent dhe përpiqeshin të zgjeronin kontaktet politike me autoritetet italiane për t'i përkrahur. Po ashtu dhe mbreti Zog kishte përfaqësues të tij pranë Legalitetit dhe përpiquej të rriste influencën e tij për të bashkuar të gjitha organizatat politike të emigracionit shqiptar në Itali kundër shtetit komunist shqiptar të pas-Luftës së Dytë Botërore.

Qëllimi i kësaj kumtese do të jetë hedhja dritë mbi organizimin e emigracionit politik shqiptar në Itali, marrëdhënia mes tyre si dhe me shtetin komunist shqiptar në dekadën e parë pas Luftës së Dytë Botërore. Së dyti, kumtesa synon edhe analizimin e raportit midis shtetit shqiptar dhe emigrantëve politikë shqiptarë, të cilët konsideroheshin zyrtarisht si “kriminelë lufte”.

Emigracioni shqiptar në Itali

Pas Luftës së Dytë Botërore, Qeveria provizore e Shqipërisë i bëri një kërkesë OKB-së për t'i dorëzuar të ashtuquajtur “kriminelët e luftës”, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve ndodheshin me strehim edhe në Itali, Greqi e Austri. Që në 25 shkurt 1945 qeveria shqiptare iu drejtua Komisionit të Kombeve të Bashkuara për krimet e luftës në Londër për t'i kthyer në Shqipëri të ashtuquajturit kriminelë të luftës, shqiptarë, italianë dhe gjermanë. Por kjo kërkesë e Shqipërisë pas shumë kërkesash ndër vite ndaj Komisionit nuk u plotësua me arsyen e thjeshtë, se këta njerëz do të ekzekutoheshin me të vënë këmbë në Shqipëri.¹⁵

¹⁵ AMPJ, Viti 1948, Dosja 217, Fleta 1-4.

Italia ishte kthyer në strehë të shumicën dërmuese të ish-politikanëve shqiptarë që qeverisën Shqipërinë gjatë kohës së luftës, duke shërbyer në administratën fashiste apo dhe atë naziste gjatë pushtimit të vendit. Pjesa më e madhe e tyre u angazhuan në Itali në organizatën politike, Blloku Kombëtar Independent. Gjithashtu në Itali ishin strehuar në kampet e IRO-s edhe shumica e eksponentëve të Ballit Kombëtar, të cilët ishin në antagonizëm me Bllokun Independent dhe përpiqeshin të zgjeronin kontaktet politike me autoritetet italiane për t'i përkrahur. Po ashtu dhe mbreti Zog kishte përfaqësues të tij pranë Legalitetit dhe përpiqej të rriste influencën e tij për të bashkuar të gjithë organizatat politike të emigracionit shqiptar në Itali. Legata shqiptare në Romë nëpërmjet agjentëve të saj mblidhte dhe transmetonte në Tiranë informacione të detajuara mbi organizimin dhe takimet që këto grupime politike të emigracionit shqiptar zhvillonin. Tirana duket se ishte në dijeni të çdo nisme politike dhe të hyrje-daljeve nga Italia të eksponentëve të veçantë

“

Që në 25 shkurt 1945 qeveria shqiptare iu drejtua Komisionit të Kombeve të Bashkuara për krimet e luftës në Londër për t'i kthyer në Shqipëri të ashtuquajturit kriminelë të luftës, shqiptarë, italianë dhe gjermanë. Por kjo kërkesë e Shqipërisë pas shumë kërkesash ndër vite ndaj Komisionit nuk u plotësua me arsyen e thjeshtë, se këta njerëz do të ekzekutoheshin me të vënë këmbë në Shqipëri.

”

dhe detyrave që atyre ju ishin ngarkuar nga organizatat e tyre respektive. Ndër të ashtuquajturit kriminelë lufte për Shqipërinë konsideroheshin politikanët shqiptarë, që kishin përgatitur pushtimin e Shqipërisë më 7 prill 1939, ata që kishin bashkëpunuar me italianët gjatë pushtimit italian, si dhe regjentët gjatë pushtimit nazist. Të tillë për Shqipërinë ishin, Mustafa Kruja, Ali Këlcyra, Ernest Koliqi, Mehdi Frashëri, Rexhep Mitrovica, Fiqiri Dine, Hasan Dosti, Xhafer Deva, Gjon Marka Gjoni, Kol Bib Miraka. Në lista ishin futur edhe krerët e Ballit Kombëtar si Mit'hat Frashëri dhe ai i Legalitetit Abaz Kupi, si dhe gjeneralë dhe ushtarakët Preng Previzi, Hysni Dema, Xhelal Staravecka, Alush Leshanaku, Sadik Premtja, Mehmet Alemi e Ali Nivica.¹⁶ Të gjithë këto personalitete kishin arritur të largoheshin nga Shqipëria në përfundim të Luftës së Dytë Botërore dhe ishin strehuar përkohësisht në Itali dhe ku një pjesë e konsiderueshme e tyre angazhoheshin në organizatat shqiptare në mërgim me idenë e një rikthimi sa më të shpejt në Shqipëri, pas përmbyesjes së regjimit komunist.

Legata shqiptare në Romë qendër e aksionit shqiptar ndaj emigrantëve politikë

Për autoritetet shqiptare të gjithë shqiptarët e strehuar nëpër kampet e IRO-s në Itali, Greqi e Austri konsideroheshin me një rrezikshmëri të lartë në angazhimin e tyre me propagandë antikomuniste ndër shqiptarët e thjeshtë dhe Shqipëria komuniste herë pas herë dërgonte kërkesa për rikthimin e tyre në Shqipëri për t'iu nënshtruar ligjeve të saj mbi dënimin e tyre. Kështu më 19 qershor 1947 i Dërguari

¹⁶ AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 19-20.

i Jashtëzakonshëm i Shqipërisë dhe Ministër Fuqiplotë i Republikës Popullore të Shqipërisë në Beograd, Tuk Jakova i dorëzoi Charles Peake, ambasador i Britanisë së Madhe dhe John M. Cabot, të Ngarkuarit me Punë të SHBA në Beograd, një notë të qeverisë shqiptare, ku i kërkohej qeverive angleze dhe amerikane dorëzimin e kriminelëve të luftës, që ndodheshin nën juridiksionin e tyre në Itali, në Greqi dhe në zonat e pushtimit anglo-amerikan të Gjermanisë dhe Austrisë.¹⁷ Në raportet që drejtoheshin Ministrisë së Jashtme në Tiranë nga funksionarët shqiptarë të legatave jashtë vendit, bie në sy gjuha indoktrinuese dhe propagandistike tipike e kohës, si dhe një konsideratë tejet negative ndaj vendeve që i strehonin “armiqtë” e Shqipërisë komuniste. Gjithashtu duket se legatat shqiptare jashtë shtetit ishin në dijeni të lëvizjeve, takimeve dhe aktivitetit të elementit shqiptar në emigracion dhe raportonin rregullisht Tiranën mbi këto aktivitete deri në detaje të vend-takimit, pjesëmarrjeve dhe bisedave që ishin kryer. Duket se ka pasur dekonspirime dhe Tirana ishte në dijeni të plotë të vendimmarrjeve të organizatave shqiptare në emigracion. Tirana vihej në dijeni edhe për mosmarrëveshjet dhe antagonizmat midis grupeve politike shqiptare në emigracion si dhe ishte e mirëinformuar edhe mbi përkrahjen që mbreti Zog i bënte njërit apo tjetër grupi politik. Për Shqipërinë komuniste qeveritë e vendeve të Italisë, Austrisë si dhe Greqisë i kishin strehuar, financuar dhe mbajtur në kushte të mira të gjithë kriminelët e luftës, si dhe u kishin mundësuar dhe organizimin e tyre në aktivitete kundra Shqipërisë. Në Austri, Xhafer Deva vazhdonte të ishte aktiv kundra Shqipërisë, duke u angazhuar në “Komitetin Nacional të Shqipërisë”. Në

¹⁷ AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 17.

Greqi të kërkuarit e Shqipërisë për krime lufte, përkraheshin nga qeveria monarkiste dhe anglo-amerikanët dhe ata madje ishin pjesë aktive e provokacioneve dhe e aksioneve kufitare kundra regjimit komunist në Shqipëri. Ndërsa në Itali të kërkuarve shqiptarë iu ishin krijuar kushte shumë të mira, duke i strehuar në hotele të mira në Merano, Rimini, Romë, Milano, Reggio Emilia dhe shumë pak prej tyre ishin strehuar në kampin e Santa Maria di Leucca-s. Të gjithë ata ishin të lirë të lëviznin dhe disa prej tyre kishin shkuar dhe në Egjipt e Greqi për të punuar me shqiptarët e tjerë kundra Shqipërisë komuniste.¹⁸

Diplomaci - survejim – riatdhesim?

Pas vendosjes së Lidhjeve diplomatike mes Shqipërisë dhe Italisë më 1949, ende një ndër problemet imediate për t'u zgjidhur midis dy shteteve mbetej ai i riatdhesimit të shtetasve të mbetur në të dyja anët e Adriatikut. Për sa i përket shtetasve shqiptarë të mbetur në Itali, Legata shqiptare kishte bërë shpallje për shqiptarët e mbetur në Itali që të regjistroheshin pranë zyrës së legatës në Romë, në mënyrë që të riatdhesoheshin. Herë pas here Legata i dërgonte Tiranës raportime mbi numrin e shqiptarëve në Itali, shpërndarjen e tyre dhe mbi mundësitë reale për të kthyer në Shqipëri ata që dëshironin të riatdhesoheshin. Në dukje bie në sy, se numri real i shqiptarëve që donin të ktheheshin dhe kishin paraqitur dhe kërkesat e tyre pranë Legatës shqiptare në Romë ishte shumë i vogël. Nga ana e Legatës kërkohej një rritje e punës për të bindur

¹⁸ AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 21.

njerëzit për t'u kthyer, duke i mikluar ata me propagandën pozitiviste mbi arritjet e Shqipërisë komuniste.

Në një raport¹⁹ që përfaqësuesi shqiptar në Romë, Zenel Hamiti i dërgoi Ministrisë së Jashtme në Tiranë më 27 nëntor 1949 shkruhej se, në Itali ndodheshin përafërsisht 1000 shqiptarë të larguar në mënyra të ndryshme nga atdheu i tyre. Vetë legata i kategorizonte këta shqiptarë në dy kategori. Në kategorinë e parë përfshiheshin, të ikur për punë ordinere dhe të ndodhur në Itali pse ishin studentë, tregtarë, të ardhur për kurime të ndryshme, ushtarë të ish-gardës mbretërore, muzikantë, vajza shqiptare të martuara më italianë dhe që ishin braktisur prej burrave të tyre e ndodheshin rrugëve të Italisë, si dhe shqiptarë të burgosur. Në kategorinë e dytë futeshin të arratisurit nga Shqipëria për bashkëpunim me pushtuesin nazi-fashist, këta të fundit po ashtu, ndaheshin në dy grupe; a) drejtuesit kryesorë të organizatave reaksionare dhe konshientë për luftën kundra Shqipërisë dhe demokracive popullore, dhe b) të arratisurit dhe viktimat të propagandës reaksionare, të cilët konsideroheshin nga shteti shqiptar si jo aq fajtorë si grupi i parë, pasi kishin qenë thjesht pasues të verbër të “udhëheqësve të tyre kriminelë”.²⁰

Për Legatën shqiptare ishte e qartë, se shumica e shqiptarëve në Itali e njihnin gjendjen politike të Shqipërisë, ndaj dhe nuk kishin asnjë marrëdhënie me legatën. Ndaj dhe numri i shqiptarëve që iu përgjigjën thirrjes së Legatës për t'u regjistruar për riatdhesim ishte tepër i vogël. Vetëm pas dy muajsh që legata kishte bërë shpalljen, ishin regjistruar gjithsej 11 persona. Por kishte edhe nga ata që

¹⁹ AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 13-16.

²⁰ Po aty, Fleta 13.

nuk dinin ç'kishte ndodhur në Shqipëri dhe madje kishin dhe informacione jo të sakta. I tillë ishte për shembull, rasti i një zonje, dr. Marika Furrxhi, e cila i ishte drejtuar legatës me kërkesë për riatdhesim, duke kujtuar se Përfaqësues Fuqiplotë i saj për Shqipërinë ishte, Mit'hat Frashëri.²¹ Një rast tjetër ishte ai i inxhinier Myzafer Dragotit me banim në Livorno, mbaruar në Politeknikun e Torinos, i cili i kishte drejtuar një letër-kërkesë për riatdhesim legatës, duke iu lutur të merrte parasysh gjendjen e tij kritike financiare dhe që preferonte më mirë të kthehej e të kontribuonte për atdheun e tij, se sa të shkonte në Holandë, ku i ishte ofruar një punë si inxhinier. Kishte dhe nga ata shqiptarë që ishin paraqitur në Legatë për t'u regjistruar, si Rrok Lufi nga Shkodra, apo Qeram Pustina, Llazar Zambaku, Violeta Traska por që më pas nuk ishin bëtë më të gjallë.²² Shumica e shqiptarëve mbas Luftës së Dytë Botërore ishin të shpërndarë nëpër kampet e IRO-s si dhe në Frascati, në kampin e administruar nga Ministria e Brendshme italiane. Të ashtuquajturit "krerët e reaksionit shqiptar" nga qeveria shqiptare, jetonin me ndihma nga bashkëpatriotët e tyre në Itali, por kishte dhe nga ata shqiptarë në kampe që bënë ndonjë punë tek-tuk, apo mbaheshin nga paratë e bashkëshorteve të tyre italiane.²³

Duket se Legata shqiptare kishte informacione të hollësishme mbi kampet e IRO-s dhe të numrit të shqiptarëve të ndodhur në to. Sipas informacioneve që Legata i dërgonte Ministrisë së Jashtme, pas vizitave që njerëz të legatës zhvilluan në kampet e IRO-s Tirana informohej se në:

- 1) Bagnoli, që ishte kampi më i madh i IRO-s në të gjithë

²¹ Po aty, Fleta 8.

²² Po aty, Fleta 9.

²³ Po aty, Fleta 13-14.

Italinë, strehonte rreth dhjetë mijë veta të kombësive të ndryshme. Kampi ndodhej në perëndim të Napolit dhe ngjitur me qytetin. Në këtë kamp ndodheshin në vitin 1949 rreth 300 shqiptarë, të cilët legata i ndante respektivisht sipas përkatësive dhe simpatizimit politik. Kështu prej tyre 10 – 15 ishin me Partinë Agrare, afro 200 vetë me Ballin Kombëtar dhe pjesa e mbetur me Legalitetin. Përfaqësuesi i Ballit Kombëtar në kamp ishte Ali Begeja dhe nga Legaliteti ishte Mazar Pustina dhe Legata njoftonte, se si Balli si Legaliteti punonin me refugjatët shqiptarë në këtë kamp për t'i bërë për vete.²⁴

- 2) Kampi i Aversa-s ishte një kamp tranzit për ata refugjatë që kishin marrë vizat dhe do të emigronin për Amerikë, Kanada, Australi dhe që prisnin të iknin. Legata njoftonte se nuk kishte një numër të saktë të refugjatëve të kampit, meqenëse kishte gjithmonë lëvizje dhe vetë njerëz të Legatës nuk ishin lejuar ta vizitonin, për shkak të statusit të veçantë të kampit.²⁵
- 3) Kampi Pagani, afër Salernos, strehonte 30-40 refugjatë shqiptarë, por që nga informacionet e legatës ishte e vështirë të përcaktoheshin përkatësitë politike të refugjatëve midis Ballit Kombëtar dhe Legalitetit.²⁶
- 4) Kampi i Barit, në Santa Fara, strehonte 60-70 shqiptarë të ndarë dhe këta midis Ballit Kombëtar dhe Legalitetit.
- 5) Kampi në Trani strehonte 50-60 shqiptarë, nga të cilët 15 prej tyre ishin me Legalitetin të kryesuar nga Halil Mëniku dhe të tjerët me Ballin Kombëtar nën

²⁴ AMPJ, Viti 1950, Dosja 254, Fleta 63.

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty.

drejtimin e Asllan Zenelit.²⁷

- 6) Kampi Senegalia afër Ancona-s kishte 38 shqiptarë me kryetar të Ballit Kombëtar, Gani Tafili nga Vlora.
- 7) Kampi i Barleta-s në veri të Barit në të cilin ndodheshin vetëm 10 shqiptarë, nga 200 refugjatët me kombësi të ndryshme që mbante si kamp.
- 8) Kampi Cava dei Tereni në Vila Alba të Salernos kishte 15 shqiptarë nën drejtimin e dr. Vasil Dhimitrit.
- 9) Kampi i Vila Calana po në rrethinat e Salernos me 10 shqiptarë nën Sabaudin Camin.
- 10) Kampi Capua në rrethinat e Napolit strehonte 13 shqiptarë nën Cize Merkon nga Vlora.
- 11) Kampi Jesi në provincën e Ancona-s, që strehonte 70-80 shqiptarë nën drejtimin e Jani Dilos të Ballit Kombëtar.
- 12) Kampi Fermo në rrethet e Asceli-Picenas, ku shqiptarët e atyshëm drejtoheshin nga përfaqësuesi i Legalitetit Allaman Harri, por legata nuk ishte në dijeni të numrit të saktë të shqiptarëve.²⁸

Pengesë për riatdhësimin e shqiptarëve në Shqipëri sipas Legatës shqiptare nxirrte sidomos puna dhe propaganda që bëhej në Itali nga disa organizata politike, të cilat punonin kundra Shqipërisë komuniste. Kështu, ndër organizatat aktive në truallin italian ishin “Balli Kombëtar”, “Legaliteti”, “Shqipëria e Lirë”, “Blloku Independent”, rreth të cilave ishin mbledhur kokat e “reaksionit” shqiptar jashtë vendit. Po sipas legatës shqiptare në Romë, këto organizata kishin shpërndarë nëpër kampet e IRO-s dhe në Frascati njerëzit e tyre, të cilët merreshin me propagandën kundra Shqipërisë dhe përbënin një pengesë serioze për punën e

²⁷ Po aty, Fleta 64.

²⁸ Po aty.

legatës në drejtim të bindjes së shqiptarëve me strehim në Itali për t'u riatdhesuar.²⁹

Një shqetësim tjetër për Legatën shqiptare në Itali ishte dhe grumbullimi që ishte vënë re i shqiptarëve nëpër kampe, të cilët mendohej se do të thirreshin për të ikur më pas drejt Argjentinës, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, pasi mendohej se kampet e IRO-s do të mbylleshin së shpejti.³⁰ Të gjithë rekrutimet do të bëheshin në kampin e Napolit dhe prej Italisë mbas mbylljes së kampeve të IRO-s nuk do të kishte më imbarkime për SHBA, Kanada, Australi, Argjentinë etj. Imbarkimet do të zhvendoseshin në Bremen të Gjermanisë, ku nuk përjashtohej mundësia edhe e stërvitjes së refugjatëve shqiptarë edhe në Bremen për t'u parashutuar dhe futur më pas në Shqipëri³¹ me mbylljen e kampeve të IRO-s në Itali do të shkëputeshin lidhjet e mundshme që Legata në Romë mund të krijonte me këta shqiptarë për t'i bindur të riktheheshin në Shqipëri. Përpos këtij fakti, Legata i bënte me dije Tiranës se ndër elementet shqiptarë të kampeve të Italisë, kishte dhe nga ata që po mendohej të dërgoheshin në Greqi dhe Jugosllavi, në mënyrë që të hidheshin më pas drejt Shqipërisë me qëllime diversioni dhe përmbysjen e regjimit. Njësoj, siç mund të bëhej edhe me ata shqiptarë që do të dërgoheshin drejt Amerikës, të cilët do të stërviteshin dhe trajnoheshin për çdo eventualitet, për t'u futur në territorin shqiptar me qëllime diversioni.³² Nga vizitat në kampe, që njerëz të Legatës bënë, ajo u vu në kontakt me disa shqiptarë aty, të cilët i shërbyen informata mbi mënyrën e organizimit dhe të aksioneve që përfaqësues të grupeve politike në emigracion të shqiptarëve donin të ndërmerrnin, duke rekrutuar dhe refugjatë nga kampet e

²⁹ Po aty, Fleta 14.

³⁰ Po aty, Fleta 14-15.

³¹ AMPJ, Viti 1950, Dosja 254, Fleta 63.

³² AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 14.

sipërpërmendura. Ndaj Legata njoftonte Tiranën, se Xhafer Deva dhe Xhelal Mitrovica të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, kishin grumbulluar një sasi gegësh për t'i dërguar në Shqipëri. Po ashtu të tjerë shqiptarë ishin grumbulluar në Jug të Lecce-s për t'u bërë gati për të zbarkuar si diversantë në brigjet e Himarës, Llogarasë, Karaburunit dhe Bisht Pallë.³³ Xhafer Deva dhe Xhelal Mitrovica konsideroheshin nga Legata shqiptare në Romë si agjentë të Gestapos dhe rreth tyre ata kishin mbledhur ish-ushtarakë të Regjimentit Kosova, si dhe kosovarë të tjerë. Pjesa më e madhe e anëtarëve të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, rrinin në Siri, por dhe në Greqi, Egjipt dhe Itali.

Tirana vazhdimisht informohej nga Legata shqiptare mbi të dhëna të organizimit, konflikteve, dhe nismave të reja politike të emigracionit politik në Itali. Duket se legata kishte njerëzit e saj si brenda vetë emigracionit politik, por edhe furnizohej me informacione nga agjencitë e inteligjencës së vendeve mike me Shqipërinë. Kështu po në 1949 Tirana informohej, se në Itali ishte krijuar një Komitet i ri politik, me atributet e një qeverie provizore, me dakordësinë e grupeve kryesore politike dhe me mbështetjen e britanikëve dhe të jugosllavëve. Ky komitet do të merrte përsipër përmbyshjen e situatës politike në Shqipëri, duke pasur si qendër të aktivitetit të tij kundër Shqipërisë, Kosovën dhe qendër e tij organizative New York-un, por në të përfshiheshin përfaqësues nga të gjitha vendet ku kishte emigrantë politikë shqiptarë.³⁴ Informata mbi grumbullimin e emigrantëve shqiptarë në Pejë dhe Prizren, Legatës shqiptare iu komunikuan edhe nga i dërguari me punë në Itali i Ambasadës sovjetike, i cili i bëri me dije në një takim në shtator 1949, se Komiteti politik me kriminelë lufte shqiptarë po qëndronte në Pejë,

³³ Po aty.

³⁴ AMPJ, Viti 1950, Dosja 215/1, Fleta 56.

i kryesuar nga Seit Kryeziu dhe një nënkomitet politik po qëndronte në Prizren. Më parë përfaqësuesi sovjetik kishte njoftuar legatën shqiptare se kriminelë luftë shqiptarë të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, ishin grumbulluar në Prishtinë e në Shkup.³⁵

Siç përmenda më sipër, Legata shqiptare në Romë ishte shumë e informuar mbi mbledhjet e grupeve shqiptare në Itali dhe mbi aktivitetet që ata zhvillonin si me emigrantët shqiptarë ashtu edhe me grupet e tjera jashtë Italisë. Një interes të veçantë për Legatën ishte survejimi dhe raportimi në Tiranë i Bllokut Independent me qendër në Itali, për të cilin Legata dukej se kishte informata të sakta të takimeve të Bllokut, derisa i raportonte Tiranës edhe emrat e pjesëmarrësve në takime si dhe vendimet që merreshin në to. Kështu për shembull, Zenel Hamiti i dërgonte Tiranës informata se në 24 shtator 1949 në shtëpinë e Shefet Vërlacit ishte mbledhur Komiteti drejtues i bllokut Independent ku morën pjesë:³⁶

- | | |
|-----------------------------|------------------------------|
| 1. Ismail Vërlaci – Kryetar | 13.Thanas Gega |
| 2. Kadri Myftiu – Sekretar | 14.Gjona Marka Gjoni |
| 3. Eqerem Vlora | 15.Due Gjon Markaj |
| 4. Safo Vlora | 16.Xhemil Dino |
| 5. Ernest Koliqi | 17.Ali Vrioni |
| 6. Namik Resuli | 18.Dod Nikolla |
| 7. Luigj Gargjolla | 19.Xhemil Dino |
| 8. Stefan Gazulli | 20.Ali Vrioni |
| 9. Albert Akshija | 21.Dod Nikolla |
| 10.Jorgji Ruço | 22.Kol Bib Mirakaj |
| 11.Eduart Liço | 23.Nexhmedin Vrioni |
| 12.Lin Shkreli | 24.Spiro Sheko ³⁷ |

³⁵ Po aty, Fleta 55.

³⁶ AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 27.

³⁷ Po aty.

Në këtë mbledhje sipas informatave që Legata shqiptare i dërgonte Tiranës, u kritikua puna e Ernest Koliqit për mosdakordësim të Bllokut me Ballin Kombëtar dhe grupet e tjera politike shqiptare në Komitetin për Çlirimin e Shqipërisë nga komunistët. Tirana ishte e informuar se ishte Balli Kombëtar që kishte rezistuar ndaj Koliqit me shokë, duke i konsideruar si kolaboracionistë ndaj dhe kishte refuzuar të bashkëpunonte me Bllokun, por edhe me zogistët. Tirana konsideronte Bllokun Independent si një organizatë që punonte në Itali për të rekrutuar shqiptarët e Italisë të vepronin kundra Shqipërisë, duke qenë se ai përbëhej kryesisht nga ish-funksionarë të lartë të Shqipërisë gjatë kohës së pushtimit fashist.³⁷

Me vëmendje Legata në Romë ndiqte dhe lidhjet që eksponentë të emigracionit politik shqiptar kishin në mënyrë të veçantë me Vatikanin, të cilin Shqipëria e konsideronte si një ndër qendrat e konspiracionit antikomunist. Sipas Legatës në Vatikan ndodheshin tre priftërinj shqiptarë me në krye Pater Valentinin (Giusseppe Valentini), të cilët bënë pjesë në C.I.P. (Centrio istruzioe publica). Me këta priftërinj mbanin lidhje Luigj Gargjolla, Ernest Koliqi dhe C.I.P. punonte për të edukuar fetarisht shqiptarët katolikë. Sipas Legatës persona me rëndësi që lidheshin me Vatikanin ndër emigrantët politikë shqiptarë ishin dhe Kol Bib Mirakaj dhe Gjon Marka Gjoni me të birin. Katolikët shqiptarë në Itali, njoftonte legata shqiptare, edukoheshin nga Azione Cattolica, dhe krijimi i një partie katolike shqiptare nuk dukej se ishte ndër planet e këtyre emigrantëve.³⁸

Në një raport tjetër që legata i dërgonte Tiranës

³⁷ AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 27-29.

³⁸ AMPJ, Viti 1950, Dosja 254, Fleta 6

përmendet me cektësi dhe një ndër informatorët e saj në Itali, një farë Gulio, prej të cilit Legata kishte marrë informacione të rëndësishme mbi Ballin Kombëtar dhe takime që eksponentë të lartë të Ballit, si Zef Pali zhvillonin çdo javë me një shqiptar, Gjovalin Sheldija që punonte në Ministrinë e Jashtme italiane. Nëpërmjet Sheldijas, Balli mbante lidhjet me Ministrinë e Jashtme të Italisë për të mundësuar ndihmën e saj për këtë organizatë.³⁹ Gjithashtu me dyshim për autoritetet shqiptare shikohej dhe afërsia që eksponentë të Ballit kishin me njerëz të IRO-s dhe dyshohej se punonin për të afruar shqiptarë nëpër kampe për të punuar për Ballin dhe hedhur më pas në Shqipëri me qëllime të përmbysjes së regjimit komunist.⁴⁰ Me shqetësim konstatoheshin dhe lidhjet që kërret e Ballit Kombëtar kishin me politikanë të forcave të ndryshme politike italiane, të partisë republikane, demokristiane, prej të cilëve ata ndërtonin politikat e tyre në përkrahje të kauzës së Ballit dhe kundra interesave shtetërore shqiptare.

Me shqetësim Legata shqiptare njoftoi Tiranën se pas vdekjes së Mit'hat Frashërit, ngushëllime për vdekjen e papritur të tij pranë Komitetit të Çlirimit, në ish-shtëpinë e Abaz Kupit në Romë shkuan për ngushëllime disa funksionarë politikë të shtetit italian, si Sekretari i Përgjithshëm i Palazzo Chigi-t, Zoppi; Dr. Lo Faro i Zyrës Ballkanike; Gjeneral d'Antonio përfaqësues i Drejtorisë së Policisë; Mareshali Galina i Policisë së Romës, ambasadori i Belgjikës, ministri grek në Romë dërgoi ngushëllimet me letër, ndërsa përfaqësuesit e SHBA dhe Britanisë së Madhe ngushëlluan me telefon.⁴¹ Legata shqiptare mendonte se interesi i shtetit italian ishte që t'i mbante afër eksponentët

³⁹ AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 4.

⁴⁰ Po aty, Fleta 5.

⁴¹ Po aty, Fleta 38-39.

kryesorë të emigracionit shqiptar, ndaj dhe vazhdonte t'i mbështeste financiarisht dhe materialisht ata. Ministria e Jashtme e Italisë, sipas Legatës shqiptare, kishte rritur kontaktet me njerëzit e Ballit Kombëtar dhe madje mbështeste dhe përpjekjet e Ballit për të stërvitur dhe dërguar njerëz me mision në Shqipëri. Kështu shteti italian do të mund të informohej më konkretisht mbi gjendjen e brendshme reale të Shqipërisë, për të orientuar më pas politikën ndaj Shqipërisë.⁴²

Në këtë kuadër të influencimit mbi elementet e organizatave politike shqiptare në Italia, me interes është edhe influenca e shtetit grek, i cili dukej se interesohet për organizimin politik të emigracionit shqiptar në Itali. Në janar të 1949 Legata jonë në Romë njoftonte Tiranën se në Itali kishte ardhur nga Greqia me qëllimin e zhvillimit të disa takimeve me eskponentë politikë të emigracionit, av. Vangjel Qirko, me origjinë nga Vlora, por që jetonte pas luftës në Athinë. Ai kishte shkuar sipas Legatës në Itali për të transmetuar edhe një mesazh të autoriteteve greke, për të bashkuar të tëra grupimet politike të emigracionit në Itali me qëllim organizimin e një rezistence dhe dërgimit në Shqipëri të elementeve që do të punonin për përmbysjen e regjimit komunist. Një bashkim i këtyre grupimeve i interesonte Greqisë për të ardhmen, duke mbështetur këto organizata për të "çliruar Shqipërinë" dhe marrë pjesë në qeverisjen e "së nesërme".⁴³ Ndaj dhe përfaqësuesi i Athinës në Romë i kishte dërguar Marka Gjonit dy shqiptarë për ta bindur të veprojnë në interes të bashkimit me Ballin dhe organizatat e tjera, me synimin e hedhjes së njerëzve të tij në Shqipëri dhe ngritjen e një rrjeti spiunazh nga

⁴² AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 6.

⁴³ Po aty, Fleta 7.

brenda Shqipërisë, qoftë dhe organizimin e çetave që do të luftonin autoritetet zyrtare shqiptare.⁴⁴ Për autoritetet shqiptare me këto veprime shikohej një lloj ndërhyrje e Greqisë në territorin italian në kundërshtim me interesat italiane dhe konkludohej se “grekët e shikonin me sy të keq influencën e italianëve tek shqiptarët dhe italianët reciprokërisht”. Qëllimi i grekëve ishte bashkimi i kurorave greke e shqiptare dhe ishin kundra mbretit Zog ndaj kërkonin bashkimin e grupeve politike shqiptare në Itali pa Zogun, ndërsa Italia kërkonte edhe pjesëmarrjen e Zogut. Por të dy shtetet përpiqeshin të punonin e mbanin afër elementet e emigracionit politik shqiptar në Itali.⁴⁵

Legata shqiptare në Itali mundohej që të bënte për vete dhe të bindte të punonin në interes të Shqipërisë, elemente të rinj në moshë, siç mund të ishin studentë shqiptarë, të cilëve Legata ju ofronte materiale propagandistike mbi Shqipërinë. Po ashtu legata kërkonte nga Tirana t'i mundësonte asaj lehtësirat e riatdhesimit të shqiptarëve, duke shkurtuar procedurat dhe afatet e pritjes së përgjigjes ndaj atyre që ishin regjistruar për riatdhesim. Ndryshe rrezikonin që këta njerëz të humbnin durimin dhe të mos paraqiteshin më në legatë. Gjithashtu Legata i kërkonte Tiranës që persona që do të kërkonin të regjistroheshin për t'u riatdhesuar duhet t'ju pranohej kërkesa dhe diferencimi i tyre të bëhej pasi të mbërrinin në Shqipëri. Ndryshe këta shqiptarë do të mikloheshin nga “armiqtë” e Shqipërisë dhe do të përgatiteshin për t'u hedhur në aktivitete diversioni kundra Shqipërisë. Sipas Legatës shqiptare në Romë, Tirana duhet ta bënte për vete emigracionin shqiptar në Itali dhe se ata që do të ktheheshin më mirë të ishin në “duart tona” sesa në duart e “armikut”.⁴⁶

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 15.

Një target-grup i mundshëm për riatdheshim midis shqiptarëve të Italisë ishin dhe personat, që sipas legatës ishin të akuzuar si spiunë të Shqipërisë nga organizatat politike të shqiptarëve në Itali apo që gjendeshin në burgjet e Italisë për akuza që ju ishin bërë atyre që në kohën e fashizmit. Numri i tyre sipas Legatës duhet të ishte aty tek 35 persona, por që binde ndesh me numrin që autoritetet italiane pretendonin, që ishte vetëm 5 të burgosur shqiptarë.⁴⁷ Një rast i tillë për shembull ishte ai i Dalip Hasës, i cili ishte dënuar me 101 vjet burg për akuzën e sabotimit të ushtrisë italiane më 1939. Hasa i kishte dërguar një lutje Legatës për të ndërmjetësuar për lirimin e tij dhe riatdheshimin në Shqipëri. Ndaj rasteve të tilla të ngjashme Legata kërkonte ndërhyrjen e Tiranës pranë autoriteteve italiane për t'i lehtësuar punën Legatës dhe për t'i bërë për vete këta shqiptarë dhe mundësuar sa më shpejt riatdheshimin e tyre.⁴⁸ Të burgosur të tjerë në burgjet italiane shënoheshin shtetasit shqiptarë, Haxhi Gjokollari, Qamile Meta, Ibrahim Muka, Kol Avrami dhe Qazim Sefa. Ky i fundit, më 1952 rezultonte i liruar nga burgju, por që kishte refuzuar të kthehej në Shqipëri e kërkoi azil në Itali.⁴⁹

Gjithashtu, Legata i propozonte Tiranës që të lejohej që të dërgonte nëpër kampet e IRO-s njerëz, të cilët të punonin individualisht me shqiptarë të strehuar në këto kampe dhe t'i bindte për t'u riatdhësuar.⁵⁰ Tjetër problem që Legata shqiptare kërkonte prej Tiranës ishin dhe aspektet financiare të procesit të riatdheshimit. Sipas saj shumica e shqiptarëve që kishin shfaqur interes për t'u riatdhësuar ishin në gjendje të keqe ekonomike, sa

⁴⁷ AMPJ, Viti 1954, Dosja 238, Fleta 22.

⁴⁸ AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 47.

⁴⁹ AMPJ, Viti 1952, Dosja 161, Fleta 54.

⁵⁰ AMPJ, Viti 1949, Dosja 214, Fleta 8.

as para për të bërë dy fotografitë që kërkonte formulari i regjistrimit nuk kishin. Ndaj duhej gjetur një zgjidhje për të përballuar shpenzimet e riatdhesimit të tyre. Po ashtu dhe pajisja e atyre shqiptarëve që s’kishin pasaporta, i duhej gjetur një zgjidhje, pasi IRO-s kishte shfaqur mendimin që mund të pajiste shqiptarët me pasaporta të lëshuara nga vetë IRO. Por sipas Legatës kjo mund të sillte probleme mbi identitetin e atyre që do të pajiseshin me këto pasaporta, pasi mund të tentohej të futeshin në Shqipëri elemente të dyshimtë.⁵¹ Tjetër shqetësim i Legatës shqiptare për shqiptarët që tregonin interes për t’u riatdhesuar ishte edhe frika e tyre ndaj autoriteteve shqiptare dhe hetimit që ata mund t’ju bënin atyre për vitet e kaluara në emigracion, punët që kishin kryer dhe ku ishin strehuar.⁵²

Si përfundim duhet theksuar se një nga çështjet kryesore në marrëdhëniet politike midis Shqipërisë komuniste dhe Italisë pas Luftës së Dytë Botërore deri në nënshkrimin e Traktatit të Paqes mes dy vendeve ishte problemi i dorëzimit të ashtuquajtur “kriminelë luftime”. Italia nuk i ktheu dhe hodhi poshtë disa herë kërkesat e Shqipërisë mbi mbajtjen prej saj të “kriminelëve shqiptarë të luftës”, duke bërë që Shqipëria të mendohej me taktika të tjera për t’i bindur njerëzit të riatdhesoheshin apo dhe duke infiltruar agjenturën e saj nëpër kampet e IRO-s,⁵³ por pa sukses.

⁵¹ Po aty.

⁵² AMPJ, Viti 1957, Dosja 376, Fleta 3.

⁵³ Po aty, Fleta 6.



| Ma. Leonora Laçi

Leonora Laçi merret me studime historike, fokusi saj është periudha komuniste dhe çështje të emigracionit politik shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore. Mjaft shkrime janë botuar në gazeta dhe në revista të ndryshme me karakter historik, fetar e kulturor. Ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ka bërë parathënie dhe redaktime librash. Është Sekretare e Përgjithshme në Shoqatën “Trojet e Arbrit” me qendër në Kosovë, nga viti 2014 deri tani, dhe bashkëpunëtore e jashtme e ISKK. Libra të botuar: 1. *Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1955*, Rozafat, Shkodër: 2015. 2. *Veprimtaria e Kol. Xhemal Laçit përmes dokumenteve dhe kujtimeve (1912-1994)*, 2MPrinting, Durrës: 2016. 3. *Abati i Mirditës- imzot Frano Gjini, Martiri i kishës katolike*, bashkautorë Leonora Laçi, Tomë Mrijaj, Shkodër: 2018.

KOMITETI KOMBËTAR “SHQIPËRIA E LIRË”

DHE VEPRIMTARIA E EMIGRACIONIT

NË VITET 1949-1953

Abstrakt

Kumtesa ka synimin e qartë që të vë në dukje veprimtarinë e emigracionit shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore dhe krijimin e Komitetit “Shqipëria e Lirë” si e vetmja organizatë që synonte të përfshinte grupime të ndryshme politike.

Punimi do të fokusohet në këto nën tema: Formimin e Komitetit, organizimin e brendshëm të tij dhe qëllimet. Përfshirjen apo mospërfshirjen e të gjitha fraksioneve politike të mërgatës, a duhej të bëheshin pjesë të Komitetit, shqiptarët që kishin bashkëpunuar me fashizmin?! Qëndrimet e mbretit në mërgim. Cili ishte qëndrimi që mbajtën fqinjët ndaj Shqipërisë komuniste? Planet anglo-amerikane dhe “Kompania 4000”.

Emigrimi i shqiptarëve në prag të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, u drejtua kryesisht në vendet fqinje e më vonë përtej Atlantikut. Ky emigracion i detyruar nga rrethanat politike në Shqipëri, ishte i përçarë dhe përveç problemeve që hasën në kampe refugjatësh, atyre u duhej të përballonin dhe urrejtjen mes njëri-tjetrit, çka nuk solli asnjë dobi, por përkundrazi vetëm sa i ndihmoi komunistët të merrnin dhe të forconin pushtetin e tyre për 45 vite rresht. Përpara se të fillonte ndonjë operacion guerril, kishte probleme të komplikuara diplomatike për t'u zgjidhur.

Së pari, ishte përçarja e emigracionit shqiptar. Tre grupet kryesore politike ishin në sherr dhe komunikonin me vështirësi në mes tyre. Monarkistët, në veçanti mbreti Zog, dhe shefat e tij ushtarakë Abaz Kupi e Nuçi Kota, ishin të përcaktuar kundër Ballit Kombëtar republikan, kundër Frashërit, Ermenjit, Zef Palit, Hasan Dostit dhe Vasil Andonit. Të dy palët, ishin kundërshtarë të betuar të independentëve nacionalë, të njohur me emrin Indipendenza, që ishin kryesisht katolikë nga zonat veriperëndimore të vendit. Kosovarët, në verilindje të drejtuar prej familjes Kryeziu, ishin një grup tjetër. Po kështu edhe ca njerëz, si Ihsan Toptani, që kishin një ndikim në saje të prestigjit familjar dhe zotësisë individuale. (Bethel Nicolas- *“Tradhëtia e Madhe”* Tiranë 1993, fq. 56-57).

Këta grupime politike, bashkoheshin në dy gjëra: urrejtja kundër komunizmit dhe mosbesimi i përgjithshëm i tyre ndaj vendeve fqinje, që kërkonin aneksimin e territorit shqiptar. Në vitin 1948, u shtrua realisht çështja e bashkimit të grupeve të emigracionit politik, e cila u nxit dhe nga konflikti, që shpërtheu midis Partisë Komuniste të Shqipërisë e Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

Para vitit 1948, ajo (Shqipëria) nuk ishte tjetër veç një avampost i perandorisë së Stalinit, por në fund të këtij viti ky vend i vogël e i ngushtë, i shtrënguar midis Jugosllavisë rebele dhe Greqisë së copëtuar nga lufta civile, vetëm 55 milje në ngushticë larg Italisë që po e merrte vehten nga trauma e zgjedhjeve të saj të prillit 1948, dukej se ishte bërë kyçi i shumë planeve strategjike. (Bethel Nicolas-“Tradhëtia e Madhe” fq. 40).

Krijimi i Komitetit “Shqipëria e Lirë” ishte një hap i rëndësishëm për të vendosur punët e shqiptarëve në drejtimin e duhur.

Komiteti Kombëtar “Shqipëria e Lirë” dhe veprimtaria e emigracionit në vitet 1949-1953

“Asnjë Shqiptar i çfarëdo bindjeje politike, nuk e ka dashur pushtimin nuk ka punuar për të e po ashtu nuk ka patur mundësi ta shmangë.”⁵⁴

Leonora Laçi

Emigrimi i shqiptarëve, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, u drejtua kryesisht në vendet fqinje dhe përtej Atlantikut.

Ky emigracion i detyruar nga rrethanat politike në Shqipëri, ishte i përçarë dhe përveç problemeve që hasën në kampe refugjatësh, atyre u duhej të përballonin dhe urrejtjen mes njëri-tjetrit, çka nuk solli asnjë dobi, por përkundrazi vetëm sa i ndihmoi komunistët të marrnin dhe forcojnë pushtetin e tyre për 45 vite rresht.

⁵⁴ Eugjen Merlika, “Mustafa Kruja në historinë shqiptare”. 2012.

Përpara se të mund të fillonte ndonjë operacion guerril, kishte probleme të komplikuara diplomatike për t'u zgjidhur.

Së pari, ishte përçarja e emigracionit shqiptar. Tre grupet kryesore politike ishin në sherr dhe komunikonin me vështirësi në mes tyre.

Monarkistët, në veçanti mbreti Zog, dhe shefat e tij ushtarakë Abaz Kupi e Nuçi Kota, ishin të përcaktuar kundër Ballit Kombëtar republikan, kundër Frashërit, Ermenjtit, Zef Palit, Hasan Dostit dhe Vasil Andonit. Të dy palët, ishin kundërshtarë të betuar të independentëve nacionalë, të njohur me emrin Indipendenza, që ishin kryesisht katolikë nga zonat veriperëndimore të vendit.

Kosovarët, në verilindje të drejtuar prej familjes Kryeziu, ishin një grup tjetër. Po kështu edhe ca njerëz, si Ihsan Toptani, që kishin një ndikim në saje të prestigjitetit familjar dhe zotësisë individuale.⁵⁵

Këta grupime politike, i bashkonin dy gjëra: urrejtja kundër komunizmit dhe mosbesimi i përgjithshëm i tyre ndaj vendeve fqinje, që kërkonin aneksimin e territorit shqiptar. *Para vitit 1948, ajo (Shqipëria) nuk ishte tjetër veç një avampost i perandorisë së Stalinit, por në fund të këtij viti ky vend i vogël e i ngushtë, i shtrënguar midis Jugosllavisë rebele dhe Greqisë së copëtuar nga lufta civile, vetëm 55 milje në ngushticë larg Italisë që po e merrte vehten nga trauma e zgjedhjeve të saj të prillit 1948, dukej se ishte bërë kyçi i shumë planeve strategjike.*⁵⁶

Në vitin 1948, u shtrua realisht çështja e bashkimit të grupeve të emigracionit politik, e cila u nxit dhe nga

⁵⁵ Bethel Nicolas, "Tradhëtia e Madhe" Tiranë 1993, fq. 56-57.

⁵⁶ Bethel Nicolas, "Tradhëtia e Madhe" fq. 40.

konflikti, që shpërtheu midis Partisë Komuniste të Shqipërisë e Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

Në këtë kohë Amerika dhe Britania e Madhe, sikurse dhe Italia e Greqia, ndërhyjnë, që emigracioni politik të bashkohej në një organizëm të vetëm.⁵⁷

Në këtë kohë grupe të vogla emigrantësh shqiptarë, nën kontrollin dhe regjinë e shërbimeve të fshehta britanike e amerikane, ndërmorën iniciativën, për t'u hedhur në atdhe nga deti, toka dhe ajri. Qëllimi kryesor ishte propaganda në popull, për të mbajtur lart moralin e tij, sabotimin dhe aksione të tjera, për të përgatitur terrenin e një invadimi më të madh, përmbysjen e komunizmit.

Ushtarët e lirisë, që propaganda komuniste i quante “kriminelë lufte” apo diversantë, stërviteshin në Maltë, Mynih dhe Heidelberg. Ishte Komiteti për Rusinë i qeverisë Britanike, i formuar më 1946 për të përballuar kërcënimin sovjetik në botën e pasluftës, ai që lëshoi idenë e çlirimit të popullit shqiptar nga sundimi komunist.⁵⁸

Shqipëria, u përmend për herë të parë në mbledhjen e 25 nëntorit 1948 të këtij Komiteti, ku një numër i madh ambasadorësh të ardhshëm ishin mbledhur për të diskutuar rrugë të tjera të zhvillimit të Luftës së Ftohtë.⁵⁹

Nën udhëheqjen e Christopher Warner dhe Ivone Kirpatrick, Komiteti nisi të shtynte për një politikë të re sulmuese ndaj BS më 1947. Sipas zërave brenda qeverisë britanike ekzistonte mendimi se Perëndimi, “nuk mund të fitonte ‘Luftën e Ftohtë’, në qoftë se nuk ndërmerrej një sulm ‘brenda shteteve satelite’”. Operacioni iu dorëzua

⁵⁷ *Historia e popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj. (vitet 1939-1990) vëllimi IV*, Tiranë 2009. fq. 270.

⁵⁸ Corke Jane-Sarah-” *Operacionet e fshehta dhe strategjia e Luftës së Ftohtë e SHBA*” Globus R, 2010, fq. 167.

⁵⁹ Bethel Nicolas- “*Tradhëtia e Madhe.*” fq. 42.

Grupit të Posaçëm të Veprimit Politik brenda MI-6, grupi do mbikëqyrej nga britaniku David Smiley, njohës i mirë i Shqipërisë dhe shqiptarëve, ku kishte shërbyer gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Pjesë e këtij operacioni këtë herë u bënë dhe amerikanët, ku drejtori i Zyrës amerikane të Bashkërendimit Politik (ZBrP) Frank Wisner u vu në dijeni dhe e miratoi projektin në pranverë të vitit 1949. Ai dhe zyrtarët britanikë, me të cilët bashkëpunoi, shpresonin se një kundër rrotullim i mbarë në Shqipëri mund të nxiste kryengritje të ngjashme në Europën Lindore.

Zbatimi i planit iu ngarkua SIS-it dhe DKP-së. Si amerikanët, ashtu dhe anglezët, mbanin kontakte me grupet e shqiptarëve emigrantë, prandaj të dyja palët nisën të mobilizonin lidhjet e tyre për realizimin e grushtit kundërrevolucionar të shtetit.

Anglezët, vunë në dispozicion, Maltën, si bazë të përparuar për operacionin dhe disa anije të vogla për lidhjen e agjentëve. Amerikanët e siguruan operacionin me mjete financiare dhe materiale, si dhe vunë në dispozicion aerodromin Wheelus Field në Libi, si bazë prapavije dhe pikë furnizimi.⁶⁰

Asokohe kishte takime mes shërbimeve të fshehta amerikane dhe britanike. Në dokumentin NSC 58 të Shtabit të Planifikimit Politik, që drejtohej nga George Kennani, vihet në dukje fakti, se do përdoshin refugjatët, për të nxitur rezistencën në bllokun lindor. Nën këtë plan, të dëbuarit e Europës Lindore do të mblidheshin së bashku në të ashtuquajturit “Komitete të Lirisë”, të cilët do të financoheshin prej SHBA-së.

⁶⁰ Philby Kim- “Lufta ime e heshtur”. Shtëpia Botuese Onufri ,2004, fq. 165.

Nuk kishte kohë më për të humbur për Perëndimorët, mbasi ndodhi humbja e Çekosllovakisë dhe Kinës, dhe për pak po humbinin Berlinin Perëndimor dhe Greqinë. Ai kishte humbur monopolin në armatimin bërthamor, pjesërisht si rrjedhojë e akteve tradhëtare të qytetarëve amerikanë e britanikë.⁶¹

Prandaj, më 1949, Shqipëria ishte një kullë e izoluar dhe e cenueshme “e ndikimit rus në periferi të Europës Perëndimore”.⁶² Sipas analizës së bërë në veprën: *“Operacionet e fshehta dhe strategjia e Luftës së Ftohtë e SHBA”* të Sarah-Jane Corke, duke i kushtuar një kapitull të veçantë për emigracionin shqiptar të viteve 1948-’53 me titull “Eksperiment Klinik”, thuhet shprehimisht: *“Operacioni më i turpshëm që u krye nga SHBA ishte “Operacioni Valuable” (Operacioni i Vlefshëm), një operacion paraushtarak “i pronësuar” nga Britania e Madhe i krijuar për të tronditur qeverinë komuniste të Enver Hoxhës”*.⁶³

Në qershor të 1949, filloi puna për formimin e një komiteti politik, me atributin e një qeverie provizore, ku me ndihmën e shteteve perëndimore do destabilizonte situatën e brendshme në Shqipëri si dhe do përmbyste regjimin e E. Hoxhës. Qëllimi i operacionit, ishte përmbysja e shtetit të Enver Hoxhës dhe destabilizimi i situatës së atëhershme politike në të gjitha vendet e Lindjes. Lordi konservator, Nikolas Bethel, i cili, ka shfletuar në arkiva dokumente të asaj kohe, thotë se: *“Shqiptarët, kishin pranuar të viheshin nën kujdesin britanik, për të përmbysur qeverinë komuniste shqiptare, që ata urrenin. Ata nuk e konsideronin veten kukulla, por patriotë, që luftonin për të*

⁶¹ Bethel Nicolas- *“Tradhëtia e Madhe.”* fq. 130.

⁶² Corke Jane-Sarah- *“Operacionet e fshehta,”* fq. 166-167.

⁶³ Corke Jane-Sarah- *“Operacionet e fshehta ...”* fq. 164-165.

çliruar vendin e tyre.” Filbi ishte caktuar bashkëkomandant i këtij operacioni.

Përpara anglo-amerikanëve dolën disa probleme në dukje të zgjidhshme, por ishin më të thella seç dukeshin. Problemi i parë ishte, vendi se ku duhej të formohet Komiteti? A duhet të përfshihej i gjithë emigracioni me fraksionet politike apo duhen mënjanuar grupe të caktuara?! A duhej të bënin pjesë në Komitet shqiptarët, që kishin bashkëpunuar me fashizmin?! Kush duhej të zgjidhej në krye si njeriu më i pakompromentur dhe më i pranueshëm për të gjithë?! A mund të veprime pa miratimin e mbretit Zog tashmë në mërgim?! Ky komitet, do kryente rolin e një qeverie në mërgim në rrugë diplomatike apo do hidhej në sulme konkrete, me veprime të armatosura? Përveç këtyre problemeve ekzistonte dhe një mosbesim ndër shqiptarët emigrantë, duke qenë se SHBA e kishte njohur qeverinë e E. Hoxhës, ndonëse përpjekjeve për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike nuk u realizuan kjo sepse shteti shqiptar konsiderohej si zonë influence e Bashkimit Sovjetik, ku ndryshonte me Perëndimin dhe nga pikëpamja ideologjike, ndonëse në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ishin vetë anglezët, që kishin ndihmuar me armë e municione si dhe në të holla komunistët shqiptarë e më pak grupet e tjera politike pro perëndimore.

Formimi i Komitetit dhe organizimi i brendshëm i tij. Ku duhej të formohet Komiteti?

Pavarësisht të gjithave, më 26 gusht 1949, u shpall në Paris formimi i Komitetit Kombëtar “Shqipëria e Lirë”,

nën kryesinë e patriotit të njohur Mit'hat Frashëri.⁶⁴ Po më 26 gusht të atij viti, gazetat e njohur amerikane, japin shënimet e veta *"The Christian Science Monitor"*, shkruan: *"Sipas lajmeve të besueshme në Paris u themelua Komiteti Kombëtar Shqipëria e Lirë, i cili do të ketë selinë në Shtetet e Bashkuara. Qëllimi i tij do të jetë përfaqësimi i të gjitha shtresave shqiptare të cilat dëshirojnë vendosjen e një qeverie e cila respekton të drejtat dhe liritë e shtetasve të vet. Në këtë Komitet përfshihen personalitete të shquara shqiptare, në sferën shoqërore dhe politike dhe do të ketë selinë e vet në New York. Formimi i Komitetit, bëhet në një kohë të paqartë kur forcat e armatosura greke po korrin fitore kundër guerriljeve komuniste, kur tensioni politik midis Titos dhe Stalinit po shkallëzohet. Dhe në një kohë kur Shtetet e Bashkuara po përcjellin me vëmendje gjendjen Ballkanike. Fakti që selia e këtij Komiteti të porsaformuar të jetë në Shtetet e Bashkuara lë të kuptohet se Ministria Jashtme Amerikane mbështet këtë përpjekje. Mit'hat Frashëri udhëheqësi i këtij grupit pritet të arrijë së shpejti në Amerikë."*⁶⁵

(...) Komiteti i ashtuquajtur "Shqipëria e Lirë", nuk doli si një kombinacion grupesh politike, por si një komitet që përfaqëson masën e shqiptarëve jashtë.⁶⁶ *Koalicioni i partinave e personalitetet qi e kryesonin e pas tyne, mbeshtetja e përkrahja e SHBA e t'Anglis e bane qe Komiteti në fillim gëzonte një prestigj e zhvillonte një propogand të fuqishme anti-komuniste*⁶⁷. Në shtator 1949, në takimin midis sekretarit të Departamentit të Shtetit, Din Aceson dhe sekretarit britanik, Ernest Bevin, në

⁶⁴ Lamaj Idriz, -Komiteti Kombëtar "Shqipëria e Lirë", New York 2000, fq. 21.

⁶⁵ Po aty, fq. 21-22.

⁶⁶ AMPJ Dosja 254, viti 1950. "Relacion mbi emigracionin politik shqiptar", fq. 29.

⁶⁷ Dokumente të siguruara nga arkivi personal i Xhemal Laçit.

Uashington, kur ato do të binin dakort, që të shfrytëzonin të gjitha mundësitë për ndryshimin e situatës në Shqipëri dhe rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri, si hallkën më të dobët në zinxhirin e bllokut sovjetik, ndaj dhe vendosën të intensifikonin përpjekjet, për ta dobësuar dhe eliminuar atë.⁶⁸

Në këtë takim, Bevini u tha Aqësonit, Gladvin dhe Levin Tomsonit, se politika e Britanisë kundrejt Enver Hoxhës, është politika e “armiqësisë së ndezur”, se ai shqetësohej të dinte “në se ne do të biem dakord përfundimisht se objektivi i përpjekjeve tona është të rrëzojmë qeverinë e Hoxhës kur të paraqitet rasti i parë. Por nëse Hoxha largohet, kush do ta zëvendësojë atë? –Ai ishte skeptik për Komitetin e ri shqiptar në mërgim dhe i tha Aqësonit se ajo që nevojitet është “gjetja e një personi, që mund të përdorim si lider në duart tona”.⁶⁹

A duhet të përfshihej i gjithë emigracioni me fraksionet politike apo duhen mënjanuar grupe të caktuara, a duhej të bënin pjesë në Komitet shqiptarët që kishin bashkëpunuar me fashizmin?!

Ekipi amerikan së bashku me atë anglez, shkuan për të negociuar në Romë me refugjatët shqiptarë. Detyra e tyre ishte të bindnin shqiptarët, që të pajtoheshin në mes tyre për caktimin e një presidenti dhe të një komiteti ekzekutiv, që do të formonin qeverinë e vendit pas çlirimit prej komunistëve.

Negociatorët perëndimorë i vlerësonin shqiptarët si

⁶⁸ *Historia e popullit shqiptar... (vitet 1939-1990)* vëllimi IV, Tiranë 2009. fq. 252.

⁶⁹ Bethel Nicolas, “Tradhëtia e Madhe.” fq. 119.

njerëz grindavecë dhe të leshtë nga mendja. Megjithatë duhet përmendur se shqiptarët kishin interesat e tyre ligjitime. Shumë prej tyre i shqetësonte ideja e kthimit të tyre në agjentë të amerikanëve e britanikëve, ideja se ata ishin blerë nga të huajt, për të sulmuar qeverinë shqiptare, sado e urryer që të ishte ajo. Përveç fraksioneve politike, që ndryshonin në parime të cilat kishin vepruar brenda Shqipërisë politike gjatë Luftës së Dytë Botërore, ekzistonte dhe grupi i Kosovës me liderin e saj ing. Xhafer Devën, një figurë luajale dhe kyçe gjatë dhe pas luftës. Një tjetër figurë e rëndësishme ishte dhe kapidan Ndue Gjon Marku, që ka organizuar hedhjen e parashutistëve të grupit ing. Xhafer Devës, dhe ka këmbëngulur, që në Komitet të përfshihej dhe intelektual i shquar ing. Xhafer Deva, për faktin se ishte njeri me influencë në Veri dhe Verilindje të Shqipërisë Etnike.⁷⁰

Në vitet 1948-1949, kur për shumë emigrantë kishte më shumë fjalë se punë, Xhafer Deva përpiqet, që brenda trupit të KKSHL që po themelohej, të përfaqësohej edhe Kosova me viset e tjera të robëruara nën Jugosllavi, pa marrë parasysh se cili do të ishte përfaqësues. Ai ndikoi zhdrejtasi tek anglezët, që çështja e Shqipërisë etnike të mos ndahej prej problemit të shtetit të cunguar shqiptar.⁷¹

Përpjekjet e kapidanit Ndue Gjon Markut hasin në pengesë për mospranimin e tij në Komitetin e parë nga ana e përfaqësuesve të organizatës Balli Kombëtar.

Për sa i takon organizimit të brendshëm të Komitetit, ai do drejtohej nga një Komitet Ekzekutiv nën kryesinë e Mit'hat Frashërit me anëtarë Abaz Kupin, Seit Kryeziun, Zef Palin dhe Nuçi Koten. Vdekja e papritur e Frashërit, tronditi Komitetin por vendin e tij e zuri Hasan Dosti. Përveç kësaj,

⁷⁰ Referuar shkrimit të Tomë Mrijaj- "Kapidani Ndue Gjon Marku me histori dhe dhe sot." Gazeta Illyria, 13-15 prill, 2004.

⁷¹ Lamaj Idriz- "Xhafer Deva në dritën e letrave të veta" New York, 2002, fq. 9.

funksiononte dhe një Komitet i Përgjithshëm Konsultativ, me përbërje më të gjërë, u krijua dhe junta ushtarake, që ishte një organ sekret, që do kontrollonte planet ushtarake. Junta u kryesuar nga monarkisti Abaz Kupi me dy zëvendës Abaz Ermenjin dhe Seit Kryeziun, dhe sekretar i juntës u zgjodh Gaqi Gogo.

Në deklaratën e miratuar në Londër në shtator 1949, theksohej se qëllimi i KKSHL ishte lufta për të fituar pavarësinë e Shqipërisë dhe për të siguruar sovranitetin e integritetin e saj.⁷² Krijimi i KKSHL i dha frymëmarrje aktivitetit antikomunist të emigracionit politik. Komiteti ndoqi dy rrugë për të zhvilluar aktivitetin e tij propogandën dhe me veprime të armatosura, duke hedhur parashutistët në zonat, ku ishin çetat antikomuniste. Operacioni i viteve 1949-1953, që u financua nga anglo-amerikanët synonte çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha komuniste e vendosjen aty të një regjimi pro perëndimor.⁷³

Ndonëse angazhimi anglo-amerikan nuk pranohej hapur dhe konsiderohej si sekret. Në fakt konspiracioni anti-Hoxha ishte vetëm një element i vogël në politikën Ballkanike të aleatëve perëndimorë. Dhe meqë Shqipëria ishte vendi më i vogël i Ballkanit, në çdo moment mund të sakrifikohej në favor të interesave më të rëndësishme që kishin amerikanët me fqinjët më të mëdhenjë të Shqipërisë.⁷⁴ Komiteti më 6 shtator të vitit 1950 nxori në qarkullim numrin e parë të gazetës “*Shqipëria*” si organi zyrtar propogandues. Nuk dihet për personat drejtues të saj, ajo që theksohet është aspiratat e Komitetit Kombëtar “Shqipëria e Lirë” dhe lidhjet e ngushta me Komitetin “Europa e Lirë” dhe me komitetet e tjera të vendeve, që ndodhen nën sundimin komunist. U krijua dhe radioja “Zëri i Shqipërisë së Lirë”, ku emisioni i parë

⁷² *Historia e popullit (1939-1990) ...*, fq. 271.

⁷³ *Po aty*, fq. 272.

⁷⁴ Bethel Nicolas, “*Tradhëtia e Madhe*.” fq. 124

i saj filloi më 13 shtator 1951. Që në fillim KKSHL filloi përpjekjet për të shtrirë ndikimin e misonit të vet nacionalist te anëtarët e federatës “Vatra” dhe të organizatës “Shqipëria e Lirë”,⁷⁵ megjithëse nuk gjeti mbështetjen e duhur, për shkak të qëndrimit të këtyre organizatave pro regjimit komunist të E. Hoxhës.

Gjatë viteve 1949-1953 edhe qeveria britanike i bashkoi përpjekjet e saj me ato amerikane, për të rrëzuar regjimin komunist në Shqipëri, përmes inkurajimit dhe mbështetjes së grupeve të armatosura antikomuniste brenda dhe jashtë vendit.⁷⁶ Edhe pse britanikët kishin dështuar në tentativën e mëparshme ata sërish nuk mund të ngelnin prapa amerikanëve.

A mund të veprohej pa miratimin e mbretit Zog tashmë në mërgim? A do e mbështeste mbreti këtë nismë?!

Zogu, mbronte pozitën se ai nuk kishte abdikuar nga fronin, se ai ishte larguar nga vendi i tij me miratimin e parlamentit e të popullit të tij, për shkak të agresionit të huaj. Njoftimi i parë perëndimor rreth operacionit shqiptar, arriti tek mbreti Zog në maj të 1949, në pritjen që u bëri dy delegatëve

“

Në deklaratën e miratuar në Londër në shtator 1949, theksohej se qëllimi i KKSHL ishte lufta për të fituar pavarësinë e Shqipërisë dhe për të siguruar sovranitetin e integritetin e saj.

”

⁷⁵ Lamaj Idriz, *Komiteti Kombëtar “Shqipëria”* fq. 25.

⁷⁶ *Historia e popullit (1939-1990....)*, fq. 25

amerikanë, Robert Lou dhe Robert Minor në vilën e tij në Aleksandri të Egjiptit, ky takim u duk se shkoi mirë.

Por në takimin e dytë, ku morën pjesë dhe delegatët britanikë, mbreti nuk ra dakort për krijimin e qeverisë në mërgim, pas disa ditësh të deleguarit e Fuqive të Mëdha erdhën sërish të takonin Mbretin, por me propozime të modifikuara, ku diplomacia e emrit bindi mbretin e mërguar për krijimin e qeverisë.

Ky ishte dhe akti më i komplikuar politik i anglo-amerikanëve, që duhej të ekzekutohej pa u rënë zarët nga duart, pra bindjen e mbretit Zog dhe marrjen e miratimit prej tij, duke qenë se pjesëmarrja e Mbretit në Komitet ishte e pamundur. Nuk kishte asnjë mënyrë tjetër, që pozicioni i tij ta lejonte atë të merrte pjesë në ndonjë organ përfaqësues shqiptar, përveçse si lider i tij. Dhe çdo njeri e dinte se nëse do të projektohej qenia e tij si kryetar i ndonjë organi të tillë, njerëzit e Ballit do të tërhiqeshin menjëherë prej tij. Nga ana tjetër, nënshtrimi e pranimi i tij i planit politik dhe ushtarak ishin thelbësore, sepse në qoftë se ai e denonconte atë plan, të gjithë monarkistët do ta denonconin atë gjithashtu dhe do ta braktisnin.⁷⁷

Me realizimin me sukses të masave parapërgatitore diplomatike, ishte koha të ndërmerreshin hapat përgatitore ushtarake.

Cili ishte qëndrimi që mbajtën fqinjët?

Vlen të përmendet situata dhe qëndrimet e vendeve fqinje, për të kuptuar se pse u zgjodh Shqipëria nga anglo-amerikanët. Pas vitit 1948, me prishjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë, Shqipëria u rrethua nga pikëpamja

⁷⁷ Bethel Nicolas-*Tradhëtia e Madhe.* fq. 64.

gjeografike me vende, qeveritë e të cilave ishin rreshtuar hapur kundër regjimit komunist në Tiranë.

Për një periudhë trevjeçare (1950-1953), që përkoi dhe me rritjen e trysnisë së Bllokut Përëndimor, për të rrëzuar regjimin komunist në Shqipëri, Beogradi zbatoi një politikë të ashpër antishqiptare. Ai hyri në lidhje dhe me qeveritë perëndimore e ato fqinje, jo thjesht kundër qeverisë së Tiranës, por edhe kundër interesave kombëtare të Shqipërisë.⁷⁸Për sa i përket Greqisë, ajo mori pjesë aktive në zbatimin e planeve të hartuara në perëndim, gjatë viteve 1949-1953, për të rrëzuar regjimin komunist në Shqipëri.

Më 2 maj 1949, me nismën e palës italiane, u vendosën marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve. Por qeveritë e dy vendeve vazhduan të qëndronin në pozita të ngurtësuara, të kushtëzuara dhe nga klima e përgjithshme e Luftës së Ftohtë midis dy blloqeve.⁷⁹Vlen të përmendet dhe korrespondenca e Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë me Ministrinë e Jashtme Italiane për kthimin e refugjatëve shqiptarë, që ndodheshin nëpër kampe të ndryshme, të cilët po vepronin kundër regjimit të Enver Hoxhës, mosbashkëpunimi i qeverisë italiane mund të çonte dhe në ftohjen e marrëdhënieve mes dy vendeve.*⁸⁰

Në një notë proteste dërguar Legatës Italiane në Tiranë, iu kërkua qeverisë italiane, që të hiqte dorë menjëherë nga aktiviteti armiqësor, si dhe të dorëzonte “kriminelët e luftës” shqiptarë, që strehoheshin në Itali, një kopje e notës i është dërguar dhe sekretarit të Kombeve të Bashkuara.⁸¹

⁷⁸ *Historia e popullit (1939-1990...*, fq. 256.

⁷⁹ *Historia e popullit (1939-1990 ...*, fq. 254.

⁸⁰ * **Shënim:** Në Arkivin e 3.MPJ Shqiptare ndodhen korrespondencat me MPJ Italiane për çështjen e emigrantëve.

⁸¹ AMPJ Dosja 254, viti 1950, fq 16. Legatës Shqiptare në Romë.

CIA përgatit njerëzit e vet, plani ushtarak në Myhni. Kompania 4000.

Situata politike pas prishjes me Titon dukej qartë, që ishte në disfavorin e Enver Hoxhës. Kësisoj, Frank Wisner dhe planifikuesit e tjerë të CIA-s vendosën krijimin e Kompanisë 4000, një njësi paraushtarake shqiptare, e cila do të përdorej për Misionet Klandestine kundër Shqipërisë. Në korrik të vitit 1949 OPC dhe CIA, caktuan oficerin e tyre të operacionit, që do të shkonte në Europë, për organizimin e forcave guerrile shqiptare, ai ishte Majkëll Burke. Ky rast klinik, do të ishte një eksperiment në veprimtarinë e Luftës së Ftohtë. Qëllimi ishte të provohej nëse ishte e mundur të rrëzohej ose të destabilizohej një qeveri komuniste, nëpërmjet kombinimit të veprimeve politike të hapura me veprimet sekrete paraushtarake. Operacionet amerikane ishin më ambicioze se ato britanike megjithëse në zbatim do përdroreshin të njëjtat forma. Për operacionet u përdor Gjermania Jugore, duke qenë se ishte e pushtuar nga SHBA. Këshilltari special i CIA-s Nojvil, hodhi idenë e maskimit të rekrutëve shqiptarë, që do përdroreshin për operacione subversive, duke i cilësuar ata si “batalione pune”, nën komandën e ushtrisë amerikane, sepse kështu nuk ngjallnin dyshime.

Kompania 4000, ishte një njësi e përbërë nga 250 emigrantë komando shqiptarë, nën komandën amerikane, por me oficerë shqiptarë, me hierarki të tyre, me kapter dhe rreshterë, efektivit për atë njësi ishte zgjedhur sipas çelësit kombëtar, i ngjashëm me vetë Komitetin Shqiptar, dy të pestat ruajalistë dy të pestat Balli Kombëtar dhe një e pesta të pavarurit.⁸²

Pasi u gjet ambienti që ishte një vilë e madhe e rrethuar

⁸² Fejtone të Luftës së Ftohtë, marrë nga revista “Danas”.

me një mur të lartë dhe e vendosur në një kodrinë jashtë Hajdelbergut, me pamje nga lumi Necker. Shpejt erdhën rekrutët e parë, që do instruktoheshin nga amerikani Thomas Mangeli. Arrijnë në fillim Abaz Kupi, Abaz Ermenji e Sait Kryeziu, me sekretarin Gaqi Gogo, të gjithë ishin ruajalistë. Në grupin e ardhshëm arrijnë Çauash Basho ballist i vjetër dhe kolonel Xhemal Laçi monarkist, që kishte ndjekur akademinë ushtarake italiane dhe ishte njëri nga pesë shqiptarët me shkollë në stërvitje themelore ushtarake. Rekrutët, që do hidheshin në malet e Shqipërisë, pasi bënë formalitetet e kontrollin shëndetësor dhe morën uniformat dhe u ndanë në tri toga.

Toga e parë, ishte e mbushur me monarkistë që komandoheshin nga kolonel Xhemal Laçi, toga tjetër që përbëhej nga 30 ballistë drejtohej nga Sami Butka, ndërsa toga tjetër, që kishte 12 monarkistë, 5 ballistë dhe 13 ithtarë të Sait Kryeziut. Togën e tretë e komandonte Kolë Hila, ndërsa pasuesit e Kryeziut quheshin “agrarë”. Ajo që binte në sy, është se shumica nuk kishin arsim ushtarak, ku kishte dhe analfabetë. Në Fjetonin “Analet e Luftës së Ftohtë”, instruktorët amerikanë, ishin të vetëdijshëm se dhe ata të arsimuarit në shkolla ushtarake italiane, dashje – pa dashje ishin të lidhur me italianët, por ky mendim nuk vlente për kolonel Xhemal Laçin, që e konsideronin si të pastër.

Detyra e rekrutëve ishte të ruanin depo municionesh si dhe të përgatiteshin fizikisht, të stërviteshin me armë, të mësonin të përdornin eksplozivin, radioaparaturën, parashutën etj.

Ditët po kalonin dhe stërvitja bëhej më intensive më 11 tetor 1950 oficer komanduesi amerikan Thomas Mangelly thirri dy oficerët shqiptarë më të lartë, për nga grada,

majorin Çausht Basho të Ballit Kombëtar dhe kapitenin Xhemal Laçin të rrymës ruajaliste. Ua lexoi urdhrin për shkuarjen e grupit të parë të komandove në shkollën speciale për guerrilje në Hajdelberg. Ishin zgjedhur 16 njerëz nga të tri grupet politike, të përfaqësuar në “Çetën 4000”. Raujalistët ishin Adem Gjura, Salih Daliu, Llesh Nikolla, Ali Rama, Iljaz Toptani, Daver Agai, Xhetan Daci dhe Ramadan Cenaj. Njerëzit e Ballit Kombëtar, ishin Xhemal Mara, Sadik Bega, Harun Aga dhe Miftar Planeja, ndërsa agrarët e Kryeziut ishin Selim Daci dhe Rexhë Berisha. Pas përgatitjeve të fundit i dërguan në Athinë dhe nga aty do lëshoheshin me parashuta në malet e Shqipërisë.

Ishte vendosur që Adem Gjura, Salih Daliu, Selim Daci, Iljaz Toptani, Xhetan Daci të lëshoheshin me parashuta në rajonin e Martaneshit, ndërsa Ramadan Cenaj, Miftar Planeja, Halil Nerguti dhe Rexhë Berisha të lëshoheshin në veri të Kukësit, në rajonin e Lumës. Ishin zgjedhur këto rajone si pika hedhjeje sepse mendohej se antikomunistët vepronin aty dhe parashutistët mund të bashkoheshin me ta. Dhe në fakt ashtu ishte. Shumë shqiptarë nacionalistë qëndruan maleve të Shqipërisë së Veriut me shkodranë e mirditorët në krye si: Dr. Mark Gjomarkun, Llesh Gjomarkun, dom Zef Oroshi, Mirakajt, Prek Calin, Gjon Destanishën, Jup Kazazin, kapiten dr. Gjelosh Lulin në bashkëpunim me çetat nacionaliste të Kosovës të kryesuara nga prof. Ymer Berisha, Uk dhe Shaban Sadiku, Ndue Përlleshi, Shaban Polluzha, Mulla Idriz I Gjilanin dhe heroinën e pamposhtur shkodrane Marie Shllakun etj.⁸³

Këta i kallnin datën komunistëve, dhe vetëm mposhtja

⁸³ Mrijaj, Tomë. “Parashutisti Alush Lleshanaku shembull i rezistencës antikomuniste deri në vdekje”.

e tyre mund t'i siguronte jetëgjatësi sistemit, që erdhën në pushtet, me zgjedhje dhe vota antidemokratike, veprimtaria e çetave të maleve rezistoi heroikisht deri në fillimin e viteve 1950.

Grupe të tjera parashutistësh që u hodhën në atdhe ishin Hamit Matjani, Zenel Shehu, Halil Branica, Haxhi Gjyle, Xhelo Tresova dhe Tahir Prençi. Halil Branica u sëmur, por u hodh një ditë më vonë. Hedhja e grupit u bë në Korçë. Por bazat, që konsideroheshin si të sigurta dhe më të përshtatshme ishin Martaneshi, Bulqiza dhe Mati.

Në radiogramët që dërgoheshin situatë në Shqipëri dukej favorizuese dhe shpresëdhënëse. Por realiteti qëndronte ndryshe shumë nga rekrutët ishin kapur nga Sigurimi ose ishin paditur nga familjet që i kishin strehuar.

Grupe të tjera ishin ai i Mirditës, Shkodrës që përbëhej nga Kolë Çuni, Gjon Gjinaj, Pjetër Gjoci, Bardhok Gjeta, Ndue Frisku, Mirash Marku, Nikoll Marku, Pashko Leta e Zef Luka, Ndue Melyshi, Ndue Pjetri Gjemarkaj grupi i Elbasanit përbahej nga Alush Lleshanaku, Halil Hoxha, Rexhep Kasa, Zenel Cena, Nuri Plaka, Abedin Xhango, e grupi tjetër përbahej prej Xhevdet Blloshmit, Shqyri Biçakut, Isa Kallos, Kamber Allës.⁸⁴

Peripecitë, që kaluan në malet e Shqipërisë janë të panumërta, megjithëse vazhdonin t'i jepnin kurajo njëri-tjetrit duke besuar se situata në Shqipëri do ndryshonte shumë shpejt. Ushtarët e lirisë, sakrifikuan gjithçka deri dhe jetën e tyre dhe të familjeve për ideale, për një Shqipëri të lirë e demokratike. Tradhëtia e agjentit të dyfishtë Kim Filbit, bëri që operacioni amerikan të dështonte, që në hapat e parë të tij. Ishte Radio-Tirana, që dha lajmin e kobshëm duke i dhënë grushtin përfundimtar në fund të këtij viti, ku njoftoi

⁸⁴ Luka Zef "Njiqind shqipe që erdhën me prue lirne-Ditar", fq. 60-61.

se prijësit e operacionit si dhe shumë komando lokale ishin në duart e Sigurimit dhe se prisnin gjykimin.

Faktet u bënë të qarta, në prill të vitit 1954, kur në Tiranë filloi gjykimi. Katastrofa dhe mos suksesi i operacionit shqiptar, ishin shumë më të mëdha sesa mund të merrte me mend CIA. Për 18 muaj Sigurimi, kishte dërguar radiomesazhe të rreme pasi ishte këshilluar e njoftuar nga Shërbimi Sekret Rus.

Hamit Matjani u dënua me varje në litar, ndërsa të tjerët me pushkatim, për shtatë ditë u trumpetua me të madhe e u dekonspirua e gjithë veprimtaria politike e mërgatës shqiptare, duke dekonspiruar në Radio –Tirana, jo vetëm operacionin Shehu-Matjani, por dhe pesë vjetët e luftës dhe të intrigave me emigracionin shqiptar.

Arrijmë në përfundim, se misionet klandestine amerikane dhe Kompania 4000 ishin përpjekja e vetme serioze për rrëzimin e regjimit komunist të Shqipërisë. Me gjithë dështimin në misionin e saj, përsëri ky grusht burrash larg vendit të vet la gjurmë në një prej momenteve kyçe të historisë së Luftës së Ftohtë.

Por si do t'i gjykojë historia këta shqiptarë të rinj: si tradhtarë të vendit të tyre apo thjeshtë idealistë, që kërkonin një Shqipëri ndryshe?! A e dhanë jetën për një Shqipëri të Lirë apo për lojërat politike të çastit?!

Gjithsesi sakrificat e tyre duhet nderuar dhe koha do të jap përgjigjen e duhur.

Bibliografia

- Eugjen Merlika "Mustafa Kruja në historinë Shqiptare. 2012.
- Bethel Nicolas, "*Tradhëtia e Madhe.*" Tiranë 1993.
- Historia e popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj. (Vitet 1939-1990) vëllimi IV*, Tiranë 2009.
- Mrijaj, Tomë. "Parashutisti Alush Lleshanaku shembull i rezistencës antikomuniste deri në vdekje".
- Luka, Zef "*Njiqind shqipe që erdhen me prue lirne-Ditar*". AMPJ Dosja 254, viti 1950, fq 16. Legatës Shqiptare në Romë.
- Fejtone të Luftës së Ftohtë, marrë nga revista "Danas".
- Corke, Jane-Sarah- "*Operacionet e fshehta dhe strategjia e Luftës së Ftohtë e SHBA*" Globus R, 2010.
- Philby, Kim- "*Lufta ime e heshtur*". Shtëpia Botuese Onufri, 2004.



| Prof. asoc. dr. Pranvera Teli (Dibra)

Pranvera Teli (Dibra), ka lindur në qytetin e Shkodrës në vitin 1972. Arsimin fillor e të mesëm e ka kryer në qytetin e lindjes. Studimet Universitare në Degën e Historisë i ka ndjekur në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, 1990-1994. Më pas ka vazhduar studimet pasuniversitare 1-vjeçare në programin Master në Histori pranë Central European University, Kolegji i Budapestit. Në shtator të vitit 1995 ka filluar punën si pedagoge e lëndës së “Historisë Bashkëkohore të Evropës dhe SHBA”, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Historisë. Në shkurt të vitit 2001 fitoi gradën shkencore “Doktor i Shkencave” në Histori, në UT, Fakulteti Histori-Filologji, Departamenti i Historisë. Në vitin 2007 mori titullin shkencor “Profesor i Asociuar” po në Histori. Nga maji i viti 2001 e në vazhdim drejton Drejtorinë e Arkivit Historik pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Megjithatë nuk i ka ndërprerë asnjëherë angazhimet e saj në mësimdhënien si lektore e jashtme pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, dhe në kërkimin shkencor. Ajo është pjesëmarrëse në disa konferenca shkencore dhe botuese e disa punimeve shkencore, monografi, artikuj e kumtesa në fushën e historisë së politikës së jashtme shqiptare gjatë shekullit XX.

EPILOGU I NJË DIKTATURE.

NGA “TERRORIST” NË “TË

PADËNUESHËM” I NDANTE

VETËM NJË DET. RRËMBIMI I

PESHKAREXHËS “DUKATI” PËR

ARRATISJE NË ITALI, 6 JANAR 1989

Radhët e emigracionit shqiptar jashtë vendit, kategorisë që kishin lënë Shqipërinë pas vendosjes së regjimit komunist në vend, shtoheshin vazhdimisht nga njerëz të guximshëm që nuk pranuan më, as zinxhirët politikë në Shqipëri dhe as jetesën e rënduar ekonomike për ta dhe familjet e tyre. Pavarësisht nga arsyet që i detyruan të linin vendin e tyre të lindjes dhe familjet, ata etiketoheshin nga regjimi si “reaksonarë”, “tradhtarë”, e në gjysmën e dytë të viteve

'80-të edhe si “terroristë”. Çdo kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror konsiderohej vepër penale e parashikuar në nenin 13 e 127 të Kodit Penal të RPSSH.¹

Ngjarja e analizuar në punim është një arratisje e ndodhur në janarin e vitit 1989, vetëm një vit e gjysmë para se shqiptarët të kapërcenin kangjellat e ambasadave të huaja në Tiranë, për të kërkuar largimin e tyre nga Shqipëria, ngjarje që simbolizoi shembjen e “Murit të Berlinit” shqiptar. Nga ana tjetër, kjo ngjarje ndodhi po ashtu pas tre vitesh diskutimi e marrëdhëniesh të tensionuara midis Tiranës e Romës zyrtare, për trajtimin e çështjes së gjashtë Popajve dhe hyrjes së tyre në ambasadën italiane në dhjetor 1985, pak muaj pas vdekjes së diktatorit. Ky incident kishte bllokuar marrëdhëniet dypalëshe midis dy vendeve, duke frenuar në këtë mënyrë shumë procese bashkëpunimi të nisura më parë. Nga ana tjetër kjo ngjarje e kishte bërë shumë të ndjeshëm opinionin publik e mediatik italian, duke detyruar parlamentin italian të merrej me trajtimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe duke i kërkuar qeverisë italiane të qëndronte fort në respektimin e të drejtave të Popajve, që kishin kërkuar azil politik në territorin e ambasadës italiane. Media italiane transmetonte të plota zhvillimet politike në Itali rreth kësaj çështjeje. Kanalet televizive italiane ndiqeshin fshehurazi nga shqiptarët, dhe shpesh shërbyen si burim informacioni e nxitjeje për të kërkuar një jetë më të mirë për familjet e tyre.

Ndërkohë kushtet e vetë izolimit ekstrem në Shqipëri kishin sjellë si pasojë direkte një krizë të rëndë ekonomike në vend dhe pa stabilitet e pakënaqësi për situatën politike në vend. Në këto kushte udhëheqja politike shqiptare e

¹ Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më tej AMEPJ), fondi i MPJ, viti 1989, d. 494, fl. 93, Korrespondencë midis Hetuesisë së Përgjithshme dhe MPJ, 13 janar 1989.

detyruar filloi një lloj hapjeje të kontrolluar drejt Perëndimit, por pa prekur parimet e saj ideologjike. Në kuadër të këtyre përpjekjeve u vendosën marrëdhëniet diplomatike me Gjermaninë në vitin 1987, Shqipëria mori pjesë për herë të parë në takimin e ministrave të jashtëm të Ballkanit, shkurt 1988. Njëkohësisht Tirana zyrtare filloi të interesohet për rregullat e pranimit në Tregun e Përbashkët Evropian, meqenëse ishin kufizuar shumë importet e eksportet me vendet anëtare të këtij blloku, për sa kohë Shqipëria nuk e njihte këtë organizatë. Por, rruga drejt Tregut të Përbashkët Evropian ishte e vështirë. Aq më e vështirë bëhej kur tek qeveria shqiptare nuk kishte vullnet politik për të bërë ndryshimet e duhura politike, rrugë të cilën po ndiqte e gjithë Evropa Lindore.

Italia duke qenë vendi më i afërt dhe me lidhje historike me Shqipërinë dhe shqiptarët, do të ishte edhe dëshmitare e braktisjeve të para të vendit dhe kërkesave për strehim politik në Itali, nga shumë shqiptarë që guxuan të bënin një hap të tillë. Kjo dukuri jo vetëm do të tensiononte marrëdhëniet ndërmjet dy

“

Italia duke qenë vendi më i afërt dhe me lidhje historike me Shqipërinë dhe shqiptarët, do të ishte edhe dëshmitare e braktisjeve të para të vendit dhe kërkesave për strehim politik në Itali, nga shumë shqiptarë që guxuan të bënin një hap të tillë. Kjo dukuri jo vetëm do të tensiononte marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve me regjime krejt të ndryshme politike, por edhe do të trajtohej në dy këndvështrime të ndryshme nga të dyja palët.

”

vendeve me regjime krejt të ndryshme politike, por edhe do të trajtohej në dy këndvështrime të ndryshme nga të dyja palët. Mjaft domethënës është edhe qëndrimi ndaj një ngjarjeje, që nga njëra anë tronditi jo pak marrëdhëniet shqiptaro-italiane, dhe nga ana tjetër do të rriste presionin e Italisë për respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Më 6 janar 1989, rreth orës 22:00, anija e peshkimit “Dukati”, pronë e Ndërmarrjes së Peshkimit të qytetit të Durrësit, gjatë kohës së peshkimit në detin Adriatik, devijoi kursin e saj dhe mbërriti në afërsi të portit të Brindisit në Itali.

Kjo ishte vepër e kapitenit të saj Enver Meta, 30 vjeç i martuar me një fëmijë, dhe e marinarit Bardhyl Vogli 22 vjeç. Të dy kishin izoluar dhe vënë nën presion 7 anëtarë të tjerë të ekuipazhit, ndërkohë që në anije ata kishin strehuar edhe 7 persona të tjerë, shokë e familjarë që donin të largoheshin nga Shqipëria. Në të zbardhur të datës 7 janar anija e peshkimit “Dukati” mbërriti në Brindisi.

Metë, Vogli, dhe 7 personat e tjerë të fshehur në anije kërkuan strehim politik në Itali, ndërsa pjesa tjetër e izoluar e ekuipazhit kërkoi kthim në atdhe bashkë me anijen. Veprimet e Tiranës zyrtare ishin të shpejta. Me t’u vënë në dijeni, në mëngjes herët të 7 janarit 1989, Ministria e Punëve të Jashtme urdhëroi diplomatët e ambasadës shqiptare në Romë të niseshin urgjentisht në Brindisi për të takuar autoritetet italiane. Njëkohësisht, u njoftua ministri i Jashtëm Reis Malile, që ndodhej në Paris për vizitë pune. Po atë ditë, pa bërë asnjë analizë të shkaqeve të kësaj ngjarjeje, në Ministrinë e Punëve të Jashtme u thirr ambasadori italian dhe iu dorëzua një notë verbale, ku kërkohet që nën frymën e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, të ndërhyhej pranë autoriteteve përkatëse, për kthimin në Shqipëri të anijes së peshkimit “Dukati”, së bashku me 7 anëtarët e ekuipazhin e

saj, ndërsa për “anëtarët e bandës së organizuar terroriste”, siç i quante ata qeveria shqiptare, t’i dorëzoheshin drejtësisë shqiptare në përputhje me normat e njohura të së drejtës ndërkombëtare.²

Në notë këto persona akuzoheshin për një sërë akuzash si kontrabandistë, probleme me drejtësinë shqiptare, persona në ndjekje nga organet e policisë shqiptare etj., gjë që nuk shkonte me regjimin e brendshëm në Shqipëri. Një person me problem me drejtësinë nuk mund të ishte kapiten i një anijeje në një regjim të tillë politik, si ai komunist në Shqipëri.

Pala shqiptare e konsideroi përdorimin e anijes “Dukati” jashtë territorit shqiptar si rrëmbim i pronës shtetërore nga banda terroriste, ndërkohë që anija ishte vetëm mjeti për t’i dërguar ata në Itali, pasi anija iu dorëzua menjëherë organeve shtetërore italiane, të cilat do ta kthenin atë në Shqipëri. Ndërkohë këto akuza tingëllonin të rënda për palën italiane.

Zëvendësministri i Jashtëm Sokrat Plaka i kërkoi ambasadorit italian që në kuadër të marrëdhënieve të mira midis dy vendeve, të ktheheshin në atdhe të gjithë të arratisurit e cilësuar “terroristë”. Në fakt, ambasadori bëri të qartë faktin se nëse personat e akuzuar kishin shkelur në tokë italiane ata duhej të ekstradoheshin sipas normave juridike ndërkombëtare. Për ambasadorin e rëndësishme ishte që në këtë ngjarje nuk kishte pasur viktime, që për palën shqiptare dukej një fakt i parëndësishëm dhe nuk përmendet asnjëherë gjatë trajtimit të ngjarjes. Për zyrtarin e lartë shqiptar “*ky moment ishte një rast i mirë për të treguar luftën tonë të vendosur të përbashkët kundër terrorizmit*”.³

2 ² AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.4-5, Notë e MPJ për ambasadën italiane në Tiranë, 7.1.1989.

3 ³ AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.9-10, Informacion i takimit të S. Plakës me ambasadorin italian, 7 janar 1989.

Azilkërkuesit u dërguan në Komisarjatin e Policisë duke hapur për ta proces hetimor, ndërkohë që filluan procedurat për kthimin në Shqipëri të anijes dhe pjesës tjetër të ekuipazhit.

Ndërkohë, ambasada shqiptare në Romë kreu takime me autoritetet e policisë italiane, kapitanerinë e portit, prokurorinë, dhe në Ministrinë e Jashtme italiane dhe transmetoi kërkesën e qeverisë shqiptare për kthimin në atdhe të gjithë personave që ndodheshin në bordin e anijes.

Ministria e Jashtme italiane u përgjigj se kërkesa për azil politik e një pjese të personave të mbërritur në Itali kërkonte që problemi të trajtohej nga Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët, ku Italia ishte anëtare.

Prokuroria e Brindisit nga ana e saj deklaroi se personat e mbërritur në Itali do të trajtoheshin në përputhje me legjislacionin italian e atë ndërkombëtar për ekstradimet. Në këtë rast ata kërkonin informacion nga drejtësia shqiptare për “veprimtarinë e tyre kriminale e kontrabandiste” në Shqipëri.⁴

Prokuroria e Brindisit vuri në dijeni përfaqësuesit e ambasadës shqiptare në Romë, se ata do të ishin në kontakte të ngushta me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme italiane për trajtimin e rastit.⁵

Pjesa e ekuipazhit që do të kthehej me dëshirën e tyre u mor në pyetje në prezencën e përfaqësuesve të ambasadës shqiptare, të cilët morën edhe rolin e përkthyesit. Normalisht të frikësuar, të pyeturit kërkuan të gjithë dënimin e “terroristëve”.

4 AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.19, Komunikim i ambasadës shqiptare në Romë me MPJ, 7.1.1989

5 AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.41-44, Relacion i ambasadës shqiptare në Romë për MPJ, 10.1.1989

Por, ky teatër po ndodhte në tokën italiane dhe ky ishte fati i Enver Metës e shokëve të tij.

Reagimi në të njëjtin qëndrim i institucioneve italiane doli jashtë pritshmërisë të palës shqiptare. Ministria e Jashtme shqiptare i kërkoi ambasadës së saj, që këto informacione, që vinin nga institucionet italiane të mos bëheshin publike dhe të këmbëngulej shumë që *“terroristët të na dorëzohen, të kthehen në atdhe, nesër maksimumi, pavarësisht nga hetimet”*. Mesa duket mungonte një dosje konkrete akuzash nga drejtësia shqiptare.⁶ Lajmi u bë publik në Itali, por jo në Shqipëri. ANSA telefoni në ambasadën shqiptare në Romë, por përgjigjja ishte se nuk kishin të dhëna të plota. Pala italiane këmbënguli që hetimet të përfundonin për 2 anëtarët e ekuipazhit që akuzoheshin për sekuestrim personi, ndërkohë që po pyeste të gjithë pjesëmarrësit në ngjarje. Ambasada u vu në dijeni nga burimet e policisë italiane, se nëse personat që kishin organizuar arratisjen rezultonin njerëz të ndershëm, atyre do u jepej azil politik në Itali, në të kundërt do të akuzoheshin për terrorizëm.

Tirana zyrtare iu përgjigj negativisht kërkesës së palës italiane për të dhëna shtesë nga drejtësia shqiptare për këta persona dhe vazhdoi të këmbëngulte që të gjithë personat të ktheheshin në atdhe, e të gjykoheshin këtu, për veprimtarinë e tyre terroriste.

E ndodhur nën presionin e drejtësisë italiane për dorëzimin e provave të tjera që mund të implikonin këto persona si terroristë nga njëra anë dhe mungesa e provave nga ana tjetër, qeveria shqiptare po përpiqej të kthente në Shqipëri për gjykim të arratisurit, ndryshe kjo ngjarje do

6 AMEPJ, Fondi i MPJ,V.1989, D.494, fl.20, Komunikim i ambasadës shqiptare në Romë me MPJ, 7.1.1989

të shërbente si precedent për shumë shqiptarë të tjerë, të mbërthyer nga kushtet e vështira ekonomike.

Pala shqiptare këmbënguli që anija të kthehej bashkë me “terroristët” brenda dy ditëve pavarësisht nga hetimet, por këto presione nuk ndryshuan qëndrimin e qeverisë italiane për t’i çuar hetimet deri në fund. Këtë qëndrim të qeverisë italiane e mbështeti fuqishëm media italiane e pavarur. Nën titujt *“Refugjatë apo terroristë? Sot e vërteta për anijen shqiptare. Komandanti i akuzuar për sekuestrim personi, do të gjykohet në Brindisi. Për ambasadën ata janë terroristë dhe trafikantë”*, publiku italian u ndërgjegjësua se çfarë po ndodhte në fakt ndërmjet dy vendeve. Vetëm me datë 9 janar, para këmbënguljes italiane që hetimet të vazhdonin në Itali, qeveria shqiptare kuptoi se dy botët ishin larg njëra-tjetrës. Më 9 janar anija “Dukati” u nis për në Durrës pa grupin terrorist.

Vetëm atëherë qeveria shqiptare bëri publik lajmin brenda vendit, sikurse njoftoi të gjitha përfaqësitë shqiptare jashtë vendit, për veprën e bandës së organizuar terroriste. Ndërkohë që u mundësua kthimi i anijes “Dukati” në portin e Durrësit, për Enver Metën dhe njerëzit që e shoqëronin dhe kishin kërkuar qëndrim në Itali, duhej kohë për një vendimmarrje të drejtë sipas palës italiane. Kjo ishte goditja e radhës për qeverinë shqiptare, e cila i mendonte shumë më lehtë procedurat duke qenë se vetë nuk ishte nënshkruese e asnjërës prej konventave ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e individit, sikurse ndodhej edhe jashtë Konferencës së Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropian.

Personeli i ambasadës shqiptare në Romë nëpërmjet avokates Roza Kardone, arbëreshe, mike e ambasadës,

filloi të shqyrtonte nenet e Kodit Penal italian që mund të implikonin dhe dënonin 9 azilkërkuesit. Më pas, sipas kërkesave të Kodit Penal italian, do të hartoheshin nga pala shqiptare edhe të dhënat që kërkonte Prokuroria e Brindisit. Një dosje e plotësuar nga pala shqiptare do të ishte zgjidhja e vetme sipas tyre.

Sapo mbërritën në Shqipëri më 10 janar, 7 anëtarët e ekuipazhit që kishin kërkuar kthimin në Shqipëri, u thirrën në hetuesinë e Durrësit. Ata u morën në pyetje rreth ngjarjes, u përgjuan në bisedat ndërmjet njëri-tjetrit dhe kështu u ndërtuan histori të ndryshme, që mbërthenin me akuza Enver Metën e Bardhyl Voglin.

Më 10 janar 1989, me kërkesën e tij u prit në një takim zyrtar në Ministrinë e Jashtme a. i. i ambasadës italiane Patricio Fondi, i cili i transmetoi qeverisë shqiptare, se nga pyetjet dhe dëshmitë e marinarëve shqiptarë që ndodheshin në Itali dhe që kishin kërkuar strehim politik, ishte arritur në këto konkluzione:

Kapiteni Meta dhe një marinar tjetër akuzoheshin “për sekuestron e personit” dhe ndaj tyre kishte filluar procedura penale. Ndërsa 7 personat e tjerë ishin konsideruar se nuk kishin kryer krim. Kërkesa e tyre për strehim politik po shqyrtohej nga një komision i përbërë nga përfaqësues të qeverisë italiane, dhe nga Komisioneri i OKB-së për Refugjatët. Sipas Fondi-t, kërkesa e tyre ishte e vështirë të refuzohej.⁷ Kjo ishte një goditje e dytë e drejtpërdrejtë që i jepej qeverisë shqiptare dhe reputacionit të saj brenda e jashtë vendit. Një realitet i ashpër politik si ai shqiptar përballë me shtetin e të drejtës që funksiononte në Italinë

7 AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.70-71, Informacion i Drejtorisë Juridike në MPJ për takimin me a. i. të ambasadës italiane Fondi, 10.1.1989.

fqinje. Ministria e Jashtme shqiptare nuk ra dakord me interpretimin e bërë nga drejtësia italiane, duke i akuzuar të gjithë si fajtorë e duke kërkuar kthimin e tyre pranë drejtësisë shqiptare. Ajo kërkoi që akuza ndaj kapitenit duhej plotësuar me akte të tjera, dhe se duheshin dënuar njësoj të 9-të personat e akuzuar. Politika shqiptare vuri në lëvizje të gjithë motorët e saj që të plotësohej dosja e fakteve dhe akuzave me çdo gjë që kërkonte Kodi Penal italian, që ata të shpallehin të 9-të të fajshëm. Akuza kryesore që propozonte avokatja ishte “rrëmbim me forcë” dhe “ndryshim i drejtimit të barkës, përvetësimi dhe dëmtimi i pasurisë së shtetit, rrezikimi i jetës së tjetrit” etj. Shteti shqiptar nëpërmjet avokates, por edhe segmenteve të ndryshme politike u mundua të ndikonte mbi drejtësinë italiane për një vendimmarrje në ngarkim të 9-të azilkërkuesve, duke i konsideruar ata fajtorë. Madje u përgatit edhe një urdhër-arresti në Shqipëri për t’u dërguar në Itali. Kryetari i Gjykatës së Barit përjashtoi mundësinë e ekstradimit të tyre, pasi nuk kishte një konventë ekstradimi midis dy vendeve.

Nëpërmjet Ministrisë së Jashtme dhe ambasadës shqiptare në Romë, Hetuesia e Përgjithshme shqiptare i dërgoi Ministrisë së Drejtësisë italiane më 13-14 janar 1989, materiale shtesë hetimore në ngarkim të tyre dhe kërkoi që ngjarja të shihej me vëmendje në frymën e marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve, dhe në interes të tyre të realizohej ekstradimi i tyre i shpejtë në Shqipëri.⁸ Baza ligjore ndërkombëtare e përmendur ishin “*normat ndërkombëtare mbi luftën kundër terrorizmit e piraterisë të pranuar botërisht nga dy shtetet*”.⁹

8 AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.90-96, Material i Hetuesisë së Përgjithshme të RPSSH dhe MPJ për ambasadën shqiptare në Romë për t’u përcjellë në Ministrinë e Drejtësisë italiane, 14.1.1989.

9 Po aty, fl.96

Ndërkohë që filloi procesi gjyqësor ndaj Metës e Voglit për akuzën e “*rrëmbim personi*”, media italiane e ndërgjegjshme për situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri filloi t’i bënte jehonë dëshmisë të Enver Metës 30-vjeçar, në sallën e gjyqit. Ai shpjegoi arsyet e forta ekonomike e sociale që e kishin detyruar të ndërmernte këtë akt që rrezikonte të mos shihte më gruan dhe vajzën. Gazeta e Barit “Tribuna Business” e datës 13 janar botoi artikullin me titullin “*Atje në Durrës, në shtëpinë time 17 persona jetonin në dy dhoma*” e nëntitull “*Tregim dramatik i Enver Metës, kapitenit shqiptar që u arratis në Pulia*”.¹⁰ Artikulli e përshkruante Metën si një djalë 30-vjeçar i plakur para kohe, thellësisht i ligështuar, por që dëshironte të fillonte të jetonte në një mënyrë ndryshe. Më poshtë artikullshkruesi duke shprehur një opinion më të gjerë publik, shkruante se “*atij i rrinte pak i madh kostumi i terroristit*”, duke shmangur etiketimin si “terrorist” që i ngarkohej nga qeveria shqiptare. Ai nuk ishte shprehur asnjëherë se kishte diçka kundër qeverisë së tij apo vendit të tij, apo se kërkonte të kryente një akt që rrezikonte Shqipërinë. Ai kërkonte vetëm të shpëtonte nga hallet e tij të mëdha ekonomike.¹¹

Me kërkesën e avokates Kardone, Ministria e Jashtme dhe ambasada shqiptare miratuan prezencën e saj në seancën e 16 janarit për gjykimin e Metës e Voglit.¹² Dy shqiptarët u mbrojtën nga katër avokatët të gjetur nga Instituti Kristian i Haritaga-s, ku qëndronin edhe 7 personat e tjerë. Gjyqi ndiqej në sallë nga shumë gazetarë e aktivistë të shoqërisë civile italiane. Më 21 janar, ANSA njoftoi se Meta e Vogli u

10 AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.233, Përmbledhje e shtypit italian e përgatitur nga ambasada shqiptare në Romë për MPJ.

11 Po aty.

12 AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.237, Korrespondencë e ambasadës shqiptare në Romë me MPJ,16.1.1989

lanë të lirë. Në fakt drejtësia italiane i la të lirë dy shqiptarët e arrestuar nën akuzën se kishin sekuestruar ekuipazhin e peshkarexhës për të ardhur në Brindisi. Ata u deklaruan të pafajshëm, sepse kishin vepruar në “kushtet e nevojës” duke kufizuar paqësisht lirinë e tjetrit. Gjykata italiane vuri theksin se të pandehurit kishin mbështetur gjatë pyetjes së tyre ekzistencën në vendin e origjinës të një shtypjeje të vërtetë e të veçantë të së drejtës, për të shprehur mendimin e tyre për të lëvizur jashtë territorit të shtetit shqiptar dhe për të ushtruar lirisht besimin e tyre fetar etj.¹³ Mbrojtja theksoi se rrethanat mund të konsideroheshin si të njohura botërisht dhe të vërtetuara, siç duhet nga botimet e përfshira në aktet e një organizmi ndërkombëtar, politikisht të pavarur dhe të njohur universalisht për luftën e tij në favor të të drejtave civile, siç ishte Amnesty International. Argumentet e kësaj organizate për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri, u paraqiten nga mbrojtja dhe gjykata i mori në konsideratë. Mete e Vogli u shprehën se përveç kushteve ekstreme ekonomike e shoqërore, ata shtypeshin për të shprehur lirisht mendimet e veta, apo për të ushtruar liritë fetare, apo për të lëvizur jashtë shtetit. Gjykata argumentoi se e vetmja mundësi që kishin për t’iu shmangur nënshtrimit nga rreziku ishte pikërisht ajo e ikjes jashtë me një mjet të përshtatshëm për arritjen e këtij qëllimi, siç ishte mjete i lundrimit, i përdorur nga të ikurit, duke pasur parasysh mungesën e mjeteve të tjera të “ligjshme”.

Fakt i rëndësishëm në mbrojtje të aktit të kryer nga Enver Mete ishte edhe mos ratifikimi nga shteti shqiptar i

13 AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.311-317, Vendimi i Gjykatës së Brindisit, Seksioni i Dytë Penal, 20.1.1989

“Konventës ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike” dhe të “Konventës ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore”. Këto fakte mbështesnin tezën e mbrojtjes për mungesë të respektimit të lirive themelore, mbi të cilat qeverisej një shtet modern demokratik. Ndaj edhe kufizimin e *lirisë së kufizuar* të ekuipazhit, gjykata e konsideroi të rregullt, pasi ishte bërë me qëllim për t’iu larguar rrezikut që i nënshtroheshin në Shqipëri dhe për të fituar “lirinë në kuptimin e gjerë të saj.”¹⁴ Gjykata i shpalli Enver Metën dhe Bardhyl Voglin si të padënueshëm për fajin e tyre të akuzuar, sepse kishin vepruar në “kushtet e nevojës”. Gjykata urdhëroi lirimimin e tyre të menjëhershëm, dhe kalimin në kampin e emigrantëve të tjerë politikë.¹⁵

Avokatja Kardone e konsideroi vendimin e lirimimit të dy marinarëve si të pajustificuar. Sipas saj “*Gjykimi është i motivuar dhe i orientuar nga Roma, ndërsa vendimi kishte më tepër karakter politik sesa juridik*”. Madje avokatja nuk u lejua të takonte as kryetarin e gjyqit. Pala shqiptare e quajti këtë vendim jo të arritur mbi baza ligjore, por një vendim politik. Madje përmendja e disa vlerësimeve politike për Shqipërinë në vendimin e Gjykatës u interpretua si ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë nga organi ligjor italian. Për këtë u protestua pak kohë më vonë pranë organeve kompetente italiane.¹⁶ Në Ministrinë e Jashtme në Tiranë u shtrua për diskutim edhe mundësia, që çështja e kërkesës së tyre për ekstradim të arratisurve nga Shqipëria,

14 AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.311-317, Vendimi i Gjykatës së Brindisit, Seksioni i Dytë Penal, 20.1.1989.

15 AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.311-317, Vendimi i Gjykatës së Brindisit, Seksioni i Dytë Penal, 20.1.1989.

16 AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.319, Korrespondencë midis MPJ dhe Hetuesisë së Përgjithshme, 20.4.1989.

të vazhdohej në Gjykatën e Apelit në Leçe, por ministri i Jashtëm Malile porositi në minutat e tij *“tani që po ngrihen akuza për të drejtat e njeriut, a do ngacmuar kjo çështje? Më mirë tani për tani ta ndjekë vetë avokatja”*.¹⁷

Çështja pushoi në maj 1989. Para vendosmërisë së drejtësisë dhe qeverisë italiane dhe interesat e drejtpërdrejta të qeverisë shqiptare për të zgjidhur me Italinë disi pranueshëm për Tiranën zyrtare, çështjen e gjashtë Popajve të mbetur në ambasadën italiane, që nga viti 1985, nevoja për t'u mbështetur ekonomikisht, por edhe politikisht nga Italia fqinje në kontaktet e para me TPE, përpjekjet për të përmirësuar sadopak imazhin negativ të Shqipërisë në trajtimin e të drejtave të njeriut, tani që po synohej të trokitej në dyert e organizmave ndërkombëtare, e detyruan Hetuesinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Jashtme t'i kërkonin ambasadës, që të hiqte dorë nga ndjekja e problemit

Zyrtarisht Enver Mete e Bardhyl Vogli dhe njerëzit që i shoqëruan do të mbeteshin e trajtoheshin si refugjatë shqiptarë në Itali, pionierë të dyndjeve të mëdha me refugjatë shqiptarë, që do të mbërrinin në Itali një vit më vonë, në 1990, me hyrjen forcërisht në ambasadën italiane në Tiranë.

¹⁷ AMEPJ, Fondi i MPJ, V.1989, D.494, fl.303, Informacion i hartuar dhe qarkulluar brenda MPJ, 23-24 shkurt 1989.



Dr. Gjon Boriçi
Instituti i Historisë/Akademia e
Studimeve Albanologjike

Gjon Boriçi, ka lindur në Tiranë më 12 qershor 1977. Ka kryer studimet universitare në Fakultetin Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës. Ka kryer studimet e doktoraturës në Qendrën e Studimeve Albanologjike, sot Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Teza e doktoraturës ka analizuar marrëdhëniet shqiptaro-kineze gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Ka një përvojë 14 vjeçare në arsimin e lartë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Autor i tetë monografive dhe mbi 40 artikujve shkencorë. Më 10-30 shtator 2017, u përzgjedh së bashku me 27 studiues të tjerë nga e gjithë bota për të marrë pjesë në programin ndërkombëtar të kërkimit shkencor «China Studies» në Pekin, të organizuar nga Akademia e Shkencave Sociale dhe Ministria e Kulturës e Republikës Popullore të Kinës. Fusha e studimit është historia bashkëkohore e Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

“PËRPJËKJET E SIGURIMIT
TË SHTETIT PËR TË VËNË
NËN KONTROLL
EMIGRACIONIN POLITIK
SHQIPTAR NË VITET 1945-1974”

Abstrakt

Studimet që po ndërmerren kohët e fundit dhe paraqitja e tyre në konferenca shkencore serioze për të hedhur dritë mbi të kaluarën komuniste të Shqipërisë janë domosdoshmëri për brezat e vendit tonë. Lufta e Dytë Botërore për Shqipërinë përfundoi më 29 nëntor 1944. Partia Komuniste Shqiptare si forca kryesore dhe më pas e vetme që do të përqendronte

pushtetin e sapofituar në duart e saj, filloi pa humbur kohë evidentimin e atyre që i konsideronte armiq të popullit që në fakt ishin armiq të pushtetit të saj. Jo pak prej këtyre armiqve të popullit u larguan nga vendi dhe kaluan në vendet perëndimore. Shumica e tyre u strehua në Itali e më pak në Francë dhe në vendet e tjera. Nga hulumtimi i kujdesshëm i arkivave të Sigurimit shqiptar të shtetit që kam studiuar dhe që do t'i paraqes për herë të parë përpara auditorit të kësaj konference shkencore dhe më gjerë, më rezulton se Sigurimi shqiptar me urdhër të posaçëm të Byrosë Politike dhe personalisht të Enver Hoxhës ka bërë ç'ishte e mundur për të vënë nën mbikëqyrje të arratisurit politikë shqiptarë në perëndim dhe familjet e tyre në Shqipëri. Janë harxhuar sasi konsiderueshme të hollash dhe është bërë presion i pashembullt deri në limitet e rezistencës psikike dhe fizike njerëzore që Sigurimi i shtetit të kishte akses tek emigracioni politik antikomunist shqiptar. Hulumtimi i arkivave të ish-Sigurimit të shtetit ka kërkuar kohë të konsiderueshme. Falënderoj për mundësinë e hulumtimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të shtetit për këtë çështje, Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH). Kumtesa që do të paraqes ka karakter historiko-analitik. Çdo burim informacioni që do të paraqitet në këtë kumtesë do të jetë i mbështetur në fakte autentike dokumentare.

Fjalë çelës: Shqipëri, Sigurim, emigracion politik, ndjekje, përpunim, kontroll, agjitacion politik.

Problemi i legjitimitetit të pushtetit komunist

Përfundimi i luftës në Shqipëri solli si detyrë imediate për pushtetarët e rinj konsolidimin e pushtetit të sapofitur. Një një vend të shkatërruar nga lufta dhe nga grindjet e brendshme, pushteti i komunistëve ishte gjithnjë i rrezikuar. Për këtë arsye Enver Hoxha në cilësinë e kryeministrit të Shqipërisë, nuk hezitoi që në muajt e parë të vitit 1945 të bënte hapat e parë në drejtim të konsolidimit të pushtetit të tij. E dinte mirë se përveç problemeve të brendshme, jo pak telashe mund t'i sillte elementi i arratisur jashtë vendit me ushtrinë pushtuese gjermane. Për këtë arsye, pak ditë pas përfundimit të luftës në Evropë dhe kapitullimit pa kushte të Gjermanisë naziste, më datë 23 maj 1945, Enver Hoxha i dërgon një notë presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Herri Truman (Harry Truman) që bazuar në vendimin e komisionit qendror të datës 23 shkurt 1945 për zbulimin e kriminelëve të luftës të cilët gjendeshin në kampet e përqendrimit në Itali, t'i dorëzoheshin Shqipërisë të konsideruarit kriminelë lufte prej saj.⁸⁵ Kjo letër e Enver Hoxhës dërguar presidentit amerikan nga dokumentet që kam hulumtuar deri më tani, mbeti pa përgjigje. Lidhur më këtë sipërmarrje të kryeministrit shqiptar, u organizuan në shkallë vendi manifestime dhe dërgesa telegramesh drejtuar qeverisë në Tiranë lidhur me ekstradimin në atdhe

⁸⁵ Arkivi Qendror i shtetit [më tej: AQSH], Fondi [më tej: F.] 490/Këshilli i Ministrave [më tej: KM], Viti [më tej: V.] 1945, Dosja [më tej: D.] 5, fl. 1. Pjesë nga nota e Enver Hoxhës shkruar në frëngjisht dërguar presidentit amerikan Herri Truman: "...Kjo kërkesë legjitime e popullit shqiptar ende nuk ka patur përgjigje, por ne konstatojmë me keqardhje që kriminelët më të këqinj shqiptarë të luftës si Ali Këlcyra, Mit'hat Frashëri, Abas Kupi, Kadri Cakrani, Koço Muka, Vehip Runa dhe shumë të tjerë mbahen në kampe dhe trajtohen mirë pavarësisht bashkëpunimit të tyre të dukshëm me nazistët gjermanë dhe janë lënë të lirë nëpër Itali për të vijuar intrigat e tyre fashiste ndaj popullit dhe humanizmit progresiv".

të të arratisurve të konsideruar kriminelë luftime.⁸⁶ Një ndër kërkesat më të bujshme që qeveria e Shqipërisë i paraqiti Komisionit Ndërkombëtar të Kriminelëve të Luftës me seli në Londër më datë 22 qershor 1945, ishte edhe dërgimi në Shqipëri i gjeneralit italian Dalmaco (Dalmazzo) që të gjykohej nga vetë populli shqiptar.⁸⁷

Afërsisht një vit pas çlirimit të Shqipërisë, më 22 tetor 1945, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare [më tej: PKSH], mbajti një mbledhje të posaçme për t'i dhënë jetë legjitimitetit të pushtetit nëpërmjet zgjedhjeve për në asamblenë kushtetuese.⁸⁸ Legjitimiteti politik i forcës fituese të luftës kundër pushtuesve në vend i duhej me domosdo PKSH-së për të goditur të gjithë kundërshtarët e saj politikë dhe jo vetëm. Nëse zgjedhjet do të fitoheshin bindshëm, dominimi i situatës së brendshme prej PKSH-së do të ishte i plotë.⁸⁹

Përveç dominimit të situatës së brendshme, kishte edhe një tjetër faktor që ia impononte PKSH-së legjitimitetin e pushtetit. Ky faktor kishte të bënte me pozitën tejet delikate të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Siç përmendet edhe në raport, aleatët nuk kishin ndërmend për momentin të njihnin qeverinë e Shqipërisë të dalë nga mbledhja e Beratit 1944.⁹⁰ Zgjedhjet PKSH-ja duhet t'i realizonte me

⁸⁶ AQSH, F. 490/KM, V. 1945, D. 61, fl. 1-17. Telegramë drejtuar Qeverisë Demokratike Shqiptare, mbi dorëzimin dhe gjykimin e kriminelëve të luftës.

⁸⁷ AQSH, F. 490/KM, V. 1945, D. 284, fl. 1. Kërkesë e Komisionit Qendror për hetimet e krimeve të luftës të kriminelëve të luftës drejtuar Komisionit Ndërkombëtar të Kriminelëve të luftës në Londër për dorëzimin e gjeneral Dalmacos, për t'u gjykuar nga vetë populli shqiptar.

⁸⁸ AQSH, F. 14/Organet Udhëheqëse [më tej: OU], V. 1945, D. 1, fl. 8. Procesverbal i Plenumit të Komitetit Qendror datë 22.X.1945.

⁸⁹ Po aty, fl. 9. Pjesë nga raporti: "Me pak fjalë mund të themi se e dominojmë situatën e brendshme".

⁹⁰ Po aty. "Për sa i përket vendit tonë aleatët – as që kanë ndërmend të na njihin, d.m.th. situata jonë e jashtme me gjithë kredin që kemi fituar, nuk është përmirësuar. Por duhet të mbajmë marrëdhënie të mira me aleatët, pse duhet të mbrojmë paqen, kjo është në interesin e B.S. e në tonin».

sukses pasi synonte të ndikonte tek aleatët veçanërisht perëndimorë dhe për këtë arsye zgjedhjet duhet të ishin sa më demokratike.⁹¹ Jo vetëm impakti tek aleatët, por synimi ishte të neutralizohej çdo opozitë veçanërisht emigracioni shqiptar i arratisur në vendet perëndimore. Çdo formë opozite duhej mbajtur nën kontroll dhe siç shprehej vetë Enver Hoxha në raport “është puna jo vetëm të fitojmë, por të fitojmë në mënyrë Schiacciante”.⁹²

Sipas Koçi Xoxes, fitorja e PKSH-së duhej të mbështetej tek një propagandë e fortë dhe të bëhej ç’ishte e mundur që reaksioni të mos bindte popullin të bojkotonte zgjedhjet.⁹³ Në këtë pikë më i prerë paraqitet Sejfulla Malëshova kur shprehej se pushteti i PKSH-së ishte fituar me luftën e popullit shqiptar dhe se ishte zgjidhur edhe çështja e regjimit, regjim popullor.⁹⁴ Në mbështetje të fjalës së

⁹¹ Po aty. “Zgjedhjet do të jenë një masë që do të influencojë në aleatët – pse do t’i bëjmë sa më demokratike. Do të kërkojmë që të mos biem në kundërshtim me ndonjë element ose grup tjetër si po ngjan në vendet e tjera Rumani, Bullgari etj., ku ka grupe të organizuar. Këtu nuk ka grupe të tilla, veçse elementa që lufojnë me parrulla pushtetin tonë”.

⁹² Po aty.

⁹³ Po aty, fl. 10. Pjesë nga fjala e Koçi Xoxes: “Prandaj ne duhet ta mbështesim propagandën tonë në: 1) fitoren e lëvizjes tonë, fitoren tonë, 2) në realizimet tona, ato që do bëjmë sidomos (kripa, mielli e shpërndarja e ushqimit), 3) mënyra e zgjedhjeve, 4) mbështetja e mënyrës tonë organizative. Kundërshtarët kanë filluar që sot të lëvizin. Ata mund të na bojkotojnë. Abstenimi mund të jetë për ta rruga më e mirë, dhe në këtë mund të përfitojnë edhe nga gjendja prapanike e vendit, që nuk është mësuar të votojë. Numri i mosvotonjësve shkon me dashka padashka në aktiv të reaksionit. Prandaj duhet të shikohet mirë e të luftohet abstenimi që na dëmton rëndë. Nga ana tjetër ç’masë policore që mund të mirret është në dëmin tonë dhe një armë për reaksionin. Prandaj do ta shtrojmë në organet e mbrojtjes etj..., dhe në gjithë partinë, me konferenca, me shtyp etj...».

⁹⁴ Po aty, fl. 11. Pjesë nga fjala e Sejfulla Malëshovës: “Populli shqiptar me luftën e tij zgjidhi çështjen e pushtetit, të regjimit. Ai bëri një revolucion, një ndryshim, cili është ky regjim? Regjim popullor. Në të vërtetë kjo që bëjmë ne është një koncesion, ky i ka rrënjët që nga Jalta – ku B.S. bëri disa koncesione si p.sh. në Jugosllavi. Edhe ne pa këtë situatë të sotme, nuk do të mblidhnim Asamblenë, por do bëheshin zgjedhjet e reja brenda bazave të regjimit tonë të hedhur që në luftë. Në lidhje me zgjedhjet, ne duhet të shohim forcën tonë e të reaksionit. Forca jonë, megjithë dobësimet e shumta, është e madhe. Kundërshtarët tanë janë të dobët pse nuk kanë mundur të organizohen seriozisht. Por ka pakënaqësi të lidhura me gjendjen: çfarë kemi premtuar në luftë, e çfarë japim; dmth

Malëshovës, Enver Hoxha mendonte se PKSH-ja nuk duhet të lejonte grupe opozitare, jo me masa policore, por me propagandë.⁹⁵ Në fakt siç do ta shikojmë më poshtë, kjo fjalë e Enver Hoxhës ishte thjesht fasadë sa për të marrë në mënyrë të legjitimuar pushtetin. Regjimi i ri që do të instalohej edhe ligjërisht nëpërmjet zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945 në Shqipëri, duhet të kishte vetëm një zë; atë të Enver Hoxhës nëpërmjet pushtetit absolut të PKSH-së.

Në fakt, imazhin që duhet të kishte vendi e kishte theksuar vetë disa ditë më përpara Enver Hoxha në mbledhjen e Plenumit IV të PKSH më 17 tetor 1945.⁹⁶ Në këtë plenum, përveç fjalëve lavdëruese për Bashkimin Sovjetik, Hoxha tërheq vëmendjen edhe për një fenomen i cili do të vijojë të ishte një nga gurët e themelit të politikës së tij; emigracionin politik dhe për këtë përgjegjës bënte anglo-amerikanët.⁹⁷ Sipas Hoxhës, që Shqipëria të kishte pozitë të qëndrueshme ndërkombëtare, duhej me patjetër të kishte të qëndrueshme pozitat në vend.⁹⁸ Forcimi i pozitës në vend synonte të eliminonte çdo formë kundërshtimi ndaj autoritetit të PKSH-së dhe atij vetë. Reaksioni i brendshëm sipas Enver

masat pretendojnë më shumë se ç'mund të marrin në realitet. Por reaksioni jonë nuk ka ato lidhje që ka në vende të tjera si p.sh. në Jugosllavi. Me gjithë këto ata punojnë”.

⁹⁵ Po aty, fl. 12. Pjesë nga fjala e Enver Hoxhës: “Ne nuk duhet të lejojmë grupe opozite, jo me masa policore, por me propagandë. Kur ne jemi në pamundësi ne nuk mund t'i ndalojmë. Në luftën politike ne duhet të kemi fakte”.

⁹⁶ AQSH, F. 14/OU, V. 1945, D. 2, fl. 1. Mbi situatën politike të jashtme dhe të brendshme, raportuar nga Enver Hoxha më 17 tetor 1945.

⁹⁷ Po aty, fl. 3. Pjesë nga fjala e Enver Hoxhës: “Anglo-Amerikanët përpiqen të shpëtojnë ç'të mundin sa më tepër nga mbeturinat e fashizmit, përpiqen të forcojnë pozitat e reaksionit, ta rigrumbullojnë, dhe ta riorganizojnë për ta bërë një barrierë të vërtetë kundër vendosjes dhe triumfit të demokracisë së vërtetë. Eksodi i madh i kriminelëve të luftës fashiste, i kuislingëve, gjen strehë dhe përkrahje në gjirin e ushtrisë anglo-amerikane dhe në zonat e okupuara prej tyre”.

⁹⁸ Po aty, fl. 4. “Forcimi i pozitave tona ndërkombëtare varet nga konsolidimi i pozitave tona të brendshme të cilat janë të kondicionuara me një punë intensive dhe të drejtë nga ana jonë, varet nga zbatimi i drejtë i vijës tonë të Partisë”.

Hoxhës, duhej goditur fort pasi kishte patur ndihmën fashizmit.⁹⁹ Anglo-amerikanët do të përbënin armikun kryesor që duhej goditur me propagandë të ashpër pasi sipas Hoxhës ndihmonin elementin e arratisur shqiptar. Fakt për këtë, është një artikull i botuar në gazetën “Bashkimi” ku akuzohej misioni i UNRRA-s për ndihmën që u jepte në Itali të arratisurve shqiptarë.¹⁰⁰ Ky artikull u përgënjeshtura nëpërmjet një letre drejtuar gazetës Bashkimi nga vetë kryetari i misionit dr. Oakley Hill më 25 janar 1946.¹⁰¹

Fillimi i goditjes së elementit të arratisur

Një tjetër element që pritej të rriste besueshmërinë e PKSH dhe të qeverisë së saj, ishte edhe fushata e organizuar me peticione dhe telegrame nga populli shqiptar drejtuar qeverisë shqiptare për dorëzimin dhe gjykimin e kriminelëve të luftës. Gjatë të gjithë muajit qershor 1945 janë me qindra telegrame të ardhura në adresë të qeverisë shqiptare në Tiranë nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, ku i kërkohej të bënte presion në qeveritë e vendeve të tjera (veçanërisht atyre perëndimore) për dorëzimin në Shqipëri dhe gjykimin e kriminelëve të luftës të arratisur nga vendi pak para çlirimit të tij.¹⁰² Interesant është fakti se shumica e telegrameve dërguar qeverisë shqiptare në Tiranë vinin nga

⁹⁹ Po aty, fl. 5. “Reaksioni i brendshëm hëngri një grusht të rëndë ushtarakisht dhe politikisht dhe krerët më influentë të tij dolën jashtë kufirit, ose u kapën prej nesh dhe u gjykuan”.

¹⁰⁰ AQSH, F.490/KM, V. 1946, D. 160, fl. 1. Orvatje e përgënjeshtimit të misionit UNRRA mbi botimin e artikullit në gazetën «Bashkimi» për ndihmën që u jep UNRRA tradhëtarëve të Shqipërisë në Itali.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² AQSH, F. 490/KM, V. 1945, D. 61, fl. 1-17. Telegramë drejtuar Qeverisë Demokratike Shqiptare, mbi dorëzimin dhe gjykimin e kriminelëve të luftës.

zonat e jugut të Shqipërisë, aty ku lëvizja nacional-çlirimtare kishte edhe bazën e saj. Vlora, Tepelena, Delvina, Gjirokastra mbanin “rekordin” në dërgimin e telegrameve për qeverinë shqiptare lidhur me kriminelët e luftës të arratisur.¹⁰³

Akti i parë i qeverisë shqiptare ndaj të arratisurve politikë shqiptarë ishte ligji nr. 26 i datës 15 janar 1945 mbi konfiskimin e pasurive të tundshme dhe të patundshme të të arratisurve politikë.¹⁰⁴ Neni (artikulli) 2 i këtij ligji, familjeve të të arratisurve u linte vetëm pjesën e domosdoshme për jetesën.¹⁰⁵ Kjo do të thoshte se familjarët e të arratisurve duhej thjesht të mbanin frymën gjallë. Ky ligj nuk do të ishte gjëja e vetme negative që do t’u ndodhte atyre. Gjithashtu, në një shkresë dërguar kryeministrit Hoxha nga ministri i Drejtësisë, Manol Konomi, paraqitet një projekt-ligj ku detajohej edhe një kategori tjetër personash që kishin bashkëpunuar sipas tij me armikun së bashku me pjesëtarë të tjerë të familjes së tyre.¹⁰⁶ Sipas nenit 3 të këtij projekt-ligji, ishte e mundur t’i konfiskohej pasuria një familjeje kur një pjesëtar i saj ishte dënuar si kriminel lufte ose armik i popullit dhe veçan kësaj edhe me konfiskimin e pasurisë.¹⁰⁷ Lidhur me konfiskimin e pasurive të të arratisurve do të ishte edhe vetë ish-kryeministri shqiptar Fan Noli i cili do t’i dërgonte një letër Enver Hoxhës në vitin 1948 që të ndalte këto akte të paligjshme, por do të mbetej pa përgjigje.¹⁰⁸

Elementi i pushtetit komunist shqiptar që kishte

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ AQSH, F. 490/KM, V. 1945, D. 141, fl. 1. Ligj mbi konfiskimin e pasurive të tundshme dhe të patundshme t’arratisurve politikë. Shih edhe dosjen 252, viti 1946, tek i njëjti fond.

¹⁰⁵ Po aty.

¹⁰⁶ Po aty, fl. 2. Tiranë, më 1.X.1945.

¹⁰⁷ Po aty, fl. 3.

¹⁰⁸ AQSH, F. 490, V. 1948, D. 327, fl. 1-2. Letër e Fan Nolit dërguar Enver Hoxhës mbi ndalimin e shpronësimit të një shtëpie pronë e një shqiptari të arratisur në SHBA. Data e saktë e dërgimit të kësaj letre është e palexueshme në dokument.

“

Akti i parë i qeverisë shqiptare ndaj të arratisurve politikë shqiptarë ishte ligji nr. 26 i datës 15 janar 1945 mbi konfiskimin e pasurive të tundshme dhe të patundshme të të arratisurve politikë. Neni (artikulli) 2 i këtij ligji, familjeve të të arratisurve u linte vetëm pjesën e domosdoshme për jetesën. Kjo do të thoshte se familjarët e të arratisurve duhej thjesht të mbanin frymën gjallë.

”

nën drejtimin e Enver Hoxhës po sillej me një arbitraritet të ashpër dhe me dënime kolektive ndaj kundërshtarëve të regjimit që po instaloheshin në vend. Në vend të ligjit të miratuar në parlament, qeveria kishte ngritur një komision

marrë detyrën e qeverisjes së qyteteve lidhur me ligjin e mësipërm, kërkonte udhëzime sesi do të procedohej me zbatimin e këtij ligji. Rasti më unikal për këtë, është në Shkodër ku në një letër dërguar kryeministrit, më 11 qershor 1945 Riza Dani kërkonte udhëzime se ç'masa duheshin marrë lidhur me zbatimin e këtij ligji.¹⁰⁹ Përgjigja nga Tirana, erdhi katër ditë më vonë më 15 qershor 1945 me vetëm dy fjali: «Çështja është në studim. Pritni udhëzime».¹¹⁰

Në fakt, ligji i 15 janarit 1945 ishte krejtësisht i paligjshëm pasi nuk ishte miratuar nga parlamenti shqiptar edhe për faktin se një institucion i tillë në Shqipëri nuk ekzistonte dhe se në vend ende nuk ishin zhvilluar zgjedhjet. Që në vitin e parë të pushtetit të saj, PKSH

¹⁰⁹ AQSH, F. 490/KM, V. 1945, D. 142, fl. 2. Kërkesë nga Riza Dani sesi duheshin marrë masat për sekuestrimin e pasurisë së Musa Jukës e të tjerëve të kësaj kategorie.

¹¹⁰ Po aty, fl. 2.

të posaçëm për konfiskimin e pasurive private e cila vetëm në rrethin e Korçës me vendimin e saj datë 25 tetor 1945 kishte tjetërsuar pronat e Selim Mustafa Mborjes me shkakun se ia kishte shitur nipi i tij italianëve.¹¹¹ Vetë ministri i Financave, Ramadan Çitaku, në datën 18 tetor 1945, kërkonte me urdhër të prerë rretheve të gjithë listën e pronave që ishin sekuestruar ose të komunikoheshin arsytet se përse nuk ishin realizuar detyrat e ngarkuara.¹¹² Në valën e madhe të sekuestrimeve të pasurive kishte edhe raste si ai i Dervish Xhaferri nga fshati Bashaj i Vlorës i cili ishte konsideruar i arratisur kur në fakt ishte anëtar i ushtrisë nacional-çlirimtare dhe ishte ende efektiv i Batalionit II të Brigadës XXII të Divizionit V.¹¹³ Vetë drejtori i Mbrojtjes së Popullit, Koçi Xoxe, më datë 3 dhjetor 1945, kishte kërkuar sqarime lidhur me këtë çështje dhe kërkonte zgjidhjen e saj.¹¹⁴ Gjithashtu, për këtë çështje kishte kërkuar sqarim edhe vetë kryeministri Hoxha.¹¹⁵

Megjithatë, lufta e ashpër kundër elementit të arratisur si brenda (në formë ilegaliteti) ashtu dhe jashtë do të merrte përmasa të rënda. Vetë ministri i Brendshëm, Haxhi Lleshi, me anë të një shkresë datë 4 korrik 1945, lajmëronte kryeministrinë mbi vdekjet e dhunshme që kishin ndodhur në burgje dhe për këtë nuk ishte vepruar konform neneve 60, 61, 60 dhe 70 të aprovuara nga Komiteti Qendror.¹¹⁶ Për këtë arsye, për të justifikuar krimet, qeveria shqiptare me vendimin e saj nr. 2 të datës 26 janar 1945, kishte vendosur

¹¹¹ Po aty, fl. 6.

¹¹² Po aty, fl. 9. Qarkore e ministrit të Financave Ramadan Çitaku dërguar komiteteve ekzekutive të Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Beratit, Vlorës, Gjirokastrës, Korçës, Shkodrës, Kukësit dhe Peshkopisë. Tiranë, 18.X.1945, Nr. Prot. 2586/XI.

¹¹³ Po aty, fl. 10.

¹¹⁴ Po aty.

¹¹⁵ Po aty, fl. 11, 13.

¹¹⁶ AQSH, F. 490/KM, V. 1945, D. 285, fl. 1. Mbi vdekjet me dhunë në burgje dhe te komandat ushtarake.

krijimin e Gjyqit Special për të gjykuar kriminelët e luftës me kryetar Koçi Xoxen dhe prokuror të gjyqit Bedri Spahiun.¹¹⁷ Qeveria shqiptare e aprovoi gjyqin special me vendim nr. 4 të datës 10 mars 1945.¹¹⁸

Një vit pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945 dhe me fillimin e konsolidimit të pushtetit komunist, presidiumi i Kuvendit Popullor dekretoi më datë 22 nëntor 1946 ligjin nr. 358 për kontrollin e pasurive të vëna nga shtetasit shqiptarë gjatë regjimeve të kaluara.¹¹⁹ Ky ligj i kthente të gjitha pronat e vëna deri në vitin 1944 në prona të shtetit dhe shfuqizonte çdo hipotekë apo detyrim tjetër që mund të rëndonte mbi ato [pronat].¹²⁰ Çdo pronë sipas këtij ligji duhet të justifikonte burimin e saj dhe pasi pronari të paraqiste vërtetimin për burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, Komiteti Ekzekutiv i prefekturës duhet të bënte hetimet e nevojshme.¹²¹

Të arraturit ishin personat që ishin më së shumti në shënjestrën e pushtetit komunist në Shqipëri. Kryeministri Enver Hoxha me qarkoren e datës 22 tetor 1946 kërkonte zbatimin nga çdo prefekturë lidhur me punën e Komisionit për sekuestrimin e pasurive të kriminelëve dhe armiqve të popullit.¹²² Kjo qarkore ishte në vijimësi të shkresës së

¹¹⁷ AQSH, F. 490/KM, V. 1945, D. 312, fl. 1. Mbi krijimin e gjyqit special për të gjykuar kriminelët e luftës. Përbërja e tij ishte: Prokuror i Gjyqit: Gjeneral-Major Bedri Spahi; Kryetar: Gjeneral-leitnant Koçi Xoxe; Anëtarë: Kolonel Hysni Kapo; N/ Kolonel Beqir Balluku; Kapiten I Kl.II Hajdar Araniti; Partizan Gaqo Boboshtica; Dr. Medar Shtylla, ministër i Ekonomisë; Faik Shehu, anëtar i Këshillit Ant.N.Ç.; Halim Budo, Gjykatës, Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë; Gaqo Floqi, Gjykatës.

¹¹⁸ Po aty, fl. 2.

¹¹⁹ AQSH, F. 490/KM, V. 1946, D. 232, fl. 1. Dekret-ligj i Kuvendit Popullor mbi konfiskimin e pasurive të vëna gjatë regjimeve të kaluara prej funksionarëve dhe sipërmarrësve të shtetit me materialin përkatës.

¹²⁰ Po aty.

¹²¹ Po aty.

¹²² AQSH, F. 14/KM, V. 1946, D. 252, fl. 6. Pjesë nga qarkorja e Enver Hoxhës: «Komisioni i Kontrollit të Shtetit na njofton se deri më sot nuk keni marrë asnjë vendim për konfiskimin e pasurive të kriminelëve të luftës dhe armiqve të popullit të qarkut tuaj. Nga kjo kuptohet se nuk jeni duke treguar ndonjë interesim për sistemin e këtij problemi me rëndësi, mosinteresim ky që vjen në kundërshtim edhe me Dekret Ligjën nr. 249 datë 29.5.1946, që disponon të përfundohen sa më parë konfiskimet”.

datës 22 prill 1946 lidhur me këtë problem.¹²³ Sekuestrimet e pronave dhe të hollave bëheshin të gjitha “në emër të popullit” ndaj pronarëve të ndryshëm.¹²⁴ Në këto veprime, Sigurimi i shtetit ishte më i angazhuari për zhvatjen e floririt pronarëve.¹²⁵ Një tjetër problem që i paraqitej pushtetit komunist nëpërmjet sekuestrimeve ishte edhe përvetësimi nga ana e punonjësve të Sigurimit të shtetit të sendeve të sekuestruara.¹²⁶

Informacionet e para për emigracionin politik shqiptar në vendet e perëndimit

Që më datë 16 janar 1945, misioni ushtarak shqiptar pranë Komandës aleate në Bari të Italisë, dërgoi një informacion të detajuar lidhur me gjendjen e të arratisurve në Itali.¹²⁷ Në letrën e nënshkruar prej n/kolonel Kadri Hoxhës, Enver Hoxha njoftohet se ishte themeluar në Romë prej të arratisurve shqiptarë, Partia Agrare Anti-Komuniste[më

¹²³ Po aty, fl. 1.

¹²⁴ AQSH, F. 14/KM, V. 1946, D. 257, fl. 2. Sekuestrim pasurie dhe të hollash.

¹²⁵ Po aty, fl. 3. “Për të na dhënë sqarime ekzakte se si qëndron çashtja, bashkangjitur ju dërgojmë një letër, drejtue kësaj Kryeministrije nga z. Sami Vrioni, banues në Fier, me të cilën ankohet se organet e Sigurimit të Shtetit n’atë qytet i kanë marrë të gjitha të hollat n’ar e n’argjent që ka patur. Përfundimi të na njoftohet». Tiranë, 14 gusht 1946.

¹²⁶ Po aty, fl. 4. Njoftim nga Prokuroria e Përgjithshme: “Kemi konstatuar se kur u bie rrasa të sekuestrohet prej organeve të Policisë vegla, maqina ose sende të tjera të ndryshme, për shkak se zotnuesit e tyre kanë shkelur ligjin ose ndonjë urdhëresë të Pushtetit, këto sende nuk mbahen në dispozicion të Gjykatës Ushtarake kompetente si e don puna, gjer në dhënien e vendimit definitiv, po quhen si të konfiskuara dhe administrata e interesuar vë dorë menjëherë në to dhe i merr në posedim». Tiranë, më 4 shtator 1946.

¹²⁷ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme[më tej: AMPB]/Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit[më tej: AIDSSH], Drejtoria e Zbulimit e Emigracionit Reaksionar, Viti [më tej: V.] 1945, Dosja [më tej: D.] 50, fl. 1. Letër dërguar Enver Hoxhës nga Misioni Ushtarak Shqiptar në Bari nga n/kolonel Kadri Hoxha. Bari, 16 janar 1945.

tej: PAAK].¹²⁸ Sipas këtij informacioni, kjo organizatë kishte mundur të ndikonte në të gjithë shqiptarët e Italisë së çliruar.¹²⁹ Sipas informatave, kjo organizatë e tregonte veten si forcë opozitare ndaj Frontit Nacionalçlirimtar dhe kishte vendosur lidhje të shumta me shqiptarët në Itali, Amerikë, Egjipt dhe Turqi.¹³⁰

Propaganda që kishte filluar të bënte partia Agrare Anti-Komuniste nuk kishte sesi të mos ta shqetësonte Enver Hoxhën. Propaganda se në Shqipëri nuk ekzistonte asnjë parti tjetër përveç asaj komuniste ishte një kampion e madhe alarmi për pushtetin e sapo marrë nga PKSH-ja. PAAK e akuzonte PKSH-në se refuzonte ndihmat e UNRRA-s dhe se imitonte Jugosllavinë e cila ishte e lidhur fund e krye me Bashkimin Sovjetik dhe rrjedhimisht edhe Shqipëria do të renditej në politikën pan-sllave.¹³¹ Informacioni që e shqetësoi më shumë Enver Hoxhën ishte se kjo parti që në letër quhet gjithmonë organizatë, kishte si detyrë të kthehej në Shqipëri dhe të formonte opozitën.¹³² Fillimi i ndjekjes së vijës jugosllave dhe rrjedhimisht sovjetike nga ana e PKSH-së, padyshim që do të kishte vëmendjen e aleatëve perëndimorë në drejtim të

¹²⁸ Po aty. Pjesë nga letra e Kadri Hoxhës: “Përpara se Atdheu të çlirohesh i gjithi nga okupatori, e pikërisht mbas pak javësh që mbërriti Misioni këtu, u formue një organizatë, “Partia Agrare Anti-Komuniste” me qendër në Romë; ishte e përmbame prej Zef Sereqit, Xhemil Dinos, Nebil Dinos ish-federal i Tiranës, Jak Koçit krah i djathtë i Jakomonit, Ferit Dervishit zogist, Ymer Fortuzit, Haki Korçës student në shkencë politike, Namik Resuli ish-Federal i Tiranës, Ymër Sharra ish-profesor në Teknike të Tiranës dhe don Franko Karma spiun italian e Asim Jakova ish-deputet i Zogut. Kjo organizatë, lindun dhe e përkrahun prej Ingliizve, Amerikanëve dhe Vatikanit, propagandonte sistematikisht e me stil të gjanë kundra Lëvizjes Nacional Çlirimtare në Shqipni”.

¹²⁹ Po aty.

¹³⁰ Po aty.

¹³¹ Po aty.

¹³² Po aty. Pjesë nga letra: “Nji detyrë tjetër e kësaj organizate asht që anëtarët e kësaj të kthehen në Shqipni dhe të formojnë opozitën; dhe një detyrë tjetër asht që disa prej tyne të bashkëpunojnë me reaksionin jugosllav dhe sidomos me atë grek”.

të arratisurve shqiptarë. Po sipas informacionit të dërguar nga n/kolonel Hoxha, tradhtarët sipas tij mbaheshin nga aleatët në kampin e përqendrimit NI Carburnar dhe trajtoheshin prej tyre [aleatëve] më mirë dhe lejoheshin të dilnin në qytet.¹³³ Megjithatë, tek elementi i arratisur kishte grindje sidomos në mes të anëtarëve të Legalitetit dhe Ballit Kombëtar.¹³⁴ Misioni ushtarak shqiptar në Bari kishte përpiluar lista të sakta të emigracionit shqiptar në Itali dhe ia kishte përcjellë qeverisë në Tiranë për të ditur nëse ndonjë ishte kthyer në Shqipëri në mënyrë “që të fillohej puna me ta”.¹³⁵

Problemi i pushtetit në Shqipëri ishte një ndër gjërat që shqetësonte më shumë Enver Hoxhën. Përveç informacioneve lidhur me krijimin e partive shqiptare jashtë vendit, udhëheqësin komunist shqiptar e shqetësonte edhe deklarata e Mehmet Konicës raportuar Hoxhës nga Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit [më tej: DMP], seksioni i parë.¹³⁶ Sipas informacionit të DMP-së, të arratisurit shqiptarë në Itali ishin ndarë dy kampe, të Barit dhe të Leçes.¹³⁷ Këto grupe të arratisurish sipas DMP-së kishin filluar të bënin një aktivitet të dendur kundër Frontit Nacionalçlirimtar.¹³⁸ Të arratisurit shqiptarë vizitoheshin shpesh nga ushtarakë britanikë dhe amerikanë me inkurajimin se së shpejti gjendja në Shqipëri do të ndryshonte.¹³⁹ Edhe intelektual i Stravro Vinjau i cili jetonte në Brindizi, mbante hapur sipas informacionit krahu e reaksionit.¹⁴⁰

¹³³ Po aty, fl. 4.

¹³⁴ Po aty.

¹³⁵ Po aty.

¹³⁶ Po aty, fl. 6, 7. Deklarata e Mehmet bej Konicës nuk ka datë. Informacioni i dërguar nga Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit [DMP] është e datës 1 fruer [shkurt] 1945.

¹³⁷ Po aty, fl. 7.

¹³⁸ Po aty.

¹³⁹ Po aty, fl. 8.

¹⁴⁰ Po aty.

Nga informacioni që vinte në Leçe lidhur me të arratisurit atje sidomos për sa i përkiste ish-kryeministrit Eqerem Libohova, nuk ishin të mira. Kjo për faktin se DMP-së i mungonin krejtësisht elementet e përgatitur për të mbikëqyrur dhe kontrolluar si duhet elementin e arratisur shqiptar.¹⁴¹ Nga informatat që vinin për të arratisurit shqiptarë që gjendeshin në S. Maria di Leuca, ishin shpresëdhënëse për qeverinë shqiptare. Në atë kamp gjendeshin sipas informatave 150 tradhtarë dhe se marrëdhëniet midis zogistëve dhe legalistëve ishin të këqija.¹⁴² Në këtë kamp vetë DMP-ja kishte mundur të fuste njeriun e vet (partizanin A. Gj.) i cili kishte marrë vesh diku (pa sqaruar) se Abaz Kupa gjendej i ruajtur nga anglezët në një ndërtesë në Taranto, por se nuk kishte ndonjë informacion tjetër.¹⁴³

Informacionet për të arratisurit shqiptarë që gjendeshin në Itali, shqetësonin vazhdimisht Enver Hoxhën pasi aleatët perëndimorë [anglo-amerikanët] kishin filluar të tregonin interesim të hapur për ta dhe se gjërat kishin ndryshuar për mirë në favor të tyre.¹⁴⁴ Nga ky informacion, të arratisur shqiptarë në Itali ishin vizituar edhe nga një ministër aleat, por që emri i tij nuk dihej nga agjentët shqiptarë të DMP-së.¹⁴⁵ Ishte e qartë se elementi politik shqiptar i arratisur kishte filluar të organizohej pak e nga pak politikisht. Më datë 24 shkurt në kampin e Barit kishte mbërritur edhe Abaz Kupa me të dy djemtë e tij si dhe Gaqo Gogo dhe Isa

¹⁴¹ Po aty, fl. 9. Raporte informative nga Bari për shqiptarët e arratisur që gjendeshin në Leçe. 3 shkurt 1945.

¹⁴² Po aty.

¹⁴³ Po aty.

¹⁴⁴ Po aty, fl. 10. Shënime nga një letër e ardhur nga Italia më datë 12 shkurt 1945. Tiranë, 15 shkurt 1945.

¹⁴⁵ Po aty.

Toptani.¹⁴⁶ Gjithashtu, më datë 12 shkurt, vetë argjipeshkvi i Barit kishte vizituar në kamp Mit'hat Frashërin dhe i kishte thënë se me urdhër nga Sekretariati i Papës kishte leje të pyeste nëse kishte ndonjë shqetësim dhe të lajmëronte për çdo gjë që do ta kishte të nevojshme.¹⁴⁷

Përveç Italisë, Franca ishte një tjetër vend ku u përqendrua vëmendja e DMP-së për vitin 1945. Nga informacioni i datës 24 dhjetor 1945 i paraqitur nga DMP, që në shtator 1944 ishte themeluar në Paris Komiteti i shqiptarëve me kryetar Ramazan Shpatin.¹⁴⁸ Ky komitet sipas raportit kishte marrëveshje me aleatët me qëllim që të mblidhnin vullnetarë për të ardhur në Shqipëri së bashku me ushtrinë aleate kur këta të fundit të zbarkonin.¹⁴⁹ Informacioni i ardhur nga informatori M. Ç. i cili kishte ardhur në këtë vit nga Parisi, jepte të dhëna shqetësuese për Enver Hoxhën. Ky komitet kishte marrëdhënie të rregullta me Ahmet Zogun dhe kishte përkrahjen e ministrit të Jashtëm francez Bido (Bideaut).¹⁵⁰ Për këtë komitet, DMP-ja kishte treguar kujdes të veçantë pasi vetëm pas dy muajve nga themelimi i tij ishte krijuar brenda këtij komiteti një komiteti i ri nën kryesinë e Zija Bahollit më 2 nëntor 1945.¹⁵¹ Brenda këtij komiteti ekzistonin dy rryma të cilat ishin qartësisht të

¹⁴⁶ Po aty, f. 12. Më datë 11/11/1945 u suallën në kamp Abaz Kupi me të dy djemtë me Gaço Gogon dhe me Isa Toptanin.

¹⁴⁷ Po aty.

¹⁴⁸ AMPB/AIDSSH, Zbulimi Politik, V. 1945, D. 83. fl. 9. Raport mbi veprimtarinë politike të shqiptarëve me banim në Francë. Komiteti i Shqiptarëve kishte sekretar Nuçi Kotën, sekretar dhe anëtar Sefedin Çollakun dhe Androkli Filipeun.

¹⁴⁹ Po aty.

¹⁵⁰ Po aty.

¹⁵¹ Po aty. Pjesë nga raporti: "Komiteti i shtatorit 1944 mbas dy muajve u rrëzua prej shokëve tanë dhe u formua një komitet nën kryesinë e Zija Bahollit. Ramazan Shpati, Nuçi Kota dhe të tjerë kundërshtarë, të inatosur nga kjo gjë kanë bërë ç'është e mundur për të sabotuar veprën e Komitetit, aq sa na kanë spiunuar tek policia franceze duke thënë se është një komitet komunist dhe kanë sabotuar njohjen zyrtarisht të këtij komiteti".

ndarë sipas pikëpamjeve politike dhe jo vetëm.¹⁵² Kontrolli i këtij komiteti prej të besuarve të DMP-së ishte një sukses i madh për shërbimin e fshehtë shqiptar i cili ishte në hapat e parë të krijimit të tij.

Propaganda komuniste shqiptare vs propagandës së elementi politik shqiptar të arratisur

Fillimi i propagandës së PKSH-së në drejtim të botës së jashtme fillon me “zbarkimin” e misionit shqiptar në Bari të Italisë në korrik 1944 nën kryesinë e Bedri Spahiut.¹⁵³ Detyrë kryesore në lëmin e propagandës e misionit shqiptar në Bari ishte hedhja poshtë e njoftimeve që paraqiste fletushka me titull “Sundimi” që botohej nga aleatët nën drejtimin e zogistit Asim Jakova.¹⁵⁴ Menjëherë delegacioni i misionit shqiptar në Bari kishte filluar të paraqiste anën e vet të medaljes për sa i përkiste qeverisë së re shqiptare. Ky mision krijoi lidhje të drejtpërdrejta me shqiptarët e mërguar në Amerikë, Australi, Egjipt, Turqi, Francë dhe Angli.¹⁵⁵ Interesant është fakti që na paraqitet në këtë dokument se, shpërndarja e propagandës së misionit ushtarak shqiptar në Bari bëhej nëpërmjet postës jugosllave.¹⁵⁶

¹⁵² Po aty. “Të organizuarit në grup të Partisë lidhur edhe me PKF (partia komuniste franceze) ishin Et’hem Shushi, Thanas Çami, Murat Kaludhi, Petro Seka, Duro Shehu, Gani Zhapova, Petro Kallanxhi, Mihal Berati, Muharrem Gjirokastra, Halil Çami, Veli Deti. Elementi kundërrevolucionar përbëhej prej: Nuçi Kota, Milto Noçka, Sefedin Çollaku, Halil Tirana, Androkli Filipeu (dhëndër i Koço Kotës), Maliq Çami, Ramo Kallajxhi, Xhaferr Zhapova, Hamdi Tepelena, Ferit Shpata (i besuar i Iljaz Vrionit në legatën shqiptare në Paris), Ali Kuçi”.

¹⁵³ AMPB/AIDSSH, Drejtoria e Zbulimit Politik, V. 1946, D. 87, fl. 1. Relacion i hollësishtëm mbi aktivitetin e Misionit Ushtarak Shqiptar në Bari në drejtim të shtypit dhe të propagandës të Shqipërisë në Itali për botën e jashtme dhe shqiptarët jashtë atdheut. Përgjegjësi i seksionit të shtypit në Bari, Kol Berisha. Tiranë, 15 korrik 1946.

¹⁵⁴ Po aty.

¹⁵⁵ Po aty, fl. 2.

¹⁵⁶ Po aty.

Problem i rëndësishëm që theksohet në këtë raport ishte përkrahja që kishte siguruar Mehmet Konica nga aleatët perëndimorë në Itali dhe se falë tyre kishte arritur të vendoste autoritetin e tij tek shqiptarët e Italisë.¹⁵⁷ Në raport theksohet gjithashtu se fillimisht njerëzit e Frontit që më përpara e kishin si detyrë t'i bashkonin shqiptarët e Italisë me lëvizjen nacional-çlirimtare dhe që ishin dr. Kiço Karajani dhe Petro Marko, kishin dështuar në misionin e tyre.¹⁵⁸ Afrimiteti i dukshëm shqiptaro-jugosllav ishte një tjetër çështje që duhej sqaruar nga propaganda komuniste shqiptare në Bari nën drejtimin e Kadri Hoxhës. Kjo për faktin se çështja e Kosovës vijonte të ishte shumë e ndjeshme tek shqiptarët jashtë atdheut dhe se afrimi me Jugosllavinë do të thoshte tradhti ndaj saj [Kosovës].¹⁵⁹

Hapja e ekspozitave dhe dokumentaret me fotografi që i përkisnin luftës nacional-çlirimtare ishte një tjetër formë e propagandës që synonte PKSH-ja ndaj emigracionit politik shqiptar dhe kolonive shqiptare jashtë.¹⁶⁰ Propaganda ndaj shqiptarëve të Amerikës ishte një tjetër synim që kishte misioni ushtarak shqiptar. Broshurat dhe traktet që filluan të dërgoheshin si gjithmonë nga posta jugosllave dhe puna që u zhvillua me oficerët amerikanë me origjinë shqiptare në Bari ishin një fillim i mbarë për propagandën e PKSH e fshehur nën petkun e luftës nacional-çlirimtare.¹⁶¹ Ndër revistat më të dërguara nga Shqipëria dhe që misioni

¹⁵⁷ Po aty, fl. 3.

¹⁵⁸ Po aty.

¹⁵⁹ Po aty, fl. 4. Pjesë nga relacioni: "Çështja delikate e Kosovës, arma më e fortë e reaksionit shqiptar e të huaj është cekur dëndur me urtësinë e taktin që meritonte një çështje e këtillë në fillim kur ishte ende pa u zgjidhur, dhe si definitivisht të zgjidhur pastaj sipas dëshirës e vullnetit Sovran të popullsisve shqiptare e jugosllave të Kosovës e Metohisë".

¹⁶⁰ Po aty.

¹⁶¹ Po aty, fl. 5.

ushtarak në Bari i dërgonte për shqiptarët e Amerikës ish-in “Bota e Re” dhe “Shqiptarja e Re”.¹⁶²

Misioni ushtarak shqiptar në Bari kishte arritur të gjente edhe adresat përkatëse të shqiptarëve në Egjipt, Turqi, Francë e Itali dhe këtyre u dërgoheshin libra me përmbajtje marksiste.¹⁶³ Ishte e rëndësishme që propaganda e PKSH nëpërmjet misionit shqiptar në Bari t’i drejtohej edhe audiencës së huaj dhe për këtë arsye fillon e botohet buletini në gjuhën frënge “Nouvelles de l’Albanie/Të reja nga Shqipëria”.¹⁶⁴ Ky buletin fillimet e tij i ka në periudhën shtator 1944-janar 1945.¹⁶⁵ Prej fillimit të vitit 1945 e deri në vitin 1946, propaganda e misionit ushtarak shqiptar në Bari i kushtoi vëmendje të veçantë lidhjes së Agjencisë Telegrafike Shqiptare me agjencitë telegrafike të huaja sidomos me agjencinë ANSA të Italisë për përcjelljen e lajmeve nga Shqipëria.¹⁶⁶ Synimi ishte që të vijehej të thellohej përçarja ndërmjet elementeve të emigracionit shqiptar në Itali dhe jo vetëm. Madje, dhe agjencia e madhe amerikane e lajmeve (International News Service) merrte lajmet për Shqipërinë nga misioni ushtarak shqiptar në Bari.¹⁶⁷ Megjithatë, misioni shprehte trishtimin se gati të gjitha lajmet që merreshin prej tij për t’u transmetuar prej këtyre dy agjencive transmetoheshin të përgjysmuara.¹⁶⁸ Shqipëria shpesh paraqitej si vasale e Jugosllavisë nga agjencia Rojters (Reuters) pasi shumicën e lajmeve e merrte nga agjencia jugosllave e lajmeve TANJUG.¹⁶⁹ Këtë informatë,

¹⁶² Po aty.

¹⁶³ Po aty, fl. 6.

¹⁶⁴ Po aty, fl. 6.

¹⁶⁵ Po aty.

¹⁶⁶ Po aty.

¹⁶⁷ Po aty, fl. 7.

¹⁶⁸ Po aty.

¹⁶⁹ Po aty.

misioni ushtarak shqiptar në Bari e justifikonte me lidhjen e ngushtë që ekzistonte asokohe ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë.¹⁷⁰ Të gjitha këto informacione, përpiqeshin të shfrytëzoheshin në maksimum prej emigracionit politik shqiptar të cilët e konsideronin Shqipërinë si një vend të drejtuar nga Beogradi dhe Moska, armike të vendeve perëndimore.¹⁷¹ Vetëm shtypi komunist italian me gazetën “Unitá” e fletorja “Avanti” shkruanin mirë për Shqipërinë.¹⁷²

Propaganda komuniste e PKSH nëpërmjet misionit ushtarak kishte përballë një propagandë të fortë të elementit shqiptar të arratisur ku emrat më të spikatur që shkruanin kundër qeverisë komuniste shqiptare ishin Asim Jakova, Mehmet Cungu, Xhemal Farka, Alfred Antoni.¹⁷³ Lufta propagandistike ndërmjet pushtetit komunist në Shqipëri dhe elementit politik shqiptar të arratisur ishte gjithnjë e fortë. Shqipëria edhe pse ishte një vend i varfër, përsëri propaganda komuniste nuk rezervohej në pagimin e shumave të konsiderueshme për kohën për t’i bërë të ditur botës perëndimore lajmet nga Shqipëria.¹⁷⁴ Ishte e ditur se ekonomikisht agjencitë telegrafike në Itali vareshin të gjitha prej institucioneve bankare, shoqërive anonime, organizatave politike, dhe sipas relacionit, edhe Vatikani i ndihmonte së jashtmi.¹⁷⁵

¹⁷⁰ Po aty.

¹⁷¹ Po aty, fl. 8.

¹⁷² Po aty, fl. 16.

¹⁷³ Po aty, fl. 17.

¹⁷⁴ Po aty, fl. 18. Pjesë nga relacioni: «Është kërkuar një fond prej 60.000 lira për botimin e Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë, të përkthyer në italisht, dhe kopja e përkthyer ka mbetur në Itali pa u botuar. Është përkthyer e botuar në çiklostil «Historia Diplomatike e Epirit të Veriut» në njëqind kopje me 47 faqe. Kjo histori u është dërguar të gjitha fletoreve italiane e të huaja si dhe një shumice miqsh dhe shokësh italianë. Për këtë broshurë janë shpenzuar vetëm 1000 lira mbasi ka ndihmuar vullnetarisht një shok italian gazetar i quajtur Dott. Bonito Salvo».

¹⁷⁵ Po aty, fl. 19. “Është e natyrshme që këto agjenci mos t’i botojnë fare ose

Megjithë dobësitë e dukshme të propagandës zyrtare shqiptare, përsëri ajo ishte padiskutim më e organizuar dhe më e përgatitur nga propaganda e elementit të arratisur shqiptar. Sipas një informacioni të datës 22 mars 1946, DMP-ja njoftonte se shqiptarët e arratisur në Itali mjaftoheshin vetëm me nxjerrjen e një broshure dhe propaganda e tyre ishte thjesht propagandë kafeneje.¹⁷⁶ Ndarja politike e tyre i bënte kontradiktorë në qëndrime.¹⁷⁷ Vetëm Balli Kombëtar dukej sikur ishte më konseguenti veçanërisht në denoncimin e lidhjes së Shqipërisë me Jugosllavinë.¹⁷⁸

Nga ana tjetër, anëtarët e Legalitetit ishin lajmëruar nga Abaz Kupi se kishte marrë urdhër nga Ahmet Zogu që të mos lëviznin në asnjë mënyrë nga Italia.¹⁷⁹ Gjithashtu, me koloninë e të ikurve shqiptarë në Francë, Ahmet Zogu sipas informatave të DMP-së u dërgonte ndonjë 'kockë' dhe i porosiste që të mbanin lidhje me të arratisurit shqiptarë në Itali.¹⁸⁰ Problemi i vërtetë që kishte propaganda shqiptare

t'i botojnë ashtu siç u pëlqen reaksionit lajmet mbi Shqipërinë dhe vendet ballkanike. Lajmet tona mbi reformat e mëdha, si reforma agrare, informatat mbi sukseset e shumta të korrura prej pushtetit në çdo fushë të aktivitetit shtetnor, o janë botuar me kursim të madh ose janë lënë mënjane. Agjencive u interesonin vetëm lajme mbi incidentet në kufirin greko-shqiptar, mbi prodhimin e vajgurit dhe lajme me karakter ekonomik".

¹⁷⁶ AMPB/AIDSSH, Fondi 6, V. 1946, D. 88, fl. 4. Mbi shqiptarët reaksionarë në Itali.

¹⁷⁷ Po aty. Pjesë nga raporti: "Në disa sundon shpresa se gjendja në Shqipëri të paktën brenda katër muajve do të ndryshojë; disa të tjerë, edhe pse kanë marrë vesh se K. Ndërkombëtar jep leje për në vende të tjera, kërkojnë të venë në Egjipt, Kanada, USA e gjetkë...Shqiptarët kuislingë janë në grindje të vazhdueshme dhe pa shpresa bashkëpunimi midis tyre, megjithë tentativat që bëjnë në këtë drejtim. Mit'hat Frashëri i ardhur nga Regio Emilia disa kohë më përpara qëndroi në Romë për një muaj rresht, erdhi në kontakt me Eqerem Libohovën dhe me Ymer Fortuzin, por pa arritur në ndonjë përfundim".

¹⁷⁸ Po aty, fl. 4.

¹⁷⁹ Po aty, fl. 5.

¹⁸⁰ AMPB/AIDSSH, Drejtorja e Zbulimit Politik, V. 1946, D. 89, fl. 2. Raport mbi koloninë shqiptare të Francës. Pjesë nga aktiviteti i Ahmet Zogut: "Gjithë oficerat e Zogut janë të Legalitetit dhe me ta ndonjë tregtar. Deri tani nuk kemi marrë vesh se të jenë të organizuar, veç se kanë kontakte të shpeshta dhe disa herë bëjnë lëvizje të dyshimta që ne i kemi quajtur se bëjnë kontakte me kriminelat luftarë të ardhur këtu. Është e vërtetë se Zogu i ndihmon ata, jo rregullisht, por ju dërgon nga ndonjë kockë herë pas here. Këtë gjë e ka lënë të nënkuptohet ish-ofi-

kishte të bënte vetëm me ndihmën që merrte elementi shqiptar i arratisur nga aleatët anglo-amerikanë.¹⁸¹ Sipas agjentëve shqiptarë të DMP-së në Bari, edhe qeveria italiane së fundmi kishte filluar të mbante hapur krahun e reaksionarëve shqiptarë të arratisur dhe madje kishte filluar t'i ndihmonte edhe materialisht.¹⁸² Ministria e Luftës e Italisë kishte filluar t'u paguante rroga të gjithë oficerëve shqiptarë që kishin bërë pjesë dikur në kuadrot e ushtrisë italiane gjatë pushtimit dhe madje do të propozonte edhe një dekret-ligj ku do të autorizojë marrja në shërbimin ushtarak e të gjithë oficerëve shqiptarë që gjendeshin në Itali.¹⁸³ Jo vetëm kaq, por bankat italiane kishin filluar të pranonin shkëmbimin në lira deri në 400 franga shqiptare (1 fr.shq.=6.25 lira).¹⁸⁴ Monedha duhet të ishte e pa vulosur me stemën e re dhe personi që paraqitej për të kryer këmbimin, duhej të vërtetonte se kishte qenë në Shqipëri dhe se këto të holla i kishte sjellë ose i kishte patur pas 8 shtatorit 1943.¹⁸⁵

DMP kishte arritur që të kishte akses tek shqiptarët e Parisit (numri i tyre në total 150 vetë) dhe pjesën më të madhe të tyre e kishin simpatizantë të PKSH dhe ishte grup i lidhur me partinë komuniste franceze.¹⁸⁶ Emigracioni

ceri i Zogut Sefedin Çollaku, në inat e sipër në një bisedim që pati me Nexhat Mitrovicën. Këta kanë lidhje dhe korrespondencë si me kriminelët e Italisë ashtu dhe me njerëzit e Zogut në Kajro. Farka, i shoqëruar me një jugosllav ka qenë këtu dhe është takuar me ata, të cilëve ju ka thënë gjendjen dhe organizimin e kriminelëve shqiptarë në Itali. Midis të tjerave kemi marrë vesh me siguri se të gjitha grupet e Italisë janë bashkuar me Zogun dhe për këtë punë shkuan delegatë të të gjitha grupeve në Kajro për të shfaqur besnikëri karshi Zogut".

¹⁸¹ AMPB/AIDSSH, Fondi 6, V. 1946, D. 88, fl. 6. Pjesë nga raporti: "Oficeri ndërlihdës me misionin ushtarak tonin në Bari, kapiten Filip Vos, në çdo bisedë që ka me shokët tanë ose me të tjerë rreth Shqipërisë mundohet t'i paraqesë si të vërteta të gjitha akuzat që lëshohen mbi ne nga ana e reaksionit".

¹⁸² Po aty, fl. 8.

¹⁸³ Po aty.

¹⁸⁴ Po aty.

¹⁸⁵ Po aty.

¹⁸⁶ AMPB/AIDSSH, Drejtorja e Zbulimit Politik, V. 1946, D. 89, fl. 4. "Kundërshtarët e regjimit në koloninë shqiptare të Parisit ishin Milto Noçka dhe Nuçi Kotta dhe

politik shqiptar ishte në amulli të plotë. Përppjekja më e dukshme për të organizuar emigracionin politik ishte ajo e Ahmet Zogut ku sipas informacioneve të Sigurimit të shtetit, në vitin 1947 ai [Zogu] i bënte thirrje Ali Këlcyrës, Mehdi Frashërit, Sali Myftiut, Gjon Markut, Mit'hat Frashërit që të shkonin ta takonin në Egjipt për të krijuar kryesinë e emigracionit.¹⁸⁷ Në informacionin e datës 26 prill 1947, Sigurimi i shtetit jep detaje për lidhjet e reaksionit shqiptar me Vatikanin, Zogun, me reaksionin italian, me grekët e arratisur dhe me anglo-amerikanët.¹⁸⁸ Në gjithë këtë informacion të gjatë nga ana e Sigurimit, shikohet një përppjekje e madhe për të bashkuar në një emigracionin politik shqiptar.¹⁸⁹ Megjithë përppjekjet për bashkim të tre grupet kryesore të emigracionit politik shqiptar punonin të shkëputur nga njëri-tjetri.¹⁹⁰ Kjo përçarje sipas Sigurimit, bënte që gjendja ekonomike e emigracionit politik shqiptar keqësohej përherë e më shumë sa “mezi rronin”.¹⁹¹

dy ose pesë oficerë të tjerë zogistë të cilët ishin lidhur ngushtë me Londrën dhe veçanërisht me Zogun”.

¹⁸⁷ AMPB/AIDSSH, Drejtoria e Zbulimit, Emigracioni, V. 1947, D. 131, fl. 3. Raporte informative mbi gjendjen dhe veprimtarinë armiqësore të emigracionit reaksionar shqiptar në Itali dhe dokumente mbi organizatën tradhtare “Balli Kombëtar” në mërgim.

¹⁸⁸ Po aty, fl. 4.

¹⁸⁹ Po aty, fl. 5. Pjesë nga raporti i Sigurimit të shtetit: “Ajo që na paraqitet më me rëndësi tash së fundi në elementin reaksionar shqiptar që ndodhet në Itali, është tendenca e tyre për bashkimin midis tre grupeve, d.m.th. midis Bllokut Independent Kombëtar, Ballit Kombëtar dhe Legalitetit. Ndërsa rezultojnë dhe raportet në kohët e fundit shikohet që grupi Balli Kombëtar të interesohet më shumë për një bashkim me grupet e tjerë dhe veçanërisht Ali Këlcyra me grupin e tij i cili sa vjen i shton dhe më tepër përppjekjet e tij në këtë drejtim. Themi veçanërisht Ali Këlcyra me grupin e tij, pse ndërsa vihet re këtu në Ballin Kombëtar vazhdojnë mosmarrëveshjet midis Mit’hatit dhe Aliut dhe këto janë duke u shtuar”.

¹⁹⁰ Po aty.

¹⁹¹ Po aty, fl. 6. Pjesë nga rapoti: “Gjendja e reaksionarëve në kampe bëhet sa vjen dhe më e vështirë dhe se mezi rrojnë. Kjo ka shtuar dhe më tepër që ata t’i përvisen dhe të bëjnë tregun e zi si dhe kontrabandën, të cilët në Reggio Emilia bëjnë cigare me duhan italian dhe i shesin për cigare amerikane në Romë e gjetkë. Porse kjo gjendje e vështirë e këtyre është vënë re dhe më tepër në një shpallje që qe ngjitur në kampin e Reggio Emilias nga aleatët anglo-amerikanë, ku thuhet se është e dëshirueshme që kush do të kthehet në vendin vet, pse

Madje, sipas Sigurimit, puna kishte shkuar deri atje sa ata [emigranët] kishin lënë të kuptohej se nëse do të kishte amnisti ishin gati të ktheheshin në Shqipëri.¹⁹² Por, nuk ishte e thjeshtë të ktheheshe në Shqipëri pasi ishte arratisur pasi, jeta dhe puna e rëndë që e priste dikë nëse kthehej ishte jashtë çdo dyshimi. Gjithashtu, baza të sigurta ku mund të strehoheshin të arratisurit në Shqipëri ishte thujse e pamundur të gjeje. Ngritja e skuadrave të ndjekjes për të bërë të mundur eliminimin e elementit të arratisur brenda vendit dhe ashtu edhe ata që do të mund të hynin në mënyrë ilegale në Shqipëri, ishte një nga prioritetit e qeverisë komuniste shqiptare.¹⁹³

Në botën perëndimore informacionet mbi terrorin në Shqipëri nuk mungonin dhe imazhi i saj si vend diktatorial nxinte. Ky fakt vërtetohet nga një letër sekrete dërguar nga ministri i Jashtëm Behar Shtylla, Komitetit Qendror të PPSH-së mbi informacionin që ishte shpërndarë në Nju Jork në selinë e OKB-së mbi punën e detyruar në Shqipëri.¹⁹⁴ Raporti është i datës 2 shtator 1954 dhe titullohet “Evidenca e punës së detyruar në Shqipëri”.¹⁹⁵ Në fletët 6 dhe 9 jepen detaje të hollësishme mbi punën e detyruar që ushtrohej mbi të burgosurit politikë dhe në kampet e përqendrimit në Shqipëri.¹⁹⁶ Në raport shkruhej se qeveria shqiptare nuk bënte asnjë tentativë që të fshihte faktin e punës së

ndihmat që janë dhënë deri më sot do të rriten. Kjo solli dëshpërim të madh ndër reaksionarët, porse më tepër frikë. Gjithashtu, flitet se këta nuk ndihmohen më prej UNRRA-s por prej komandës ushtarake angleze”.

¹⁹² Po aty.

¹⁹³ AQSH, F. 14/Strukturat [më tej: Str], V. 1947, D. 246, fl. 1. “Raport i instruktorit të KQ mbi gjendjen politike, mbi elementin e arratisur dhe bazat e strehimit të tij”. Shih edhe dosjet 250 dhe 251.

¹⁹⁴ AQSH, F. 14/Str, V. 1955, D. 176, fl. 56. Raport i OKB-së për punën e detyruar në Shqipëri.

¹⁹⁵ Po aty, fl. 57.

¹⁹⁶ Po aty, fl. 58.

detyruar të imponuar kundërshtarëve politikë shumica e të cilëve ishin nga ish klasa borgjeze ose pronarë tokash.¹⁹⁷ Në raport theksohej fakti se krijimi policisë popullore më ligjin nr. 372 datë 12 dhjetor 1946, ngarkonte autoritetet policore të arrestonin individë dhe t'i dërgonin në burgje e kampe për punë të detyruar.¹⁹⁸ Sipas raportit, më 13 gusht 1947 në radio Tirana ishte dhënë njoftimi se qeveria shqiptare kishte vendosur të çonte në punë të detyruar të gjithë personat që i kishin shërbyer regjimeve anti popullore dhe që mund të ishin pa punë dhe të gjithë të çoheshin në ndërtim.¹⁹⁹

Shumica e të dënuarve politikë në Shqipëri ishin vendosur në kampe përqendrimi dhe punë të rëndë të detyrueshme përpara se të aprovohej Kodi Penal i vitit 1952 dhe të gjithë ishin dënuar nga gjykatat ushtarake duke filluar nga ngritja e tyre në janar 1945.²⁰⁰ Interesant është fakti se në raport jepen hollësi të jashtëzakonshme mbi kampet e punës së detyruar (që në raport quhen kampet e vdekjes) në Burrel, Beden, Maliq dhe Vloçisht.²⁰¹ Shumë nga të dhënat që paraqiteshin në këtë raport ishin marrë nga drejtori i Byrosë së Statistikave të Shqipërisë në zyrën Shtetnore të Hetimeve, i cili ishte arratisur më 1948, dhe kishte deklaruar se deri në fund të vitit 1947 se në Shqipëri kishte 18.000 të burgosur politikë.²⁰² Sipas Skëndër Dumes i cili para arratisjes në Greqi në vitin 1951, kishte kaluar pesë

¹⁹⁷ Po aty, fl. 60. Pjesë nga raporti i OKB-së mbi punën e detyruar në Shqipëri: “Veç kësaj, ajo imiton edhe e tejkalon shembullin e zakonshëm satelit në ushtrimin e kontrolleve të saj mbi punën dhe përdorimin në masë të së ashtuquajturës punë “vullnetare” (në të vërtetë me përdhunë) në projektet industriale, ndërtimi dhe bujqësore”.

¹⁹⁸ Po aty.

¹⁹⁹ Po aty, fl. 61.

²⁰⁰ Po aty, fl. 63. Pjesë nga raporti: «Personat e akuzuar si fashistë gjobiteshin në të holla ose me punë të detyruar nga një muaj deri në 20 vjet”.

²⁰¹ Po aty.

²⁰² Po aty.

vjet në këto kampe, kishte deklaruar se në Shqipëri kishte 10 burgje politike ku mbaheshin 10.000 njerëz në kushte të tmerrshme.²⁰³

Internimet e familjeve të të burgosurve politikë është një tjetër informacion që jepet në këtë raport. Qëllimi fillestar i kampeve të internimit ishte shpërngulja e familjeve të klasave të larta me qëllim që t'i ziheshin shtëpitë nga anëtarët e nomenklaturës komuniste në pushtet.²⁰⁴ Për të shmangur arratisjet jashtë shtetit, në kampe internimi dërgoheshin të gjithë njerëzit e dyshuar dhe familjet e tyre. Shembulli tipik për këtë është kampi i internimit i Tepelenës dhe i Himarës.²⁰⁵

Për vitin 1946, numri i të arratisurve ishte rreth 600. Me anë të veprimeve operative ishin arrestuar në numër strehuesish dhe furnizuesish të të arratirurve dhe pjesa më e madhe i ishin dhënë gjyqit. Shifrat ishin këto: të arrestuar si kriminelë lufte: 4.505 veta; Të arrestuar si strehues e furnizues të të arratisurve: 516 veta.²⁰⁶ Interesant është fakti se në mbledhjen e Byrosë Politike të datës 5 maj 1948, u aprovua vendimi për hartimin e një ligji special i cili specifikonte përgjegjësitë e organizatave tradhtarë brenda apo jashtë vendit mbi të cilët akuzat ishin të njëjta, pasi bënë pjesë në një organizatë me qëllime të caktuara anti-pushtet.²⁰⁷

²⁰³ Po aty.

²⁰⁴ Po aty, fl. 64.

²⁰⁵ Po aty, fl. 65.

²⁰⁶ AMPB/AIDSSH, Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit, V. 1946, D. 6, fl. 10. Raport mbi punën e seksionit II-të të Mbrojtjes së Popullit për periudhën dhjetor 1944-mars 1946, kundër veprimtarisë armiqësore dhe statistikat e të arratisurve kriminelë lufte dhe strehuesish diversantësh.

²⁰⁷ AQSH, F. 14/OU, V. 1948, D. 84, fl. 1. Pjesë nga mbledhja e Byrosë Politike e datës 5 maj 1948: "Një gjë të re që ka kodi është çështja e përgjegjësisë të organizatave tradhtarë. Këti qoftë udhëheqësit apo anëtarët e një organizate të fshehtë tradhtarë kanë të njëjtat akuza, mbasi këta bëjnë pjesë në një organizatë me qëllime të caktuara anti-pushtet, qëllime që njohen edhe nga vetë anëtarët e kësaj organizate".

Veprimet e Sigurimit të Shtetit ndaj emigracionit politik në vitet '50

Një problem që pati pushteti komunist në fillim të viteve '50, ishte edhe informacioni që vinte nga legatat shqiptare jashtë mbi arratisjen e studentëve shqiptarë.²⁰⁸ Megjithëse pushteti komunist në Shqipëri pas përplasjes Hoxha-Shehu të shtatorit 1953²⁰⁹, dhe dorëheqjes së Enver Hoxhës si kryeministër në korrik 1954²¹⁰ ishte konsoliduar, përsëri vëmendja ndaj emigracionit politik, ishte kryefjala e raporteve të paraqitura nga Sigurimi i Shtetit. Disa muaj përpara dorëheqjes së Enver Hoxhës si kryeministër dhe saktësisht më 29 mars 1954, Ministria e Brendshme nëpërmjet ministrit Mehmet Shehu, paraqiti një raport të detajuar me mbishkrimin tepër sekret, ku cilësohej puna e organeve të Sigurimit të Shtetit kundër elementit të arratisur.²¹¹ Në raport flitet për përpjekjet e vazhdueshme të spiunazhit amerikan për të përqendruar në duart e veta të gjithë emigracionin reaksionar shqiptar.²¹² Megjithatë

²⁰⁸ AQSH, F. 14/Str, V. 1951, D. 591, fl. 1-5. Korrespondencë e legatave tona jashtë shtetit, ministrisë së arsimit dhe e KQ të PPSH me anën e së cilës informohet për arratisjen e qëndrim armiqësor të disa studentëve.

²⁰⁹ Gjon Boriçi, "Pohimi nga byroja Politike e PPSH të dhunës ndaj të burgosurve dhe internuarve nga organet e Sigurimit të Shtetit deri në vitin 1953", në Të mohuar nga regjimi: Burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri në 1945-1990, Tiranë: AIDSSH, 2020, ff. 194-216.

²¹⁰ Gjon Boriçi, "Dorëheqja e detyruar e Enver Hoxhës si kryeministër i RPSH-së dhe kredia e parë kineze akorduar Shqipërisë, 1954", në Studime historike 3/4 2019, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike/Instituti i Historisë, 2020, ff. 217-239.

²¹¹ AQSH, F. 490/KM, V. 1954, D. 697, f. 1. "Mbi aktivitetin e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm kundër vendit tonë dhe masat e marra nga organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme".

²¹² Po aty. Pjesë nga raporti i ministrit të brendshëm Shehu: "Gjatë vitit 1953, aktiviteti i armiqve të jashtëm kundër vendit tonë, karakterizohet nga përpjekjet e vazhdueshme të spiunazhit amerikan për të përqendruar në duart e veta të gjithë emigracionin reaksionar shqiptar, me anë të bashkimit të organizatave të ndryshme të emigracionit (Itali, Francë, Amerikë e gjetkë) në Komitetin e ashtuquajtur «Shqipëria e Lirë» që është krijesë e spiunazhit amerikan. Afrimi i

raporti pranon se aktiviteti i diversantëve të hedhur në Shqipërië gjatë vitit 1953 kishte pësuar rënie krahasuar me vitin 1952.²¹³ Kjo ishte një dëshmi e qartë se fuqia nëse mund të quhet e tillë, e emigracionit politik shqiptar në perëndim ishte në rënie të vazhdueshme. Tek ky raport, jepen edhe detaje mbi numrin e arratisjeve nga Shqipëria sipas këtyre viteve:

1. Viti 1949, ishin arratisur 973 persona;
2. Viti 1950, ishin arratisur 564 persona;
3. Viti 1951, ishin arratisur 637 persona;
4. Viti 1952, ishin arratisur 207 persona;
5. Viti 1953, ishin arratisur 140 persona.²¹⁴

Siç shikohet numri i personave që arratiseshin kishte pësuar rënie të ndjeshme, kjo si pasojë edhe e forcimit të pushtetit komunist në Shqipëri. Një tjetër fakt që duhet pranuar mbi dobësinë e emigracionit politik, ishte edhe rrjeti efikas që Sigurimi i Shtetit kishte arritur të ndërtonte brenda vendit ku informohej me saktësi të madhe nga çdo rreth mbi familjet që kishin njerëz të arratisur jashtë dhe mbi të gjitha edhe se kush kishte tendenca për arratisje.²¹⁵

Emigracioni politik shqiptar ishte shumë i dobët dhe pa asnjë strategji konkrete ndaj pushtetit komunist në Shqipëri. Kjo dobësi e emigracionit politik vihet re edhe tek braktisja e plotë që iu bë komitetit “Shqipëria e Lirë” në vitin 1956 edhe nga vetë amerikanët. Ky fakt vërtetohet nga një informacion tepër sekret që ambasadori i RPSH-së në Itali, Edip Çuçi, i dërgoi Ministrisë së Jashtme në Tiranë

Jugosllavisë me Greqinë e Turqinë që u duk në vitin 1952, gjatë vitit 1953 u konkretizua me aleancën e këtyre shteteve armiq të vendit tonë, gjë që natyrisht shton rrezikun e jashtëm kundrejt Republikës sonë Popullore”.

²¹³ Po aty.

²¹⁴ Po aty, fl. 9.

²¹⁵ AQSH, F. 14/Str, V. 1948, D. 181, fl. 2. “Radiograme e korrespondencë e Komitetit Qendror të Partisë me Komitetet e partisë të rretheve e anasjelltas në lidhje me personat e arratisur për arsye politike, çështje hasmërie etj”.

“

Viti 1949, ishin arratisur 973 persona; 2. Viti 1950, ishin arratisur 564 persona; 3. Viti 1951, ishin arratisur 637 persona; 4. Viti 1952, ishin arratisur 207 persona; 5. Viti 1953, ishin arratisur 140 persona.

”

zbulimet e huaja të inteligjencës po i kushtonin emigracionit politik shqiptar pas ngjarjeve të vitit 1956 në Hungari.²¹⁹ Sipas raportit, jo pak emigrantë politikë kishin filluar të sistemoheshin në punëra të ndryshme “profesionale” dhe një pjesë e tyre ishin inkuadruar në ushtrinë amerikane në Evropë.²²⁰

më 2 korrik 1956.²¹⁶ Pas këtij sukcesi, pushteti në Shqipëri fillon e intensivon kontaktet me shqiptarët në SHBA.²¹⁷

Në një tjetër raport me mbishkrimin tepër sekret të paraqitur nga vetë ministri i Punëve të Brendshme që mban datën 7 dhjetor 1958, jepen të detajuara sipas Sigurimit të shtetit përpjekjet e armiqve të brendshëm dhe të jashtëm për përmbysjen e pushtetit popullor.²¹⁸ Një nga pikat më kyçe të këtij raporti është vëmendja sipas Sigurimit të shtetit që

²¹⁶ AQSH, F. 14/Str, V. 1956, D. 180, fl. 1. Tepër sekret: Dëshifrim nga Roma, Ministrisë së Punëve të Jashtme, 2/7/56. «Një prej këshilltarëve të Ambasadës Jugosllave i kishte thënë një nënpunësi të Legatës Rumune se; Amerikanët kanë mbetur të kënaqur nga Kongresi i tretë i Partisë së Punës të Shqipërisë drejtuar nga Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu. Gjithashtu i kishte thënë se: Amerikanët të kënaqur nga qëndrimi i Hoxhës dhe i Shehut urdhëruan shpërndarjen e komitetit kombëtar «Shqipëria e Lirë» dhe ndalimin e aktivitetit të tyre propagandistik karshi Shqipërisë. Kaq për dijeni. Edipi”.

²¹⁷ AQSH, F. 14/Str, V. 1956, D. 182, fl. 1. Mbi marrjen kontakt me shqiptarët e Amerikës. Informacion sekret nga Misioni i Përhershëm i Shqipërisë në Kombet e Bashkuara. New York, 28/7/56.

²¹⁸ AQSH, F. 14/OU, V. 1958, D. 10, fl. 6. “Mbi veprimtarinë e armiqve të brendshëm e të jashtëm si dhe mbi aktivitetin e organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme gjatë vitit 1957 dhe detyrat që dalin”.

²¹⁹ Po aty, fl. 7.

²²⁰ Po aty.

Megjithëse raporti shpreh shqetësim për vëmendjen që kishte emigracioni politik shqiptar nga zbulimi amerikan dhe britanik, përsëri tentativat e tyre për të ndërmarrë përpjekje serioze lidhur me kërcënimin dhe rrëzimin e pushtetit komunist në Shqipëri ishin të papërfillshme.²²¹ Megjithëse emigracioni politik nuk përbënte kërcënim të dukshëm për pushtetin komunist në Shqipëri, përsëri në fund të raportit të tij, ministri Hazbiu e mbyll me premtimin se Sigurimi do të luftojë edhe më me ashpërsi kundër armiqve të jashtëm.²²²

Përfundime

Gjatë të gjithë epokës së Luftës së Ftohtë, Shqipëria mbeti një vend i mbyllur dhe bota perëndimore ishte një tabu për Shqiptarët. Çdo turist i huaj që lejohej të vinte për pushime apo për vizitë në Shqipëri ishte rreptësisht i vëzhguar. Për të vëzhguar turistët e huaj ishte vetë Komiteti Qendror që lëshonte direktivat përkatëse të cilat zbatoheshin me përpikëri maksimale.²²³

²²¹ Po aty. Pjesë nga raporti i Sigurimit të paraqitur nga ministri i Punëve të Brendshme, Kadri Hazbiu: "Gjatë këtij viti zbulimi amerikan ka bërë një sërë tentativash për të shtënë nën influencën e vet gjithë emigracionin reaksionar me anë të vënies së tij në drejtimin e një 'komiteti' të vetëm të pastruar nga çdo influencë angleze, i cili mund të inkuadrohej në organizatat reaksionare ndërkombëtare dhe të koordinonte veprimtarinë e tij me atë të organizatës 'Vorio-Epirote'. Meqenëse 'Komiteti Shqipëria e Lirë' nuk u tregua i aftë në luftën kundër vendit tonë, në bashkimin e emigracionit etj., dhe meqenëse nuk ishte në gjendje t'i përgjigjej me sukses kërkesave të mëtejshme të zbulimit amerikan, në qershor të vitit 1956 amerikanët e shpërndanë, braktisën Hasan Dostin, u munduan të izolojnë krerët e organizatave të tjera reaksionare dhe në bashkëpunim me krerët e 'Komitetit Evropa e Lirë' filluan menjëherë konsultimet për zgjedhjen e një 'komiteti' të ri. Mbas 6 muaj përpjekjesh të vazhdueshme ky 'komitet' u formua me Vasil Gërmenjin, Rexhep Krasniqin, Ndue Gjon Markaj, Sotir Avramin dhe Nexhat Peshkopinë dhe u shpall në New York të vitit 1956".

²²² Po aty, fl. 49.

²²³ AQSH, F. 14/Str, V. 1967, D. 195, fl. 1. Sekret. "Mbi ardhjen e turistëve të huaj në vendin tonë". KQ i PPSH-së, Tiranë, 16.3.1967.

Sipas dokumenteve që kam hulumtuar deri tani numri i njerëzve të vrarë, të kapur dhe nën survejim familjet e tyre nga Sigurimi nga viti 1949 deri 1974 për tentativë arratisje janë si më poshtë:

Numri i përgjithshëm për vitin 1949 për tentativë arratisje ishte: 301.

Prej këtyre të vrarë: 12.

Të kapur dhe të dorëzuar: 31. Gjithsej të arratisur: 258.²²⁴

Në Itali puna për ngritjen e agjenturës kishte filluar në vitin 1950 dhe ishin rekrutuar 7 agjentë.²²⁵

Numri i shqiptarëve të emigruar politikisht jashtë:

Në Itali: 6000 vetë; Greqi: 1500; Liban Siri Transjoradani: 500; Egjipt: 150; Austri bashkë me studentët: 150; Turqi: 50; Amerikë: 100; Francë: 60; Australi: 50; Argjentinë: 20.²²⁶

Urdhri operativ për të rekrutuar agjentë pasi puna e bërë nuk është e mirë sipas Sigurimit është i datës 6 prill 1952²²⁷ dhe të bëhej çmos të penetrohej në organizatën “Shqipëria e lirë”.²²⁸

Gjatë vitit 1953 Sigurimi i shteti kishte planifikuar të mbante lidhje me 38 agjentë, 19 agjentë të ishin pa lidhje, dhe 33 agjentë do të hidheshin në vendet kapitaliste. Me Shqipërinë do të mbanin lidhje 89 agjentë për t’u dërguar në rrugë ilegale.²²⁹ Bëhej herë pas here amnisti, por 207 veta të arratisur politikë nuk përfitonin nga amnistia e këtij viti.²³⁰ Sigurimi kishte çdo dijeni për familjarët e të

²²⁴ AMPB/AIDSSH, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1949, D. 12, fl. 1-31.

²²⁵ AMPB/AIDSSH, V. 1950, D. 295, fl. 20.

²²⁶ AMPB/AIDSSH, Drejtoria e zbulimit, V. 1949, D. 253, fl. 25. Raporte dhe relacione të degës së zbulimit mbi veprimtarinë e elementit reaksionar jashtë shtetit.

²²⁷ AMPB/AIDSSH, Drejtoria e Zbulimit, V. 1952, D. 356, fl. 2. Direktivë e ministrit të Brendshëm dërguar organit të zbulimit politik mbi detyrat në drejtim të Anglisë dhe Amerikës, Jugosllavisë, Greqisë, dhe Italisë e Francës.

²²⁸ Po aty, fl. 3.

²²⁹ AMPB/AIDSSH, V. 1953, D. 385, fl. 1. Raport mbi veprimtarinë e Degës I, gjatë vitit 1953.

²³⁰ AMPB/AIDSSH, V. 1959, D. 630, fl. 1-3. Listat emërore e të arratisurve-kriminelë lufte që nuk përfitonin nga amnistia dhe lista emërore me adresat e të arratisurve.

arratisurve që kishin mbetur në Tiranë.²³¹ Listat e sigurimit për lidhjet që kishin të arratisurit me familjarët e tyre sipas rretheve.²³² Lista e familjeve të të arratisurve të Tiranës që kanë vepruar si diversantë kundër vendit dhe që familjet e tyre banojnë në qytetin e Tiranës ishte përpiluar me saktësi të madhe.²³³

Sipas regjistrimit të të arratisurve të Shqipërisë gjatë viteve 1944-1964, numrin rekord e mbante Tirana me 245 vetë të arratisur.²³⁴ Për vitin 1974 ishin internuar se u ishin arratisur familjarë 73 persona.²³⁵ Internimi si masë dëbimi e si masë administrative ka filluar të aplikohet nga viti 1950-1951, në fillim kundër elementit armik e më vonë atij keqbërës. Masa e internim- dëbimit merrej ndaj personave me shtetësi shqiptare, të huaj, ose pa shtetësi që kishin mbushur moshën 18 vjeç e paraqesin rrezikshmëri shoqërore. Këto persona ishin: Elementi antiparti, elemente me tendencë terrori, personat me tendencë arratisjeje që banonin në zona kufitare.²³⁶ Nga të gjitha dokumentet e hulumtuara deri tani dhe që po paraqiten për herë të parë në këtë artikull, mund të themi se emigracioni politik shqiptar ishte keq ose aspak i organizuar ndaj dhe suksesi i Sigurimit të shtetit ndaj tij ishte i sigurtë.

²³¹ AMPB/AIDSSH, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1961, D. 151, fl. 2. Lista e të arratisurve që kanë prindër, gra e fëmijë, e vëllezër në Tiranë.

²³² AMPB/AIDSSH, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1962, D. 184. Lidhjet e t'arratisurve që banojnë në rrethe të tjera të vendit.

²³³ AMPB/AIDSSH, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1963, D. 199, fl. 2-7.

²³⁴ AMPB/AIDSSH, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1964, D. 235, fl. 2-29.

²³⁵ AMPB/AIDSSH, Drejtoria I e Sigurimit, V. 1975, D. 126, fl. 4. Informacione dërguar udhëheqjes së partisë e shtetit mbi marrjen e masës së internimit dhe personat e internuar nga rrethi i Tiranës dhe dislokimi i tyre në rrethe.

²³⁶ AMPB/AIDSSH, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1975, D. 127/1, fleta pa numër. Sekret, informacion mbi të internuarit dhe të dëbuarit. Mehdi Bushati, Kryetar i Degës 8. Tiranë, 25 mars 1975.



Prof. asoc. dr. Afrim Krasniqi
Instituti i Historisë, ASA

Afrim Krasniqi është profesor në shkencat politike dhe në histori bashkëkohore. Prej 2022 ai është Drejtor i Institutit të Historisë (IH) në Akademinë e Studimeve Albanologjike, si dhe prej 2014 është drejtor ekzekutiv i Institutit të Studimeve Politike (ISP). Krasniqi ka kryer në FHF në Universitetin e Tiranës studimet doktorale në histori dhe marrëdhënie ndërkombëtare, si dhe ka mbaruar studimet master në Universitetin Viadrina (Frankfurt Oder) në Gjermani. Prej vitit 2022 mban titullin akademik “Prof. Dr”, ndërkohë që prej 2004 vijon të jetë lektor në UT dhe disa universitete të tjera. Ai ka qenë deputet në Kuvendin e RSH, si dhe këshilltar politik i dy Presidentëve të Republikës. Prej vitesh është komentator mbi zhvillimet politike për mediat në Shqipëri dhe ato jashtë saj lidhur me Shqipërinë. Ai ka publikuar më shumë se 15 libra studimorë, monografi, studime etj, kryesisht mbi sistemin politik, institucionet kushtetuese, shoqërinë civile, memorien ndaj të kaluarës, partitë politike, zgjedhjet si dhe studime krahasuese në vendet e EJL. Botimi më i fundit është monografia “Krizat e Ambasadave: Shqipëria 1990”.

NGJARJET E KORRIKUT 1990

DHE PËRPIJËKJET E REGJIMIT PËR TA

MINIMIZUAR IMPAKTIN E TYRE POLITIK

Një ditë pas ngjarjeve të mesnatës së 2 korrikut media shtetërore, ATSH dhe TVSH lançuan një deklaratë zyrtare të qeverisë kundër qytetarëve që hynë në ambasada. Që në fillim të deklaratës jepej epiteti denigrues “një grup vagabondësh, ish - të burgosurish për faje të vogla ordinere si vjedhje, llotarira klandestine, kumarxhi si dhe disa adoleshentë të mashtruar”.²³⁷ Nuk kishte nevojë për verifikime të emrave (u deshën më shumë se tri javë të përfundohej i gjithë verifikimi) dhe as marrja në konsideratë e faktit se në radhët e atyre që hynë në ambasada kishte një numër shumë të madh fëmijësh, grash, familjesh dhe individësh me integritet apo se mbi 85% e listës finale nuk

²³⁷ Arkivi i MPJ. Viti 1990. Dosja 1332, Kutia 48, f. 17.

kishte pasur asnjëherë ndonjë rekord penal apo kriminal. Regjimi e kishte dhënë dënimin politik përmes etiketimit zyrtar. Një strukturë e posaçme e propagandës gjendej në Komitetin Qendror dhe drejtuesi real i saj ishte këshilltari kryesor politik i Ramiz Alisë, Sofokli Lazri. Për rrjedhojë çdo deklaram i tillë reflektonte në radhë të parë mendimin e vetë shefit të shtetit.

Në praktikën e shtetit komunist deri më 1991 në çdo ngjarje të rëndësishme udhëheqja e lartë përcaktonte terminologjinë dhe më pas e gjithë struktura shtetërore, partiake, shoqërisë, diplomatike, mediatike etj., vihej në funksion të propagandës duke e cituar saktësisht atë. Kur udhëheqja vlerësonte se një individ është armik, e gjithë makineria shtetërore e partiake përsëriste të njëjtin etiketim dhe brenda orësh apo ditësh cilësimi kthehej në epitet zyrtar, prej të cilit individ vështirë se mund të ndahej në gjithë jetën e tij. Vëzhgimi i Mannettit se *“nga përvoja ne e dimë se arsytimi i shtetit, apo një urdhër nga lart, i detyron zyrtarët shqiptarë të thonë gjëra nga më të pamunduruarat, por nuk mund të mësohemi me këtë teatër absurd”*²³⁸ është i saktë. Një ditë më pas MPJ në koordinim me zyrën e propagandës në Komitetin Qendror hartoi një deklaratë, e cila në publik u paraqitet në opinion si koment i TVSH, ku midis të tjerash sulmoheshin mediat perëndimore ku *“huliganët po paraqiten si luftëtarë e heronj të luftës për demokratizimin e vërtetë të Shqipërisë. Një grusht njerëzish pa personalitet e dinjitet, të zhveshur nga çdo ndjenjë nderi e morali, të aftë të shesin edhe atdheun e kombin e tyre, po i serviret opinionit si heronjtë e rinj të këtij*

²³⁸ Annarosa Mannetti. *Diario dall'Albania (1990)*, Youcanprint, Rome, 2016, 7 maj 1990.

kombi"²³⁹. Deklarata më tej i adresoj praktikës së regjimit, udhëzimit që *"ndaj veprimeve e qëndrimeve të këqija të këtyre njerëzve duhet të ndjenjë përgjegjësi në radhë të parë familjet e tyre, ashtu siç duhet të mbajnë përgjegjësi e të rrisin interesimin kolektivat ku punojnë, organizatat e masave në qendrat e punës dhe organizatat e frontit në lagje. Kurse organet e pushtetit duhet të zbatojnë me korrektesë ligjet e rregullat e vendosura"*²⁴⁰.

Gjatë ditëve të Plenumit të 11-të media zyrtare u përfshi në një garë publikimesh të letrave, telegrameve, deklaratave apo shkrimeve me autorë të njohur apo kolektiva punonjësish, denigruese ndaj qytetarëve në ambasada. Gjatë korrikut dhe në vazhdim deri pas dhjetorit 1990 asnjë media nuk publikoi asnjë të dhënë, intervistë apo kronikë informative për rreth 5 mijë qytetarët e larguar, të vrarin apo të plagosurit nga Policia. Shteti i kishte mohuar ata dhe etiketimi "tradhtar" apo "armiq" që citohet në deklarime të udhëheqjes së lartë ishte pretencë e vendim i dhënë. Në Plenum kryeministri Çarçani mbajti referatin kryesor në emër të Byrosë Politike. Ai përdori gjuhë të ashpër ndaj qytetarëve në ambasada, *"përgjithësisht me vese të këqija, rrugaçë e të dënuar më parë, bixhozçinj e të tjerë si këtë krijuan një situatë jo të mirë në Tiranë, duke u futur në turmë e me dhunë në ambasadat e shteteve të huaja, të nxitur nga personeli i disa prej këtyre ambasadave, si dhe nga armiqtë e pushtetit popullor brenda vendit që qëndrojnë pas tyre"*. Kryeministri shtoi se *"disa nga rrugaçët e vagabondët që kanë hyrë ose janë orvatur të hyjnë në ambasada, kanë shfrytëzuar për të keq në*

²³⁹ Arkivi i MPJ. Viti 1990, Dosja 1332, Kutia 48, f. 14.

²⁴⁰ Arkivi i MPJ. Viti 1990, Dosja 1332, Kutia 48, f. 19.

“

...ndaj veprimeve e qëndrimeve të këqija të këtyre njerëzve duhet të ndjenjë përgjegjësi në radhë të parë familjet e tyre, ashtu siç duhet të mbajnë përgjegjësi e të rrisin interesimin kolektivat ku punojnë, organizatat e masave në qendrat e punës dhe organizatat e frontit në lagje. Kurse organet e pushtetit duhet të zbatojnë me korrektesë ligjet e rregullat e vendosura...

”

veprohet edhe në raste të tjera analoge, sipas normave juridike në fuqi”.

Pjesa më e rëndësishme e fjalës së kryeministrit nuk ishte përsëritja e retorikës politike, por thirrja për reagim të shtetit e shoqërisë kundër qytetarëve në ambasada, si

fillim mosnjohjen e dekretit për pajisjen me pasaporta”, si dhe nuk tha të vërtetën kur u shpreh se “asnjë nga ata që ka bërë këto akte të këqija nuk ka bërë kërkesë për të marrë pasaportë e vizë për jashtë shtetit, edhe kur u lejua për të shkuar ata vetë në ambasadat e huaja për të marrë vizën e hyrjes”²⁴¹. Në dëshmitë e të gjitha ambasadave në Tiranë janë konfirmuar raste të shumta të personave që hynë në to dhe që nuk u është miratuar kërkesa për pasaportë. Më tej kryeministri justifikoi dhunën policore dhe masat represive ndërsa u shpreh se “ndaj nxitësve të këtyre akteve armiqësore u morën menjëherë masat përkatëse ligjore dhe kështu do të

²⁴¹ AQSH. Viti 1990. Fondi 14, Dosja 3/1, Mbledhja e Plenumit të 11- të KQ të PPSH, 6-7 korrik 1990, f. 225.

dhe udhëzimi për të injoruar ndryshimet ligjore të muajit maj 1990 në veprën penale të agjitacionit e propagandës apo arratisjes jashtë vendit, në funksion të rikthimit të tyre. Konkretisht Çarçani tha se *“opinionit i indinjuar thellë nga të tilla veprime i ka dënuar ata me revoltim dhe ka pritur me pozitivitet edhe marrjen e masave ligjore kundër tyre”*, bëri thirrje për angazhim të organizatave shoqërore për sqarimin e masave, si dhe sugjeroi *“t’i kushtohet kujdes i veçantë sidomos kuptimit dhe zbatimit të saktë të nenit 35 të Kodit Penal, i cili bën fjalë për agjitacionin e propagandën, sepse ka ende kuptim jo të plotë ose keqinterpretime; të nenit 127 të Kodit Penal, që bën fjalë për kalimin e paligjshëm të kufirit, sepse edhe në këtë drejtim ende nuk ka një kuptim të plotë apo zbatim në përputhje me porositë e normat e vendosura; të ligjit për masat parandaluese kundër personave që paraqesin rrezik për rendin publik, me qëllim që ai të njihet mirë nga organet përkatëse e të zbatohet kundër atyre personave që njihen “botërisht” si të tillë”*²⁴². Fakti është se dy muaj më vonë në analizën 9-mujore të Hetuesisë së Përgjithshme raportoi se në periudhën 9-mujore janë hetuar dhe dërguar në gjyq 76 çështje për agjitacion dhe propagandë kundër shtetit, si dhe 25 çështje për fyerje të organeve të Partisë e të shtetit. Raporti konfirmon se për asnjë nga këto raste nuk është dhënë pafajësi²⁴³.

Të njëjtën retorikë denigruese përdorën edhe folës të tjerë në Plenum përfshirë kryetarin e shtetit Alia. Vlen të theksohet se në pjesën e parë të punimeve të Plenumit u fol për rininë universitare dhe çështjet e shkollës. Shumica e

²⁴² AQSH. Viti 1990. Fondi 14, Dosja 3/1, Mbledhja e Plenumit të 11- të KQ të PPSH, 6-7 korrik 1990, f. 226.

²⁴³ AQSH. Viti 1990. Fondi i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Dosja 283. f. 10.

diskutuesve nuk e cituan situatën që ndërkohë po ndodhte dhe ku pjesa më e madhe ishin të rinj, por midis tyre pati ndonjë diskutues, si p.sh, një prej sekretarëve të rinj të KP Durrës, M.Z., i cili në fjalën e tij u shpreh *“huliganët dhe veprimet e tyre të shëmtuara, i dënoi tërë opinioni ynë. Në veprimet e sjelljen e tyre nuk ekziston ideal kombëtar”*²⁴⁴.

Në fushatën mediatike kundër qytetarëve në ambasada dhe ngjarjeve të simbolizuara tek 2 korriku u përfshinë shumë emra të njohur të jetës publike, përfshirë intelektualë, krijues, shkrimtarë, artistë etj. Gazetat kryesore “Zëri i Popullit”, “Bashkimi”, “Zëri i Rinisë”, “Drita” etj., TVSH dhe ATSH etj., i kërkuan dhe publikuan deklarata të shkurtra në funksion të fushatës kundër ngjarjeve të korrikut 1990. Shkrimtari Ismail Kadare, i cili ishte nga të paktët që nuk u përfshi, dëshmoi më 1991 se *“gjatë kohës së krizës së ambasadave shumë personaliteteve të kulturës iu kërkuan deklarata për të dënuar refugjatët. Një pjesë dhanë e një pjesë jo. Ndërsa refuzova prerazi dhe nuk dhashë kurrfarë deklarate, kjo gjë se pengoi Sigurimin të përhapte të kundërtën, sipas stilit dhe përvojës që kishte për diskreditimin e personaliteteve. Për fat të keq arriti ta shpërndajë gënjeshtren”*²⁴⁵. Shumë të tjerë e pranuan dhe dhanë deklarata, të cilat u botuan më 6-7 korrik në gazetatat zyrtare të kohës.

Në gjithë ditët e para të muajit korrik zyrtarisht shteti shqiptar i cilësoi qytetarët e hyrë në ambasada si “një grup

²⁴⁴ AQSH. Fondi 14, Dosja 3/1, Viti 1990, Mbledhja e Plenumit të 11- të KQ të PPSH, 6-7.7.1990, f. 121. Më 11 korrik u botua një artikull në “Bashkimi” ku shprehej se atdhedashuria nuk është “për frikacakët, për huliganët, për njerëzit që më shumë se njerëz janë thjesht kostume që ecin, hije, kinse të figurave të ideologjive të huaja antishqiptare, pjesë e skenarit të ri të reaksionit antishqiptar dhe antisocialist. Atdhedashuria nuk është një mit. Gazeta “Bashkimi”, 11 korrik 1990, nr.60, f.3.

²⁴⁵ Ismail Kadare. *Nga një dhjetor në tjetrin*. Fayard. Paris, 1991, f.246.

vagabondësh, ish - të burgosurish për fajë të vogla ordinere si vjedhje, llotarira klandestine, kumarxhi si dhe disa adoleshentë të mashtruar”, cilësim që u përdor në unison nga të gjithë zyrtarët, mediat zyrtare, deklaratimet zyrtare dhe botimet zyrtare të kohës. Një dokument orientues i MPJ vlerësoi se kategoria kryesore e tyre përbëhej “nga njerëz të degjeneruar, vjedhës e aventurierë, huliganë e vagabondë që janë dënuar ose burgosur disa herë”²⁴⁶. Zyrtari i MPJ i ngarkuar për hartimin e dosjes së eksodit 1990, Hasan Muçostepa, shkruan në librin e tij se “nga verifikimet që u bënë në lidhje me ta, dilte se rreth 1300 veta ishin të dënuar për krime ordinere dhe disa prej tyre, ishin përsëritës në krim. Regjistrime të hollësishme mbi këtë kontingjent njerëzish u kryen edhe nga autoritetet përkatëse të vendeve pritëse, përpara nisjes së tyre në destinacionin përkatës”²⁴⁷. Tentativa për të paraqitur aktin kurajoz të atyre që rrezikuan jetën në kërkim të ikjes drejt Perëndimit si një veprim kriminelësh dhe pjesës më negative në shoqëri, mund të mos ketë efekt në një shoqëri të hapur, por në Shqipërinë e mbyllur të vitit 1990 pati efektin që PPSH kërkonte. Retorika u përdor për të mobilizuar komunistët dhe shtresat mbështetëse, sidomos ato në fshat dhe punëtorët, të cilët ishin edhe pjesa lehtësisht më e manipulueshme.

Në tërësi deklaratimet e autoriteteve kryesore përfshirë Alinë, Isain, Malilen, Gjonin etj., u bënë në ditët e para të pas korrikut, madje në Plenumin e 6-7 korrikut, kur ende një pjesë e qytetarëve që u larguan përmes ambasadave nuk kishin hyrë ende në ambasada. Ky është një detaj

²⁴⁶ Arkivi i MPJ. Dosja 1348, K. 49, A. 351, viti 1990, f. 75.

²⁴⁷ Hasan Muçostepa. *Në kërkim të parajsës*, Dituria, Tiranë, 1993, f. 71.

tjetër që dëshmon se deklaramet denigruese dhe shifrat e ofruara nga autoritetet për të “dënuarit”, “të burgosurit” etj., ishin fiktive. Por hulumtimi në dokumentet arkivorë të Ministrisë së Brendshme dhe korrespondencës së saj me Presidiumin e Kuvendit Popullor nxjerr në pah zyrtarisht fiktivitetin e të gjitha deklarimeve të mëparshme. Vetëm më 14 korrik 1990, pra pas ikjes së refugjatëve të fundit nga Tirana, Ministria e Punëve të Brendshme i kërkoi të gjitha degëve të punëve të brendshme në rrethe relacione të detajuara për të gjithë personat që janë larguar përmes ambasadave, të dhënat biografike, penale dhe profesionale të tyre. Qëllimi i relacionit ishte për të krijuar një database për të gjithë të larguarit.

Nga të dhënat e marra nga secila DPB dominojnë tre kategori: e para, individë të papunë dhe të moshës së re të pakënaqur me gjendjen e tyre dhe situatën në përgjithësi, dhe që përbënin kontingjentin kryesor të listave të vëzhgimit nga ana e policisë; e dyta, individë me të kaluar politike “jo të mirë”, ish - të përndjekur politikë e të internuar (fshati Saver në Lushnje përmendet në disa raporte²⁴⁸), apo me prindër e të afërm të dënuar politikë; si dhe kategoria e tretë, individë me “biografi të mirë”, me prindër komunistë apo zyrtarë në nivele të ndryshme administrative, gjithashtu të pakënaqur me zhvillimet në vend dhe perspektivën e tyre. Me gjithë përpjekjet e relacioneve për gjetjen e të dhënave denigruese për personat, si material justifikues edhe për

²⁴⁸ Autori Jozef Radi identifikon së paku 21 persona nga kampi i Savrës që hynë në ambasadë. Konkretisht, në ambasadën italiane: Arben G, Luan Ç, Zef V, Nasibe N, Fatmir B; në ambasadën gjermane: Alush P, Ferdinand L, Thoma P, Bislim H, Teuta S, Alfred S, Arjan Ç, Shpëtim J; në ambasadën turke: Bashkim S, Markella, S. Alfred S, Parid D, Astrit S; në ambasadën franceze: Henrik Gj, Genc Gj., si dhe citon dy persona që u arrestuan gjatë rrugës për në Tiranë dhe u dënuan me 1 vit burg. (<http://www.radiandradi.com/pse-1-korriku-eshte-dita-e-vertete-e-futjes-ne-ambasada>)

vetë cilësimin denigrues që iu ishte bërë nga hierarkia e lartë shtetërore e partiake, kategoria e tillë e evidentuar në raportet e DPB është relativisht e vogël dhe kontradiktore. Për shembull, pjesa më e madhe e femrave figuronin të etiketuara në raport për sjellje jo të mirë morale, ndërkohë që nga të dhënat zyrtare, po ashtu pjesa më e madhe e tyre hynë në ambasada familjarisht, pra ishte një vendim i marrë në familje. Së fundi, një tipar interesant i të dhënave është fakti se midis kontingjenteve që u larguan një pjesë e madhe kishte qenë në ndjekje nga policia pikërisht për tentativë arratisjeje dhe se pothuajse në asnjë rast nga raportet nuk del se ka pasur qytetarë nën vëzhgim apo akuzë si bashkëpunëtorë i shërbimeve sekrete të vendeve të tjera.

Në raportimet mbi korrikun 1990 gjithnjë është referuar fakti se në ambasada nuk pati emra të njohur intelektualësh dhe persona të rëndësishëm që mund të krijonin impakt publik. Në gusht 1990, me krenari Alia u deklaroi zyrtarëve të MMP dhe Ushtrisë se *“ata që hynë nëpër ambasada ishin njerëz pa vlerë morale, pa vlerë politike. Të huajt që e organizuan këtë veprim nuk donin një kategori të tillë, ata prisnin klientelë tjetër. Në qoftë se ata që vajtën mund t’i quajmë ushtarë, ata prisnin oficerë dhe gjeneralë, por as oficerë, as gjeneralë nuk u shkuan”*²⁴⁹, kurse në Presidium e përsëriti tezën *“dështuan se klientela që morën nuk po jua blen njeri. Fakt është se këta njerëz kanë mbetur rrugëve nuk i jep njeri ngjyrë politike sepse e shikojnë që të këto nuk janë politikanë”*²⁵⁰. Alia shfrytëzoi takimin me kongresmenin amerikan De Konsini në gusht 1990 për të sulmuar përsëri ata, duke u shprehur *“kur u futën*

²⁴⁹ AQSH. Viti 1990. Fondi 14. Dosja 442, Mbledhje e Sekretariatit të KQ, 16 gusht 1989, f. 20.

²⁵⁰ AQSH. Viti 1990. Fondi i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Dosja 169, f. 3.

këta njerëz nëpër ambasada ne thamë që midis tyre ka vjedhës e huliganë. Në shtypin perëndimor na akuzuan, duke thënë se nuk është kështu, ata janë njerëz politikë, kundërshtarë të sistemit”²⁵¹. Edhe 3 vjet më pas, në sistemin e ri politik ai e përsërit tezën duke u shprehur “2 korriku u nis si një vepër politike, por klientela e tij në të vërtetë përbëhej kryesisht nga njerëz që zgjodhën eksodin për arsye e motive ekonomike”. Me tone ironike vijon se “refugjatët shqiptarë që shkuan në Francë nuk pranuan të bisedonin me asnjë autoritet zyrtar në nivelin e Roland Dumas²⁵²-së dhe mendonin se për dy-tri ditë mund të merrnin viza për në Amerikë”²⁵³. Në librin e tij me kujtime “Jeta ime” më 2010 e konsideroi mungesën e figurave politike e publike si sukses dhe një arsye të rëndësishme përse pas ngjarjeve në ambasada nuk pati ndryshim politik në Shqipëri.

Diferenca midis etiketimit zyrtar dhe vlerësimit të diplomatëve perëndimorë ishte e thellë. Kur në fundin e qershorit autoritetet i konsideruan terroristë personat që hynë në ambasadën italiane kjo e fundit kishte vlerësim tjetër. Sipas dëshmisë së Mannettit, “në realitet, të gjashtë, të marrë në pyetje nga Xhorxho, rezultoi se ishin njerëz të thjeshtë, pa asnjë farë lidhjeje me kriminalitetin: njëri, më i moshuari (rreth të dyzetave), është liruar së fundmi nga burgu, ku ka vuajtur dhjetë vjet burg për ‘propagandë antiqeveritare’”, siç tregohet nga një dokument që ai na paraqiti. Të tjerët janë të gjithë të rinj midis moshës 25-30 vjeç, të cilët “janë të ngopur me këtë jetë” dhe shpresojnë

²⁵¹ AQSH. Viti 1990. Fondi: Presidiumi i Kuvendit Popullor, dosja 379, 21 gusht 1990, f. 11.

²⁵² Roland Dumas ka qenë politikan francez, ministër i Jashtëm i Francës në vitet 1988-1993.

²⁵³ Ramiz Alia. Unë, Ramiz Alia dëshmoj për historinë, 1993, f. 156.

ta përmirësojnë gjendjen e tyre”²⁵⁴. Pas valës së 1-5 korrikut ajo ka shënuar me tone kritike rezerva për një pjesë të kontingjentit²⁵⁵, megjithatë edhe në këtë rast ajo veçoi raste si Mati Logoreci, rastin e një “inxhinieri të shquar” apo të disa grave, studentëve dhe të rinjve etj., si modele pozitive²⁵⁶.

Debati mbi cilësinë dhe formimin arsimor të qytetarëve që hynë në ambasada shpesh ka lënë në hije aktin e tyre, i cili pavarësisht moshës, formimit dhe biografisë politike, ishte akt heroik për kohën dhe për riskun me të cilin përballlej. Me të drejtë ambasadori francez i përgjigjej MPJ se edhe këta njerëz analfabetë mund të jenë kundërshtarë të qeverisë²⁵⁷, duke i vënë theksin aktit të tyre politik, jo CV së tyre akademike. Për shumë arsye debati për numrin e diplomave dhe personave “publikë” që hynë në ambasada më 1990 ngjan i stisur dhe i sforcuar, në përpjekje për të mbrojtur tezën se intelektualët ishin mbështetës të regjimit. Kjo tezë u bë lajtmotiv edhe në fjalimet dhe takimet që regjimi organizoi gjatë muajve gusht-shtator 1990. Aspekti i vetëm i analizës që meriton debat është pozicioni që elita publike, klasa politike dhe intelektualët shfaqën ndaj ngjarjeve të korrikut. Ky debat do të kishte shumë më tepër vlerë për të kuptuar distancën e thellë në gjykimin e së keqes reale dhe në besimin tek demokracia e ndryshimi midis atyre që hynë në ambasada dhe atyre

²⁵⁴ Annarosa Mannetti. *Diario dall'Albania (1990)*, Youcanprint, Rome, 2016, 26 qershor 1990.

²⁵⁵ Mannetti ka shkruar “shumica e miqve tanë janë shumë të ashpër dhe pa asnjë kualifikim dhe mendoj se për fat të keq ata do të fryjnë radhët e të papunëve dhe ndoshta edhe kriminelëve në Itali. Por, në këtë moment, sidoqoftë, aspekti humanitar po justifikon gjithçka”.

²⁵⁶ Annarosa Mannetti. *Diario dall'Albania (1990)*, Youcanprint, Rome, 2016, 25 qershor 1990.

²⁵⁷ *Arkivi i MPJ. Viti 1990, Dosje 1334, kutia 48, viti 1990, f. 51.*

që ishin në podiumin e mitingut më 13 korrik apo pjesë e takimit më 10 gusht me Ramiz Alinë e Xhelil Gjonin.

Në debatin e iniciuar që në korrik 1990 duket se merret e mirëqenë pritshmëria se duhej të kishte intelektualë të njohur në ambasada. Në fakt, referuar përvojave të njëjta në Hungari e Çekosllovakia më 1989 apo situatave të tilla në Amerikanë Latine, me përjashtim të emigrimit masiv të opozitës pas marrjes së pushtetit nga Pinoçeti, nuk ka pasur raste të tjera kur eksodi përmes ambasadave dhe kufirit të ketë pasur protagonistë intelektualë dhe figura të njohur publike e politike. Vetë akti, - vendimi për të hyrë në një ambasadë të mbrojtur me forca policore, me mundësi të mëdha për përlëshje dhe arrestim, me mungesën e sigurisë për jetën dhe zgjidhjen paqësore, si dhe me kalim të murit rrethues apo elementeve të tjerë teknike, kërkon cilësi fizike, kurajë e reagim, shumë më të madh sesa cilësitë e inteligjencës shqiptare të kohës. Në asnjë prej ngjarjeve të tilla të rëndësishme, përfshirë janarin 1990 në Shkodër, marsin 1990 në Kavajë, korrikun në Tiranë etj., nuk ishin intelektualët dhe as personat publikë aktorë kryesorë të reagimit për më tepër në Shqipërinë komuniste ka njohur vetëm një figurë politike që arriti të emigrojë jashtë vendit, Panajot Plaku²⁵⁸ më 1957.

Nga ana tjetër, dominimi i shtresës së mesme, punëtorë dhe të rinj, në kategoritë e personave që hynë në ambasada ka përputhje me vetë logjikën klasore të diktaturës dhe regjimit komunist. Të dhënat e vitit 1990 mbi anëtarët e PPSH-së dëshmonin se vetë partia – shtet nga 145261

²⁵⁸ Panajot Plaku është zyrtari më i lartë i arratisur nga Shqipëria komuniste. Ai ishte ministër pa portofol në qeveri dhe anëtar i Komitetit Qëndror, gjeneral dhe figurë e rëndësishme e regjimit. Më 1957 Plaku u arratis në Jugosllavi, ku qëndroi deri sa vdiq më 1966. Familja e tij mbeti në Shqipëri dhe kaloi një kalvar të gjatë vuajtjesh dhe internimi deri më 1991.

anëtarë, vetëm 16% ishin me arsim të lartë. Pjesa dominuese ishin ata me arsim fillor deri në 4-8 klasë shkollë (44.47%) dhe ata me arsim të mesëm (38.65%)²⁵⁹. Në kushtet kur vetë partia në pushtet kishte këtë përbërje sociale, vjen në kontrast të thellë tentativa për ta denigruar të njëjtën përbërje sociale tek qytetarët që hynë në ambasadat e huaja në Tiranë më 1990. Aq e dukshme ishte kjo sa që vetë Alia në mbledhjen e Byrosë Politike më 14 korrik praninë e 20% të grave në ambasada e quan *“ky është një veprim tepër i ulët”* kurse qenien atyre të rreth 123-133 personave me arsim të lartë dhe 59-60 studentëve shprehet *“por edhe këta janë tipa pa karakter”*.

Përpjekja e dytë e propagandës dhe e regjimit ishte plotësimi i tezës së mungesës së personave VIP dhe intelektualë me “alarmin” se një pjesë e madhe e qytetarëve në ambasada ishin ish - të burgosur dhe me vepra penale të përsëritura. Nga të dhënat e Ministrisë së Brendshme, të përpunuara më pas edhe nga Aparati i KQ, zyrtarisht më 20 tetor 1990 u njoftua se numri total i personave që u larguan në korrik përmes ambasadave të huaja ishte 4790 persona, nga të cilët 661 ose 13% kishin qenë të dënuar²⁶⁰. Konkretisht, në ambasadën gjermane kishte 428 qytetarë ish - të dënuar, në ambasadën italiane 124, në ambasadën franceze 87, në ambasadën greke 8, në ambasadën turke 8 dhe në ambasadën hungareze 6 të dënuar, në total 661 të dënuar. Megjithatë në aspektin krahasimor kjo shifër zyrtare ishte rreth 2.5 herë më e vogël sesa numri i fëmijëve në moshë të mitur që u larguan përmes ambasadave. I kja e mbi 1500 fëmijëve e nxënësve nën 18 vjeç përbënin

²⁵⁹ AQSH. Viti 1990. Fondi 14/AP. Dosja 19, Viti 1989, Mbledhje e Sekretarit të KQ, f. 30.

²⁶⁰ AQSH. Viti 1990. Fondi i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Dosja 239, f. 3.

kategorinë e dytë më të madhe pas punëtorëve, megjithatë për regjimin investimi kryesor ishte në lajmin mbi numrin e të dënuarve.

Fushata zyrtare denigruese ndaj qytetarëve në ambasada kulmoi më 14 korrik 1990, rreth 24 orë pas largimit të tyre nga Shqipëria. Në këtë datë regjimi organizoi në Tiranë një miting të madh zyrtar si përgjigje për refugjatët e larguar dhe ndaj pritshmërive perëndimore për ndryshime të shpejta politike në Shqipëri. Takimi u bë në përmbajtje e formë të tillë për të demonstruar forcë dhe kërcënuar këdo që mund të shpresonte në liberalizim të jetës politike në vend. Sipas praktikës, pjesëmarrësit u sollën me urdhër zyrtar nga të gjitha ndërmarrjet, njësitë e Tiranës dhe qytetet e tjera. Për herë të parë në një miting të tillë zyrtar dhe në një gjendje të jashtëzakonshme mungoi pjesëmarrja e kreut të regjimit Ramiz Alia. Vetë ai disa herë ka deklaruar se mungoi për shkak se nuk kishte qenë ai iniciues i mitingut, por Sekretari i sapoemëruar i Komitetit Qendror, Xhelil Gjoni. Ky i fundit e pranon se ishte iniciues dhe se menjëherë pas tij mori përgëzime telefonike nga Alia. Studiuesi Fatos Tarifa gabimisht në një prej analizave të tij të vitit 1995 e ka zhvendosur mitingun e 14 korrikut në datën 1 shtator duke e lidhur me studentët, megjithatë, teza e tij se Alia nuk u shfaq në publik atë ditë nga frika e përsëritjes së skenarit rumun me mitingun e dhjetorit dhe fundin e Çausheskut është e gjetur²⁶¹.

Xhelil Gjoni ka dëshmuar se mitingu u bë për të treguar forcë dhe frenuar elementet antipushtet dhe mendon se ia arriti qëndrimin. Për arsye sigurie në radhët e pjesëmarrësve

²⁶¹ Fatos Tarifa. *Albania's Road from Communism: Political and Social Change, 1990-1993, Development and Change*, 26 (1), 1995, f. 144.

kishte një numër të madh civilësh të Sigurimit të Shtetit, të cilët kontrollonin reagimin e mundshëm të pjesëmarrësve. Një fakt të tillë e citon me tone kritike Xhelil Gjoni, figura kryesore politike në këtë miting. Ai bën përgjegjës për këtë ministrin e ri të brendshëm Hekuran Isain ndërsa shprehet se *“në këtë miting vura re që Hekuran Isai nga frika kishte futur civilë mes njerëzve, nga frika se mund të kishte provokime apo tentativa të ndryshme. Mua nuk më erdhi mirë, sepse unë kisha mobilizuar partinë që të merrej me garantimin e këtij mitingu”*²⁶².

Fjalimi kryesor në miting ishte ai i Xhelil Gjonit. Thelbi i fjalimit të tij gjendjet në adresimin denigrues dhe kërcënues që i bëri qytetarëve që u larguan përmes ambasadave. Gjoni u shpreh *“armiqtë duan të rrënojnë jetën tonë, të sotmen dhe të nesërmen tonë, të shkatërrojnë lirinë e fituar dhe pushtetin e popullit. Disa njerëz pa ideale e pa moral, të mashtruar apo naivë, duke shkelur mbi gjakun dhe eshtrat e martirëve, duke njollosur nderin dhe emrin e nderuar të Shqipërisë, me sjelljen e veprimet e tyre u shërbejnë drejtpërdrejtë planeve të armiqve, të cilët duan të na sjellin përsëri në fuqi borgjezinë dhe bejlerët e përmbysur... armiqve tanë u themi njëzëri: Shqipërinë dhe pushtetin popullor nuk e tundin jo më disa njerëz të çoroditur që braktisën kusarisht atdheun, por kushdoqoftë. Ata s’janë Shqipëria, ata s’janë populli”*²⁶³. Në miting shkrimtari Kiço Blushi foli në emër të intelektualëve e krijuesve duke theksuar se *“dinjiteti i intelektualit nuk mund të jetë jashtë dhe larg dinjitetit të Shqipërisë e shqiptarit”*, se Plenumet

²⁶² Xhelil Gjoni. Xhelil Gjoni. Intervistë me Arirtir Lumezi. Gazeta “Panorama”, 9 janar 2015.

²⁶³ Xhelil Gjoni. Interesat e popullit e artdheut janë të shenjta e mbi gjithçka. Bashkimi, 13 korrik 1990, f.1-2.

e KQ “i kanë hapur një fushë të gjerë veprimi inteligjencës tonë” dhe se “ajo do t’i përgjigjet çdo situatë që do ta kërkojë interesi i atdheut”.²⁶⁴ Në emër të rinisë, Sekretari i parë i Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë Lisen Bashkurti, duke iu adresuar të rinjve që u larguan përmes ambasadave tha se “ata që u shmangen këtyre tipareve shekullore të popullit dhe kombit tonë nuk kanë asgjë të përbashkët me breznitë e reja shqiptare. Askush nuk ka mundur dhe nuk do të mundë as sot dhe as mot të njollosë sado pak mendjen e kthjellët dhe gjakun e pastër të të riut shqiptar”. Ai e mbylli fjalimin me deklaratën “le ta dinë mirë miqtë dhe armiqtë tanë se nga gjokset tona rinore do të jehojë përherë e fuqishme thirrja: *Parti, nëna jonë, fjala jote, vepra jonë*”²⁶⁵. Në të njëjtën ditë me mitingun Byroja Politike zyrtarizoi disa ndryshime në nivelet e larta shtetërore e politike, midis të cilave ishte edhe shkarkimi i zv/ministrit e drejtorit të Sigurimit Zylyftar Ramizi.

Paralelisht me raportimet ndërkombëtare kritike mbi zhvillimet në Shqipëri në Tiranë vijohej aksioni i denigrimit ndaj qytetarëve që hynë në ambasada dhe i forcimit të kontrollit politik e publik. Gjatë gjithë muajit korrik dhe në vijim u zhvilluan me qindra mbledhje të detyrueshme të kolektivave punonjësve, reparteve ushtarake, stafeve akademike dhe deri tek njësitë e vogla komunale dhe ato në fshatra e kooperativave. Kryefjala e çdo takimi ishte distancimi dhe dënimi politik i qytetarëve që hynë dhe u larguan përmes ambasadave, shprehja e besnikërisë ndaj Partisë me shokun Ramiz në krye, mbështetje për vendimet e Plenumit të 11-të të Komitetit Qendror dhe marrja e

²⁶⁴ Këto Blushi. *Kronikë e mitingut, Bashkimi, 14 korrik 1990, f.3.*

²⁶⁵ Lisen Bashkurti, *Kronikë e mitingut, Bashkimi, 14 korrik 1990, f.3.*

angazhimit për detyra specifike sipas punës së tyre. Ky proces nuk ishte deklarativ, por shumë më kompleks dhe shpeshherë edhe dramatik për familjet që kishin dikë në listën e rreth 5 mijë qytetarëve në ambasada. Gjyqe publike kundër tyre, humbje e pozitës shtetërore e partiake nëse kishin të tillë, denigrim në publik dhe distancim prej tyre nga kolektivat, drejtoria dhe Partia.

Komiteti i Partisë i repartit 1222, i cili mbulonte zonën kufitare në Peshkopi, më datë 7 korrik i adresoi një letër Komitetit Qendror për *“dënimin e veprimeve të disa huliganëve të qytetit të Tiranës më 2 korrik 1990”*. Letra, krahas parullave dhe tezave të përsëritura e ideologjike përmban edhe një paragraf ku flitet se *“krahas urrejtjes”* u dhanë edhe vlerësime, si, *“veprime të tilla nuk janë bërë nga njerëz të mirë e të ndershëm, por nga ata që janë të paedukuar e që përbëjnë llumin e shoqërisë sonë”*²⁶⁶. Më 9 korrik Sekretari i Komitetit të Partisë Durrës Moikom Zeqo, informon sektorin e edukimit në Komitetin Qendror për masat e marra në këtë rreth pas ngjarjeve të ambasadave. Sipas informacionit *“komunistët u njohën me veprimet e disa huliganëve dhe njerëzve të paformuar, të cilët u futën në ambasadat e huaja”*²⁶⁷, dhe morën masa urgjente. Një prej masave ishte leximi i gazetës “Zëri i Popullit”, të datës 3 korrik në të gjitha kolektivat punonjësve dhe organizatat e PPSH, ku *“u solidarizuan me opinionin e shëndoshë revolucionar që i dënoi këto akte huliganizmi e rrugaçërie”*.

Nevoja për ta paraqitur krizën e ambasadave si produkt i agjenturave të huaja, akt kundër Shqipërisë dhe interesave të saj, keqpërdori pasivisht edhe zhvillimet në Kosovë dhe

²⁶⁶ AQSH. Viti 1990. Fondi 14/AP. Dosja 20, nr.3354, f.1-2.

²⁶⁷ AQSH. Viti 1990. Fondi 14/AP. Dosja 2/1, f. 264.

retorikën kombëtare. Për shembull, një shoqatë e njohur me emrin “*shoqata kulturore sportive ‘Dardania’*” në Vjenë lëshoi një deklaratë, të cilën e përcollën si lajm të rëndësishëm TVSH dhe ATSH. Në deklaratë sulmoheshin ashpër qytetarët që hynë në ambasada, “*kjo sjellje huliganësh, ne nuk e konsiderojmë si asgjë tjetër, por si thikë pas shpine që na erdhi nga gjaku ynë i prishur, i cili shkeli kështu mbi gjakun e bijve të Kosovës. Kjo është një tradhti e pashoqe në faqet e historisë tonë kombëtare*”²⁶⁸. Deklarata mbyllej me përsëritje të përzemërta për Komitetin Qendror të Partisë dhe udhëheqjen komuniste në Tiranë. Kjo dhe një letër tjetër i një emigranti kundër refugjatëve u përdorën disa herë nga udhëheqësit e lartë dhe media zyrtare për të krijuar përshtypjen se qytetarët që hynë në ambasada kanë kryer akt kundër kombit. Foto Çami i lexoi dy letrat në takimin që zhvilloi në Kinostudio në korrik 1990, pas disa shqetësimeve të shfaqura nga kolektivi i saj. Kur punonjësit e Kinostudios i dërguan një letër me shqetësime Ramiz Alisë më 5 korrik 1990, përgjigjia e tij erdhi më 17 korrik dhe e plotë është botuar në memoriet e shkrimtarit Teodor Laço²⁶⁹. Bashkë me letrën Alia u dërgonte edhe dy letra të ardhura nga grupe kosovare kundër 2 korrikut, njëra prej të cilave citohet më lart. Në këtë letër Alia përdor në një fjali gjithçka ai mendonte mbi 2 korrikun ndërsa shprehet “*thelbi i ngjarjeve të 2 korrikut është politik, antishqiptar dhe antikombëtar*”. Pas një leksioni të gjatë kundër perëndimit dhe pluralizmit, Alia e mbyll letrën me këshillën “*prandaj lart frymën e luftës, lart moralin komunist, lart vigjilencën e shpirtin luftarak*”. Ai i qëndroi

²⁶⁸ Arkivi i MPJ. Viti 1990, Dosja 1336, Kutia 48, Shtypi i huaj, korrik – gusht 1990, 7 korrik 1990, f.38.

²⁶⁹ Teodor Laço. Kohë për të kujtuar, kohë për të harruar, Toena, 1998, Tiranë, f.27.

edhe më tej akuzës se qytetarët e futur në ambasada kanë kryer akt tradhtie, por ndryshe nga letra, në komunikimin publik përdorte termin shoqëruar, “moralisht”. Konkretisht, gjatë një mbledhjeje të Byrosë Politike Alia u shpreh se *“tashmë arratisja trajtohet si kalim i paligjshëm kufiri jo si tradhti ndaj atdheut. Mirëpo ai që braktis atdheun, që i kthen shpinën shtëpisë, braktis nënën, babanë, vëllezërit, motrat, të afërmit etj., vihet në shërbim të armikut, që bëhet pre e të huajve ligjrisht nuk konsiderohet tradhtar i atdheut, po nga ana morale tradhtar mbetet, opinioni si të tillë e trajton. Në këto rrethana rinia dhe populli që punojnë e jetojnë në brezin kufitar nuk mund të thonë “le të ikë, le të kalojë kufirin s’ka ndonjë gjë”²⁷⁰. Mesazhi ishte i qartë: qytetarët e larguar janë moralisht tradhtarë dhe opinioni duhet t’i trajtojë si të tillë.*

Në gusht 1990 në takimin me drejtuesit e lartë të Ministrisë së Mbrojtjes Ramiz Alia kërkoi reagim të ashpër ndaj familjeve që kanë pasur anëtarë të tyre në ambasada. Nga procesverbali i takimit citohet të jetë shprehur *“ç’qëndrim duhet të mbahet ndaj familjeve të personave që kanë ikur ose janë futur në ambasada? Qëndrimi ynë është e duhet të jetë i qartë. Për mendimin tim, prindi të cilit i ka ikur djali apo vajza, nëse është në Parti, nuk e meriton të jetë... Në qoftë se ka njerëz të tillë në poste komanduese, është mirë të japin vetë dorëheqjen, kjo është më e ndershme. Në qoftë se thonë se do të mbajmë distancë nga vepra e djalit apo vajzës, këtë duhet ta tregojnë jo me deklaratat, por duke e gjykuar në mënyrë kritike, duke ua lënë postin njerëzve me figurë sa më të pastër morale”²⁷¹.*

²⁷⁰ AQSH, Viti 1990. Dosja 48, Fondi 14, Mbledhje e Sekretarëve të KQ, 24 gusht 1990, f.3.

²⁷¹ AQSH. Viti 1990. Fondi i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Dosja 442, f. 11-12.

Porosia ishte e qartë: *“opinionit i shëndoshë duhet mbajtur në këmbë e duhet hedhur në veprim edhe ndaj familjeve apo kolektivave punonjësve, pjesëtarë të së cilëve hynë nëpër ambasada. Të diskutohen qëndrimet e tyre dhe në bllok e lagje dhe të bëhet i njohur gjykimi i shëndoshë e i përgjithshëm i njerëzve”*²⁷². Ish - zyrtari i MPJ Muçostepa në librin e tij mbi ngjarjet e vitit 1990 pohon se *“me porositë e Xhelil Gjonit dhe të Ramiz Alisë komitetet e partive filluan të përjashtojnë nga partia të gjithë ata që kishin lidhje familjare me të porsa-larguarit. Vazhdonte kështu operacioni i luftës së klasave. Ky veprim e shtoi akoma më shumë indinjatën dhe zemërimin e popullit”*²⁷³. Për shembull në një prej relacioneve nga Komiteti i Partisë Peqin më 17 korrik 1990, informohet Komiteti Qendror se përmes ambasadave ka ikur një nënoficer (S. Spanjoli), dhe se dyshohet se në rrugë të ndryshme janë arratisur edhe katër ushtarakë të tjerë nga ky rreth. Relacioni thekson se tre kuadrove të divizionit nga Peqini u kanë ikur vëllezërit përmes ambasadave, dy kuadrove të tjerë u kanë ikur nipat dhe dy kuadrove u kanë ikur vëllezërit e gruas²⁷⁴.

Kur Byroja muaj më pas u mblodh për të bërë një bilanc të situatës pas korrikut 1990, u rihap çështja e masave ndaj familjeve që kishin pasur persona në ambasada. Praktika e mëparshme ishte uniforme, - familja e personit internohej dhe të afërmit e tij humbitnin mundësinë për studime të larta apo promovim në karrierën profesionale. Kjo konfirmohet edhe nga Alia, sipas të cilit *“kohët e fundit u arratisën shumë njerëz jo vetëm nga Tirana, por edhe nga rrethet e tjera. Përpara merrnim masa administrative deri*

²⁷² AQSH. Viti 1990. Fondi 14/OU, Dosja 48, f. 6-7.

²⁷³ Hasan Muçostepa. Në kërkim të parajsës, Dituria, Tiranë, 1993, f.79.

²⁷⁴ AQSH. Viti 1990. Fondi 14. Dosja 20, Nr. 3597, f. 1.

*në internim të familjeve që u arratiseshin pjesëtarët e saj. Këtë ligj ne e hoqëm dhe ishte e drejtë që e hoqëm. Po ky ligj që u hoq nuk u zëvendësua me një ligj tjetër. Si duhet të luftohet kundër tendencës për arratisje atëherë?”²⁷⁵. Përgjigjia e ministrit të Drejtësisë Enver Halili ishte se ky ligj i ri nuk po zbatohet,²⁷⁶ megjithëse kanë kaluar 6 muaj pas miratimit të ndryshimit ligjor. Alia sugjeroi disa herë angazhimin e banorëve të fshatrave në mbështetje të policisë e Sigurimit për të parandaluar ikjet nga kufiri me argumentin “*tamam në këto momente kur ata u gëzuan që morën bagëtinë në shtëpi, këtë gëzim, t’u thuhet, ta shprehin në mbrojtje të kufirit*”²⁷⁷. Ndërkohë, ndaj raportimit të ministrit të Brendshëm Isai se nuk ka pasur asnjë masë penalizuese për familjet që patën të afërm në ambasada, Alia reagoi “*si nuk është mbajtur qëndrim realisht? Realisht është mbajtur qëndrim, unë kam letra nga punonjës të MPB të cilët më thonë pse më kanë hequr nga organet e punëve të brendshme? Dhe nga ushtarakë kam marrë letra, po për të njëjtin problem*”²⁷⁸. Në konfirmim të këtij deklarami erdhi edhe deklarami i Sekretarit të PPSH në Shkodër Xhemal Dymylja, i cili u shpreh se në rastin e Shkodrës “*20-30 pjesëtarë të familjeve të tyre i kemi përjashtuar nga partia*”, kurse ministri i Mbrojtjes Kiço Mustaqi gjithashtu në një mbledhje tjetër të Byrosë deklaroi se “*atij që i ka ikur djali apo vëllai në ambasada e kemi larguar nga ushtria*”²⁷⁹”.*

²⁷⁵ AQSH. Viti 1990. Fondi 14, Dosja 4, Mbledhje e Byrosë Politike 6/7 nëntor 1990, f. 175.

²⁷⁶ AQSH. Viti 1990. Fondi 14, Dosja 4, Mbledhje e Byrosë Politike 6/7 nëntor 1990, f. 180.

²⁷⁷ AQSH. Viti 1990. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 1 qershor 1990, f.83.

²⁷⁸ AQSH. Viti 1990. Fondi 14, Dosja 19, Mbledhje e Byrosë Politike 4 dhjetor 1990, f.140.

²⁷⁹ AQSH. Viti 1990. Fondi 14, Dosja 4, Mbledhje e Byrosë Politike 6/7 nëntor 1990, f. 167.

Në përfundim

Fushata shtetërore kundër qytetarëve që hynë në ambasada ishte e pritshme dhe në përputhje me logjikën ideologjike dhe mekanizmin e dhunës, diferencimit dhe dënimit kolektiv të aplikuar nga partia shtet dhe modeli qeverisës i periudhës 1945-1990. Regjimi nuk njihte sjellje tjetër dhe vetë mentalitetet përbërëse të Byrosë Politike dhe Qeverisë nuk pranonin idenë e sfidës dhe akteve kritike qytetare ndaj tyre. Fushata denigruese ishte as masive dhe as e ashpër sa e shoqëruar me akte dhune (arrestime, ndalime, kontrole, internime, masa diferencuese në familje, vrasjet në kufi etj.), e shuajti shumë shpejt jehonën e ngjarjeve të korrikut dhe i dha mundësi regjimit të rikthehej në shtator 1990 në agjendën e vet politike.

Parë në aspektin retrospektiv ngjarjet e ambasadave ndonëse nxorën në pah pafuqinë dhe paaftësinë e regjimit për ndryshim dhe zhvleftësuan propagandën për reformat demokratizuese, demonstrojnë ndërkohë qartësisht ekzistencën 6 muaj përpara ndryshimit të një mekanizmi brutal shtetëror për denigrimin, izolimin dhe defaktorizimin e qytetarëve që u bënë pjesë e tyre.

Literatura e përdorur

Arkivi i MPJ. Viti 1990. Dosja 1332, Kutia 48, f. 17.

Arkivi Qendror Shtetëror. Viti 1990. Fondi 14, dosjet e mbledhjeve të Byrosë, Sekretariatit, Plenumit të KQ.

Arkivi i AIDSHE mbi të dhënat e MPB mbi ngjarjet e ambasadave

Arkivi mediatik (Zëri i Popullit, Bashkimi, Drita, ATSH) në korrik-gusht 1990

Annarosa Mannetti. Diario dall'Albania (1990), Youcanprint, Rome, 2016.

Fatos Tarifa. Albania's Road from Communism: Political and Social Change, 1990-1993, Development and Change, 26 (1), 1995.

Hasan Muçostepa. Në kërkim të parajsës, Dituria, Tiranë, 1993.

Ilir Demalia. Guri i fundit i dominosë. Botimet Barleti, Tiranë 2015

Ismail Kadare. Nga një dhjetor në tjetrin. Fayard. Paris, 1991.

Qemal Lame. Kur shembeshin themelet, Onufri, Tiranë, 2014

Ramiz Alia. Unë, Ramiz Alia dëshmoj për historinë, 1993.

Teodor Laço. Kohë për të kujtuar, kohë për të harruar, Toena, 1998, Tiranë.



Dr. Adriana Duka

Adriana Duka ka mbrojtur gradën Doktor Shkencash në studime letrare në vitin 2019, Universiteti i Tiranës. Ka ndjekur kursin postdoktoral në Science Communication and Public Engagement, organizuar nga University of the West of England, Bristol, si pjesë e The Western Balkan Science Engagement Programme, përgjatë vitit 2020-2021.

Pjesëmarrëse në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, autore e artikujve që kanë si objekt studimi kryesisht letërsinë shqipe.

DITËHIJET E VEPRIMTARISË POLITIKE TË

SHKRIMTARËVE TË ARRATISUR

Abstrakt

Për disa shkrimtarë, gjatë diktaturës, e vetmja zgjidhje ishte arratisja: Martin Camaj, Arshi Pipa, Bilal Xhaferi, si krijues qëndrojnë larg njëri-tjetrit, i bashkojnë të njëjtat peripeci biografike, si edhe kontributi i tyre patriotik për kulturën, artin shqiptar. Pas vitit 1990 vepra e tyre u mirëprit nga lexuesit dhe studiuesit, por e pazbardhur mbetet veprimtaria politike, jo rrallë ka ndodhur që në shtyp të botohen shkrime që hedhin hije dyshimi mbi biografinë e tyre. Qëllimi i hulumtimit tonë është profili politik i këtyre shkrimtarëve mbi bazën e dokumenteve arkivore, letërkëmbimit, revistave, intervistave dhe dëshmime të dokumentuara.

Fjalë çelës: *Martin Camaj, Arshi Pipa, Bilal Xhaferi, veprimtari politike, patriot, shkrimtar*

Hyrje

Pas vendosjes së sistemit komunist, nga Shqipëria u arratisën një numër i konsiderueshëm personash, kryesisht në ish-Jugosllavi, Greqi për të kaluar më pas në drejtim të vendeve perëndimore. Për emigracionin politik shqiptar pas rënies së pushtetit komunist më shumë është përfolur se është folur me fakte, duke ruajtur një qasje të ngjashme me atë të dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit, në të cilat të arratisurit u etiketuan si agjentë, tradhtarë.

Kjo lloj mendësie ishte e pritshme dhe e parashikueshme në atë periudhë për intelektualët e arratisur. Në një artikull editorial të revistës *Shêjzat* me titull “Domethanja e mërgimit t’onë”²⁸⁰ të vitit 1959, parashtrohen pikëpyetjet që do të ngrejë e ardhmja për të gjithë ata që e quajnë veten emigrantë politikë: “Nji gjâsend mund të bâjmë edhe âsht detyrë e jonë, si njerz e si Shqiptarë, ta bâjmë me çilterin mâ të madhe: sejcili prej nesh duhet ta caktojë qëndrimin e vet kundrejt situatës qi me hijet e me dritat e veta na shtrohet përpara.”²⁸¹ Dy janë zgjidhjet që paraqiten në shkrim, e para një jetë mërgimtari pa zhurmë e bujë, në hije duke u integruar në rehatinë e vendeve ku jetojnë e punojnë dhe harruar qëllimin fillestar, ose duke zgjedhur qëndrimin e deklaruar hapur: “Duhet me dalë nga pozitat e dyshimta, trimnisht m’u tregue të singertë me vete e me tjerët”²⁸². Camaj, Pipa dhe Xhaferi zgjodhën rrugën e dytë, gjatë gjithë veprimtarisë së tyre jashtë Shqipërisë nuk ngurruan t’i mbeten besnikë lirisë për të shkruar e folur për Shqipërinë.

²⁸⁰ <http://adsh.unishk.edu.al/items/show/373>

²⁸¹ *Shêjzat*, Nr. 3-4, 1959, f. 81 <http://adsh.unishk.edu.al/items/show/373>

²⁸² *Shêjzat*, Nr.3-4, 1959, f.82 <http://adsh.unishk.edu.al/items/show/373>

Hijet e dosjeve dhe shejzat e shkrimtarëve

Hijet e dosjeve rëndojnë mbi ta, si mistere të pazbuluara, që herë pas herë dalin në media në formën e lajmeve të ditës, që stërhollohen me hamendësime dhe gjejnë hapësirë për të përhapur dyshime. Për Camajn, Pipën, Xhaferin janë hapur dosje herët duke kaluar sipas niveleve të përpunimit dhe përparësisë që i jepte ish-Sigurimi, veprimtarisë së tyre.

Martin Camaj u arratis më 9 gusht 1948, në moshën 23-vjeçare. Në vitet kur Shkodra u bë ndër qytetet ku nisi spastrimi i të gjithë atyre që përbënin rrezik për sistemin, Camaj, mësues në Prekal, menjëherë u bë një nga njerëzit që duhej parë me lupë, sepse vinte nga një shkollim ku mësuesit e tij u përballën ndër të parët me urrejtjen e sistemit komunist. Dosja për Camajn u hap²⁸³ më 5. 5. 1948, me qëllim rekrutimin e tij, pasi kishin dyshime se bashkëpunonte me grupin e Gjon Destanishtës “Organizata nacionaliste”, anëtarët e të cilit ishin kundër pushtetit komunist.

Mënyrën e rekrutimit e planifikuan me detaje dhe nëse ai nuk do të pranonte, kishin vendosur: “ta kapim misteriozisht”²⁸⁴, ditën kur ai do të vinte në qytetin e Shkodrës për një seminar dhe skenari u realizua sipas parashikimeve të operativëve ish-Sigurimit. Në procesverbalin e mbajtur, në formën e deklarimeve të Camajt bie në sy përdorimi i fjalëve nga serbishtja, ndërkohë që nga gjuhët që njeh Camaj, në dosje thuhet se njihte italishten.

Deklarata e bërë nuk ka lidhje me shprehitë gjuhësore të Camajt, që më vonë i hasim në artikuj dhe krijimtarinë

²⁸³ AIDSSH, Fashikulli nr. 456, Martin Camaj

²⁸⁴ Po aty, fl. 10

e tij; e mbushur me shprehje tipike deklamative, të cilat i janë dhënë vetëm për t'u firmosur. Dialekti geg me gjuhën letrare përzihen si pa gjë të keq, duke zbuluar se ish-operativët e kanë formuluar dhe shkruar. Deklarata që mban datën 10. 5. 1948, 5 ditë pasi me shumë gjasa ai ishte ndaluar. Në fletën e plotësuar për të, me të dhëna biografike, shkruhet se nuk është anëtar partie apo pjesë e ndonjë organizate të partisë komuniste. Më e rëndësishmja që hedh dritë mbi faktin që Camaj kurrë s'e ka miratuar dhe as ka qenë bashkëpunëtor i komunistëve është pika 24 e formularit: "Asht rekrutue me detyrim"²⁸⁵. Ky do të ishte qëndrimi i parë dhe i fundit i Camajt në ambientet e ish-Sigurimit të shtetit dhe kambana e alarmit për të bërë një zgjedhje, për t'u larguar përfundimisht nga vendi, bashkë me Gjon Destanishtën dhe anëtarët e tjerë të organizatës dhe disa miq të përhershëm të Camajt.

Dosja survejuese e Camajt për rreth 10 vite nuk ka të dhëna. Në vitin 1958 bëhet kërkesa për ta përpunuar. Rihapja bëhet sepse në vitin 1957 fillon botimi i revistës *Shêjzat* ku Camaj ishte kryeredaktor, shkruante artikuj, afishoheshin të rejat letrare, tryezat, konferencat, seminarët që organizoheshin nga bashkatdhetarë dhe ato të nivelit akademik me karakter shkencor. Revista u shërbeu operativëve për të mësuar më shumë rreth tij, sepse po të krahasosh të dhënat që ka dosja me paraqitjet e të rejave nga jeta e Camajt vë re se shumë janë marrë të gatshme prej saj, që nga të dhënat për shkollimin, botimet, adresën e vendbanimit, deri idetë e tij, respektin dhe ndikimin që kishte tek shqiptarët e diasporës.

²⁸⁵ AIDSSH, Fashikulli nr.456, Martin Camaj, f. 11,

MARTIN CAMAJ 40


Eshte i pa kenaqur, kje vjete pse shef per buzje kude karsh:
shqiptareve nga te huajt. Ka ndiesina te ferta shqiptare, ka dashuri te
madhe per Atdhe dhe mbi te gjitha nuk shikon mesy te mire gjendjen
e partinave qe jane degjeneruar, prandaj nuk eshte shkruar ne asnje
prej tyre. Eshte marre dhe meret me letersi, per tu marre me kete i
eshte dashte ti bente per njekehe qejfin Keliqit. Eshte persona qe ama:
kanete duan ferte dhe e cmejne per njeri te pjekur dhe me kulture,
per mbi te gjitha ai ruan dashurine per Atdhe. Ka mbaruar universitetin
ne Jugesllavi. Ka ike vet, pa lejen e jugesllaveve ne Itali.

Camaj e ndërtoi profilin e tij si njeri i dijës, që ngjiti shkallët e karrierës përmes një pune të vazhdueshme. Në artikujt që botoi, kryesisht në revistën ku ishte kryeredaktor, temat lidheshin gjithmonë me letërsinë, zhvillimin e poezisë, prozës, të rejat nga botimet e shkrimtarëve shqiptarë në mërgim, por dhe ata që jetonin në Shqipëri, kryesisht shkrimtarët që Camaj vlerësonte. Shkrime të tij u kushtohen edhe promovimit të gjuhëtarëve që bënë përpjekje për të çuar njohjen dhe studimin e shqipes përpara. Nuk mungojnë kërkime dhe studime për kulturën arbëreshe, ekspeditat e shpeshta në zonat e banuara nga arbëreshët, hapën hullinë për të njohur më shumë traditat e gjuhën e ruajtur nga ata.

Në dosjen për Camajn, ish-Sigurimi, nuk e vuri dot në dyshim atdhedashurinë dhe punën e tij në lëmin e gjuhësisë e shkencës. Këtë profil të Camajt operativët nuk e godisnin dot, prandaj vunë në zbatim një plan pune ku së pari, përpiqen dhe duhet të vepronin me anë të lidhjeve mes shkencëtarëve, veçanërisht në rastet e seminarëve, konferencave dhe organizimeve që bëheshin për gjuhën dhe letërsinë shqipe; nëse kjo nuk arrihej, do vijonin me diskretitimin e figurës së tij, për të mbjellë dyshime në qarqet e diasporës, ku ai gëzonte respekt.

Me të parën nuk arritën ndonjë rezultat, atëherë filluan të vënë në lëvizje planin e hartuar në vitin 1965 për diskretitimin e figurës së tij, kjo u bë me dy mënyra: së pari, me përhapjen e fjalëve se Camaj ka nënshkruar një deklaratë si bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit dhe së dyti hartimi, shkrimi i letrave nga ana e Sigurimit dhe shpërndarja, publikimi i tyre si të shkruara nga bashkatdhetarët shqiptarë të Kosovës në emigrim.

Në një raport të datës 4. 11. 1965, në dosjen për Camajn shkruhet:



Ky plan i hartuar do të vihet në zbatim disa vite më vonë. Në vitin 1982, dosja e Camajt merret në përpunim 2/A, duke e cilësuar agjent të gjermanëve. Gjatë viteve '80 shtohet interesi dhe intensifikohet puna për të mbledhur të dhëna për të. Fillon të vihet në zbatim plani i hartuar që më 1965. Në 1986 bëhet analiza e raporteve për Camajn, ku vlerësohet rritja cilësore me informacione. Po në këtë vit, vihet në jetë plani për të demaskuar Camajn me anë të letrave anonime, përkatësisht fleta nr. 126-127, janë ruajtur me gjithë korrigjime në dosje.²⁸⁶

²⁸⁶ AIDSSH, Fashikulli Nr.456, Martin Camaj, f.126-127

Mendojme se do te ishte me me shume efekt qe fillimisht te shperndahet letra qe synon demaskimin dhe izolimin e Martinit nga "shqiponjasit" dhe mbas nje fare kohe te postohet letra e presionit direkt.

Ndiqni, evidentoni dhe na njoftoni reagimet.

“Ndiqni, evidentoni dhe na njoftoni reagimet.” Reagimet vazhdojnë edhe sot, bazuar mbi shpifjen dhe deformimin e së vërtetës.

Gjatë gjithë periudhës që dosja e Camajt është mbajtur nën përpunim aktiv mund të vërehen disa të dhëna për mënyrën sesi e kanë etiketuar: si bashkëpunëtor të rekrutuar të ish-Sigurimit të Shtetit tonë, si agjent të ish-jugosllavëve, të italianëve, të gjermanëve dhe të amerikanëve. Çdo lëvizje e Camajt nga një vend në një tjetër, cilësohet si agjenturë, e mbështetje për shtetin ku ai jetonte. Camaj nuk ruajti lidhje me të afërmit e tij dhe deri në 1975, as Sigurimi i Shtetit nuk interesohet, por ripërsërit vazhdimisht të njëjtat të dhëna.

Në 1975 fillon për herë të parë të vihet në lëvizje interesi për familjarët e Camajt, megjithatë nuk kanë të dhëna që mund t'i përfshijnë në veprimtari të dyshimta. Në fund të '80, ka disa letra të shkruara nga të afërm, drejtuar Camajt, por nuk ka ndonjë kopje të letrave të tij, madje kjo mund të shihet më tepër si një përpjekje për të gjetur rrugë komunikimi dhe mbledhur të dhëna nga ish-Sigurimi. Në njërin prej letrave, perifrazimi i fjalëve të Camajt nga letërshkruesi, i afërm, është më shumë hetim rreth kuptimit të fjalëve të shkrimtarit, se një letërkëmbim i singertë, çka dhe vetë Camaj e vë në dyshim dhe e pohon. Provokatorët nuk kanë munguar në rrethin e shqiptarëve, të cilët Camaj i ka njohur, nuk ka folur rreth tyre, por ka qenë gjithmonë i

kujdesshëm të vlerësojë shqiptarin tek ata dhe jo personin keqdashës.

Burimet arkivore, mund të shihen në dy aspekte, së pari, në syrin e ish-Sigurimit, ku i marrim të mirëqena²⁸⁷ faktet se Camaj më shumë aludohet si agjent; si të tilla mund të merren dhe burimet arkivore online të CIA-s, ku shpesh kanë vulën e “pavlerësuar” nëse janë të vërteta. Së dyti, harrohet arkiva biografike universitare dhe ajo shkencore, Bardhyl Demiraj fakton atë që vetë Camaj është kujdesur: të jetë thelbësore, e mbështetur mbi arritje që nuk kanë të bëjnë me asnjë lloj agjente, aludimi se ai la vendin për t’u vënë në shërbim të të tjerëve.²⁸⁸

Duke vënë në dyshim çdo lëvizje të Camajt, do të ishte një interpretim tendencioz. Camaj ishte një i ri, që mundësinë për të çuar më tej shkollimin e tij, e pa me largpamësi. Në çdo universitet ku ai studioi, punoi, e provoi veten si njeri i ditur, studiues serioz, njeri i letrave. Camaj nuk mund të dyzohet, në një anë njeriu i dyshuar i regjimit, e në anën tjetër shkrimtari që u njoh pas ‘90-s. Veprimtaria e tij, ishte krijimtaria. Ai ka një punë voluminoze në shkrim, redaktim, artikuj shkencorë, punë kërkimore, poezi, prozë, dramë dhe angazhimi si profesor universiteti, nuk janë të rastësishme. Nuk mund ta zëvendësosh veprimtarinë e shkrimtarit dhe profesorit me hamendësimet e ish-Sigurimit, të cilët e kanë mbushur dosjen me përsëritje vit pas viti të biografisë, por në asnjë rast me fakte dhe prova. “Dashuninë për vendin e vet e shprehte jo me deklarata plot zhurmë (po punë) të

²⁸⁷ Shkrimi i Auron Tares, “Dritëhije në histori: Martin Camaj dhe Ernest Koliqi, të pazbuluar”, 2020, i botuar online, hapi debat publik dhe i shërbeu më shumë qasjes sipas ish-Sigurimit, ku u harrua Camajn shkrimtar.

²⁸⁸ Bardhyl Demiraj, *Jeta akademike e Martin Camajt*, <https://www.albanologie.uni-muenchen.de/download>
<https://www.albanologie.uni-muenchen.de/downloads/publikationen-demiraj/jeta-akademike-e-martin-c.pdf>

palodhshme shkencore dhe letrare tek na e jepte imazhin e vet të vendit të të parëve dhe të qenies shqiptare.”²⁸⁹

Camaj asnjëherë nuk u angazhua në ndonjë grupim politik, megjithatë Lanksch këmbëngul, me idenë sipas tij prej vetë Camajt, që ai nuk merrej me politikë, po ishte njeri politik. Kjo këmbëngulje për ta përjashtuar veten, për ta hequr nga kornizat dhe etiketimet lidhet me konceptin për kohën që kishte Camaj, koncept filozofik, që më së miri e gjejmë të shprehur në romanin *Karpa*, e deri diku tek *Rrathë*: përkohësia, relativiteti, ndjeshmëria jonë dhe përjetimi i kohës, të jesh në kohë, jashtë kohe, ta përjetosh apo ta shmangësh, të kesh një vizion largapamës, apo të luash me të dhe madje ta parashikosh të ardhmen tënde, ku sistemet totalitare sfidohen dhe njeriu ka një mundësi: të zgjedhë.

Camaj luan dhe ironizon me përkohësinë e pushtetit, me rrethanat që sillen të tilla që ndryshojnë vazhdimisht, prandaj ai nuk e sfidoi sistemin komunist me një profil të kornizuar politik, ai e tejkaloi, për të qenë kundër çdo sistemi që i heq lirinë individit, e mban peng në ishullin totalitar.

“I vetmi njeri me të cilin grindej ishte miku i tij ma i ngushtë, **Arshi Pipa**. Ata të dy dijshin me u grindë, gjithnji vetëm për një temë të vetme, për përziemjen e Pipës të punëve letrare me politikën.”²⁹⁰

²⁸⁹ Hans-Joachim Lanksch, *Martin Camaj ende i pazbuluem*, Albas, Tiranë, 2017, f. 12

²⁹⁰ Po aty, f. 21

Arshi Pipa

“Vuej por qëndro”²⁹¹

Arshi Pipa, u dënua dhe vuajti 10 vite burg politik, pati shumë drama familjare dhe ëndrrat e tij për të jetuar e punuar në Shqipëri nuk gjetën vend. “Atë e detyruan komunistët të arratisesh”²⁹², më 21 shtator 1957, bashkë me të motrën Fehimen përmes liqenit të Shkodrës. Qëndroi një vit në Sarajevë e më pas u largua në SHBA, për të punuar si profesor.

Dosja e Arshi Pipës, ndryshe nga ajo e Camajt ka më shumë të dhëna për familjarët e tij, ata mbetën tëurvejuar gjatë gjithë sistemit komunist, çdo lëvizje, bisedë, opinion, letër mbikëqyrej. Gjithë korrespondenca me të afërmit në Shqipëri kalonte nëpërmjet filtrave të ish-Sigurimit, prandaj Arshi Pipa dhe e motra ishin të kujdesshëm në ato që shkruanin për të mos rrezikuar nënën dhe motrat. Pipa, rridhte nga një familje e pasur, shumë prej anëtarëve të shkolluar dhe me ndikim dikur, sistemi komunist i pa deri kur ra, si armiq.

Në dosje²⁹³, gjithçka raportohet, është e lidhur me kontaktet e të afërmit në Shqipëri, ku korrespondenca më e shpeshtë është mes Fehimes dhe motrave. 10 vjet burg në Shqipëri, i kanë mësuar Arshi Pipës shumë rreth sistemit, kështu ai ruajti miqësi vetëm me ata që ai i besonte, e njëkohësisht qëndrimet e tij i shprehu hapur duke shkruar në shtyp, në gazeta, revista, në gjuhë të ndryshme, me botime librash. Njësoj si me Camajn, ish-Sigurimi nuk mundi t’i afrohej me operativët e rëndomtë siç ndodhte

²⁹¹ Arshi Pipa, poema “Kanali”

²⁹² Uran Kalakulla, *Arshi Pipa: njeriu dhe vepra*, Toena, Tiranë, 1999, f. 112

²⁹³ AIDSSH, Dosja Nr. 273 A, 165 -2A, Arshi Pipa.

në Shqipëri, u përpoqën që përmes njerëzve që merreshin me letërsi, të mësonin rreth tij në rastet e konferencave, organizime dhe tubimeve atdhetare.

Në të dhënat e dosjes, ai cilësohet se është njeri “mjaf i mprehtë”, e “i rrezikshëm”, përveç biografisë, që siç ndodhte shpesh ripërsëritej në çdo përpunim, ruhet një kopje në anglisht e librit të tij, *Stalinizmi shqiptar*, disa prej artikujve të të cilit ishin botuar gjatë viteve ‘60 dhe ‘80. Pjesa tjetër e dosjes është një humbje kohe e sistemit për ta ndjekur por pa arritur në asnjë rast të provojnë cilësimet si agjent i SHBA-së.

Ish-sigurimi, nuk la pas dore as planet për Arshi Pipën, duke ndjekur të njëjtën metodë, duke e akuzuar dhe parë gjithmonë si tradhtar dhe kolaboracionist.

Arshi Pipa interes parësor në rininë e tij kishte të shkruarit dhe angazhimet e tij të para janë në këtë fushë. “Arshiu nuk është marrë gati fare me veprimtari politike. E kjo për dy arsye themelore: së pari, duke qenë i dhënë fort pas krijimtarisë letrare dhe studimeve në atë fushë, mendonte se me kaq e bënte edhe detyrën qytetare.”²⁹⁴ Arshi Pipa ishte i angazhuar si intelektual, në disa drejtime dhe këto u bënë shkaku i vërtetë që regjimi ta dënonte dy herë.²⁹⁵

Veprimtarinë si shkrimtar, pas arratisjes, e zhvilloi në SHBA. Studimet në Itali, për filozofi i hapen rrugën për të punuar si profesor, pa lënë pas shkrimin dhe trajtimin e shumë çështjeve politike të cilat e shqetësonin, në lidhje me Shqipërinë e më vonë me Kosovën.

²⁹⁴ Uran Kalakulla “Arshi Pipa: njeriu dhe vepra”, Toena, Tiranë, 1999, f. 214

²⁹⁵ Shih, Indrit Qehajaj “Arshi Pipa, profili i një studiuesi të padëshiruar”, në “Sigurimi dhe shkencëtarët” <http://autoritetidosjeve.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Sigurimi-dhe-shkencetaret.pdf>

BIOGRAFIJA E T'ARRATISURIT
ARSHI MUSTAFA PIPES 16

Arshiu asht i biri i Mustafas dhe i Hatëxhes, i datlindjes 1920, lindur ne lagjen Farruc (Qemal Stara) me profesion ish nepunes profesore, i pa martuare, & pa organizuare ne parti, ka qene i denuare per qeshtje politike, nuk ka kryere sherbimin ushtarak, din gjuhe te hueja, italishte, jugosllavishte, dhe frengishte, me shtetsi dhe kombesi shqiptare, rrejdha ne shtresat e pasura te qytetit.-

Gjate rregjimit te zogut si vete familja e tije kane simpatizuar ate rregjim, per faktin se duke qene te pasur, kane qene privilegjuare nga aj rregjim. Basesj i Arshiut ka ushtruar profesionin si advokat. Nuk dihet qe gjate asaj perjudhe te kene ushtruar ndonji aktivitet ne favor te atij rregjimi. Arshiu ka vazhduare gjimnazin.-

Ardhjen e akupatoreve e kane pritur mire familjarishte. Baba i Arshiut perseri asht marre me pune se advokat deri ne vitin 1942-43 koha ne te cila ka vdekur. Arshiu ne kete koha del jashte shtetit dhe shkon ne Itali per te kryere studimet e fakultetit juridik, mbasi rrine disa koha ketehet perseri duke mos e kryere shkollen. Arshiu mbasi kethen nga Italia ne Shqiperi, fillon te simpatizojë shum ballin kombetare, dhe si i till propagandon ne favor te saje, kurse nji vlla tjetër i Arshiut (Vllaz Agri) ~~po~~ dihet se ka qene nje nga aktivistet ma te njokur te organizates tradhtarë t'ballit kombetare dhe i lidhur ngushte me klerin katolik. Siki Duke qene keshtu Vllaj i Arshiut, Myzaferi ka treguar aktivitet te dukshem ne detyre te popullit.-

Arshi Pipa nuk ngurroi të shprehte mendimin dhe tezat tij për pushtetin diktatorial, duke nisur nga problemet ekonomike, arsimore, kulturore dhe ato politike. Në librin *Stalinizmi shqiptar*, i cili është pjesë e dosjes formulare, Pipa shprehej: “Komunizmi imponoi mbi popull një ideologji që krijoi një kope skllevëris prej individëve të lirë, që shkakton një psikologji të egërsisë dhe torturës së panjohur për shqiptarët, futi me forcë një kod etik që i kthen fëmijët në spiunë të vetë prindërve të tyre. Një ideologji e tillë ka tipare të kundërta me atë që karakterizon mentalitetin shqiptar.

Faktet që mund të perdoren për demaskimin e t'arratisurit
Arshi Pipa janë:

1) Në keken kur studjente në Firence dhe pikerisht mbas ekupitimit të vendit tëma nga Italianet Arshiu thirret nga ana e Italishtit Del Monte i cili qëndronte pranë Jakememit dhe ngarkohet prej tij si redaktor i një organi të Universitetit. Si rrjedhim vihat në shërbim të Italianeve.

2) Gjate ekupasjemit, në keken kur Arshiu ishte këtyer nga studimet, ju shërben atyre me anë të shume artikujve e shkrimeve që shkruante në të cilat kritikonte L.N.C.

- Në gjate kësaj keke me inisjativën e tij heton një të përmuajshëm me titull "Kritika", e cila ishte një breshurë me frymë fashiste dhe kishte si qëllim të mashtroente popullin dhe mashte fytyrën e vërtetë të ekupatave. Në të kritikonte lufta N.C. dhe që gjate ishte përparimtare ndërsa fashizmit i thureshia levdata etj.

3) Bashkëpunon me organizatën e Ballit Kombëtar duke bërë arkitasjen dhe propagandën në favor të saj.

4) Mbas qëllimit këndet me një here në aktivitet armiqësor kundër pushtetit populler të perës agritur. Behet antar i organizatës të agjentëve dhe sabetatereve qëllimi final i se ciles ishte rezimi me feresë i pushtetit populler duke u mbeshetur dhe në adimën që do ju jepet nga jashtë. Bën pjesë në grupin e ashtu quajtur "Social - Demokrat" që drejtohet nga Gjergj Kekeshi dhe që me anë të ketij të fundit lidhet me qëndrën e organizatës.

- Në radhët e organizatës që thuhet në sipër Arshiu ka qenë nga më aktivët dhe kryente më zell detyrat që i ngarkoheshin si psh.

a) Duke u mbeshetur në elementin kundërshtar bente arkitasjen dhe propagandën kundër pushtetit, duke bërë thirrje për rezimin e tij.

b) Duke shfrytëzuar dhe detyrën si profesor grumbulloante në shtëpinë e tij atë dhe gjetke studenta nga radhët e të pa kësajurve dhe shvilloante me të bisada politike. J^u fliste kundër pushtetit duke ju thënë se ky pushtet kishte për qëllim të shkatëronte dhe varfëro-

Sidoqoftë, ai nuk mund të lulëzojë. Por, ai mund të prodhojë konfuzion dhe lajthitje.²⁹⁶ Duke shkuar më tej në analizat e tij, ai e parashikoi mënyrën sesi mund të përmbysesh sistemi. Ai e luftoi fort me penën e tij, bëri opozitë, duke e ditur që çdo kopje e asaj që botohej lexohej nga ish-Sigurimi.

Arshi Pipa u arratis dhe u rikthye në Shqipëri për të parë se kishte ardhur dita për t'u vërtetuar ato që ai kishte deklaruar për shumë vite larg Shqipërisë, ku ndikimi mbetej në diasporë dhe gjithmonë me shpresën se do të dëgjohej

²⁹⁶ Arshi Pipa, *Stalinizmi shqiptar*, f. 44

“

Komunizmi imponoi mbi popull një ideologji që krijoi një kope skllëvërisht prej individëve të lirë, që shkaktonte një psikologji të egërsisë dhe torturës së panjohur për shqiptarët, futi me forcë një kod etik që i kthen fëmijët në spiunë të vetë prindërve të tyre.

- A. Pipa

”

fjala e tij nga ata që nuk e donin atë që ai e cilëson dhe përkufizon si stalinizëm dhe ishte i bindur për këtë “-izëm”.

Interesi i Pipës, pasi u arratis, lidhej me atë që ai la në mes kur themeloi revistën Kritika, në vitin 1940, e ndërprerë në 1944. Qasja kritike, analiza e thelluar e temave të cilat ishin të lidhura me të ardhmen e shqiptarëve, përbënë interes për të dhe u paraqitën në shkrime të shumta. Studimi i arbëreshëve, i letërsisë shqipe, analizat mbi krijimtarinë e shkrimtarve që ai vlerësonte, ishin interesa dhe pasione të përbashkëta me Camajn, që u konsoliduan me miqësi deri

në ndarjen nga jeta. Pika e vetme ku ata ndaheshin, ishte mungesa e interesit nga Camaj për të shprehur publikisht qëndrime mbi partitë dhe politikën në përgjithësi, ndërsa Pipa, e ndoqi paralelisht angazhimin si intelektual, të ardhmen politike të vendit tonë, duke ruajtur karakterin polemizues njëkohësisht.

Arshi Pipa përmendet, po është akoma i panjohur në rrethin e gjerë të lexuesve, shumë mbeten për t'u studiuar. Si një ish-i burgosur politik kërkoi lirinë e tij, në të gjitha dimensionet, arratisja ishte mbijetesë për të thënë i lirë mendimin. Në kohën kur qe në burg, krijoi dhe ishte mënyra për të mbijetuar emocionalisht dhe psikologjikisht:

“Poezia më ka mbajtur gjallë, isha i armatosur me kulturë. Dituria e vërtetë të jep fuqi, letërsia veçanërisht.²⁹⁷ Gjithë jeta e tij iu kushtua krijimit, studimit, publicistikës, në liri. Me rikthimin në Shqipëri, ai kërkoi të takonte rininë, duke e parë shpresën tek ata.

Bilal Xhaferi

“Ku vallë më çon kjo rrugë e largët?”²⁹⁸

Bilal Xhaferi u arratis më 31. 8. 1969. Fëmijëria dhe rinia e tij është e mbushur me drama, i mbetur jetim pas vdekjes së nënës dhe pushkatimit të babait, ai ishte pjesë e atyre që biografia do t’i përndiqte gjatë gjithë jetës. Dosja për të u hap që në dhjetor 1963, ku nga 2/B kaloi në prill të 1964 në përpunim 2/A. Për shumë vite ai punoi gjithmonë në punë të vështira, që në moshë të hershme, megjithatë kjo nuk e pengoi që të shkruante e të botonte.

Koha kur ai vendosi të arratisëj, pas disa vështirësive dhe pengesave që sistemi i kishte nxjerrë, ishte diskutimi që bëri në një mbledhje të Lidhjes së Shkrimtarëve për romanin *Dasma* të Ismail Kadaresë. Fjala e B. Xhaferit ishte e mbushur me kritika kundrejt romanit dhe menjëherë pati reagime, ku ndër ta thuhet se foli dhe ministri i Kulturës, Fadil Paçrami i pranishëm në atë mbledhje, duke e quajtur Xhaferin “armik”, si biri i një të pushkatuari. Sigurimi në Shqipëri e përndoqi Xhaferin hap pas hapi, çdo lëvizje, fjalë, miqësi e tij ishte nën lupë. Në planin e masave që u hartua për të, theksohet se çdo rrethanë jetësore e tij të vihet nën vëzhgim: korrespondenca, miqtë, ku nuk mungojnë provokatorët dhe të ashtuquajturit “letrarët e rinj”, njësoj si në rastin e Pipës, që ishin një nga

²⁹⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=mmBn3XnRcTA>

²⁹⁸ Bilal Xhaferi, poezia Atdheu

burimet e inskenimeve për të ngritur akuza.

Në dosje ka sajesa, me të njëjtat teknika dhe mënyra që përdorte Sigurimi i Shtetit, si shembull mund të merret një deklaratë e gruas së mikut të tij, se i shoqi bashkë me Xhaferin, do të përmbysnin pushtetin. Pesha e survejimit, i rrethuar vazhdimisht nga njerëz të cilët ishin vetëm për të vjelë prej tij, një fjalë a një veprim që ta fusnin në burg, presioni i vazhdueshëm dhe kulmimi me diskutimin që Xhaferi bëri, bënë që të merrte vendimin për t'u arratisur më 31 gusht të vitit 1969.

Xhaferi kaloi në Greqi dhe u mbajt në Athinë për disa kohë, në internim. "Shokët e tij brenda tre muajve u lanë të lirë të shkonin në Amerikë, kurse për Bilalin, tha Sefo, u desh ndërhyrja e ambasadës amerikane, që ta linte të ikte. Pas një muaji edhe ai u nis të ikte nga Greqia për në Amerikë. U vendos në Boston dhe punoi te gazeta "Dielli" në fund të 1971. Largohet nga Çikago dhe hap revistën "Krahu i Shqiponjës", e cila u botua deri në numrin 39."²⁹⁹

Sipas Selfo Hoxhës, Bilalin e çojnë në Janinë: "Sigurimi shqiptar kishte ndërhyrë deri këtu, duke e udhëzuar qeverinë greke si ta "trajtonte" Bilalin. Ne çamët e mërgimit ndërhyëm fuqimisht në organizma të OKB-së për ta tërhequr."³⁰⁰ Në SHBA, gjithashtu u përpoqën të diskretitojnë figurën e Xhaferit, siç ishin përpjekur të bënin me Camajn, duke përgatitur letra anonime, për ta futur në konflikt me komunitetin çam. Më 1978 plagoset nga të panjohur, ndërkohë që ishte nisur për të shkuar në një darkë, për kremtimin e 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit.³⁰¹

Një ndodhi tjetër që akoma nuk është zbardhur: "Nuk

²⁹⁹ Edip Hoxha "Dashamirësia përballë përpjekjes", në: Bilal Xhaferi, Vepra 5, Arbëria, Tiranë, f.64

³⁰⁰ Po aty, f. 11

³⁰¹ Bashkim Kuçuku, *Lexime të veprës së Bilal Xhaferit*, Tiranë, 2012, f. 215

mund të lë pa përmendur këtu atë që i bëri sigurimi shqiptar, duke i djegur më 1983 dhomën e tij të punës. Një humbje e madhe për Bilalin dhe për ne. Shumë materiale me vlera artistike dhe historike u dogjën. Kjo e dëshpëroi atë pa masë. Një ditë më tha: ky është pushkatim i dytë për mua. Iu vu punës për ta ripërtërirë materialin, por në shtator të vitit 1986 vdiq.”³⁰²

Në Shqipëri, deri kur u arratis, B. Xhaferi kishte ndërtuar një emër si shkrimtar, duke botuar një vëllim me tregime në 1966 “Njerëz të rinj, tokë e lashtë”, një vëllim me poezi “Lirishta e kuqe” 1967, romanin “Krastakraus”. 1967-ta ishte një vit suksesi për letrarën dhe konsolidimin e emrit të tij si shkrimtar, por kjo zgjati pak. Vetëm një vit më pas i hiqet e drejta e botimit; pas diskutimit për romanin e Kadaresë, më 1968 i ndalohen veprat dhe internohet në fshatin Hamallë të Durrësit. Këtë kalim, nga emri shkrimtar, në të internuar, e vulosi me të arratisur, për të shpëtuar brenda vetes shkrimtarin dhe lirinë e fjalës.

Në 1970 fillon punë në gazetën Dielli, ku qëndron deri në 1972. Për të themeluar më vonë dhe drejtuar deri në fund të jetës, 1974-1986, revistën *Krahu i Shqiptonjës*, që do të bëhet puna e tij e përditshme, me shkrime, publicistikë, poezi, tregime, skeçe, romane. Kontributi i Xhaferit, lidhet me përkrahjen e çamëve, çështjet shqiptare, megjithëse jo të gjithë bien dakord, ndër ta Kadare.

Shkrimtarët e arratisur përballë Kadaresë

Kur përmendet B. Xhaferi dhe një nga arsytet e arratisjes është diskutimi që ai bëri për romanin të I. Kadaresë,

³⁰² Selfo Hoxha, “Gjithnjë pranë njëri-tjetrit”, në *Vepra* 5, f. 110

Dasma. Kjo çështje, pjesë e dosjes së Xhaferit, është diskutuar shpesh, dhe nga Kadare. Në një intervistë të dhënë, ai shprehet: “në atë sallë ka ndodhur diçka shumë e rëndë nga ajo që është dukur ose është rrëfyer”³⁰³, të cilën e cilëson si goditje politike. “Goditja e tij ishte e pamoralshme dhe e pabesë, tipike në atë kohë, nga ato që të çonin drejt rënies e ndoshta drejt burgut. Shkurt, njëri nga kolegët, e fajësoi tjetrin për “dekantizëm” dhe “nxirje të realitetit”. Kolegu (përndryshe kolosi tjetër) nuk u përgjigj. “Ky është thelbi i ngjarjes”³⁰⁴, të tjerat shprehet Kadare: “Dalja kokëulur nga salla gjithashtu, e më pas mënjanimi, kapërcimi i kufirit, përfundimi në SHBA, ku jetoi i lirë për 18 vjet, pa dëshmuar pothuajse asgjë serioze për ferrin nga shpëtoi, e kanë rrënjën tek ai akt fillestar.”³⁰⁵

Kadare e sheh, diskutimin e Xhaferit si inskenim për ta goditur, ndërkohë që akoma ruan prej këtij diskutimi shijen e hidhur, duke e përmbledhur në një fjali gjithë jetën e Xhaferit. Ky diskutim është parë si inskenim për të goditur Kadarenë dhe është lënë të nënkuptohet se Xhaferi u përdor nga regjimi. Ndërkohë që Xhaferi, nuk ka shprehur mllef ndaj tij, po këtë moment, ndoshta veprim i nxitur, e ka bërë për të përkrahur letërsinë e realizmit socialist. Ndërkohë që në veprat e tij, nuk ka gjurmë të realizmit socialist, u përpoq që me anë të një diskutimi të gjente përkrahje dhe të ndryshonte opinionin e sistemit për të.

Në letërkëmbimet, në të dhënat biografike që janë botuar nga studiuesi dhe miqtë që kanë ndarë shumë vite afër tij, Xhaferi nuk e siguronte jetesën vetëm me punën e tij prej shkrimtari, publicist apo botuesi, ai ishte i detyruar

³⁰³ Aida Tuci, *Rreth dosjes Bilal Xhaferi: Një enigmë me disa të panjohura*, Onufri, Tiranë, 2014, f.131

³⁰⁴ Aida Tuci, *Rreth dosjes Bilal Xhaferi: Një enigmë me disa të panjohura*, Onufri, Tiranë, 2014, f.132

³⁰⁵ Po aty, f.132

të bënte punë të ndryshme, ndërkohë dhe të merrej dhe me krijimtari.³⁰⁶ Djegia e redaksisë, plagosja, sëmundja, puna e krahut, mospasja e një diplome, të gjitha bashkë nuk ia lehtësuan jetesën, por përkundrazi. Megjithatë me aq sa mundi ai nuk reshti së krijuari dhe si në prozë, si në poezi. Vendi i Xhaferit në letrat tona është i çmuar, ai arriti të shkruante sa ishte në Shqipëri, një letërsi që dilte nga skemat dhe kornizat e realizmit socialist, kjo dhe e bëri atë krejtësisht të padëshiruar, gjithë të tjerat ishin rrethana që sot mund të përdoren si justifikim nga ata që ishin kundër tij dhe nuk kanë të bëjnë me qenësinë e tij si shkrimtar.

Kadare nuk ka pasur raport miqësor as me Arshi Pipën përpara se të binte sistemi. “Janë dy dosje që s’kanë të bëjnë fare me njëra-tjetrën. Njëra prej tyre ajo e B. Xhaferit, si një sajësë e pistë, siç u tha, nuk mund të bëjë pjesë në kronikën e asnjë kulture dhe që të jem i sinqertë, s’kam ndonjë dëshirë ta kujtoj. Ndërkaq ndërlikimi me Arshi Pipën, duke qenë i një natyre krejtësisht tjetër, e ka në vetvete edhe peshën dhe dinjitetin e atyre incidenteve që, edhe pse të rënda, janë pjesë e natyrshme e kalendarit të letërsisë.”³⁰⁷ Xhaferi, ndoshta besonte shumë se si shkrimtar do i hapte rrugën, nëse do bënte një diskutim ku të ruante vijën e partisë. Lirinë, më vonë nuk e përdori kurrë për të goditur të tjerët, shkroi vetëm si patriot, pa u marrë me askënd personalisht.

Ndërkohë që Arshi Pipa, i njohur për penën e mprehtë, analizat e pakompromis, dinte kë të shigjetonte dhe nuk u fsheh as kur erdhi rasti për të folur për shkrimtarin që në Shqipëri vlerësohej si më i rëndësishmi. “Në mënyrë

³⁰⁶ *Lexime të veprës së Bilal Xhaferit*, përg. Bashkim Kuçuku, Dhurata Shehri, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 2012

³⁰⁷ Aida Tuci, *Rreth dosjes Bilal Xhaferi: Një enigmë me disa të panjohura*, Onufri, Tiranë, 2014, f. 129

paradoksale, siç mund të tingëllojë, ai është shkrimtari më i madh realist i realizmit socialist në Shqipëri. Nëpërmjet groteskut të tij të sofistikuar, parodive të tij dhe lojërave të fjalëve, lexuesi e kupton realitetin shqiptar shumë më mirë se nëpërmjet portreteve dhe tablove të stolisura, si ato të Kako Pinos, që zbukurojnë Shqipërinë socialiste.”³⁰⁸

Arshi Pipa, e analizon figurën e Kadaresë në rrafshin e gjerë, të marrëdhënies pushtet diktatorial, talent letrar, të cilën e cilëson si “aleancë të pandershme në histori”. Ai shprehet se: “Kadare është, padyshim, një shkrimtar shumë i talentuar, i vetmi shqiptar që krahasohet me përfaqësuesit bashkëkohorë të gjinisë së narrativës. Prej tij kërkohet një qëndrim i ndershëm. Unë them i ndershëm, artistët nuk mund të jenë detyrimisht shembuj të heroizmit moral. Që të kenë mundësi të shprehin në vetvete në regjimet diktatoriale ata duhet të mbijetojnë, por ka mënyra për të jetuar dhe gradë kompromisi, pa bërë lojë të dyfishtë dhe pa u shitur krejtësisht.”³⁰⁹ Në këtë përmbledhje me shkrime për Kadarenë, Pipa tregohet i drejpërdrejt dhe merr e analizon sipas romaneve qëndrimet e shkrimtarit, veçanërisht ndaj veriut, ndaj qytetit të lindjes etj.

Arshi Pipa e vlerësonte si shkrimtar, për talentin dhe stilin, ai përktheu në anglisht romanin e Kadaresë, *Kronikë në gur*, por duke e shoqëruar me një parathënie që për sistemin diktatorial, do të ishte e papranueshme dhe e rrezikshme për vetë Kadarenë. Ndryshe nga mospajtimi me veprimin e Xhaferit, për Arshi Pipën, Kadare ka bërë kthesë, më vonë, në kushte të tjera, kur parathënia e Pipës nuk e rrezikonte, Kadare e riboton romanin në anglisht: “Kështu, me shumë vonesë, teksti i tij u bashkua, më në

³⁰⁸ Arshi Pipa, *Subversion drejt konformizmit: fenomenet Kadare*, Phoenix, 1999, përkth. Bardhyl Shehu, f. 57

³⁰⁹ Po aty, f. 77

fund, me parathënien, asaj që kishte qenë zanafillë e së keqes. Ky bashkim ngjante vërtet si një zgjidhje simbolike e asaj ndarjeje, atij që e kishte përkthyer me aq dashuri, e prej të cilit ishte shkëputur aq pikëllueshëm. Kjo rivendosje e harmonisë ishte njëherësh ngadhënjim i saj mbi përçarjen, të fshehtë e së cilës ai e mori me vete atje ku shkoi. Ne nuk e dimë atë, ashtu sikurse ai s'do ta marrë vesh kurrë epilogun pajtues. Ndërkaq jam i sigurt se, sikur ta merrte vesh, atje ku ndodhet, siç thuhet, shpirti i tij do të gjente edhe më shumë paqe.”³¹⁰

Camaj, nga ana tjetër nuk ka pasur një marrëdhënie me kaq pikëpyetje, sipas vetë Kadaresë janë takuar së pari, në një panair libri në Gjermani më 1981, ku Camaj i ishte prezantuar, ndërsa Kadare pohon se e njihte nga shkrimi “Romani i eshtrave”, artikulli i Camajt për botimin e parë të romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*. Duket se kanë gëzuar një respekt reciprok për njëri-tjetrin, pavarësisht se Kadaresë nuk iu mundësua një takim me të para se Camaj të ndërronte jetë. Në botimin e fundit të veprave të Camajt, Kadare është dhe një nga autorët e parathënies që shoqëron botimin.

Të tre shkrimtarët e arratisur, në raport me marrëdhëniet me Kadarenë, mund të shihen si raport mes shkrimtarit dhe pushtetit, atyre qëurvejoheshin dhe nuk u lanë rrugë zgjidhje, përveç largimit. Nga ana tjetër kishte gjatë periudhës komuniste nga ata që ia dolën mbanë, të mos cenoheshin as nga censura, e as nga pushteti. Ky raport talent-shkrimtar, siç e cilësonte Pipa, gjatë komunizmit mbetet akoma me shumë pikëpyetje, sepse më shumë se me letërsinë ka të bëjë me moralin, krejt të parëndësishëm për veprën, kësaj nuk është e udhës që akoma shkrimtarë

³¹⁰ Aida Tuci, *Rreth dosjes Bilal Xhaferi: Një enigmë me disa të panjohura*, Onufri, Tiranë, 2014, F. 130

si Camaj, Pipa, Xhaferi të shihen e të analizohen biografite e tyre nën hijen e dosjeve.

Përfundime

“Armiku më i madh i totalitarizmit mbetet kujtesa. Diktaturat, qofshin të djathta, qofshin të majta, ato naziste, komuniste, sidomos këto të fundit, zhdukin e zhdukin provat, dëshminë, kujtesën e shkruar, bëjnë dhe zhbëjnë dosje, dokumente, ndalojnë e djegin libra, i vërsulen kujtesës së pashkruar, bisedave, rrëfimit, mendimit”³¹¹, shprehet Visar Zhiti, për shkrimtarët e mënjanuar, dënuar e zhdukur gjatë periudhës komuniste.

Camaj, Pipa, Xhaferi, u shkëputën fizikisht prej atdheut, po e gjithë jeta e tyre, ishte në shërbim të tij. Asnjëri nuk jetoï në hije, secili kontribuoi në fushat e publicistikës, kulturës, ndikoi për të dhënë mendimin ndryshe që nuk lejohej në art dhe letërsi, në Shqipërinë komuniste. Nuk bënë kompromise me artin e tyre. Hijet e dosjeve, janë fantazma të cilat vazhdojnë të keqpërdoren, si të vërteta, për publikun e gjerë, ndërkohë që ato duhet të trajtohen e shihen vetëm ana e errët e sistemit dhe e dëshmisë sesa shumë i urrente sistemi komunist ata që qenë gjithmonë të lirë në mendim dhe në krijimtarinë letrare.

Vendi i Camajt, Pipës, Xhaferit, nuk mund të përcaktohet nga biografia e shkruar prej ish-Sigurimit të shtetit, krejt e parëndësishme për lexuesit dhe studiuesit e veprës së tyre letrare. Leximi i krijimtarisë së tyre, ribotimi dhe përhapja e saj, do të mundë dhe të çlirojë emrat e tyre nga hijet e së shkuarës.

³¹¹ Visar Zhiti, *Kartela të realizmit të dënuar dhe panteoni i nëndheshëm*, Uegen, Tiranë, 2020, f. 84

Bibliografi

- AIDSSH, Fashikull Nr. 273 A, 165 - 2A Arshi Pipa
AIDSSH, Fashikull Nr. 456 Martin Camaj
Fashikull, Bilal Xhaferi
Kalakulla, Uran. *Arshi Pipa: njeriu dhe vepra*, Toena, Tiranë, 1999
Lanksch, Hans-Joachim. *Martin Camaj ende i pazbuluem*, Albas, Tiranë, 2017
Pipa, Arshi. Stalinizmi shqiptar: aspektet ideo-politike, IKK & Princi, Tiranë, 2007, përkth. Çapajev Zera
Pipa, Arshi. *Subversion drejt konformizmit: fenomeni Kadare*, Phoenix, 1999, përkth. Bardhyl Shehu
Tuci, Aida. *Rreth dosjes Bilal Xhaferi: Një enigmë me disa të panjohura*, Onufri, Tiranë, 2014
Xhaferi, Bilal. *Përtej largësive*, Toena, Tiranë, 1996
Xhaferi, Bilal. *Vepra letrare 4*, Arbëria, Tiranë, 2010
Xhaferi, Bilal. *Vepra letrare 5*, Arbëria, Tiranë, 2010
Lexime të veprës së Bilal Xhaferit, përg. Bashkim Kuçuku, Dhurata Shehri, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 2012
Zhiti, Visar. *Kartela të realizmit të dënuar dhe panteoni i nëndheshëm*, Uegen, Tiranë, 2020

Burime nga interneti

- <https://peizazhe.com/2017/07/28/dosja-e-camajt/>
<http://www.gazetadita.al/si-i-rekrutonte-udb-ja-intelektualet-shqiptare-ne-vitet-50-rasti-i-martin-camajt-dhe-hasan-kaleshit/>
<https://www.albanologie.uni-muenchen.de/downloads/publikationen-demiraj/jeta-akademike-e-martin-c.pdf>
<http://adsh.unishk.edu.al/collections/show>
<https://www.cia.gov/readingroom/document/cia-rdp80-00810a005600130002-7>
<https://peizazhe.com/wp-content/uploads/2020/07/Mitet%C3%AB-rreme-Auron-Tare.pdf>
<https://www.youtube.com/watch?v=mmBn3XnRcTA>
<https://55news.al/dossier/item/239974-teknologjia-e-shpifjes>
<https://www.youtube.com/watch?v=0RODhoXC68o>
<https://27.al/camet-e-pabese-si-kundershtare-politike-te-regjimit-komunist-rasti-i-disidentit-bilal-xhaferri/>



| Prof. asoc. dr. Enis Sulstarova

Prof. Asoc. Dr. Enis Sulstarova është lektor i parë pranë Departamentit të Shkencave Politike. Ai është diplomuar si sociolog nga Middle East Technical University (Ankara/Turqi) në vitin 2000. Në vitin 2002 mbaroi studimet për master pranë të njëjtit universitet në degën e Shkencave Politike dhe Administrimit Publik. Në vitin 2011 mbrojti gradën “doktor i shkencave” pranë Universitetit të Tiranës dhe në vitin 2016 mori titullin “profesor i asociuar” pranë të njëjtit universitet. Gjatë viteve 2013-2015 ai ka qenë “Marie Curie Fellow” pranë Institutit Georg Eckert në Braunschweig të Gjermanisë. Fushat e tij të interesit janë nacionalizmi, politikat e identitetit, sociologjia politike, ideja e Evropës. Enis Sulstarova është autor i disa librave dhe i një numri artikujsh të botuar në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit.

EMIGRACIONI POLITIK NË LETËRSINË E

REALIZMIT SOCIALIST

Abstrakt

Realizmi socialist ishte një letërsi politike në shërbim të luftës së klasave. Sidomos romanet dhe novelat e realizmit socialist me agjenturë paraqisnin figurën e “armikut” të jashtëm dhe të brendshëm që kërcënonte lirinë e popullit dhe ndërtimin e socializmit. Kumtesa do të hulumtojë paraqitjen e emigracionit politik shqiptar në romanet Armiqtë nga Fatmir Gjata dhe Mërgata e qyqeve nga Nasho Jorgaqi. Të dyja romanet bazohen në ngjarje të vërteta dhe kanë në qendër zbulues të Sigurimit të maskuar në mesin e mërgatës politike shqiptare. Analiza do të përqendrohet në ndërtimin e personazheve negative përballë atij të zbuluesit dhe në përshkrimet në këto romane të vendeve perëndimore ku vepronin zbuluesit. Mjediset që shfaqen më shpesh janë kampet e emigrantëve, kafenetë apo

kabaretë, por përshkruhen edhe pjesë të tjera të jetës së përditshme qytetare, si fabrika dhe banesa ku vihet theksi në shenjat e shfrytëzimit klasor. Këto panorama përforconin propagandën e regjimit se vendeve perëndimore, me gjithë epërsinë e tyre materiale ndaj Shqipërisë, u mungonte humaniteti dhe drejtësia sociale që supozohej se ishin arritur në Shqipërinë socialiste.

Hyrje

Ky artikull është një pjesë e një studimi më të gjerë mbi letërsinë me agjenturë të botuar në Shqipërinë komuniste. Fokusi i artikullit është përshkrimi i emigracionit politik shqiptar dhe i mjediseve të huaja ku vepronte ai në këtë nën-gjini të letërsisë së realizmit socialist. Qëllimi ynë është që të paraqitet zhvillimi i luftës së klasave në letërsi dhe përmes letërsisë, duke nxjerrë në pah antagonizmin, në njërin krah, midis personazhit pozitiv, që tipizon njeriun e ri socialist në profesionin e zbuluesit dhe personazhit negativ, emigrantët politikë që tipizojnë “klasat armike” që komplotonin dhe vepronin kundër Shqipërisë socialiste, dhe, në krahun tjetër, duke përshkruar mjediset e mjeruara të qyteteve perëndimore, për t’i treguar lexuesve shqiptarë se si kapitalizmi po kalbëzohej së brendshmi. Janë përzgjedhur për analizën tonë romanet: *Ankthi i ditëve të fundit* (1983) i Skifter Këlliçit, tema e të cilit është rrëmbimi në Greqi i ish-kryeministrit Koço Kota prej një grupi partizanësh shqiptarë të maskuar si emigrantë politikë; romanet *Mërgata e qyqeve* (pjesa e parë 1982a & pjesa e dytë 1982b) me autor Nasho Jorgaqin dhe *Armiqtë* (1984),

me autor Fatmir Gjatën, të cilët janë rrëfime të letrarizuara të veprimtarisë së zbuluesve të Sigurimit, që ishin infiltruar te mërgata politike shqiptare në disa shtete perëndimore. Analiza jonë në këtë artikull do të përqendrohet te ndarja midis personazheve pozitivë e atyre të lëkundur apo “të gabuar”, në njërin krah, dhe te personazhet negativë, në krahun tjetër. Vazhdimi i artikullit është i ndarë në tri pjesë. Në të parën analizojmë luftën e klasave në romanet agjenturë, përmes portretizimit të personazheve: origjinës klasore, formimit, karakterit dhe veprimeve të tyre. Pjesa e dytë merret me disa skena të vendeve perëndimore që përshkruhen në këta romane dhe pjesa e përmblylëse përmbledh përfundimet e studimit.

Lufta e klasave në realizmin socialist

Letërsia e realizmit socialist ishte një letërsi e luftës së klasave. Sipas kritikës letrare të asaj kohe, lufta e klasave në letërsi është e pashmangshme, për katër arsye. Së pari, duke u nisur nga mësimi i Leninit se çdo klasë ka kulturën e vet, kuptohej se letërsia socialiste ishte pjesë e kulturës dominante socialiste, por kjo e fundit nuk vendosej menjëherë në shoqëri dhe për një kohë i duhet të luftonte me “mbeturinat e kulturës së ish-klasave shfrytëzuese”. Arsyeja e dytë pse letërsia e realizmit socialist zhvillonte luftën klasore ishin gjurmët e shoqërisë kapitaliste dhe të ideologjisë kapitaliste në ndërgjegjen e punonjësve, meqenëse marrëdhëniet socialiste të prodhimit nuk mund t'i zëvendësonin menjëherë ato kapitaliste. Në këtë mënyrë, meqenëse letërsia duhej të ishte pasqyruese e realitetit,

shkrimtari mund të mos dallonte dukuritë e reja prej gjurmëve të shoqërisë së vjetër që akoma ishin të pranishme në socializëm. Duke i dhënë një peshë të madhe këtyre të fundit, ai mund t'i bënte lëshime "ideologjisë borgjeze e revizioniste" në letërsi e arte. Arsyeja e tretë për zhvillimin e luftës së klasave në letërsi ishte se përmes letërsisë mund të depërtonin në kulturën socialiste ide dhe forma të huaja për të, prandaj "sa kohë që ekziston rrethimi borgjezo-revizionist, mbrojtja e letërsisë e arteve nga agresioni ideologjik... mbetet detyrë e përhershme". Së fundi, edhe letërsia ishte trualli praktik ku duhej vërtetuar drejtësia e ligjeve të përgjithshme të marksizëm-leninizmit, kundër teorive të tjera letrare e kulturore, të cilat cilësoheshin si pjesë e propagandës kundërkomuniste (Madhi 1984: 8-12).

Konceptimi i letërsisë si një armë ideologjike në luftën klasore çonte patjetër në pyetjen se kush do ta përdorte këtë armë, pra nëse letërsia dhe artet do të përfaqësonin botëkuptimin dhe ideologjinë e proletariatit apo atë të borgjezisë, do të synonin krijimin e njeriut të ri apo "çoroditjen e tij me moralin e kalbur borgjez" (Brahimi 1975: 77). Duke qenë se letërsia shihej si armë, shkrimtarët e realizmit socialist ishin luftëtarët e saj, sikurse e shprehte diktatori shqiptar në vitin 1968: "artistët dhe shkrimtarët tanë janë partizanë të denjë të këtij realizmi, luftëtarë të vendosur të vijës revolucionare të Partisë dhe të masave punonjëse (Hoxha 1983: 431). Shkrimtari e kishte për detyrë të shkruante mbi heronjtë e socializmit, ai ishte si të gjithë punonjësit që e drejtonin punën e tyre drejt realizimit të një plani të përgjithshëm. Temat mbi të cilat ai duhej të punonte ishin të përcaktuara nga organet e partisë, fjalimet e udhëheqësit, organizatat letrare e kulturore etj. Letërsi me agjenturë

kanë shkruar shumë nga shkrimtarët që kanë qenë aktivë në atë kohë. Disa prej tyre ishin edhe kuadro të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe ndonjë tjetër ishte informator i Sigurimit, siç është provuar kohët e fundit për Nasho Jorgaqin (shih Abcnews.al, 2020). Shkrimtarëve të nomenklaturës së MPB-së apo ata jashtë saj që porositeshin të shkruanin vepra me agjenturë, u lejohej qasje në dosjet sekrete të Sigurimit. Shkrimtarit Nasho Jorgaqi shteti i mundësoi jo vetëm qasje te dosjet e Sigurimit, por edhe një udhëtim jashtë shtetit, gjoja si gazetar sportiv që shoqëronte ekipin e volejbollit “Dinamo”, për të parë vendet që do të përshkruante në romanin *Mërgata e qyqeve* (Jorgaqi, 2012: 474-475). Maskimi si gazetar në shtete të huaja dhe vëzhgimi fshehurazi i vendeve ku mblidhej mërgata shqiptare e vinte autorin në pozitë të ngjashme me zbuluesin, që ishte heroi i veprës së tij.

Herói pozitiv në letërsinë e realizmit socialist duhej të kishte karakter aktiv shoqëror, ta luftonte të keqen, të krijonte dhe ndërtonte me vetëmohim duke u udhëhequr nga ideale të larta shoqërore, deri në vetëflijim. Vetitë e tij, si “i miri” në roman apo novelë ishin partishmëria, atdhedashuria, fryma kolektive, vigjilenca, urrejtja për armikun, dashuria për punën, disiplina, modestia, optimizmi, morali i shëndoshë familjar, dëshira për t’u përmirësuar etj. (Brahimi, 1975: 121). Heronjtë pozitivë të kampionit tonë letrar janë zbulues të Sigurimit që veprojnë jashtë vendit (Gjata, 1984; Jorgaqi, 1982a; 1982b) dhe partizanë të ngarkuar me detyra zbulimi (Këlliçi, 1983). Të gjithë ata janë burra me karakter të fortë, të bindur në idealin komunist, të palodhur në punë, vetëmohues e familjarë të përkushtuar. Zbuluesit e Sigurimit edhe kur

hiqen se kanë tradhtuar atdheun, prapëseprapë bien në sy në mërgatën politike për vetitë pozitive të karakterit dhe tërheqin simpatinë e qendrave të huaja të zbulimit, të cilët u besojnë atyre detyra të rëndësishme. Edhe pse jetojnë për vite me radhë në një mjedis të huaj, të rrethuar nga njerëz të zvetënuar e janë gjithë kohës nën një trysni të lartë psikologjike prej provave e tundimeve, zbuluesit asnjëherë nuk lëkunden dhe nuk dyshojnë te vetja dhe te drejtësia e misionit të tyre. Manush Kelmendi, heroi pozitiv i *Mërgatës së qyqeve*, e sheh veten në pasqyrë në prag të daljes nga kampi i refugjatëve politikë:

Për një çast m'u duk vetja i huaj, tek shikoja trupi tim të gjatë e të dobësuar, flokët e rralluar, rrudhat që më kishin prerë fytyrën, thinjat. Vetëm sytë më kishin mbetur po ata që kishin qenë. Thellë bebëzat më shkrepnin dhe askush veç meje nuk kuptonte se ç'donte të thoshte kjo (Jorgaqi, 1982a: 26).

Po kështu, zbuluesi Ajet Curri, heroi pozitiv i romanit *Armiqtë*, e ka ndërgegjegen e qetë kur ndodhet i infiltruar midis armiqve të klasës, sepse atë e frymëzon dashuria për popullin dhe socializmin, për të cilët ai duron torturat e armiqve, madje është i gatshëm të japë edhe jetën (Gjata, 1984: 65). Ndryshe nga super-agjenti 007 i letërsisë policeske perëndimore që i zgjidh vetë situatat e vështira, zbuluesit e Sigurimit në veprat e realizmit socialist nuk ndjehen asnjëherë vetëm, sepse ata e dinë që kanë me vete popullin. Zëri i brendshëm i kujton vazhdimisht Manush Kelmendit se ai është veshi, syri dhe grushti i popullit në mesin e të arratisurve që komplotojnë kundër atdheut (Jorgaqi, 1982a: 229; 1982b: 153, 324, 451). Zbuluesi në mesin

e mërgatës politike ndodhet në vijën e parë të luftës së klasave. Ndonjëherë atij i duket sikur është kthyer mbrapsht në kohë në Shqipërinë e vjetër ku vegjëlinë e shfrytëzonin klasat sunduese. Kjo është një përvojë e mundimshme për personazhin Ajet Curri, por edhe e dobishme, sepse i përforcon bindjen te misioni që i kanë caktuar.

E pati tmerrësisht të vështirë të rikthehej në realitetin e së kaluarës. U kthye mbrapsht, nga drita në errësirë. Ky ishte për të një stërmundim mbinjerëzor. Si mund të mohojë njeriu ripërtëritjen, diellin, gëzimin, jetën e re dhe të rikthehet te jeta e molepsur, të shtypja e shfrytëzimi çnjerëzor, te përbuzja, pabesia, hidhërimet, errësira? Po Ajet Curri u kthye, e pa, e pësoi, e nuhati, e provoi edhe një herë atë çka ishte përmbysur në Shqipëri gati një dekadë vitesh më parë. Dhe atëherë e preku madhështinë e revolucionit popullor, madhështinë e përmbysjes së pushtetit të vjetër, madhështinë e socializmit. Pikërisht kjo dritë e revolucionit e bën atë të mundë armiqte, të mundë errësirën (Gjata, 1984: 207-208).

Në romanet me agjenturë ka personazhe që, gjykuar nga origjina familjare dhe pozita e tyre klasore, gjenden në anën e gabuar të luftës së klasave. Këta janë qytetarë që normalisht do të duhej të ishin përkrahës të sistemit socialist, por që të gënjyer apo të joshur me premtime të rreme nga armiqte, ose për shkak të konflikteve apo probleme të ndryshme vetjake, rrezikojnë të kthehen në armiq të popullit e të socializmit. Disa për shkak të ndonjë grindjeje banale janë arratisur nga vendi dhe tashmë gjenden para presioneve për t'u rekrutuar në shërbimet sekrete të shteteve të huaja. Këto situata në romane e novela janë ilustrime të mënyrave se si, po të përdorim terminologjinë e kohës, “kontradikta joantagoniste”

në shoqërinë socialiste midis “njerëzve tanë” mundet që në rrethana të caktuara të kthehen në “kontradikta antagoniste” klasore (Madhi, 1984: 14). Në rast se “të gënjerit” e kuptojnë gabimin dhe kërkojnë të kthejnë rrugë duke e shlyer atë, heronjtë pozitivë u vijnë në ndihmë. Një “i gënjer” është Mevlani, truproja e Xhevdet bej Leskajt në mërgim, personazhe të romanit *Ankthi i ditëve të fundit*. Xhevdet beu e ka tërhequr pas vetes duke e mashtruar se një fshatar i kishte vrarë të atin, kur në të vërtetë fajtori për krimin është ai vetë. Pasi Mevlani e mëson të vërtetën i ndihmon partizanët e ngarkuar me arrestimin dhe sjelljen në atdhe të Xhevdet beut (Këlliçi, 1983: 128-145). Ajet Curri, zbuluesi që hiqet si armik i Shqipërisë bindet se Kujtimi dhe Sabriu, dy vëllezër që u arratisën për shkak të një faji në punë të Kujtimit, janë penduar për këtë veprim dhe duan të kthehen në atdhe. Ajeti i bind që të bëjnë lojën e diversantit bashkë me të. Të dy vëllezërit e kryejnë detyrën me sukses, pushteti popullor i fal e ata kthehen për të vijuar jetët e tyre në Shqipëri (Gjata, 1984). Manush Kelmendi, zbulues i Sigurimit jashtë shtetit, e ka të qartë se një nga detyrat e tij është që të dallojë armiqtë e paepur të regjimit komunist prej “të gënjerëve”. Të dytët duhet t’i nxisë me kujdes që të largohen prej ndikimit të armiqve e mundësisht të kthehen në atdhe: “Mos harro se në mes tyre ka të gënjer e të penduar. Ti do t’u zgjasësh dorën dhe do t’i kthesh në shtëpi...” (Jorgaqi, 1982a: 94). Dallimi midis dy kategorive të mërgatës del në pah kur Shqipëria shpall amnistinë për të gjithë të arratisurit që nuk kanë kryer krime ndaj vendit të tyre. Çdo “i gënjer” bie në dilemë prej shansit që po i jepet për t’u kthyer pranë familjes si edhe për faktin që regjimi komunist po i zgjat dorën e pajtimit: “Po ishte krejt i hutuar dhe i çoroditur. Ai i ngjan njeriut që ka ndenjur për një kohë të gjatë në errësirë dhe kur i bie një rreze drite, i

merren mendtë e i vishen sytë, mezi orientohet” (Jorgaqi, 1982b: 166). Në këtë roman një personazh “i gënjyer” është Shpendi. Ai është arratisur pas një grindjeje me sekretarin e këshillit të fshatit. Në kampet e refugjatëve dhe më vonë në Belgjikë nuk përzihet me politikë dhe ka sjellje korrekte. Ai bëhet miku më i mirë i Manushit, aq sa këtij i vjen keq që nuk mund t’ia tregojë identitetin e vërtetë dhe misionin që po kryhen.

Sipas estetikës marksiste-leniniste, heroit negativ në letërsinë e realizmit socialist duhej të përfaqësonte gjithçka që i kundërvihet revolucionit dhe socializmit. Heroi negativ, pra “i keq”, nuk dilte vetëm prej klasave të përmbysura, por ai gjendej edhe te ajo “kategori njerëzish, të cilët, në etapa të caktuara të zhvillimit, i kundërvihen revolucionit, hyjnë në kontradiktë të hapur me të” (Brahimi, 1975: 126). Heronjtë negativë në realizmin socialist paraqiteshin në rubrikën e të shëmtuarës, ndaj të cilës duhej mbajtur qëndrim kritik, sepse ata i përkisnin botës bashkëkohore kapitalisto-revizioniste, ose klasave të vjetra që kërkojnë përmbysjen e sistemit socialist në Shqipëri. Personazhet përfaqësues të ish-klasave sunduese në Shqipëri detyrimisht duhej të ishin njerëz të zvetënuar shpirtërisht, madje me shije të vjetruara, ngaqë u kishte ngelur sahati në një kohë tashmë të kapërcyer nga zhvillimi historik (Uçi, 1973: 44, 117).

Për qëllimet e analizës sonë, personazhet negative të romaneve e novelave me agjenturë i ndajmë në të huaj dhe vendas. Agjentët e huaj i përkasin spiunazhit të fuqive pushtuese gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe, pas lufte, agjencive perëndimore të spiunazhit dhe të atyre të vendeve fqinje me Shqipërinë. Agjentët e huaj rekrutojnë e stërvitin agjentët shqiptarë të arratisur, edhe nëpërmjet agjencive

të ngritura enkas për refugjatët prej vendeve komuniste, si ishte USEP (United States Escapee Program), e cila në romane del si mbulesë për veprimtari spiunazhi (Jorgaqi, 1982a: 5-12; Gjata, 1984: 153-154). Vatikani me klerin katolik paraqiten si bashkëpunues me agjenturat perëndimore kundër Shqipërisë (Jorgaqi, 1982a: 197; 1982b: 397).

Në krijimet që kemi analizuar në këtë artikull agjentura perëndimore, në bashkëpunim me atë të vendeve fqinje, planifikon që të përmbysë regjimin komunist në Shqipëri dhe të sjellë në krye të vendit marionetat e saj që do ta anulojnë pavarësinë e vendit. Sipas romanit *Ankthi i ditëve të fundit*, sapo Shqipëria çlirohet, agjentura britanike organizon kundërshtarët e komunistëve që kanë mërguar në Greqi. Nëpërmjet tyre synohet që Shqipëria dhe i gjithë Ballkani të jenë sferë e ndikimit britanik. Ja si fantazon gjeneral Hemfri:

Kështu jo vetëm ajo, po tërë Ballkani duhet të jetë nën sferën tonë. Po Shqipëria do të jetë perla më e bukur e kësaj kurore margaritarësh. Do të vendosim atje dhe kolonë çifutë, rreth 200 mijë, që sot enden të persekutuar lart e poshtë udhëve të botës, për të gjetur atdheun e tyre të humbur. Ky atdhe do të jetë Shqipëria (Këlliçi, 1983: 205).

Një karakteristikë e agjentëve të huaj në romanet dhe novelat me agjenturë është vetëbesimi i tepruar te vetja dhe nënvlerësimi ndaj komunistëve shqiptarë dhe Sigurimit, sjellje që i pengon të parandalojnë dështimin e misioneve të tyre. Kur gjeneral Alfieri i shërbimit sekret të vendit fqinj shpreh dyshim se kundërzbulimi shqiptar mund ta ketë zbuluar grupin agjenturor, koloneli Smit i CIA-s i thotë se ai po ia ngre më kot vlerën Sigurimit, sepse shqiptarët janë ende kalamaj në zanatin e punëve të fshehta (Gjata,

1984: 47). Manush Kelmendi, heroi pozitiv i *Mërgatës së qyqeve*, ka rastin t'i tregojë Mis Hendersonit, e cila e kishte "rekrutuar" dikur në kampin e refugjatëve dhe që vite më vonë ka ardhur në Shqipëri e maskuar si turiste, se ai vetë është dëshmia e gjallë se Sigurimi e ka mposhtur agjenturën e huaj (Jorgaqi, 1982b: 468-478).

Romanet *Mërgata e qyqeve* dhe *Ankthi i ditëve të fundit* janë plot me personazhe që përfaqësojnë klasat e pronarëve të tokave, tregtarëve dhe funksionarëve shtetërorë. Ata janë arratisur nga Shqipëria dhe vihen në shërbim të shteteve të huaja me qëllimin që një ditë të fitojnë pozitat e dikurshme. Mërgata politike në Greqi miraton në një mbledhje që Shqipëria të ishte pjesë e një shteti të huaj: "Ata megjithëse do të ishin vasalë të zotërinjve të tyre të ardhshëm, nën vete do të kishin bujkrobër një popull" (Këlliçi, 1983: 83). Mërgata kundërkomuniste në Perëndim ekzistonte sepse kështu e donte interesi i fuqive të huaja: "Vlera e mërgatës rritej e ulej sipas situatave e interesave të padronëve të saj" (Jorgaqi, 1982a: 309).

Edhe politikanët e mërgatës që hiqen si patriotë e flasin për lirinë e popullit prej komunistëve, në realitet e dinë se popullin nuk e kanë me vete dhe se nuk e kanë pasur as

“

Edhe politikanët e mërgatës që hiqen si patriotë e flasin për lirinë e popullit prej komunistëve, në realitet e dinë se popullin nuk e kanë me vete dhe se nuk e kanë pasur as atëherë kur ishin të pushtetshëm.

”

atëherë kur ishin të pushtetshëm. Këtë e pranojnë vetë krerët e Legalitetit në mërgim: “Se, me thanë të drejtën, populli s’na ka ardhë mbrapa athena e jo ma tash kur ne kena hup me të tana e ai asht mëkambë e zgjue për bukuri prej atyne...”; “S’është më ai popull injorant e leckaman që kemi lënë. Armiku im dhe i yti i ka bërë për vete dhe i ka dhënë aq të mira sa të mos ta ketë nevojën ty dhe mua...” (po aty: 81-82, 241-242). Simbolika kombëtare që mbajnë politikanët e mërgatës flet për “patriotizmin” e tyre anakronik: njëri, ish-deputet në kohën e Zogut, mban një kravatë kuqezi me shqiponjë njëkokëshe, kurse një tjetër, ish-kryeministër në kohën e pushtimit gjerman, e mban flamurin ngjitur me një citat arabisht nga Kurani (po aty: 40, 181).

Edhe pse kanë prejardhje të njëjtë klasore dhe urrejtje për regjimin komunist, personazhet armike nuk janë të bashkuar dhe marrëdhëniet e tyre me padronët e huaj dhe me njëri-tjetrin karakterizohen nga egoizmi, shfrytëzimi, mashtrimi dhe shantazhi. Sado që sa për sy e faqe nuk rreshtin përpjekjet për bashkimin e mërgatës, kjo nuk mund të arrihet përderisa mërgata është vënë në shërbim të shërbimeve të huaja sekrete:

Mërgata jonë gjithmonë është lojë e mjerë në duar të huaja. Ne, me dashje ose pa dashje, bëjmë lojën e tyre. Sepse duhet ditur që të gjithë ato forca të huaja që kanë interesa në Shqipërinë e sotme e fillojnë nga ne. Kuptohet, atëherë, pse unë dhe ti nuk e kemi veten në dorë. Ne vërtet jemi shqiptarë, flasim një gjuhë, po ti je lidhur me atë që s’jam lidhur unë e unë s’e njoh atë me të cilin je lidhur ti (po aty: 186).

Për shkak të përçarjes së thellë të pafuqisë në rritje të mërgatës politike, njëri nga eksponentëve të saj bën krahasimin me qyqen: “Jemi bërë të tërë qyqe, qyqe të vjetra. E ç’mund të bëjë qyqja? Qyqja e vjetër as këndon më, as pjell, veç ndjell zi e vdekje...” (po aty: 132). Epilogu i mërgatës është vdekja e saj, dhe këndi i nekrologjive i gazetave të mërgatës e bënte të prekshëm për të gjithë dështimin e pashmangshëm (Jorgaqi, 1982b: 203).

Sido që të ketë qenë hyrja e tyre në rrugën e spiunazhit apo sabotazhit, vjen një kohë kur agjentët vendas janë të detyruar ta vazhdojnë nga frika e demaskimit. “Vullnetarët” që dalin nga mërgata për t’u stërvitur si diversantë që do të parashutohen në Shqipëri, në realitet janë shtrënguar për ta bërë një gjë të tillë, përndryshe do të dërgohen si ushtarë në Vietnam apo Afrikë: “Tani zgjidhni se ku doni t’i lini kockat!” (po aty: 270). Të tjerë “vullnetarë” nxiten nga krerët e mërgatës. Një nga ata, që është plagosur keq nga rënia me parashutë gjatë stërvitjes, tashmë është penduar dhe i shfryhet Manush Kelmendit:

Se ti dhe shokët e tu na shitët. Na shitët për një copë bukë shpirtin dhe fuqitë e trupit... Ju thoni se paska nevojë për ne populli shqiptar. Paska nevojë që ne të mbledhim në trupin tonë vdekjen dhe një ditë të shkojmë të zbrazemi në mes tij... (po aty: 401).

Siç shihet, disa nga personazhet negativë përjetojnë brejtje të ndërgjegjes dhe kanë dilema për rrugën që kanë zgjedhur, ndryshe prej heronjve të Sigurimit, të cilët nuk dyshojnë asnjëherë në drejtësinë, moralin dhe legjitimitetin e punës së tyre.

Skena të jetës borgjeze

Përmes romaneve me agjenturë të realizmit socialist, lexuesve shqiptarë të izoluar në një masë të madhe nga kontakti me botën jashtë shtetit, u jepeshin skena të jetës në shtetet kapitaliste, të para me syrin e zbuluesit. Ideja ishte që të tregohej jeta e mjeruar e emigracionit politik në Perëndim në kontrast me “lulëzimin” e shoqërisë socialiste në atdhe, degradimi moral i emigracionit politik në kontrast me “njeriun e ri” socialist dhe se pas fasadës së shkëlqyer të vendeve kapitaliste fshihej shfrytëzimi klasor. Skena e parë është kampi i refugjatëve politikë. Kampet e përshkruar në romanet *Mërgata e qyqeve* dhe *Armiqtë* administrohen nga USEP, një organizatë kishtarë bamirëse, që, sipas autorëve të romaneve, shërben si maskim për shërbimet sekrete për të rekrutuar të arratisur nga shtetet komuniste. Funksonimin e kampit Lavoro te romani *Armiqtë* e përmbledh togër Andoni, oficeri që drejtonte sigurinë:

Këta nëpunës [të USEP-it], nën maskën e ndihmës për të arratisurit dhe të shpirtmadhësisë hyjnore, zgjidhnin emigrantë, i rekrutonin, i mësonin nëpër kurse dhe pastaj i dërgonin si diversantë dhe spiunë në Shqipëri e në vendet e tjera ish-socialiste. Ata që nuk ishin të aftë për këtë punë i nisnin nëpër minierat e botës. Të tjerët, zakonisht pleqtë e të sëmurët, i mbanin në kamp, pa treguar ndonjë kujdes të veçantë as për shëndetin e tyre, as për nevojat e tyre të vogla të domosdoshme. Të vdekurit i varrosnin prapa murit të kampit, të krisurit i dërgonin në çmendinë, ata që thyenin disiplinën i fushonin në burg, ndonjë e shisnin si bagëtitë të fermerët e pasur, ndonjë tjetër, mendimet e të cilit i kishin blerë informatorët, e internonin në ishuj të pabanuar (Gjata, 1984: 153-154).

Mërgimtarët trajtohen pa subjektivitet, thjesht si trupa për t'u përdorur në Luftën e Ftohtë ose në punë të rënda. Si për të treguar se mërgimtarët në dhe të huaj nuk gjejnë as varr pas vdekjes, në romanin *Mërgata e qyqeve* shënohet se pranë kampit të Llazirës në Greqi, USEP-i ka blerë një copë tokë për varrosjen e mërgimtarëve, por për mungesë vendi trupat qëndronin atje vetëm për pesë vjet. Që të ruhej varri për më shumë se kaq duhet paguar një shumë parash që në gjallje, gjë që është jashtë mundësive për shumicën e mërgimtarëve në kamp (Jorgaqi, 1982a: 8). Refugjatët politikë e dinë se nëse jeta e tyre do të mbyllet në kamp, ata nuk do të kishin prehje as pas vdekjes dhe do të humbasë çdo shenjë e jetëve të tyre në këtë botë, prandaj shumë prej tyre bëjnë çmos për t'u larguar nga kampi, duke u kapur pas premtimeve të udhëheqësve politikë të mërgatës dhe duke spiunuar njëri-tjetrin te përgjegjësit e kampit.

Në kamp një pjesë e mërgatës politike ka krijuar iluzionin se janë subjekte politike të afta për të marrë vendime për të ardhmen e atdheut. Ata janë të ndarë në parti politike, zhvillojnë mbledhje në kafenenë e kampit dhe grinden e përleshën me partitë e tjera, gjithnjë të vëzhguar nga rojet dhe rekrutuesit e shërbimeve sekrete. Në kampin Lavoro ndodhet edhe Emini, kryetari i Legalitetit që nuk ka asnjë anëtar e thotë: "E ç'rëndësi kanë anëtarët. Rëndësi ka... që ne kemi popullin me vete" (Gjata, 1984: 150-151). Në fakt, partitë grinden me njëra-tjetrën se cila i shërben më mirë agjenturave të huaja, duke u ofruar këtyre trupat e refugjatëve politikë, për t'u përdorur si "mish për top" në operacionet e fshehta kundër komunizmit. Mirëpo, kur merret vesh dështimi i grupeve të diversantëve të dërguar në Shqipëri dëshpërimi kaplon kampin dhe besimi te partitë e emigracionit shkërmoqet:

Shumica e tyre bënin një jetë të veçuar, ishin mbyllur në vetvete dhe ishin larguar nga organizatat ku bënin pjesë më parë. Atyre nuk u interesonte më asgjë, i kishte lëshuar zemra dhe mendonin vetëm si e si të iknin sa më parë nga ai kamp e të shkonin për të kërkuar punë në Francë, Belgjikë, në Amerikë, qoftë edhe prapa diellit. Të paktë ishin ata që mbanin akoma shpresë për t'u kthyer në Shqipërinë “e çliruar” (po aty: 312).

Autorët e romaneve me agjenturë përpiqen që të skualifikojnë motivin patriotik prej veprimeve për mërgatës politike, sepse kuptohet se kjo as që nuk mund t'u kalonte ndërmend gjatë regjimit komunist. Mirëpo është trishtuese dhe revoltuese njëkohësisht që edhe pas rënies së komunizmit, romani *Mërgata e qyqeve* botohet pa ndryshime dhe autori i tij pretendon se ai i ka qëndruar kohës, ndërkohë që ai bazohet kryekëput mbi dosjet e Sigurimit (aq sa i është lejuar autorit t'i konsultojë), mbi rrëfimet subjektive të zbuluesve, të cilët nuk mund të tregonin gjëra të tjera veç linjës zyrtare, dhe pa vizituar mjediset e mërgatës politike ku zhvillohen ngjarjet e librit. Nuk ëshë se Nasho Jorgaqi pretendon se libri e tij shënon arritje të veçanta artistike, por ai vlerëson pikërisht funksionin e tij si dëshmues i historisë dhe i psikologjisë kolektive të mërgatës politike të Shqipërisë, të cilën autori në fakt e ka njohur nga larg dhe përmes syzeve të ideologjisë komuniste. Sigurisht që Jorgaqi nuk ka sesi ta mohojë se libri i tij dhe se librat me agjenturë i shërbenin kryekëput propagandës së atij sistemi, siç ishte në fakt detyra e çdo krijimi artistik në atë kohë, atij nuk i kërkohet as që të mohojë krijimin e tij si autor, por atij nuk mund t'i falet anashkalimi i plotë i shtypjes që ushtronte

sistemi komunist mbi popullin, e cila i kishte detyruar disa të arratiseshin dhe pastaj të hidhen në veprime politike për përmbysjen e komunizmit, sikurse ai mund të tregojë tashmë edhe për kalvarin e gjatë të mundimeve që kanë hequr familjarët dhe të afërmit e mërgimtarëve politikë nga regjimi komunist. Në vend të mburrjeve se “vepra sfidoi me sukses kohën e vështirë të tranzicionit, kohën e përmbysjes së një sistemi, idealet e të cilit ishin në themel të veprës” (Jorgaqi, 2003), romani mund të ishte ribotuar me rishikim apo parathënie kritike që evidenton problematikën e kohës kur është shkruar, rolin që ka pasur Sigurimi në mbajtjen në këmbë të totalitarizmit, veprimtarinë e këtij midis mërgatës, si edhe rolin e shkrimtarëve të realizmit socialist në propagandimin e ideologjisë sunduese.

Pas qëndrimit në kampet e refugjatëve, mërgimtarët i pret shfrytëzimi në fabrika dhe miniera, që përbëjnë skenën tjetër të jetës borgjeze në letërsinë me agjenturë. Kontratat e tyre i lidhin autoritetet e kampeve dhe krerët politikë, që i shesin te industrialistët, si xhambazët shesin kuajt. Në fakt, ata punësohen njëlloj si të ishin kafshë pune: rreshtohen dhe përfaqësuesit e fabrikave u vijnë rrotull duke u parë moshën, shëndetin dhe dhëmbët (Jorgaqi, 1982a: 36-37). Edhe pse punojnë në punët më të rënda, statusi i mërgimtarit ua ndalon që të bëjnë greva dhe të kërkojnë të drejtat që kanë punëtorët e tjerë në vendin e punës. Pavarësisht se sa vërtetësi ka në përshkrime të tilla, motivi është i qartë: paraqitja e shfrytëzimit klasor në vendet kapitaliste. Lihet e nënkuptuar se kushtet e punës në Shqipërinë socialiste ishin ku e ku më të mira, kur në të vërtetë konsumi i fuqisë punëtore ishte më i lartë në Shqipëri, për vetë kushtet e punës dhe teknologjinë e vjetruar. Ndërsa kompensimi financiar për punën u ka

lejuar shumë pjesëtarëve të mërgatës që të kalojnë një jetë dinjitoze për vete dhe familjet e tyre në Perëndim, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për pjesën më të madhe të punëtorëve dhe të kooperativistëve në Shqipërinë komuniste. Rënia e regjimit u shoqërua me emigrimin e shumë punëtorëve në Perëndim, të cilët pranonin më mirë “shfrytëzimin” e punës së tyre atje se sa të qëndronin në mes të mjerimit të gjithanshëm të Shqipërisë në vitet 1990.

Politika e mërgatës ndodhte në kafenetë ku ajo mbledhej, që përbëjnë skenën tjetër borgjeze që ndeshim në romanet me agjenturë. Në kafenenë “Kap Nord” (Cap Nord) të Brukselit paraqiten “partitë” e mërgatës, secila në tryezë më vete: agraristët, “kryeministri” Fehmi Dani, Lidhja e Dytë e Prizrenit, Legaliteti, “Blloku Independent” (po aty: 155-158). Grindjet e “partive” në kafene nuk pushojnë asnjëherë, aq sa në disa tubime të mërgatës një polic është gjithnjë i pranishëm për të parandaluar përleshjet fizike. Krerët e mërgatës në secilën tryezë flasin për “politikën e madhe” të botës dhe bëjnë propagandë kundër komunizmit në Shqipëri, që tingëllonte groteske prej përçarjes së mërgatës dhe pafuqisë së saj për të ndryshuar gjendjen në atdhe:

Asnjëherë Shqipëria s’ka parë anarki më të madhe sesa sot. Të gjithë janë njësoj si këmbët e dhisë... Kanë bërë tokën kolektivçe, thuhet se tashti do të kërkojnë të bëjnë edhe gratë... Turp për faqe të zezë!” Ata flisnin e flisnin dhe mua më dukej sikur kanali i ujërave të zeza po zbrazej në sallën tonë... Po në të vërtetë, ato ishin vetëm fjalë çapraze e shfrime plot zemërim e urrejtje të njerëzve të dëshpëruar e të mundur. Mendja e tyre e ngathët dhe e trulllosur nuk ishte në gjendje të bënte më shumë se kaq (po aty: 115).

Në romanet me agjenturë përmenden shkarazi fasadat e ndriçuara të qyteteve perëndimore, ndërsa theksohet mjerimi i lagjeve periferike të punëtorëve, ku jetojnë edhe mërgimtarët politikë shqiptarë. Banesat e këtyre në periferitë e Parisit e të Brukselit janë si mos më keq: të ngushta, të pista, me orendi të vjetra e të shtrembra. Një pjesë e mirë e mërgimtarëve jetojnë të vetmuar, por edhe ata që kanë krijuar familje nuk janë më mirë, sepse fëmijët u kanë marrë rrugë të keqe, rrinë pa punë, nuk e mbajnë veten, konsumojnë narkotikë dhe nuk interesohen për politikën e fatet e atdheut, sepse e mbajnë veten për “qytetarë të botës”, siç përshkruhet në një episod të romanit *Mërgata e qyqeve* (Jorgaqi, 1982b: 108-112). Situatën e mjeruar të mërgatës politike e thekson dëshira që shprehin disa prej personazheve për t’u kthyer në Shqipëri dhe për të jetuar thjesht në ndonjë fshat apo qytezë, mirëpo krimet që kanë bërë kundër popullit shqiptar dhe urrejtja që ata shprehin orë e çast ndaj komunizmit ua ndalojnë kthimin. Nuk mund ta dimë nëse ka pasur të mërguar politikë që e kanë lexuar *Mërgatën e qyqeve* dhe kanë marrë vendimin për t’u kthyer në Shqipërinë komuniste, por ajo që dimë nga kujtimet e disa “të gënjerve” që janë kthyer pas amnistisë është se ata janë parë gjithnjë me dyshim dhe janë përndjekur nga Sigurimi e madje janë dënua më vonë me burg.

Përfundime

Letërsia e realizmit socialist në Shqipëri ofronte një ngjasim (simulim) të socializmit, pra një panoramë idealiste të shoqërisë socialiste, e cila duhej të funksiononte si pjesë

e aparatit ideologjik që legjitimonte totalitarizmin dhe modelonte “njeriun e ri”. Mirëpo, letërsia e realizmit socialist materialin jetësor për ta trajtuar artistikisht duhej ta merrte nga realiteti socialist, të cilit ajo duhej t’i shërbente si udhërrëfyese. Kësisoj, funksionin e saj letërsia e realizmit socialist nuk mund ta kryente pa e shfytëruar realitetin në emër të ideologjisë. Disa nga veprat letrare të analizuar në këtë artikull mbështeten në ngjarje reale të Luftës së Ftohtë, disa madje mund të riprodhojnë besnikërisht të dhëna të marra prej dosjeve sekrete të Sigurimit dhe të Ministrisë së Punës së Brendshme, por ky fakt nuk i bën këto vepra më pak të trilluara se sa ato që janë plotësisht fryt i fantazisë. Ndarja binare midis personazheve pozitivë dhe atyre negativë të veprave me agjenturë ishte karakteristikë më e gjerë e realizmit socialist në Shqipëri. Gjithsesi, te romanet me agjenturë ndarja në “të mirë” dhe “të këqij” (si edhe kategoria e përkohshme e “të gënjyerve”, që në fund shkrihej te ajo e “të mirëve) synonte të ishte më e besueshme për sa kohë që i referohej “luftës së heshtur” që Sigurimi zhvillonte kundër “agjentëve”, brenda dhe jashtë shtetit. Romanet me agjenturë, sidomos me anë të përshkrimeve të mërgatës politike në shtetet perëndimore, i shërbenin forcimit të “vigjilencës revolucionare” dhe stimulonin ashpërsimin e luftës së klasave gjatë socializmit.

Personazhet e romaneve me agjenturë të realizmit socialist janë në përgjithësi të një kallëpi dhe lehtësisht të parashikueshëm për sa i përket zbulimit të karakterit dhe të veprimeve të tyre. Zbuluesit e Sigurimit që veprojnë në mesin e mërgatës politike të vendeve perëndimore janë burrërorë dhe me karakter të qëndrueshëm, ndërsa të mërguarit paraqiten të zvetënuar dhe të lëkundur. Pozicionimi i personazheve dhe i rrethit të tyre shoqëror

gjatë Luftës së Dytë Botërore është përcaktues për krahët e kundërt në të cilët ata gjenden më pas: krerët e mërgatës politike janë ish-funksionarë të mbretërisë dhe të qeverive kuislinge. Biografite e tyre janë lënda e parë që përdorin zbuluesit për t'i njohur dhe për t'i manipuluar. Sipas paraqitjes së saj në disa romane të realizmit socialist, mërgata politike e urren popullin shqiptar dhe kërkon që të rikthehet në pushtet për ta nënshtruar dhe shfrytëzuar më keq se më parë. Vlerat e tyre projektohen te e shkuara dhe vetëdija se e shkuara nuk do të përsëritet i dëshpëron e i bën të urrejnë vendin e tyre, popullin, regjimin në fuqi, por edhe padronët e huaj që i (sh)përdorin. Midis mërgatës nuk ka kurrfarë mirëbesimi, krerët e saj konkurrojnë për të marrë pëlqimin dhe paratë e padronëve të huaj, secili prej tyre përpiqet që ta përdorë pa skrupull tjetrin. Përshkrimi i mjediseve ku vepron mërgata politike, kampet e refugjatëve, kafenetë apo lagjet periferike e të zymta të qyteteve industriale, e përforcon idenë se asaj i ka ikur koha dhe se e ka humbur luftën kundër komunizmit. Në krahun tjetër, Sigurimi i Shtetit, “arma më e dashur e Partisë”, organi më i tmerrshëm dhe më i urreyer i diktaturës, shfaqet në këta romane si një institucion që i shërben interesit kombëtar e shoqëror dhe që kurdoherë vepron brenda kuadrit ligjor, pavarësisht se ndeshet me armiq të rrezikshëm. Madje, zbulimi i Sigurimit në shtete të huaja vijon edhe sot të përshkruhet si një pjesë e lavdishme e historisë së tij, pavarësisht se brenda në Shqipëri ai ishte një vegël qorre dhe mizore e regjimit. Mirëpo, pavarësisht se çfarë shkruhet në romane si *Mërgata e qyqeve*, *Armiqtë* dhe *Ankthi i ditëve të fundit*, veprimtaria e zbuluesve në radhët e mërgatës politike nuk dihet nëse solli ndonjë rezultat me

rëndësi për shtetin dhe regjimin, por dihet se ajo është shfrytëzuar më shumë nga aspekti propagandues.

Burimet

- Abcnews.al. (2020) "Agron Tufa: Nasho Jorgaqi, spiun i Sigurimit të Shtetit, me pseudonimin 'Dragoi' (Dokument)", *Abcnews.al*, 27.09.2020. Internet: <https://abcnews.al/agron-tufa-nasho-jorgaqi-spiun-i-sigurimit-te-shtetit-me-pseudonimin-dragoi-dokumenti/> (vizituar më 21.12.2020).
- Brahimi, R. (1975) *Letërsia dhe artet në dritën e Partisë*. Tiranë: Naim Frashëri.
- Gjata, F. (1984 [1966]) *Armiqtë*. Tiranë: Naim Frashëri.
- Jorgaqi, N. (1982a) *Mërgata e qyqeve 1*. Bot. i 2-të. Tiranë: Naim Frashëri.
- Jorgaqi, N. (1982b) *Mërgata e qyqeve 2*. Bot. i 2-të. Tiranë: Naim Frashëri.
- Jorgaqi, N. (2012) *Hire letrare, shpalime historike : Studime, vështrime, ese*. Tiranë: Vllamasi.
- Jorgaqi, N. (2013) "E vërteta e Mërgatës së qyqeve dhe ndihma e Kadri Hazbiut", *Panorama*, 14.01.2013. Internet: <http://www.panorama.com.al/e-verteta-e-mergates-se-qyqeve-dhe-ndihma-e-kadri-hazbiut/> (vizituar më 21.12.2020).
- Këlliçi, S. (1983) *Ankthi i ditëve të fundit*. Tiranë: Naim Frashëri.
- Madhi, R. (1984) *Lufta e klasave në letërsi e arte në vendin tonë (1967-1981)*. Tiranë: 8 Nëntori.
- Uçi, A. (1973) *Estetika, jeta, arti*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Politik.



LEKË TASI

Lekë Tasi u lind më 1929. Studioi violonçel nën drejtimin e pedagogut Walter Caletti, në vitet 1939 - 1943, më pas me Ymer Skënderin, në Liceun Artistik në vitet 1949-1952. Punoi çelist i parë në Orkestrën e Radios dhe të Teatrit të Operës ku u pushua për motive politike në vitin 1967. I ati Koço Tasi, avokat me profesion, i njohur në vitet '20, kishte qenë Anëtar i Parlamentit të Parë Shqiptar pas Kongresit të Lushnjës. Pas Revolucionit të qershorit, emigroi për 17 vjet në Greqi. Xhaxhai Akile Tasi, me karrierë të ngjeshur politike në kohën e luftës. Vdiq në burgjet e diktaturës. Leka u pushua nga puna dhe u dërgua me punë të detyruar, pak më vonë u internua familjarisht në Grabjan të Lushnjës, 1975-1990. Jetën e kësaj periudhe e ka rrëfyer në librin autobiografik *“Grabjani rrëzë kodrave”*, Tiranë, 2009. Aktiviteti i tij kryesor është piktura. Megjithëse autodidakt, ka punuar seriozisht qysh herët duke kopjuar sipas natyrës dhe duke mësuar nga mjeshtrit e mëdhenj. Me kthimin e tij, pas internimit, në Tiranë më 1990, ai rifillon të pikturojë dhe ka ekspozuar në vitet 1992, 2003, 2007, në Galerinë Kombëtare të Arteve; një ekspozitë personale në Pejë, “Galeria Exit”, 2005, si dhe disa ekspozita kolektive në Tiranë dhe Durrës.

EMIGRACIONI 1944-1990: PËR NJË KTHIM

TEK E VËRTETA FAKTIKE NË KURRIKULAT

E SHKOLLËS

Abstrakt

Si përherë në historinë tonë, idetë dhe nismat pozitive na kanë ardhur së jashtmi, nga emigracioni ynë që punonte, shkollohej dhe aktivizohej në vende të lira, sepse e ndiente ndrydhëse mungesën e hapësirës në vend. Dhe shumë edhe ktheheshin për të punuar e për të luftuar. Emigracioni ka tri momente: fillimin e shekullit XX, arratisjet gjatë regjimit enverist dhe atë mbas viteve 1990. Emigracioni i dytë, që përbën temën e konferencës (1944), karakterizohet kryesisht nga vendosmëria e mjaft të rinjve për të përmbysur diktaturën e imponuar me terror dhe për këtë qëllim u kthyen të organizuar nga aleatët, me armë në dorë, në vitet 1949-1954 dhe u flijuan. Sakrificat e tyre mbetet motiv

krenarie, sepse ata kërkuan në fakt rihyrjen e Shqipërisë në radhën e vendeve që do të përfitonin nga fitorja e fuqive perëndimore. Mbi këtë bazë duhet vlerësuar periudha e gjysmës së dytë të shekullit XX në Shqipëri: të krahasohen kontributet e regjimit nga njëra anë dhe të kundërshtarëve të tij, sot kur ky kthim në radhën e kombeve europiane është bërë realitet së paku pjesërisht dhe shpresohet për plotësisht. Pretendimet se fitorja e komunistëve në vitin 1944 e bëri të mundur ditën e sotme janë thjesht iluzione të atyre që kanë folur tërë jetën pikërisht kundër kësaj perspektive dhe madje kanë vepruar përditë me punë “shkencore” dhe propagandistike. Krenaria e krahut “reaksonar” bëhet edhe më e merituar kur kujton ata që rezistuan edhe mbas, siç janë luftëtarët nëpër male, derisa u vranë o morën arratinë ose mbaruan nëpër burgje, si dhe intelektualët që mbajtën dinjitetin, por edhe juristët që i mbrojtën ata patriotë kundër ilegalitetit të hapur duke e paguar kurajën e tyre civile me një fund të tmerrshëm nën tortura. Ajo kategori personash përbëjnë realisht thelbin e historisë sonë. Sepse, si kudo, vendin e nderit e zë pjesa që i qëndron besnike lirisë, madje heroikisht, dhe nuk i nënshtrohet shtypësit. Detyra e historisë tash e tutje është të bëjë bilancin e ballafaqimit që ndodhi, me hollësi dhe në planin individual.

Hyrje

Përherë idetë dhe nismat pozitive na kanë ardhur së jashtmi, si ndikim rinovues i botës tek emigrantët, që përmes letrave në familje, librave e gazetave të botuara atje

dhe të shpërndara në atdhe, aksionit lobues në qeveritë dhe opinionin e vendeve ku jetonin promovonte fatin e Shqipërisë. Por vendimtar ka qenë veprimi i tyre në atdhe kur ktheheshin për të punuar e luftuar në vend. Këtu përvoja e fituar përzihej me kërkesat familjare e krahinore të veprimtarëve. Idetë më të avancuara, duke hasur në mjedis të prapambetur, kanë çuar shumë nismëtarë të shquar në humbje, edhe kur ato ishin të realizueshme dhe të dëshiruara nga populli. Kanë fituar përkundrazi grupet që manovronin me ndihmën dhe organizmin e huaj duke instaluar diktaturën. Kësisoj vëmë re një vijë demarkacioni konstante mes mbajtësve të pushtetit, me regjime autoritariste madje të dhunshme, dhe opozitarëve të tyre, prurës idesh të përparuara që zbatohen me frymë debati e koncesionesh nga dy anët, pra me qarkullim të pushtetit sipas modeleve që kishin njohur dhe për të cilat ndiheshin të aftë. Të *fortët* e kanë mbajtur gjendjen larg reformave qytetëruese, duke përdorur dorë të hekurt dhe pa pyetur për viktima, kurse opozitarët e tyre njihen si elitë intelektuale me kontribute personale në kulturë, po edhe si viktima të dhunës së të parëve. Kjo ndarje e klasës politike karakterizon tërë shekullin e parë të shtetit tonë 1912-2012, me kulm regjimin e E. Hoxhës nga 1945 deri 1990, me një bilanc dhjetëra mijërash pushkatimesh e burgim-internimesh.

SHKAQET: Duke i munguar Shqipërisë ekonomia dhe kultura moderne (shkollat, bankat, industria, rrugët) të cilat nxjerrin natyrshëm një klasë politike të mirëfilltë, pra jo vetëm individë apo familje të izoluara me nivel, faktori që duhet hulumtuar mbetet vetë politikani si njeri, të dhënat e tij familjare (origjina e tij, feudale, borgjeze, patriarkale apo

tregtaro-intelektuale) dhe sigurisht ato personale (serioz e me karakter, apo e kundërta, të provuara këto me të kaluarën e tij). Kjo e fundit merr rëndësi ngaqë rrallë tek ne ndodh ndërrimi i pushtetit pa dorën e huaj si faktor përcaktues. Kështu që, para se BE-ja të na bëhej ndihmëse dashamirëse dhe garantuese, politikani për të marrë frenat e qeverisjes, do të lëshonte pe fuqisë së huaj që shqetësohej për interesat e veta mbi të gjitha. Kjo praktikë përjashtonte kategorinë e intelektualëve patriotë, të cilët falë formimit dhe karakterit lëshonin shumë më pak nga ai i kredhuri në traditën orientale, ku çdo akt kërkonte kundërvleftën... Tejpërtej shekullit të parë si shtet, i mandatuari nga regjimi i kaluar, dhe njëherazi i pëlqyer nga bota, ose dhe i “zgjedhuri”, ka qenë mjaft i parashikueshëm, kurse i ardhuri nga vullneti i asaj elite që e quajtëm intelektuale e nacionaliste duke mos ceduar fort, do të binte viktimë e pasardhësit që priste radhën tek antikamera e të huajit, i gatshëm të përmbushte interesat e atij të huaji. Fuqitë e mëdha rregulluese të ekuilibrave evropiane, e mbanin Shqipërinë dhe në një farë mase e mbajnë akoma në status observacioni, deri sa të zgjidhen probleme afatgjata të rajonit e më tej.

Tre janë momentet e emigracionit masiv shqiptar: fillimi i shekullit XX, arratisjet gjatë regjimit enverist, dhe vitet 1990.

Emigracioni i dytë që e kemi si temë karakterizohet nga vendosmëria e disa qindra personash, të rinj e burra nacionalistë që, të stërvitur nga aleatët zbarkuan ose u infiltruan ose u hodhën me parashutë me detyrë informimi e me qëllim final përmbysjen e regjimit të Enver Hoxhës, fillimisht në vitet 1949-1954, dhe pastaj në grupe ose individë

të mbetur në male. Publiku ynë i rëndomtë vazhdon të ketë edhe sot një imazh negativ për këtë kategori tragjike për shkak të filmave të prodhuara në kohën e regjimit, të cilat i portretizonin si të egër e të rrezikshëm, kurse popullsinë si bashkëpunuese me Sigurimin. (Po dalin fakte që e përmbysin këtë pozicion). Ato filma ose drama vazhdojnë të shfaqen me pretekstin e vlerës artistike të tyre, megjithëse ende nuk ekziston dhe as nuk inkurajohet prodhimi i filmave me të dhëna reale të asaj periudhe. Kjo njëanësi vjen nga ndërrimi i butë i sistemit në 1991, me kushtin e vendosur nga pushteti dorëzues (d.m.th nga Moska) që kuadri ekzistues të mos prekej për krimet e bëra, kështu që edhe librat e historisë të mos i pasqyronin ato veçse lehtëzi. Nxënësit e studentët e këtyre dekadave mbetën kështu të profilizuar të mos e njohin të kaluarën ashtu siç ka qenë dhe siç ua tregojnë një pjesë e madhe e prindërve...

Sakrificat e diversantëve kur e shohim çështjen në kushtet e tanishmes: Shqipëria vend i anëtar i NATO-s, me ndonjë familje që merr edhe pension nga SHBA pikërisht për ato shërbime kundër komunizmit, të cilat i kanë kushtuar kryefamiljarit të saj jetën në gjyqet e asaj kohe, përbën problem adresimi ideor, që një shtet serioz duhet ta zgjidhë. Duhet të sqarohen zyrtarisht ato luftime, vuajtje e dënime, nëse kanë qenë vetëmbrojtje e ligjshme shtetërore si thonë disa studiues, apo motiv krenarie si rezistencë heroike ndaj një diktature mizore që torturonte gjithë vendin, dhe sipas gjykimit të arritur ashtu të trajtohen edhe në shkolla. Pa një hulumtim dhe vendim ekspertësh, do të vazhdohet të derdhet përçmimi dhe madje përqeshja e publikut mbi këtë kategori shqiptarësh porsia atëherë kur të torturuar rëndë ata shkonin drejt litarit ose tërhiqeshin zvarrë kufomat e tyre nëpër rrugët e qyteteve.

Kryesorja është dokumentimi i fakteve. I plotë, jo i pjesshëm! Për të bërë ndryshimin e nevojshëm kundrejt perceptimit të sotëm (ende të ancoruar në ekzaltimin e LNÇI, me fare pak korrigjime) duhet theksuar si pozitive përpjekja e nacionalistëve të emigruar, pa përjashtuar edhe fërkimet edhe mes tyre, tipar negativ i shqiptarit politik pikërisht në çastin kur kërkohet urgjentisht uniteti. Duke e theksuar me objektivitet dhe disa hollësi domethënëse këtë defekt tradicional tonin, kontribuohet në fitimin e një mendësie të shëndoshë, falë të cilës popujt përparojnë. Historia dhe mënyra se si shkruhet ajo, është një faktor shumë i rëndësishëm që Shqipëria të sigurojë prestigj në botë. Ajo luftë e pabarabartë (sepse vuanin dhe familjet) e në kushte terrori, kishte qëllim në fakt rikthimin e Shqipërisë si aleat i Perëndimit. Kjo përkatësi në Koalicionin Antifashist pohohet si argument sot nga historianët e regjimit të kaluar, thjesht për të rilidhur në kushtet aktuale një fill të këputur përfundimisht nga ana e Enverit në 1946. Aleanca u kthye në armiqësi qysh gjatë luftës madje siç del në vetë dokumentet e LNÇI. Ekzekutimet e komandantëve të luftës, për dyshime spiunimi me aleatët është prova më e qartë se lëvizja partizane ishte ngritur pikërisht për të ruajtur avampostin tonë stalinist e titist nga ndikimi perëndimor kur të mbaronte lufta. Literatura aleate, kryesisht britanike që trajton këtë hark kohor e thekson armiqësinë e skajshme antialeate që u shfaq në Shqipëri si një kujdes i PKJ për ta mbajtur besnik E. Hoxhën të vetja e saj, duke i falur postin e liderit absolut, me kusht pikërisht këtë vigjilencë që populli të mos gëzonte fitoren, por të hynte në një izolim, terror e varfëri të skajshme. Përcaktuese për jugosllavët ishte frika se pozicioni gjeografik i Shqipërisë dhe varfëria ekstreme e

vendit do ta çonte cilindo lidërsnip, qoftë komunist, por të ndryshëm nga Enveri, drejt një bashkëpunimi me aleatët me qëllim përfitimi ekonomik, kështu edhe të simpatisë së popullit. (Kjo pistë duhet gjurmuar nga historianët sot: A kishte ndër krerët komunistë nga ata me një pritshmëri kryekëput të ndryshme nga ç'pasoi mbas luftës? Ngjan të kishte; krimet ishin bërë të gjitha më urdhër dhe insistimin e Enverit, eliminimi i tij eventual nga vetë udhëheqja, do ta çlironte ndofta të gjithë Lëvizjen nga përgjegjësia për këto krime të kota, duke i hapur dyert drejt një pavarësie që do t'i shpëtonte dhe ata vetë nga zhdukja. Por masat ishin marrë nga bërthama Jugo-enveriane, kështu që ky variant nuk ndodhi edhe për mungesë eksperience krahasuar me atë të PKJ). Në atë izolim të vendosur me paramendim nga Miladini për ta manovruar Enveri, me anë të një diktature brenda diktaturës, lufta e klasave parim marksist u shndërrua në terror jashtë dhe brenda partisë (me tipar plus hakmarrjen personale ndaj atyre që ia njihnin të kaluarën). Dhe ky plan vetëvrasës për vendin u pranua prej një KQ përherë e më të paralizuar. Kuadrot e luftës u pastruan duke ia lënë vendin thjesht brohoritësve. Kështu praktika staliniste e nisur qysh me Luftën e Spanjës dhe vrasjen e Troçkit, një eliminim së brendshmi i fraksioneve, megjithëse jo e panjohur nga kryesorët, (Mehmet, Nako etj.) u zbatua në kurriz të tyre pa mundur ata të reagojnë. Kështu shpjegohet vargani i gjatë i ekzekutimeve në hierarkinë partiake krahas zhdukjes së elitës ekzistuese, qoftë kundërshtarë, indiferente po edhe simpatizuese. Fushatat e ekzekutimeve e shndërronin komunizmin e nisur me shpresa "... për një botë të re" në tiparet e vrasjeve tinëzisht me njëri-tjetrin, trashëgimi

aziatike, që mendohej e tejkaluar. Në fakt fushatat me dënime të rënda për ndreqjen e gabimeve në kulturë, naftë, ushtri, nuk kishin qëllim të evitonin ndonjë farë dëmi nga ndikimet ose ndërhyrjet e huaja siç paraqiteshin, (i dëmtuar pa kthim ishte i tërë sistemi) por qenë pretekste për të mbajtur në terror dhe njëkohësisht për të depersonalizuar të aftët, që duke pranuar “fajin” përlësisht ta adresonin krizën te vetja e jo të politika e partisë. Me terror të gjithanshëm, detyroheshin ta bënë hapin e nënshtimit, ose më inteligjentët, të tërhiqeshin me kohë në anonimitet. Ekziston brenda kësaj tematike një material i bollshëm për historianët që të hetojnë pulsën e masës, se si dhe kush i rebelohej diktaturës, duke nxjerrë në shesh vlera morale sa herë individit ose grupe shpallnin pavarësinë e tyre. Mes tyre fraksioni partiak në Durrës – i quajtur ‘Grupi i 47-ve’ i shtypur me ekzekutime; letrarët – që kundërshtuan diktatin e KQ qysh me krijimin e LSHA; historianët që nuk miratuan teorinë e Enverit për Haxhi Qamilin; protestat në Konferencën e Tiranës kundra borgjezimit të bllokut, dhe veçanërisht gjyqet e plenumet për ushtrinë. Këto të fundit (pushkatimi i gjeneralëve për gjoja faje antiparti) i ndajshkruhen kinse paranoies së diktatorit, kur në fakt s’ishin tjetër veçse hapa të llogaritura ftohtë, për t’i siguruar vazhdimësi pushteti familjes së vet.

E. Hoxha, pra del kreu që gëzonte monopolin eskluziv të lidhej me qendrat e komunizmit ndërkombëtar kudo ku spostoheshin ato në raport me Tiranën. Kështu, nën një komandim absolutisht vertikal, partizanët marrë në tërësi, nga luftëtarë për një jetë të lirë u bënë dora e armatosur e një grupi që e sundoi vendin, duke i vrarë e burgosur shokët pa akuza reale, në fillim për të krijuar diktatin e

“

Në fakt fushatat me dënime të rënda për ndreqjen e gabimeve në kulturë, naftë, ushtri, nuk kishin qëllim të evitonin ndonjë farë dëmi nga ndikimet ose ndërhyrjet e huaja siç paraqiteshin, (i dëmtuar pa kthim ishte i tërë sistemi) por qenë pretekste për të mbajtur në terror dhe njëkohësisht për të depersonalizuar të aftët, që duke pranuar “fajin” përulësisht ta adresonin krizën te vetja e jo të politika e partisë.

”

me shërbim në Shqipëri si dhe vetë arkivat e Foreign Office më pas pohojnë gabimin e aleatëve në mosmbështetjen e nacionalistëve. Mbi këtë bazë duhet vlerësuar e tërë periudha e gjysmës së dytë të shekullit të 20-të në Shqipëri. E cila po të inkuadrojë krejt shekullin e parë të shtetit shqiptar, gjen shpjegime të diferencuara, nëse do të njihen më thellë kontribuesit si individë. Për shkak të

hekurt, e pastaj me planifikim si armiq të familjes kur ai të mos ishte më, ose si punëtorë pa pagesë për një ekonomi të nisur të mbaruar, dhe duke i mbyllur gojën shoqërisë të pa asnjë perspektivë mbijetese përveç përdhosjes në çdo hap, në zyrë, në punë, në dyqan e deri në burg, ku krijoi modën e ridënimit. Kjo është e vërteta historike që i korrespondon dhe imazhit tonë të mjerë të njohur në botë kur ra komunizmi. E demonstroi këtë mjerim dyndja jonë drejt Perëndimit, mjaft e veçantë në krahasim me atë të popujve të tjerë lindorë...

Burimet perëndimore e përligjin këtë ndarje të pahirtë mes bashkëluftuesish, për aq sa tregojnë raportet e komandës së Mesdheut, deri në fundin e 1944-ës. Oficerët

veçantisë historike shqiptare të përgjithësuar, kemi siç pohuam më lart një ndarje kryesore në vija mjaft të qarta mes qeveritarëve dhe opozitarëve. Ndryshe nga vendet e tjera ballkanike, ku jeta politike paraqet edhe gjasime me atë europiane, me kalime të rregullta të pushtetit nga një qeveri te tjetra, si dhe krijim për bindje të rreshtimeve koherente konservative e liberale, tek ne, qeveritari ka qenë gjithmonë autoritarist i mbështetur në një kulturë patriarkale (taraf), kurse opozitari ka gëzuar përkrahje shumë më të dobët si promovues reformash. Dallimi ka qenë edhe në rrafshin intelektual në favor të këtij të fundit (nacionalist në kuptimin patriot- i shkolluar- me sens civil, ndaj dhe i prirur te parlamentarizmi). Këto cilësime nënkuptojnë nga autoritaristi feudal (me përjashtime - lehtësi në koncesione më të thella fuqive të huaja, dhe më të kursyera për intelektualin nacionalist. Shembull përbëjnë tre-katër diktatorët që numërojmë, të cilët totalizojnë 95% të viteve që jemi shtet.

Kthehemi te pika e fortë e përkrahësve të LNCL, pjesëmarrja me koalicionin antifashist, gjë që e mbështesin jo aq te efektiviteti real i saj (e paqenë siç u shpjegua më lart), por te akuza që kundërshtarët nacionalistë janë bashkëpunorë me rreshtimin nazifashist dhe humbës të LDB. Kjo pikë e historisë mund të gjurmohet, duke e abstraguar nga formalizmi: (ne morëm pjesë në fitore) dhe duke llogaritur se sa përfituam nga nga koalicioni si tërësi, dhe sa përfituam/u dëmtuam nga tre aleatët lindorë, Jugosllavi, BS, Kinë. Rezultatet janë të njohura, por nuk janë evidentuar siç duhet (krahsimisht: në terma ekonomike dhe duke llogaritur edhe perspektivën e përealizuar në se s'do të refuzonim Aleancën më Perëndimin) shkurt si do të ishte fati i Shqipërisë nëse hipotetkisht do të vazhdonte

me sukses lufta dhe rezistenca nacionaliste kundra grupit të infiltruar të PKJ. Atëherë do të kishim një gjykim krejt të kundërt nga ai që vazhdon të bëhet për inerci, d.m.th, duke parë shkëlqimin e një eventualiteti të tillë, do të kritikoheshin nacionalistët, për butësi dhe humbje rastesh, gjë që pajtohet edhe me kritikën që bën vetë historiografia britanike dhe personalitete të rangut, se nuk u veprua drejt me nacionalistët shqiptarë që u lanë pa ndihma.

Natyra e koncesionit faktorit fqinj nga njëri qeveritar te tjetri, në forma të hapura ose të mbuluar, kjo temë është ende në fillim të zbulimit të saj, ose më mirë të themi të publikimit (sepse faktet dihen por fshihen). Ndo nga një ndjeshmëri e vjetëruar që druan koston në prestigjin e vendit, po edhe prej përkatësisë politike së shkruesve. Por, intelektualiteti shtyn drejt transparencës, dhe madje urgjentisht, qoftë për t'u rreshtuar me normën që po adopton historishkruarja në botën e përparuar, tërësisht pa komplekse të tilla, ashtu dhe për të edukuar breza studentësh, studiuesish dhe vetë publikun në pranimin e të vërtetës sado të hidhur, me qëllim amendimi moral të shoqërisë.

Duke përmbledhur, dështimi konstant, njëqindvjeçar, i intelektualëve patriotë në qeverisje, e zgjeron ligjërimin tek një tipar që është përfolur sepse i provuar: paaftësia shqiptare si shoqëri për të formuar shtet. Kjo ka ngritur një frymë pesimiste tek ata që e vuajnë, të cilët prej ligështimit refuzojnë të çmojnë rastet e rezistencës duke i quajtur të parëndësishme. A është vetëm ajo paaftësi shkaktarja e vetme? Apo e ka “ndihmuar” edhe indiferenca apo antipatia e fuqive europiane që kishin në dorë ta ndihmonin shtetin e ri? Paralelisht me largimin e urdhëruar së larti

të oficerëve britanikë në 1944, kemi të shprehur edhe simpatinë e shumë prej tyre ndaj kauzës shqiptare. Madje në dokumentet e dequalifikuar të FO tridhjetë vjet më vonë shihet një gati angazhim pro-shqiptar i Britanisë në të ardhmen, që çuditërisht për pesimistët, doli e u vërtetua në 1999 me luftën e Kosovës.

Sepse qoftë pozicioni i favorshëm gjeopolitik në kushtet e përhershme të rivalitetit perëndimor me Rusinë, bashkuar me një filoshqiptari personalitetesh britanike, europiane dhe amerikane ndaj vetive dhe mundësive të mira të këtij vendi, mund të lozin një rol pozitiv për shanset tona, gjë që ngjan të jetë ende në diskutim. Po si mund të vepohet në këtë drejtim kur rëndon akoma në tekste vizioni i një lufte NCL me vlera të pashlyeshme historike? Për ta hedhur poshtë këtë pozicion duhet bërë transparencë mbi të gjitha ngjarjet, personat, që e kanë sabotuar aleancën. Kjo po ndodh aktualisht në gazeta, me dëshmi gojore të vuajtësve dhe të diversantëve. Nga ana tjetër ekziston teza se një shtet që të ekzistojë ka stuktura mbrojtëse dhe është e ligjshme që ato të përdorin dhunën. Fjala është për Sigurimin. Që këtej rrjedh për mendimin e mbrojtësve të kësaj teze që aleancat, ftohja e tyre dhe miqësitë janë kthesa të politikës, të interesave që ndryshojnë, ndaj duhet viktimat të pranojnë logjikën e historisë dhe të rasenjohe me versionin aktual të historisë deri sa të provohet e kundërta, gjë që mund të vonohet mbasi shumica e opinionit e ka pranuar ashtu. Një ngrirje e tillë s'mund të lëvizë mbasi askush nuk propozon qoftë një referendum ose një sondazh serioz... Argumenti bazë i historiografëve ende me kredi është ky: historia shkruhet sipas dokumenteve. Dhe ja një hollësi që zhvleftëson historinë e bazuar në

dokumente dhe ngre vleftën e informacionit gojor. Nga sa dihej prej kohësh (por nën zë, prandaj duhet sqaruar) ka qenë normë e përcaktuar në Shqipërinë e qeverisur nga Partia, në çdo fushë të rëndësishme të jetës, ligji i miratuar në Kuvend të modifikohet në zbatim dhe madje të përmbysëj thelbi në bazë nga porosia që dërgonte KQ gojazi përmes instruktorëve, të cilët *jepnin vijën*. Çdo kundërshtim i vijës përbënte shkelje të ligjit (!) Gjithkush mund të mbronte veten, por pa shkelur këtë mekanizëm. Episode të zbatimit të këtij lloji ligji (që sanksiononte liri fjale, shtypi, mbledhje dhe zgjedhjeje dhe i bënte faje këto liri në praktikë) dihen: burgime, pushkatime, varje. Po edhe servilizma të skajshme që nuk e shpëtonin nga plumbi, por i kursenin torturat të pandehurit, si edhe një fije shpresë) po edhe me kundërshtime të guximshme (që presin të njihen, d.m.th të kalojnë nga dokument gojor në të shkruar) të cilat rivendosin dinjitetin e elementeve të veçantë pra dhe të shoqërisë në tërësi, duhet të zbulohen me saktësi e të botohen. Te këta individë e grupe, duke përgjithësuar, do të dallojmë fatin e mbrapsht nga njëra anë të patriotëve që udhëhiqen nga ide (përherë humbës, mbasi masa nuk i ndjek, qoftë e shtrënguar ose me dashje), dhe në krahun e kundërt, krerë fisesh në dekadat e para të shtetit, dhe konspiratorë me të huaj në krye në dekadat e mëvonshme, përherë mbështetës të pushtetit dhe kundra ligjit. Këtë profil të dyfishtë e shpjegon përbërja historiko-psikologjike e jona. Dhe sa për rastin që kemi në fjalë, e ilustron trajtimi që iu bë kuislingëve tanë nga perëndimorët, në dallim me cilindo të vendeve të tjera lindore. Shkurt kundërshtarët e komunizmit kanë marrë përsipër përgjegjësi në dukje anti-aleate (në dukje sepse Shqipëria e 14 muajve (Shtator

1943-Nëntor 1944) nuk kishte ushtri dhe krerët e saj ishin nga më të shquarit intelektualë në kuptimin që i dhamë më lart.

Krenaria e krahut “reaksionar” (nacionalistë antikomunistë), e shpërfillur edhe për faj të disa gabimeve që do të shihen më pas, bëhet edhe më e merituar, kur kujton ata që rezistuan edhe mbas, siç janë luftëtarët nëpër male derisa u vranë ose morën arratinë ose mbaruan nëpër burgje, si dhe intelektualët që mbajtën dinjitetin po edhe juristët që i mbrojtën ata patriotë në gjyqe e pa minimum legaliteti, duke e paguar kurajon e tyre civile me një fund të tmerrshëm nën tortura. Kjo kategori personash përbëjnë realisht boshtin e historisë sonë. Sepse, si kudo, vendin e nderit e zë pjesa që i qëndron besnike lirisë, veçanërisht ajo me heroizëm, po dhe ajo që nën trysinë e jetesës së vështirë, duron me dinjitet e nuk i nënshtrohet me lajka shtypjes. Detyra e historisë tash e tutje është të bëjë bilancin e ballafaqimit që ndodhi, me hollësi dhe në planin individual për shkak të rolit që individi i *ndryshëm* ka luajtur në një sfond shoqëror tërësisht të ndrydhur prej nevojave jetike dhe pak a shumë konformist.

Përkundër thënies antihistorike tashmë të vjetëruar në botë se “historinë e shkruajnë fitimtarët”, po fiton mënyra e re, kritike dhe antisubjektiviste që të vërtetat e fshehura të dalin në shesh. Në Shqipëri distanca mes versionit zyrtar dhe fakteve të njohura në popull, por të heshtura është e madhe. Po të merret si bazë kriteri i parashtruar në hyrje, u duhet kushtuar vëmendje e veçantë te grupet e mëposhtëm:

1. Nacionalistët, një kategori e gjerë, që shkon nga:
 - a) kundërshtuesit e përçarjes në tërë territorin gjatë

LDB në mbrojtje të unitetit mes forcave antipushtuese të angazhuara djathtas-majtas BK, NCL në luftë, dhe shkaqeve e rrethanave se si u eliminuan të parët në çast ose më vonë gjatë 45 vite diktaturë. b) Parti që luftuan Italinë por ndienë në një farë momenti rrezikun e madh të PKJ dhe bërthamës të instruktuar prej saj, dhe u detyruan të mbrohen duke braktisur luftën/të mbrojnë status quo-në deri në mbarim të luftës. (Të qiten në dritë sesi Legaliteti provoi ca kohë bashkëpunimin me Frontin NCI dhe padashje i dha kredi Grupit Miladin-Enver, dhe si u shkëput pastaj duke i rezistuar në pozita të disfavorshme. Balli Kombëtar, pse dhe si iu qas karremit të unitetit me pjesëmarrjen në Konferencën e Mukjes, duke i lejuar gjithashtu kohë zhvillimi Grupit në fjalë. E bënë të dy palët për naivitet, se iludoheshin që mund të respektohej identiteti i tyre si në luftë dhe më vonë. Përgjegjësia e tyre duhet të gjykohet nga historiografia me kriterin e përkundërt nga ai i derisotmi: pse i lejuan (dhe jo pse i penguan sadopak) Komunistët të zaptojnë vendin dhe ta qeverisin ashtu si e qeverisën, me rezultat mijëra viktima kryesisht të shquara dhe një ekonomi të rënuar. Muharrem Bajraktari dhe Kryezestë nuk e bartin këtë përgjegjësi, sepse kanë qëndruar tërë kohën në luftë me pushtuesit (fjala është për logjikën e aleatëve fitimtarë, të cilët e pranojnë edhe vetë gabimin e politikës së tyre në Shqipëri gjatë asaj faze).

2. Kundërshtuesit brenda Frontit (që kuptuan vijën përçarëse të PKJ me Enverin agjent) dhe u eliminuan për vetëm qenien e tyre nacionalistë ose marksistë, dhe kryesisht sepse kishin një emër të mirë në popull ose ishin me karakter, pra telash për vijën pro PKJ.

3. Intelektualët në Drejtësi, Ekonomi, Kulturë që kërkuan pavarësi sipas ligjit dhe kundër udhëzimit të fshehtë konspirativ. Këta i përkasin kategorisë së papërfshirë në

politikë, të cilët patën fatin ose detyrimin profesional të merren me punëra ekonomiko-profesionale në sistemin e regjurg fund e majë nga partishmëria (“vëri kazmën interesit të vendit, por zbato porosinë e fshehtë nga lart, pra bindu verbazi”) dhe i qëndruan ndërshmërisë së tyre.

4. Të dërguarit nga Perëndimi për rrezimin e diktaturës. Trima idealistë që vunë në rrezik jetën e tyre duke zbarkuar ose parashutuar për të luftuar diktaturën. Ndër ta kanë qenë edhe shumë që e kishin përjetuar presionin çnjerezor mbi fshatrat, megjithatë zgjodhën ta sfidonin edhe një herë atë. Një hetim i tillë i dokumenteve dhe dëshmime gojore do të sjellin në njohje raste të shumta veprimesh heroike, duke i dhënë jo vetëm historisë material të vërtetë, por edhe ndërgjegjes popullore një kompensim moral që bashkë me luftën aktuale kundra korrupsionit (rezultat indirekt i sistemit të mbrapsht kolektivist që shkaktoi individualizmin më ekstrem) do të luftojë dhe disfatizmin e përhapur që, me të drejtë, shumë e konsiderojnë të qëllimshëm si plan antishqiptar dhe detyrë të dhënë nga i huaji të fortëve të politikës në momentin e këmbimit të pushtetit në vitin 1990.

5. Të dënuarit nga gjyqet për faje të pabëra dhe rezistenca e tyre duke mos hyrë në shërbim të Sigurimit gjatë viteve të tmerrshme të burgut.

6. Punës propagandistike përdhosëse me ririnë dhe me talentet, për t’i thyer moralisht, duke u injektuar një mendësi skllavi.



| MSc. Andrea Llukani

MSc. Andrea Llukani ka lindur në Tiranë, më 18 dhjetor 1966. Studimet e larta i ka përfunduar në Universitetin Kombëtar “Kapodistria” të Athinës. Gjithashtu ka studiuar në Institutin “Gëte” dhe është specializuar në “Pravoslavna Akademia”, të Çekisë. Gjatë viteve 1998-2002, ka qenë pedagog në lëndën e Historisë së Krishtëritimit, ndërsa më 2001-2002 ka qenë drejtor i radios “Ngjallja”. Prej vitit 2003 deri më 2013 ka qenë Përgjegjës i Personelit të Kompanisë “Global Petroleum Albania”. Aktualisht është Përgjegjës i Sektorit të Konservimit të Koleksioneve në “Muzeun Historik Kombëtar”. Prej vitit 2002 është anëtar në International Federation of Journalists dhe më 2006 anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Andrea Llukani ka botuar 50 libra, disa prej tyre i ka përmbledhur në 12 vepra. Gjithashtu ka shkruar artikuj në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit: “Global Challenge”, “Diskutime”, “Studime Muzeologjike”, “Dritëhije”, “Albanon”, “Emanthia” etj. Prej vitesh është kryeredaktor i gazetës dygjuhëshe shqip-italisht “Rrënjët”, “Le Radici”. Gjithashtu është anëtar i redaksisë së revistave shkencore “Studime Muzeologjike” dhe “Dritëhije”, si edhe koordinatori i revistës letrare – kulturore “Pelegrin”.

Andrea Llukani është kryeredaktor i gazetës dygjuhëshe shqip-italisht “Rrënjët”.

DITËHIJE MBI VEPRIMTARINË E PESHKOPËVE

ME ORIGJINË SHQIPTARE EVLOGJIO KURILLA

DHE PANDELEJMON KOTOKO

Abstrakt

Kjo kumtesë trajton dritëhijet mbi veprimtarinë e peshkopëve Evllogjio Kurilla dhe Pandelejmon Kotoko, të cilët qenë me origjinë shqiptare (lindur në Korçë), por kishin kombësi greke. Evllogjio Kurilla dhe Pandelejmon Kotoko qenë kandidatët për episkopë për të zgjidhur çështjen e njohjes së autoqefalisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë. Ata qenë anëtarë të përfaqësisë, që u nis për në Konstandinopojë më 28 mars 1937 dhe në prani të përfaqësuesve të Patriarkanës Ekumenike nënshkruan marrëveshjen. Më datën 11 prill 1937 në Kishën e „Trinisë së Shenjtë“ të Halkit u bë dorëzimi në gradën episkopale i Pandelejmonit, dhe po atë ditë në Kishën e „Shën Gjergjit“

në Fanar u dorëzua Evlogjio Kurilla. Pas dorëzimit të tyre, më 12 prill 1937 Patriku Veniamin dhe Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike të Kostandinopojës nëshkruan Tomin Patriarkal të njohjes së Autoqefalisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë. Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë përbëhej nga Kryehirësia e Tij, Kristofori Kryeepiskop i Durrësit, Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë, Agathangjel Çamçe Mitropolit i Beratit, Evllogjio Kurilla Mitropolit i Korçës dhe Pandelejmon Kotoko Mitropolit i Gjirokastrës. Më 29 shtator të vitit 1939, me anën e një shkrese të firmosur nga Xhafer Ypi e njoftonte Kurillën, se duhej të largohej nga Korça, me pretendimin se nuk kishte nënshtetësinë shqiptare. Pasi u largua nga Shqipëria Evllogjio Kurilla u emërua profesor i historisë në Universitetin e Athinës. Emrin e Evllogjio Kurillës mbajnë shumë libra, artikuj, transkriptime, fjalime dhe predikime. Si specialist i paleografisë ai ka transkriptuar shumë kodikë dhe dorëshkrime që gjendeshin në Bibliotekën e Athinës. Në vitin 1942 në një mbledhje të Senatit Akademik të Universitetit të Athinës, Evllogjio Kurillën e akuzuan si nacionalist shqiptar dhe tradhëtar, i cili e kishte kthyer katedrën e historisë së Universitetit të Athinës në një katedër antikombëtare. Pandelejmon Kotoko e mbajti postin e Mitropolitit të Gjirokastrës nga viti 1937 deri në vitin 1941. Pas ripushtimit të Gjirokastrës prej italianëve Kotoko u largua nga Shqipëria me ushtrinë greke. Pasi u vendos në Athinë themeloi Komitetin Qendror për Epirin e Veriut.

Fjalë kyçe: Evllogjio Kurilla Mitropolit i Korçës, Pandelejmon Kotoko Mitropolit i Gjirokastrës, Tomi Patriarkal i njohjes së Autoqefalisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë, Senati Akademik i Universitetit të Athinës, Komiteti Qendror për Epirin e Veriut.

Hyrje

Evlogjio Kurilla (Fig.1) ka lindur në fshatin Ziçisht të Korçës në vitin 1880. Studimet e larta teologjike dhe filozofike në Universitetin e Athinës i ka përfunduar në vitin 1912, ndërsa më 1935 mbrojti doktoraturën me temë „Voskopja dhe Akademia e saj“. Po këtë vit u emërua profesor i historisë në Universitetin e Selanikut. Evlogjio Kurilla ka marrë pjesë në përfaqësinë, e cila u nis për në Kostandinopojë më 28 mars 1937 dhe në prani të përfaqësuesve të Patriarkanës Ekumenike ka nënshkruar marrëveshjen për dhënien e Tomit të Autoqefalisë të Kishës Ortodose të Shqipërisë³¹².

Më 11 prill të vitit 1937 u dorëzua Mitropolit i Korçës në Kishën Patriarkale të „Shën Gjergjit“ në Fanar³¹³. Imzot Kurilla organizoi shkollën katekiste të së dielës, themeloi korin kishtar nën drejtimin e Sotir Kozmosit³¹⁴, mbledhi

³¹² Më 1936 qeveria shqiptare dërgoi në Athinë kryeministrin Koço Kota për të biseduar me përfaqësuesit e Patriarkanës Ekumenike. Pas kësaj në nëntor të vitit 1936 erdhën në Tiranë Pandelejmon Kotoko, Pandeli Evangjeli dhe Vasil Avrami për të biseduar me Kristofor Kisin. U vendos që një delegacion i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë i përbërë nga imzot Kristofori dhe Josif Kedhi të shkonte në Athinë më 20 shkurt 1937 për të biseduar me Mitropolitin e Trapezuntës Krisanthin. Pas bisedimeve në Athinë delegacionit iu shtuan edhe dy kandidatët për episkopë Evlogjio Kurilla dhe Pandelejmon Kotoko. Kështu përfaqësia u nis për në Konstandinopojë më 28 mars 1937 dhe në prani të përfaqësuesve të Patriarkanës Ekumenike nënshkruan marrëveshjen. Kështu më 12 prill 1937 Patriku Veniamin dhe Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike të Kostandinopojës nënshkruan Tomin Patriarkal të njohjes së Autoqefalisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë. Tomi iu dorëzua imzot Kristoforit duke e caktuar atë si Kryepiskop të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Ceremonia e dorëzimit të Tomit u zhvillua në Sallën e Madhe të Patriarkanës, me pjesëmarrjen e Patrikut Ekumenik Veniaminit, anëtarëve të Sinodit të Shenjtë të Patriarkanës, Konsullit të Shqipërisë në Stamboll Asaf Çaçulit etj. Viron Koka, *Përpyekjet për njohjen e Kishës Ortodokse Autoqefale nga Patriarkana (vitet '20-'30), 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 73-74; *Veprimet e fundit Patriarkale dhe Sinodike të Kishës së Kostandinopojës*, Orthodhoksia, Kostandinopojë, viti XII, 1937.

³¹³ -Apostolou Glavina, *H Orthodhoksi Aftoqefali Eklisia tis Alvanias*, Iperesia Dhimosievmaton, Thesaloniki 1998, faqe 105.

³¹⁴ -Kristofor Beduli, *Mbi muzikën dhe koret në kishën tonë ortodokse*, Tempulli, Nr. 11, Korçë 2005, faqe 17.

“

Pasi u largua nga Shqipëria imzot Kurilla u emërua profesor i historisë në Universitetin e Athinës. Emrin e Evllogjio Kurillës mbajnë shumë libra, artikuj, transkriptime, fjalime dhe predikime.

”

materiale folklorike, etnografike etj. Meritë e tij ishte çelja e seminarit „Jovan Banga“³¹⁵ në qytetin e Korçës. Mitropoliti i Korçës, Evllogjio Kurilla bëri shumë përpjekje për zhbllokimin e fondit të filantropit Jovan Banga, i cili qe i bllokuar në Bankën Kombëtare të Greqisë. Pas një sërë gjygjesh në qytetin e Follorinës, u mundësua të lëvrohej vetëm një pjesë e vogël nga fondi që pati lënë filantropi Jovan Banga. Me

gjithë këtë aktivitet produktiv imzot Kurilla nuk u vlerësua, por përkundrazi qeveria shqiptare më 29 shtator të vitit

³¹⁵ -Seminari “Jovan Banga” u çel në Korçë, më 1937. Shuma vjetore që përdorej për të mbajtur gjimnazin ishte 800 lira turke. Drejtor i seminarit ka qenë dr. Vasil Joanidhi. Seminari u çel pas marrëveshjes që bëri Kryesia e Kishës me titullarin e Mitropolisë së Korçës dhe me këshillin administrativ të administrimit të testamentit të filantropit Jovan Banga. Mitropiliti i Korçës me anën e një letre falënderimi i shprehte Jovan Bangës mirënjohjen e thellë të qytetarëve korçarë për këtë gjest human kaq bujar. Për nder të tij gjimnazi i Korçë mori emrin e tij, duke u quajtur gjimnazi “Jovan Banga”. Seminari “Jovan Banga” funksionoi deri në vitin 1941. Më pas u mbyll nga shkaku i luftës. Sipas revistës Predikimi në vitin shkollor 1937-1938 në Seminar studionin 27 nxënës: 7 qenë nga Korça, 6 nga qarku i Korçës, 3 nga Erseka, 4 nga Përmeti, 6 nga Gjirokastra dhe 1 nga Vlora. Spiro Konda jepte lëndët e gjuhës shqipe dhe asaj greke, Dhimitër Mano lëndën Etërit e Shenjtë, Nella Bosa jepte gjuhën frënge etj. Lëndën e muzikës kishtarë e jepnin Paskal Banda dhe Miçua i verbër. Arben Gjata, *Shkollat e Mitropolisë së Shenjtë të Korçës*, Tempulli, Nr. 11, Korçë 2005, faqe 68; Alma Gjermani, *Dhuruesit korçarë të shek. XIX*, Tempulli, Nr. 13, Korçë 2008, faqe 21; Kristofor Beduli, *Shkollat Teologjike-Hieratike*, Neraida, Tiranë 2001, faqe 44-45; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944*, Tiranë, 1992, faqe 32-33; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe Kulturë*, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 2006, faqe 52; Predikimi, Nr.10, Viti V (tetor-nëntor 1938); Dhimitër Taqi Fundo, *Disa shënime dhe kujtime mbi muzikën në Korçë*, Tempulli, Nr. 1, Korçë 2000, faqe 51; Kristofor Beduli, *Mbi muzikën dhe koret në kishën tonë ortodokse*, Tempulli, Nr. 11, Korçë 2005, faqe 16.

1939, me anën e një shkrese të firmosur nga Xhafer Ypi e njoftonte se duhej të largohej nga Korça, me pretendimin se nuk kishte nënshtetësinë shqiptare³¹⁶.

Pasi u largua nga Shqipëria imzot Kurilla u emërua profesor i historisë në Universitetin e Athinës. Emrin e Evllogjio Kurillës mbajnë shumë libra, artikuj, transkriptime, fjalime dhe predikime³¹⁷. Si specialist i paleografisë ai ka transkriptuar shumë kodikë dhe dorëshkrime që gjendeshin në Bibliotekën e Athinës. Ai ishte një njeri i shquar në fushën e letrave dhe të teologjisë. Në një libër të tij, botuar në vitin 1935, Kurilla ka shkruar se Voskopoja është themeluar nga shqiptarët dhe më tej është populluar nga popullsia shqiptare dhe vllahe. Gjithashtu ai theksonte se në Voskopoje u ngjiz ideja e bashkimit shqiptar dhe e shkrimit të gjuhës shqipe. Ky pohim dhe disa të tjera si ky, qenë shkaku që në vitin 1942 në një mbledhje të Senatit Akademik të Universitetit të Athinës, Evllogjio Kurillën e akuzuan si nacionalist shqiptar dhe tradhëtar, i cili e kishte kthyer katedrën e historisë së Universitetit të Athinës në

³¹⁶ -Dion Tushi, *Pjesë monografie për Evllogjio Kurillën*, Tempulli, Nr. 14, Korçë 2009, faqe 75; Apostolou Glavina, *H Orthodoxoksi Aftoqefali Eklisia tis Alvanias*, Iperesia Dhimosievmaton, Thesaloniki 1998, faqe 110; Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë*, Globus R, Tiranë 2006, faqe 210.

³¹⁷ -Kurilla nuk ka botuar në gjuhën shqipe. Vepra e tij në fushën e albanologjisë është botuar në greqisht. Kjo vepër përbëhet nga disiplina të ndryshme të botuara në periodikë ose në libra më vete. Disa nga punët e tij janë: 1-Bibliografia e Epirit dhe Shqipërisë ku citohen mbi 3000 autorë që nga antikiteti deri në fillimet e shek. XX. 2-Korça. Përshkrim i zgjeruar historik i këtij qyteti. Botuar në periodikun Makedhoniko Imerollogjio, Athinë 1909. 3-Origjina e shqiptarëve dhe lidhjeve të tyre me grekët. Botuar në periodikun Foni tis Ipirou me pseudonimin Pellasgos, më 5 nëntor 1910. 4-Fjalë të urta në toskërisht. Tridhjetë fjalë të urta të zonës së Korçës, me përkthim dhe shpjegim në gjuhën greke. 5-Çështja kuçovllahë dhe origjina e shqiptarëve. Botuar në Embros, Athinë 1923. 6-Grigor Argjirokastriti dhe përkthimi në gjuhën shqipe i Dhiatës së re. Studim gjuhësor dhe interpretues. 7-Kisha e Shqipërisë në Iliri. Botuar në periodikun Eklis, Athinë 1934. 8-Shkolla Jeratike e Korçës Seminari Jovan Banka. Botuar në periodikun Drita, Tiranë 1937 etj. Dion Tushi, *Pjesë monografie për Evllogjio Kurillën*, Tempulli, Nr. 14, Korçë 2009, faqe 81-95; Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë*, Globus R, Tiranë 2006, faqe 211.

“

Pandelejmon Kotoko e mbajti postin e Mitropolitit të Gjirokastrës nga viti 1937 deri në vitin 1941. Pas ripushtimit të Gjirokastrës prej italianëve Kotoko u largua nga Shqipëria me ushtrinë greke. Pasi u vendos në Athinë themeloi Komitetin Qendror për Epirin e Veriut.

një katedër antikombëtare³¹⁸. Imzot Evllogjio Kurilla vdiq më 21 prill të vitit 1961 në Athinë. Shërbesa e përmortshme u zhvillua në Mitropolinë e Athinës me pjesëmarrjen e Kryeepiskopit të Greqisë Theoklitit dhe hierarkëve të tjerë. Për jetën dhe veprimtarinë e Mitropolitit të Korçës Evllogjio, foli ish-episkopi i Gjirokastrës Pandelejmon Kotoko.

Pandelejmon Kotoko

”

Pandelejmon Kotoko (Fig.2) ka lindur në Korçë në vitin 1890. Studimet e larta i kreu në

Institutin Teologjik të Halkit në Stamboll, ku u diplomua në vitin 1912. Tema me të cilën mbrojti diplomën ishte „Mësimi i Joan Gojartit për misionin pimantik“³¹⁹. Ndërmjet viteve 1924-1925 në Korçë u botua revista “Zëri i Orthodhoksisë”, e cila ka qenë revista e parë e Kishës Ortodokse. Drejtor dhe kryeredaktor i revistës ka qenë Pandelejmon Kotoko. Nga revista “Zëri i Orthodhoksisë” u botuan vetëm tre numra. Në vitin 1936, Kotoko mbrojti Doktoraturën në Drejtësi, ndërsa më 11 prill 1937 u dorëzua Mitropolit i Gjirokastrës në kishën e

³¹⁸ -Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, Toena, Tiranë 2010, faqe 138-139; Dion Tushi, *Pjesë monografie për Evllogjio Kurillën*, Tempulli, Nr. 14, Korçë 2009, faqe 76.

³¹⁹ -Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10.

„Trinisë së Shenjtë“ të Halkit. Pandelejmon Kotoko e mbajti postin e Mitropolitit të Gjirokastrës nga viti 1937 deri në vitin 1941. Pas ripushtimit të Gjirokastrës prej italianëve Kotoko u largua nga Shqipëria me ushtrinë greke³²⁰. Pasi u vendos në Athinë themeloi Komitetin Qendror për Epirin e Veriut³²¹.

Më 31 mars 1945, Kryeepiskopi Kristofor Kisi³²² u ka dërguar një letër anëtarëve të Sinodit të Shenjtë me Nr. Prot. 176, me anën e së cilës u kërkonte të shfaqnin mendimin e tyre në lidhje me aktivitetin antishqiptar të episkopit të Gjirokastrës, Pandelejmon Kotoko. Ndër të tjera në letër kryetari i Sinodit të Shenjtë, Kisi shkruan se peshkopi dioqezës së Gjirokastrës, Pandelejmon Kotoko *de facto*

³²⁰ -Apostolou Glavina, *H Orthodoxoksi Aftoqefali Eklisia tis Alvanias*, Iperesia Dhimosievmaton, Thesaloniki 1998, faqe 111.

³²¹ -Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 221; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 108; Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë*, Globus R, Tiranë 2006, faqe 204-206.

³²² -Kristofor Kisi (1890-1958) ka lindur në lagjen Kala të Beratit në vitin 1890. Studimet e larta i ndoqi në Shkollën Patriarkale të Halkit ku u diplomua në vitin 1906. Tema që mbrojti diplomën ishte “Mbi prejardhjen e jetës monakale”. Me përfundimin e studimeve teologjike më 1908 u kthye në atdhe dhe filloi punë në gjimnazin e Jovan Bangës në Korçë. Në vitin 1916 u dorëzua në gradën priftërore në Kostandinopojë dhe u caktua kryefamullitar në Makrohor. Më vonë u hirotonis episkop i Sinadës, post të cilin e mbajti deri në vitin 1923. Duke parë përpjekjet e otodoksëve shqiptarë për autoqefali, imzot Kristofori u kthye vullnetarisht në Shqipëri, ku mori në drejtim Mitropolinë e Beratit. Më 21 nëntor 1923 imzot Kristofori së bashku me imzot Jerotheun dorëzuan në gradën episkopale Theofan Nolin në kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Ndërsa në vitin 1929 u tërhoq në manastir duke mos marrë pjesë në veprimet antikanonike që po kryheshin në Kishën Ortodokse Shqiptare. Më 1934 imzot Kristofori zuri vendin e Mitropolitit të Korçës dhe në vitin 1937 u zgjodh Kryetar i Sinodit të Shenjtë dhe Kryeepiskop i gjithë Shqipërisë. Për shumë vjet qëndroi në krye të Kishës Ortodokse në Shqipëri. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodoxke Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i KOASH-it, Tiranë, 1992, faqe 43-44; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 58; Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10; Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimit e tij*, Tiranë 2004, faqe 37-38; *Personalitet madhor i Kishës sonë Ortodokse*, Ngjallja, korrik 1996, faqe 9; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 178-180; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 110-111; Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 261; Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite of the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007, page 261.

është shkarkuar nga detyra dhe është zëvendësuar, por vendim pushimi nuk është marrë dhe shkarkimi i tij nuk është dekretuar për shkak të pengesave, që paraqet statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili të drejtën e pushimit të kryetarit dhe të anëtarëve të Sinodit ia ka rezervuar vetëm kryetarit të shtetit. Për t'i dhënë fund kësaj çështjeje kryetari i Sinodit të Shenjtë, Kisi u drejtohet anëtarëve të sinodit që me anën e shkresave përkatëse të shfaqnin mendimin e tyre³²³.

Sipas Statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, imzot Pandelejmon Kotoko kishte bërë shkelje statutore dhe kanonike sepse kishte braktisur dioqezën e Gjirokastrës. Në letrën e tij, Mitropoliti i Beratit, Vlorës dhe Myzeqesë imzot Visarion Xhuvani (Fig.3) i sugjeron Sinodit të ndjekë procedurat, që përcakton Statuti në lidhje me Gjykatën Shpirtërore, e cila ishte organi kompetent për të gjykuar çështjen e braktisjes së detyrës kishtarë. Pasi të ndiqeshin të gjitha procedurat përkatëse, atëhere Gjykata Shpirtërore do të vendoste pushimin nga detyra të titullarit të Mitropolisë së Gjirokastrës. Për këtë vendim të Gjykatës Shpirtërore Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë lipsej të njoftonte qeverinë shqiptare sepse ajo e kishte të drejtën e miratimit të shkarkimit nga detyra peshkopale të peshkopëve³²⁴.

Më 16 maj 1945 u mbledh Sinodi i Shenjtë i KOASH-it, nën kryesinë e Kryepiskopit Kristofor, Mitropolitit të Korçës dhe zëvendës i përgjithshëm i Dioqezës së Gjirokastrës, imzot Agathangjelit, Mitropolitit të Beratit

³²³ -Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 1.

³²⁴ -Pavli Haxhillazi, *Një letër e panjohur e Visarion Xhuvanit*, Shqiptarja.com, 14 tetor 2012, faqe 20; Pavli Haxhillazi, *Një letër e panjohur e Visarion Xhuvanit*, Le Radici, Anno 10, Nr. 5, Ottobre 2012, pagina 18; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 3-4.

dhe Vlorës, imzot Visarionit dhe Ikonomit të Madh Stavrofor Vasil Marku. Sinodi i Shenjtë në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme shqyrtoi dhe më pas dekretoi pushimin e imzot Kotokos. Ndër çështjet që u diskutuan qenë se në vitin 1940 peshkopi Pantelejmon Kotoko, në atë kohë titullar i Dioqezës së Gjirokastrës është larguar nga Shqipëria pa lejen e Kryetarit të Kishës, duke shkelur kështu artikullin 26 të Statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Pas këtij akti Sinodi i Shenjtë e ka konsideruar të dorëhequr dhe Kryeepiskopi ka emëruar si Zëvendës të Përgjithshëm të Dioqezës së Gjirokastrës peshkopin e Korçës imzot Agathangjelin³²⁵. Gjithashtu ka urdhëruar që të mos përmendet gjatë meshës emri i peshkopit të dorëhequr në kishat e peshkopatës së Gjirokastrës. Përpos faktit se është larguar nga Shqipëria pa lejen e Kryetarit të Kishës, peshkopi Pantelejmon Kotoko duke shtuar fajet e tij kanonike ka pranuar dhe kryesinë e një komisioni, që punon kundra integritetit të vendit³²⁶.

Më 13 qershor 1945 Kryeepiskop Kristofor Kisi i ka dërguar një shkresë me numër protokolli 238, Ministrisë së Drejtësisë, me anën e së cilës i parashtronte për dekretim vendimin e Sinodit të Shenjtë të KOASH-it. Gjithashtu, Ministria e

³²⁵ -Agathangjel Çamçe (1877-1946) ka lindur në qytetin e Korçës më 1877. Në vitin 1913 emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku u shqua si aktivist i lëvizjes kombëtare. Në vitin 1919 u dorëzua në gradën priftërore në Nju Jork, ku shërbeu dy vjet duke celebruar shërbesa fetare në gjuhën shqipe. Në vitin 1921 Atë Agathangjel Çamçe erdhi në Shqipëri dhe një vit më vonë më 1922 mori ofiqin e Arkimandritit. Në muajin shkurt të vitit 1929 u dorëzua Episkop i Beratit, Vlorës dhe Kaninës në Kishën Katedrale të Ungjillëzimit prej imzot Visarionit dhe imzot Viktorit. Në vitin 1941 imzot Agathangjeli u dorëzua Mitropolit i Korçës. Imzot Agathangjel Çamçe ka vdekur në vitin 1946. Dhimitër Beduli, *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944*, botim i KOASH-it, Tiranë 1992, faqe 44; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 58-59; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 108-109; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 6.

³²⁶ -Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 5-6.

Drejtësisë me anën e shkresës që mban numrin e protokollit 794, datë 19 qershor 1945 i përgjigjet se vendimi i Sinodit të Shenjtë është me vend, sepse i përgjigjet misionit të lartë fetar dhe patriotik të institucioneve tona fetare. Kisha Ortodokse me të drejtë nuk mund të toleronte një peshkop, që ka zhvilluar dhe zhvillon veprimtari antikombëtare të vazhdonte të mbante titullin e një dioqeze shqiptare³²⁷. (Fig.4) Kotoko ka vdekur në Athinë më 24 maj 1969.

Bibliografi

- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 1.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 3-4.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 5-6.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 7-8.
- Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.
- Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- Apostolou Glavina, *H Orthodhoksi Aftoqefali Eklisia tis Alvanias*, Iperesia Dhimosievmaton, Thesaloniki 1998.
- Dion Tushi, *Pjesë monografie për Evllogjio Kurillën*, Tempulli, Nr. 14, Korçë 2009, faqe 74.
- Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944*, botim i KOASH-it, Tiranë 1992.
- Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006.
- Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar*

³²⁷ -Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 7-8.

në *Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10.
Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë*, Globus R, Tiranë 2006.
Pavli Haxhillazi, *Një letër e panjohur e Visarion Xhuvanit*,
Shqiptarja.com, 14 tetor 2012, faqe 20.
Pavli Haxhillazi, *Një letër e panjohur e Visarion Xhuvanit*, Le
Radici, Anno 10, Nr. 5, Ottobre 2012, pagina 18.
Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, Toena, Tiranë 2010.
Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar
nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007.
Viron Koka, *Përpjekjet për njohjen e Kishës Ortodokse Autoqefale
nga Patriarkana (vitet '20-'30), 70 vjet të Kishës Ortodokse
Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993,
faqe 74.
*Veprimet e fundit Patriarkale dhe Sinodike të Kishës së
Kostandinopojës*, Orthodhoksia, Kostandinopojë, viti XII, 1937.



| Msc. ark. Elma NDRECA

Msc. Ark. Elma NDRECA ka lindur në Shkodër, më 24 mars 1994. Studimet e larta i ka përfunduar në Universitetin Politeknik të Tiranës, dega arkitekturë. Është specializuar në Stuttgart, në Hohenheim University, në fushën e efiçencës së energjisë dhe të burimeve të rinovueshme dhe në West Attica University të Athinës, për aspekte të projektimit. Në punën e saj si arkitekte është fokusuar në projektimin e ndërtesave rezidenciale dhe të hotelërisë. Prej vitit të kaluar punon për projektimin e objekteve në funksion të strukturave të mbrojtjes dhe të sigurisë.

REFLEKSIONE PËR EKSODIN E 2 KORRIKUT

1990 DHE “RRUGËN E AMBASADAVE”

Abstrakt

Ngjarjet e korrikut të vitit 1990, të njohura si “Ngjarjet e Ambasadave”, akoma edhe pas kaq vitesh, trajtohen përmes miteve dhe enigmave. Duket sikur akoma ekziston një *“heshtje konsensuale”* rreth të vërtetave të plota, ndaj korrikut të ‘90. Një studiues dhe politolog i njohur shqiptar ka shkruar: *“Asnjë aktor politik nuk e citon këtë ngjarje, asnjë zë publik nuk e evokon, asnjë institucion kërkimor nuk e studion, nuk ka asnjë arkiv serioz mbi të dhe nuk janë bërë publike dokumente që disponohen, për më tepër në asnjë rast nuk është bërë inventarizimi i 4795 shqiptarëve, të cilët rrëzuan Murin Shqiptar të Berlinit dhe me aktin e tyre, i paraprinë protestave të dhjetorit 1990.”* Diplomatat perëndimorë, dëshmitarë, protagonistë dhe ndërmjetësues të lidhur me “Ngjarjet e Ambasadave”, janë të gatshëm dhe flasin me pasion për këto ngjarje. Ato nuk ngurrojnë që të shprehin habinë e tyre, se si vetë Tirana, akoma nuk e trajton dhe nuk e nderon

në përmasat e duhura këtë segment të historisë së saj. Dinamika dramatike lidhur me “Ngjarjet e Ambasadave” “zyrtarisht” u mbyll me datën 14 korrik të vitit 1990, atëherë kur qytetarët e ngujuar u “lejuan” të prekin tokën e vendeve perëndimore, ndërsa në Tiranë, në sheshin “Skënderbej”, qytetarët u thirrën në rresht, në “mitingun e turpit” për të damkosur rininë dhe heronjtë e ambasadave, të cilët guxuan të parët, të shembnin muret e ndarjes dhe të izolimit. Ky kontrast i thellë, i cili shpreh në vetvete dramën e madhe të Shqipërisë së kohës, meriton vëmendje për të çmuar të vërtetat e jetuara në Shqipërinë e lodhur nga tranzicioni zhgënjyes. Këto ngjarje historike dhe situata aktuale, inspiruan idenë për të propozuar një muze lidhur me rënien e komunizmit në Shqipëri, në vendin ku sistemi mori goditjen e tij të parë, me “Ngjarjet e Ambasadave”. Zona ku janë ambasadat ka një trashëgimi historike, e cila bazohet në një dinamikë ngjarjesh të dhimbshme. Duke patur parasysh këtë dimension, projekti i propozuar, përpiqet të bashkëkohësojë këtë hapësirë historike, duke e kthyer Ambasadën Gjermane në një muze dhe duke krijuar një seri hapësirash publike e instalacionesh artistike përgjatë Murit të Bllokut të Ambasadave. Pikërisht MURI, si element që në të shkruarën u përdor për të ndarë njerëzit, sot ai do të shërbejë si element përbashkues, duke krijuar hapësira të reja, momente e ngjarje atraktive dhe një frymë të re, në kryeqytetin e shqiptarëve.

Fjale Kyçe: Muri, Muzeu, Komunizmi.



Figura 1. Pushtimi i Ambasadës Gjermane nga qytetarët shqiptarë. Korrik 1990 (Faqja zyrtare e Ambasadës Gjermane)

Në mesnatën e 9 nëntorit të vitit 1989 qindra e mijëra qytetarë nga ish-RDGJ vërsuan drejt Perëndimit. Muri prej 155 kilomerash, i konsideruar përgjatë gjithë kohës së Luftës së Ftohtë si linja e hekurt midis dy botëve të kundërta, u shemb. Kufiri i ndarjes ndërmjet Gjermanisë Lindore dhe asaj Perëndimore, ku tanket e Traktatit të Varshavës dhe NATO-s qëndruan përballë njëri-tjetrit për dekada me radhë, e humbi kuptimin, ashtu si dhe shteti socialist i Gjermanisë Lindore. 11 muaj pas rënies së Murit të Berlinit, Gjermania u ribashkua.

Në kontekstin e këtyre zhvillimeve, shoqëria shqiptare, e cila mbahej e shtypur nën diktaturën komuniste dhe në izolim të plotë ndërkombëtar, filloi lëvizjet e para demokratike. Presioni i brendshëm dhe ndikimi i faktorëve demokratikë në zhvillimet e evropiane, ndikuan për një ritëm më të lartë dhe për një shpejtësi më të shtuar në format e rezistencës antikomuniste të kohës.

Shqiptarët kërkonin me çdo kusht më shumë liri, hapjen e kufijve dhe shembjen e “Mureve Ndarës” me botën demokratike.

Shembja e “Murit të Berlinit” ishte ngjarja më inspiruese për shqiptarët. Disa ngjarje dramatike, në formën e protestave dhe të revoltave antikomuniste u shënuan në fillim të vitit 1990. Pak muaj më pas, më 2 korrik të vitit 1990, një kamion me 36 persona mbi të, shembi murin e pasmë të Ambasadës Gjermane dhe hyri në oborrin e saj. Kjo ngjarje i hapi rrugën shumë personave të tjerë, që vërshuan në oborrin e kësaj ambasade.

Ditët në vijim, përmes murit të shembur, në Ambasadën Gjermane, hynë dhe u strehuan edhe qindra të tjerë. Brenda një jave, numri i shqiptarëve që donin të largoheshin përmes Ambasadës Gjermane arriti në 3199. Qindra të tjerë ishin futur e strehoheshin në Ambasadat e Italisë, Francës e Greqisë. Ata kërkonin largimin nga Shqipëria në shenjë proteste ndaj sistemit totalitar e diktatorial.

Me kalimin e kohës, kushtet e jetesës të personave të futur në këto ambasada u përkeqësuan shumë. Autoritetet shqiptare të kohës ushtruan dhunë e presion për të penguar largimin e refugjatëve nga Shqipëria. Nga ana tjetër, kancelaritë e vendeve perëndimore kishin intensifikuar bisedimet e vështira me qeverinë e Tiranës për të siguruar me çdo kusht lejen e largimit nga Shqipëria për refugjatët e futur në ambasadat e tyre.

Pas këtyre bisedimeve, më 11 korrik 1990, ish-ambasadori gjerman në Tiranë, Werner Daum, komunikoi lajmin e lejës së udhëtimit për refugjatët e futur në ambasadën Gjermane, drejt Perëndimit. Brenda një dite u realizua regjistrimi i të dhënave dhe lëshimi i pasaportave për udhëtimin e tyre jashtë vendit. Natën e 12 korrikut, refugjatët e përfshirë në “Ngjarjet e Ambasadave”, u nisën me autobusë drejt portit të Durrësit. Kolona e autobusëve kalonte përmes kordonit të forcave të rendit. Pas tyre, mijëra qytetarë u jepnin në heshtje lamtumirën të afërmve të tyre...



Figura 2. Numri i qytetarëve shqiptarë që u futën në ambasada në korrik 1990

Eksodi i 2 korrikut të vitit 1990, i lidhur me ngjarjet në “Rrugën e Ambasadave”, pikërisht në vendin ku sistemi mori goditjen e tij të parë, më kanë inspiruar, që të ideoj dhe të propozoj konceptin tim të shëndrrimit të kësaj rruge, si një destinacion atraktiv, muzeal, kombëtar e më gjerë, në nderim të të gjithë atyre, që sakrifikuan dhe kontribuan për rrëzimin e Murin Shqiptar të Berlinit dhe shembjen e Komunizmit në Shqipëri.

Zona ka një trashëgimi, e cila bazohet në një histori të dhimbshme të vendit tonë. Duke pasur parasysh këtë fakt, projekti i propozuar përpiqet të bashkëkohësojë këtë hapësirë historike, duke e kthyer Ambasadën Gjermane, në një muze dhe duke krijuar një seri hapësirash publike dhe instalacionesh artistike përgjatë murit rreth Bllokut të Ambasadës.

Muri, si një element që në të shkuarën përdorej për të ndarë njerëzit sot, do të shërbejë si element për t'i terhequr duke i

bashkuar, duke krijuar hapësira të reja, momente, ngjarje për të përqaftuar qytetin dhe për të sjellë një frymë të re në atë zonë.

Kjo ide është përkthyer në krijimin e dy itinerareve. Një itinerar i jashtëm përgjatë Murit të Bllokut të Ambasadave dhe një itinerar i brendshëm përgjatë rrugës “Skënderbej”, në të dy drejtimet. Në fokus të itinerarit të brendshëm do të jetë Ambasada Gjermane, e cila ka pasur dhe peshën me të madhe historike.

Kjo Ambasadë do të propozohet të kthehet në një muze i cili do të quhet “Muzeu i Rënies së Komunizmit” (MiRK). Ndërsa godina e rezidencës do të kthehet në një qendër kërkimore për kryerjen e studimeve të thelluara, mbështetur në burime dokumentare e arkivore shqiptare dhe të huaja, lidhur me historinë e kësaj periudhe komuniste të vendit. Aktualisht nuk ekziston një qendër e tillë e dedikuar për këtë pjesë të historisë.

Itinerari i jashtëm

Në planin urbanistik propozohet krijimi i një itinerari përgjatë të gjithë murit të jashtëm. Konceptimi i këtij itinerari është vështruar i ndërlidhur me historikun e këtij muri. Përgjatë tij do të vendosen një seri instalacionesh arti dhe do të bëhet trajtimi i hapësirës publike në të gjithë zonën e Murit të Ambasadave, duke theksuar pika të veçanta.

Instalacionet përgjatë **itinerarit të Murit të Ambasadave do të ndahen në 4 pjesë tematike**, si më poshtë:

A. MURI

Tematika e instalacioneve të Zonës A do të titullohet “Muri”. Çfarë është Muri dhe arsyeja e ndërtimit të tij. Për këtë Zonë, instalacini i propozuar do të jetë një strukturë, e cila shkruan fjalën MURI. Ajo do të jetë e vendosur në murin rrethues në pjesën e Ambasadës Kineze. Nëpërmjet këtij elementi, synohet theksimi dhe vënia në pah e rëndësisë së këtij Muri në zonë.



Figura 3. Instalacioni i propozuar

B. EXTRATERRITORIALITETI

Tematika e instalacioneve në Zonën B do të jetë edhe *Extraterritorialiteti*, i cili përkufizon termin territorit të shtetit të tyre brenda një territori të huaj. Instalacioni i propozuar në këtë Zonë do të përbëhet **nga dy kuba xhami në Murin e Ambasadës Gjermane**. Dy kuba xhami të cilët kanë hyrje; një nga rruga “Xhezmi Delli” dhe një nga ana e Ambasadës Gjermane. Ato janë një *simbolikë e fjalës Extraterritorialitet*. Nëpërmjet kutive të xhamit, ato mund të jenë pjesë e një hapësire tjetër jashtë territorit të Ambasadës, por nuk mund të ndërveprojnë me atë.

C. JETA BRENDA DHE JASHTË MURIT TË AMBASADAVE

Tematika e instalacioneve në Zonën C do të jetë “Jeta brenda dhe jashtë Murit”. Nëpërmjet kësaj teme synohet të bëhet një paralelizim i të dy mënyrave të jetesës, edhe pse në të njëjtën hapësirë tërësisht të ndryshme. Në këtë zonë, instalacioni i propozuar do të jetë **një seri pasqyrash akustike të vendosura në murin e Ambasadës Bullgare**. Duke u afruar tek këto pasqyra akustike mund të dëgjosh se çfarë ndodh përreth e përtej Murit.



Figura 4. Koncepti urban i itinerarit të jashtëm

D. GALERIA

Tematika e instalacioneve lidhur me murin në Zonën D, do të jetë në dorë të artistëve. Duke gjykuar edhe nga forma e kësaj zone, propozohet që **ajo të funksionojë si një galeri për artistët**, ku ata mund shprehin perceptimet e tyre për këtë pjesë të historisë nëpërmjet artit.

Itinerari i brendshëm

Itinerari i brendshëm, në qendrën e të cilit është “Muzeu i Rënies së Komunizmit”, do të përshkojë dy anët e rrugës “Skënderbej”. Sipas kësaj qasje, referenca kryesore e itinerarit të brendshëm, do të jenë ambasadat në të cilat kanë hyrë qytetarët shqiptarë si: ambasada kineze, gjermane, greke, franceze, bullgare, hungareze dhe çeke (ose ish-ambasada çekosllavake).




Figura 5. Koncepti urbanistik i itinerarit të brendshëm

Përballë çdo ambasade janë vendosur elementë arkitektonikë dhe artistikë, në përpjekje për të treguar historinë dhe numrin e personave të cilët hynë brenda këtyre ambasadave.

Në qendër të këtij itinerari, fokus kryesor do të ketë Ambasada Gjermane. Ky projekt propozon kthimin e kësaj ambasade në MUZE. Ky muze do t'i dedikohet rënies së komunizmit në Shqipëri. Ndërsa godina e rezidencës do të kthehet në një qendër kërkimore për kryerjen e studimeve të thelluara, mbështetur në burime dokumentare e arkivore shqiptare dhe të huaja, lidhur me historinë e kësaj periudhe komuniste të vendit. Aktualisht nuk ekziston një qendër e tillë e dedikuar për këtë pjesë të historisë.

KULLA, si element KUFIRI, do të ketë edhe funksion VROJTIMI. Pikërisht, vrojtimi si funksion do të reflektojë jo vetëm një cilësi të sistemit të kaluar, i cili nuk lejonte asgjë të



Figura 6. Koncepti arkitektonik i propozuar për Ambasadën Gjermane dhe Rezidencën

“pavrojtuar”, por do të shërbejë edhe atraksion turistik, landmark, për shkak të pozicionit.

Kulla është propozuar që të vendoset mbi gjurmët e Murit të Ambasadës Gjermane. Kjo gjetje, lejon hapësirë të gjerë shikimi mbi të gjithë zonën territoriale të ambasadave.

Në këtë rast, MUZEU ka për synim, jo vetëm aspektin edukativ përmes memories së tij historike, por edhe të shërbejë si vendtakimi preferencial, që tërheq e afron qytetarët ndërmjet tyre.

Një muze shërben për të mësuar dhe për të kujtuar. Ai shënon një përpjekje për të evokuar, kujtuar vitet e trazura të shqiptarëve nën komunizëm. Të dy objektet, godina e Ambasadës Gjermane




Figura 7. Propozim arkitektonik për Muzeun

dhe Rezidenca e saj, janë vitale për turin e edukimit me këtë pjesë të historisë së vendit tonë.

Muzeu fokusohet në ruajtjen e memories kolektive, jo vetëm nëpërmjet ekspozitave, por edhe ruajtës së godinave ekzistuese në të njëjtën gjendje, duke i shoqëruar me ndërhyjë të vogla të brendshme. Vizita e muzeut propozohet të jetë një eksperiencë, jo vetëm në aspektin vizual, por edhe atë emocional.

Duke u fokusuar në pjesën e propozuar të projektit;

- **Kati përdhe i Muzeut përmban funksione kryesore për publikun dhe për akademikët.**
- **Kati i parë dhe kati i dytë i dedikohen tërësisht pjesës së ekspozitave.** Itinerari i ekspozitave fillon në katin e parë.
- **Ekspozitat janë të emërtuara sipas rendit kronologjik të ngjarjeve,** duke nisur nga Familja POPA, e më pas tek revoltat e para, eksodi i shqiptarëve, e deri tek zgjedhjet e para demokratike.

“GUXIMTARËT PARARENDE’S”

Trajtimi i arratisjeve të para: - Në vëmendje familja POPA

Ishte një ditë e zakonshme e atij dhjetori të vitit 1985, kur 6 persona

të moshës nga 35-60 vjeç, të veshur si turistë, kaluan pragun e portës së Ambasadës Italiane në Tiranë. Ishin vëllezër dhe motra, anëtarë të familjes POPA. Babai i tyre ishte pushkatuar nga regjimi komunist, si përkrahës i Zogut. Familjarisht kishin kaluar 20 vite të vështira internimi. Por më në fund, me italishten e tyre të lënë trashëgimi nga babai dhe me sjelljen “alla perëndimore”, ata arritën të braktisin Shqipërinë e izoluar për Perëndimin e lirë.

Një histori simbol, që tregonte egërsinë e diktaturës, **një histori simbol - e para që hapi “udhën” drejt Perëndimit**, edhe pse do të nevojiteshin edhe 5 vite të tjera vuajtjesh, që shqiptarët të vërshonin nëpër dyert e ambasadave të huaja, për të arritur tek “toka e premtuar”.

REVOLTAT E PARA

Protestat dhe revoltat antikomuniste: 14 janar 1990 - 22 mars 1992

Shqiptarët të inspiruar, jo vetëm nga ngjarjet në Evropën Lindore, por edhe nga gjendja tejet e vështirë ekonomike, sociale dhe mungesa e lirive dhe e të drejtave themelore, filluan të kundërshtonin hapur dhe në mënyrë të organizuar regjimin komunist. Ky reagim sfidues antikomunist, u shfaq pas afro 46 vitesh qëndrimi nën diktaturën më të egër në histori. Dalëngadalë kjo lëvizje u shndërrua në një REVOLTË mbarë popullore që synonte vendosjen e një sistemi të ri dhe rendi të ri; politik, ekonomik e shoqëror, të bazuar tek idealet dhe vlerat e Lirisë, Demokracisë, Pluripartizmit dhe Ekonomisë së Tregut.

Ishte e qartë: Fundi i regjimit ishte i pashmangshëm. Në vendet komuniste regjimet totalitare shembeshin dita-ditës. I fundit që u shemb në mënyrë të përgjakshme ishte regjimi rumun i Çausheskut. Radhën e kishte Shqipëria.

TERRORI

Në vitin 1990, vrasjet dhe terrori në kufi nuk u kursyen për të gjithë ata që tentuan kalimin e kufirit për t'u larguar nga Shqipëria e izoluar. Sipas disa të dhënave, mosha e të vrarëve në kufi ishte nga 18 vjeç deri në 32 vjeç. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar mbi 100 të vrarë në kufi, megjithëse në muajin maj të këtij viti, Ramiz Alia kishte firmosur një Dekret, sipas të cilit "arratisja" trajtohej si "kalim i paligjshëm i kufirit" dhe nuk konsiderohej "Tradhti ndaj Atdheut". Fushata më e tmerrshme frikësuese e terrorizuese ishte përdhosja e kufomave të të vrarëve në kufi, duke i "shëtitur" e "demaskuar" rrugëve të Shqipërisë. Kjo metodë tmerruese u aplikua në të katër anët e vendit: nga Shkodra, Tropoja, Saranda, Korça, e kudo tjetër.

HYRJET E PARA NË AMBASADA

Në Tiranë, në vitin 1990 ishin të vendosura **18 përfaqësi diplomatike e konsullore, 4 përfaqësi tregtare, si dhe ekzistonin 5 rezidenca e 4 pallate banimi**. Për sigurinë fizike të tyre vepronte një repart i veçantë i përbërë nga 5 oficerë, 13 nënoficerë dhe 125 policë shërbimi. Ky repart ishte në varësi të Drejtorisë së Punëve të Brendshme të Tiranës. Forcat e sigurisë obligoheshin për të garantuar sigurinë fizike të 17 ambasadave, 2 rezidencave (franceze e çeke), 2 përfaqësive tregtare dhe të një pallati ku banonin kryesisht diplomatë të huaj. Shumica e ambasadave siguroheshin me tre vendroje, disa me nga një, por shërbimi ishte i organizuar non stop, pa ndërprerje kohore.

Përkundër këtyre masave, **më 23 qershor të vitit 1990 u regjistrua ajo që mund të quhet: "Ngjarja e Parë Serioze e Ambasadave"**. Në mbrëmjen e kësaj date, një makinë tip "Liaz", nga ata me karroceri të hapur, e drejtuar nga shoferi Fatos KACELI,

mori përpara furishëm duke e shkallmuar portën kryesore të ambasadës italiane në Tiranë (*sot selia e ambasadës së SHBA-së*). Po atë mbrëmje, një makinë tjetër tip “Saurel” e parkut të ndërtimeve minierave në Tiranë, u fërkua mbi murin e ambasadës.

Në komunikatën e MPB-së nr.154, të datës 2.7.1990, ndër të tjera njoftohet:

“Më datën 1.7.1990 prapa ambasadës së RFGJ-së, makina “Robur” me targë TR 01-928 tentoi të hynte brenda në ambasadë duke ardhur në drejtim të policit të shërbimit me qëllim për ta shtypur. Polici qëllon dy herë me pistoletë. Në këtë kohë mjeti fërkohet në faqe të murit ku 4 – 5 veta dalin sipër kabinës dhe nga karrocera e mbuluar e futen në ambasadë. Mbi mjet gjendet disa njolla gjaku”.

2 korrik 1990

Paraditën e 2 korrikut të vitit 1990 pati një intensifikim të hyrjes forcërisht në territorin e disa ambasadave.

- Në orën 10:30, kanë hyrë 6 persona në ambasadën italiane me një makinë tip “Tatra”, duke thyer murin rrethues dhe kangjellat.

- Në orën 19:00 të kësaj date, 36 persona hyjnë në Ambasadën e Republikës Federale Gjermane me një makinë “Skoda”, të drejtuar nga Ylli Bodinaku, duke çarë murin nga ana e pasme e ambasadës.

- Në orën 21:00, një makinë “Skoda”, e mbushur me njerëz ka hyrë në ambasadën greke duke shpërthyer murin anësor.

Kështu, më 2 korrik 1990, mijëra vetë, pa qenë armiq të vendit të tyre, hynë në disa ambasada perëndimore në kërkim të një jete më të mirë. Tepër diskredituese për një vend që pretendonte të ishte fanar i socializmit të vërtetë! Partia në pushtet, pasi e kapërceu situatën kritike të ditëve të para, bëri një kthesë të fortë prapa duke fajësuar struktura të pushtetit për liberalizëm të tepruar, organizatat e partisë në mbledhje të posaçme

analizuan situatën e krijuar dhe përjashtuan nga radhët e tyre prindër dhe të afërm të të ngjuarve në ambasadat e huaja.

(AQSH, Fondi 14/AP.ou.dosja .3)

“PUSHTIMI” I AMBASADËS GJERMANE

Në muajin qershor të vitit 1990, Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë kishte pak kohë që ishte stabilizuar në rezidencën e re, në “Rrugën e Ambasadave”.

Vetëm pak ditë pasi punonjësit dhe diplomatët e ambasadës u ambientuan në godinën e re, ndodhi diçka që disa muaj më parë do të ishte e papërfytyrueshme: në ditët e para të korrikut, afro 3200 shqiptarë – një për mijë banorë të vendit – vërshuan në oborrin e Ambasadës Gjermane. Shumica prej tyre ishin familje, të rinj, të reja, të cilët ishin të vendosur deri në vetë-sakrifikim që të linin pas Shqipërinë dhe të kërkonin fatin e tyre në Perëndim. *(Kush ka parë filmin artistik italo-shqiptar “Lamerica”, mund të krijojë një përshtypje të përafërt.)*

Një përshkrim më i hollësishëm i ngjarjeve, të cilat morën fund pas dy javëve – kur “okupuesit” u transportuan me autobusë për në Durrës, nga ku, ata vazhduan rrugën me anije në drejtim të Italisë – **gjendet në hyrjen e shkruar nga Werner Daum-i, të librit “Albanien zwischen Kreuz und Halbmond” (“Shqipëria mes kryqit dhe gjysmëhënës”, Muzeu Shtetëror Etnografik, Mynih 1998, f. 34-35).**

EKSODI

Lundrimi drejt Italisë

Natën e 12 korrikut 1990, nga porti i Durrësit u nisën drejt Brindizit në Itali, 3 tragete me rreth 5200 refugjatët e ambasadave. Gjatë

lundrimit drejt Italisë, shërbimi Italian i Kryqit të Kuq u kujdes për trajtimin e refugjatëve, që kishin kaluar gati dy javë të vështira me ushqim minimal dhe kushte aspak normale jetese.

Ankorimi në tokën e premtuar

Tragetet e nisura nga Durrësi, zbarkuan më 13 korrik në portin e Brindizit. Pas zbarkimit misionet humanitare u kujdesën për gjendjen shëndetësore të refugjatëve dhe trajtimin e tyre. Personat përgjegjës nga pala gjermane dhe italiane organizuan ndarjen strikt të kontingjenteve të refugjatëve mes Italisë dhe Gjermanisë. Të gjithë ata që i kishte strehuar Ambasada Italiane duhej të qëndronin në Itali dhe 3200 refugjatët e Ambasadës Gjermane duhej të largoheshin nga Italia drejt Gjermanisë...

- Media në Shqipëri dhe në botë

Media e kontrolluar nga regjimi komunist në Shqipëri u përpoq të transformonte lajmin e vërtetë lidhur me atë çfarë po ndodhte. **Ato realizuan montazhe të ndryshme filmike, sikur ambasadat nuk lejonin qytetarët shqiptarë që të dilnin jashtë, nga territori i ambasadave.** Ndërkohë në median e shkruar, vetëm një poezi i dedikohet kësaj ngjarjeje dramatike.

Në shtypin lokal nuk kishte thujse asnjë informacion rreth asaj se çfarë po ndodhte. Megjithatë qytetarët nëpërmjet stacioneve të huaja të radiove, e stacioneve televizive, italiane, greke, dhe atyre ish-jugosllave, u morën lajme mbi ngjarjet më të fundit. Ngjarja e rënies së Murit të Berlinit pati një influencë shumë të madhe për qytetarët shqiptarë. Pavarësisht censurimit i cili ekzistonte, informacioni arriti të depërtojë.

EPILOG

Më 13 korrik 1990, në sheshin “Skënderbej”, udhëheqja komuniste e Tiranës organizoi një miting, në qendër të të cilit ishte demaskimi i “të ikurve përmes eksodit të ambasadave” dhe frikësimit të familjeve të tyre dhe të popullit të revoltuar. “Të ikurit” u quajtën me shprehjen qarkulluese të udhëheqësit komunist të kohës, “jashtëqitje e kombit”. Paradoksale është që regjimi, pas mitingut, këtë shprehje donte ta vinte në gojën e **Kadaresë**, që ishte në tribunën e mitingut dhe mori fjalën, por që nuk ka pranuar asnjëherë të ketë përdorur një shprehje të tillë. Madje në veprën e tij, “Nga njëri dhjetor në tjetrin”, ai ka shkruar:

“Kur historia do ta zbulojë enigmën e 2 korrikut 1990, ky do të jetë edhe një nga çelësat për të zbërthyer disa nga ngjarjet e pashpjegueshme të historisë tragjike të shqiptarëve në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të”. Dhe shton: “Nganjëherë mendoj: dhëntë zoti të mos jem gjallë gjer atëherë për të mos e marrë vesh kurrë...”

Qëllimi kryesor i mitingut nuk ishin të ikurit, por “frenimi i njerëzve antisocializëm e antipushtet” dhe demonstrimi i forcës, bërja e qartë brenda e jashtë vendit se Shqipëria edhe e vetme do të qëndronte “si kala e socializmit në Evropë”! Organizatori i mitingut, duke iu drejtuar “armiqëve”, do të deklaronte:

“Armiqve tanë u themi njëzëri: Shqipërinë dhe pushtetin popullor nuk e tundin jo më disa njerëz të çoroditur që braktisën kusarisht atdheun, por kushdo qoftë. Ata s’janë Shqipëria, ata s’janë populli.”

(Zëri i Popullit, 14 korrik 1990)

Udhëheqja e lartë “komuniste” jetonte jashtë kohe dhe vazhdonte të ripërtypte citate e slogane enveriste; edhe pse gjatë shtatë muajve të vitit 1990 pati rritje të pakënaqësisë popullore, revolta, protesta popullore me kërkesa për




Figura 8. Trajektorja e vizitorit në Muzeun e propozuar

ndryshime që kulmuan me eksodin masiv të ambasadave.

Ekonomia vazhdonte zhytjen pa kthim në një krizë pa rrugëdalje që s'plotësonte as nevojat për produkte ushqimore të "tallonuara". Kjo situatë e kishte rritur progresivisht zhgënjimin dhe pakënaqësinë masive. Tashmë kishte filluar reagimi qytetar në rrugë e sheshe dhe në forma më të ashpra dhe agresive, paçka se akoma nuk ishte prezantuar ndonjë platformë ideore dhe organizative.

- **Itinerari fillon me ngjytjen e shkallëve në krahun e djathtë, të cilat janë dhe nyja vertikale kryesore e dedikuar për vizitorët.**

- **Më pas ekspozitat vazhdojnë në katin e dytë, të cilat i dedikohen rënies së komunizmit në shtetet e Bllokut Lindor; një**



Figura 9. Instalacion i propozuar i titulluar “Pritja”

vështrim më të gjerë të kësaj periudhe historike; si këto ngjarje ndikuan në vendin tonë - si vendi i fundit ku ra komunizmi.

- **Duke arritur kështu pikën kulmore, turi përfundon në zbritjen nëpërmjet një ashensori në oborrin e brendshëm që të drejton në pjesën e pasme të objektit.**

- Njëkohësisht në oborrin e brendshëm ndodhet dhe një nga instalacionet më të rëndësishme të objektit: **PRITJA**, që është inspiruar nga fotot e atyre ditëve të nxehta korriku në ambasadë.

Edhe pse Muri në pjesën ballore të Ambasadës do të hiqet, nëpërmjet ruajtës së gjurmëve të tij do të jetë i perceptueshëm KUFIRI. Ndërkohë hapësira përreth ambasadës do të jetë publike për qytetarët. Në të, do të ketë një seri instalacionesh të frymëzuara nga historia e kësaj ambasadë si:



Figura 10. Propozim arkitektonik për Muzeun

- **KUBA XHAMI;** - të vendosur në pjesën Lindore të Murit Ambasadës, përfaqësojnë elementë të krijuar nga inspirimi prej përmbajtjes së konceptit të *“EKSTRATERRITORIALITETIT”*, ku qytetarët shqiptarë arritën të “arratiseshim” në një territor të huaj, brenda territorit shqiptar dhe jo duke kaluar piramidat tradicionale në kufijtë tokësore të vendit.

- **RAPORTI;** - një instalacion i vendosur përballë fasadës Jugore të qendrës kërkimore që tregon **raportin e 1200 personave në 500 m²** të territorit të ambasadës gjermane, inspiruar nga imazhe të asaj ngjarjeje, referuar faqes zyrtare të Ambasadës Gjermane.

- **PASAPORTA;** - si element final i vizitës së Muzeut. Është konceptuar një **Kub i Bardhë**, i cili i mundëson çdo vizitori, që në fund të vizitës, të mund të marrë simbolikisht pasaportën për

të dalë, ashtu siç morën pasaportat qytetarët shqiptarë brenda ambasadave për t'u larguar jashtë vendit.

- **PRITJA;** - instalacion i vendosur në oborrin e brendshëm të objektit. Inspirimi për instalacionin vjen nga nga fotot historike të situatës gjatë atyre 14 ditëve në Ambasadën Gjermane. Një **karrige në mes të oborrit** të brendshëm të Ambasadës Gjermane **me këpucë te vjetra e valixhe të drejtuar drejt saj.**


Foto gjatë zhvillimit të konferencës
























Përmbledhje e kumtesave dhe referateve të mbajtura në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore të organizuar nga: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Institutin e Integritit të Ish të Përndjekurve Politikë Muzeun Historik Kombëtar Ministrinë e Punëve të Jashtme



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT